

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
ACADEMIA SCIENTIARUM ET ARTIUM KOSOVIENSIS

STUDIME

Revistë për studime filologjike

23

2016



PRISHTINË
2017

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS
KOSOVA ACADEMY OF SCIENCES AND ARTS

STUDIME
A Review for philological Studies
23
2016

Del një herë në vit.
Published annually.

Këshilli redaktues - Editorial Board

Rexhep Ismajli - Kryeredaktor, editor-in-chief

Eqrem Basha - Sekretar, secretary

Victor A. Friedman, anëtar, member

Teuta Abrashi, anëtar, member

Mehmet Kraja, anëtar, member

Idriz Ajeti, Kryeredaktor nderi - Editor-in-chief of honour

Adresa e Redaksisë / Address:

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës

Redaksia e revistës “Studime”

Rr. Agim Ramadani, nr. 305

10 000 Prishtinë

Republika e Kosovës

Tel. + 381 38 249 303

Fax. + 381 38 244 636

E-mail: ashak@ashak.org

Redaksia e revistës Studime për vitin 2016 njofton se numri 23 i vitit 2016 është bërë gati për shtyp në pjesën e parë të vitit 2017, por për arsye të natyrës së procedurave financiare nuk ka qenë e mundur të botohej në versionin e shtypur deri në fillim të vitit 2018. Meqenëse ndërkohë redaksia për përgatitjen e numrit 24 e më tutje ka përbërje të re, në marrëveshje me Sekretarin e Seksionit vendosëm që versionin elektronik në formatin PDF ta nxjerrim në faqen e ASHAK-ut qysh tash. Kuptohet që versionin e shtypur do të jetë plotësisht i njëjtë me këtë version.

Prishtinë, dhjetor 2017

Redaksia e Studime 23

Copyright © ASHAK

PËRMBAJTJA

Tryeza shkencore ESAD MEKULI NË 100-VJETORIN E LINDJES 7

Sabri HAMITI, ESAD MEKULI: PËR TY	9
Mehmet KRAJA, ESAD MEKULI DHE “JETA E RE”	15
Bashkim KUÇUKU, METAFORË IDENTITETI.....	21
Kujtim M. SHALA, SHKRIMTARÍ E IDEOLOGJI	31
Shaban SINANI, MIGJENI I ESAD MEKULIT	51
Nysret KRASNIQI, ESAD MEKULI: VERBI POETIK SI BURIM SOCIO-IDEOLOGJIK.....	69
Ymer ÇIRAKU, PËRCJELLJA E POEZISË SË ESAD MEKULIT NË KRITIKËN LETRARE - SI KOHERENCË VLERASH	79
Nehas SOPAJ, ESAT MEKULI DHE LETËRSIA SHQIPE E VITEVE '70	85
STUDIME, ARTIKUJ	91
Shkumbin MUNISHI, PIKËPAMJET DHE QËNDRIMET NDAJ SHQIPES TE SERBËT E KOSOVËS	93
Shaban SINANI, ENDONIME DHE EKZONIME PËR SHQIPTARËT DHE FQINJËT	109
Brian D. JOSEPH, UNDERSTANDING GREEK THROUGH ALBANIAN: THE CASE OF <i>PRO(S)PAPPOUS</i>	137
Norbert JOKL, SHQIPTARËT DHE GJUHA E TYRE.....	143
Bajram KOSUMI, ALEGORIA NË LETRAT NGA BURGU: ART APO ENIGMË	161
MATERIALE.....	183


Mehmet HALIMI, VISARE LEKSIKORE NGA E FOLMJA E KARADAKUT	183
Rexhep ISMAJLI, LETËR E GJERGJ PEKMEZIT PËR GJENDJEN NË SHQIPËRI PARA VITIT 1901	203
 KRITIKA, RECENSIONE.....	293
Tomor Plangarica: Remzi Përnaska: <i>Gjuhësi</i>	295
Shkumbin Munishi: Rrahman Paçarizi. Konversioni në gjuhën shqipe..	303

Tryeza shkencore

ESAD MEKULI NË 100-VJETORIN E LINDJES

Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës, Seksioni i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, në 100-vjetorin e lindjes së shkrimtarit, përkthyesit dhe intelektualit të shquar me 6 dhjetor 2016 mbajti një Tryezë shkencore për jetën dhe veprën e poetit. Tryeza u drejtua nga Këshilli organizues i përbërë nga akademikët Ali Aliu, Mehmet Kraja dhe Eqrem Basha.

Në tryezë folën: Ali Aliu, Sabri Hamiti, Bashkim Kuçuku, Kujtim Shala, Shaban Sinani, Mehmet Kraja, Ymer Çiraku, Nysret Krasniqi, Kristaq Jorgo, Fadil Grajçevci dhe Nehas Sopaj. Në këtë numër të revistës *Studime* botohen ndihmesat e pjesëmarrësve që i kanë dorëzuar ato, sipas përgatitjes së Këshillit organizues.



Esad Mekuli

ESAD MEKULI: PËR TY

1. Poeti misionar

Esad Mekuli (Plavë, 1916 – Prishtinë, 1993), poet, përkthyes, redaktor, enciklopedist. Vepra e tij kryesore *Për ty* (1955). Ky shkrim nuk mund t'i shmanget okazionit, meqë bëhet në njëqindvjetorin e Esad Mekulit e në 61 vjetorin e daljes së librit të tij *Për ty*. Dalja nga rasti, që është mëtesë e secilit shkrim për letërsinë, bëhet më e vështirë qëkur Mekuli është quajtur e vetëquajtur moti *poet misionar*. Kjo do të thotë që ai shkruan poezi si *pasion* e poezi si *mision*, poezi okazionale, sidomos poezi me tendencë të theksuar. Çështja është të mos bëhet leximi tendencioz qoftë i letërsisë së shkruar me tendencë, përndryshe kalohet në thjeshtëzime të palejueshme. Udha mbetet kërkimi i bukurisë së shkrim/leximit letrar që rrokë njëkohësisht aventurën e identifikimit letrar e kënaqësinë e leximit të poezisë, duke ndier bukurinë e saj e duke njohur strukturën e saj.

2. Libri *Për ty*

Libri *Për ty* i Esad Mekulit, që doli më 1955 në Prishtinë, u pa menjëherë një ngjarje letrare, madje kulturore. Qe libri i parë poetik i një autori vendës, i autorit që tashmë ishte bërë autoritet, si krijues e veprimtar kulturor; edhe më tepër, u bë libër kult për brezin e mëpastajmë; dhe më e rëndësishmja, mbetu libri themelor i autorit, sado që ky botoi libra të tjerë gjatë katër decenieve të tjera.

Libri përmbledh krijimtarinë poetike të Esad Mekulit të shkruar për dy decenie (rreth 30 poezi) dhe është i strukturuar me një ndërgjegje krijuese, kulturore e historike. Nis me poezinë programore *Popullit tim*, që është një eksplikim i titullit përkushtues *Për ty* të librit. Ka tre cikle: *Në hijen e robnís*, që merr vjershat e shkruara në vitet 1933-1940; *Flamujt e*

shpaluem, që ka vjershat e viteve 1941-1944 dhe *Jeta e re*, që ka vjershat e viteve 1945-1953. Libri përfundon me vjershën *Gjykimi*, porse shoqërohet me shënimin *Lexuesavet*, i domosdoshëm për ndërgjegjien autoriale të këtij strukturimi. Pra, ka një strukturë që artikulon autorin, tekstin e tij letrar dhe lexuesin, në një ndërkomunikim letrar, kulturor, historik dhe ideologjik. Duhet parë këtu një fillim e një fund e, patjetër, një substancë në mes apo në qendër.

Në vjershën e parë, kushtrimore, nëpërmjet formulës kushtuese e posesive: *Popullit tim – unë, biri yt besnik dhe – poeti*, përkufizohet poeti misionar (zë i popullit) e poezia misionare (mjete i dëshirave e vullnetit të tij). Kënga solemne, me tone himni, ngritet në nivel madhështie e të heroikes, duke i vënë përballë dy kohë. Një të shkruar të robërisë: *Këndova (edhe kur m'ishte ndalue)*; e një të lirisë: *me ty këndoj mbi fuqinë e ngjallun*. Ka ndërruar edhe statusi i këngës: herën e parë kënga e vetmuar për zgjimin, herën e dytë këngë e bashkuar për ngadhënjimin. Kështu përkufizohet poeti si prijës dhe ky është misioni i mbaruar. Por, sprova është e madhe. Në vjershën përmbyllëse të librit, *Gjykimi*, shtohet edhe koha e ardhshme; ku hyjnë në lojë *fëmijt tanë e fëmijet e fëmijvet tanë*, breznitë, shekujt. Në një diskutim idesh poetike, në formë sokratike, provohet heroika e brezit, qoftë e kapërcyer nga “belbëzimet”, “shtërzimet”, “gabi-met”, “belbëzimet e abecesë e të gjuhës”...

Pse – kush ka faj që të parët s'na kanë lanë gati kurrgjë – posë vorresh dhe padijes

kush ka faj që shekuj me radhë – errësija dhe vetëmija – si mrazet e pranverës kanë mbytë filizat mû në farë?!

Pikëpyetje, pikëçuditëse. Kështu mbyllet vepra. Kjo tezë është diskutuar edhe më parë. Këtë herë do ta lexojmë si një *metonimi* që fton për një *metaforë*, për një lexim letrar të tekstit të tij të shkruar, sepse, qoftë me imagjinime, mund të lexohet vetëm ajo që është shkruar si fjalë e parme apo si metaforë.

Atëherë poezia më e mirë e Esad Mekulit në këtë libër është në ciklin *Në hijen e robnís*, që përmban vjersha të shkruara në vitet tridhjetë, kur autori ishte i ri, pra shkrimet e tij të rinisë. 1. Për misionin poetik që theksohet me pasion. 2. Për tematikat sociale e individuale, 3. Për lirinë si

absolut të njeriut. 4. Për figurimin e ideve të *ditës* e të *natës* me kapërcimet *mbrëmje* e *agim*. 5. Për alternimet e kohëve *robëri* e *liri* me ndërmjetëzimet e trishtimit, hidhërimit deri në rebelim. 6. Madhështinë e bjeshkës e të njeriut të ngjyer në trishtimin e varfërisë. 7. Për peizazhin lotues të artikuluar me krahasimin e ngjizur në ngushticat e uni-t.

Në ciklin *Flamujt e shpaluem*, në fakt shfaqet shpalimi i fjalës, si dëshmi për imagjinim, kur shenjon, kur thërret, kur kujton apo kur vajton. Në ciklin *Jeta e re* gjuha e vjershës i dorëzohet entuziazmit në kufi të propagandës, edhe kur përpiqet të bëjë hijen e intimizimit e të dashurisë.

3. Vjershat e bukura

Lexuesi kërkon vjershat e bukura. Edhe Esad Mekuli dëshmon vetë që poezia nuk shkruhet vetëm me ide, por edhe me ndjeshmëri e formë të përsosur. Të tilla janë poezitë: *Mbramja*, *Malli për të pambërrijshëmen*, *Unë*, *Rinís*, *Djaloshi*. Një shembull përfaqësues i poezisë së Esad Mekulit është tingëllimi *Mbramja* shkruar më 1933.

MBRAMJA

*Si tufa mëndafshi t'artë në të kaltërtën shamí,
n'mes dy duersh t'bardha, dy kodra nën borë —
flakron perëndimi... Rëtë mbi krye përorë
ngasin nëpër qiell dhe zhduken n'hapsí*

*...Dhe drita e mbrame shuhet mbi çdo sukë:
cipa e natës shtrihet mbi fusha t'përhime,
malet heshtin n'errësi si me qenë të ngrime,
si të humbëte jeta — çdo gjâ u nxi, u zhduk.*

N'ajrí ndihen klithmat e natës që rá —

drujt pranë rrugës lehtas era i përkund...

Ndërsa dita e bardhë, e tretun dikund,

shigjeta të flakta mprehë errësinës me i rá.

Terri sundon botën. Katundet e shtrime

në mes të natës prehen n'luginë me andrrime.

Ky tingëllim është shkruar në trajtën e preferuar të autorit, që duke vizatuar peizazhin shpreh gjendje shpirtërore e sociale. Dramacitetin e shqetësimeve e palon kujdesshëm në djepin e konfesionit intim. Mbrëmja nuk është asfarë idile rustikale, por një shqetësim i mbrendshëm: se mbrëmja është vetëm hyrja në natë, që jep pasiguri e frikë, po edhe ëndërr që pas saj është një shpërthim drite e një ditë. Pamja shihet prej së larti, ashtu duke u humbur e tretur, prandaj një intensitet i madh për të shenjuar figurat e fundit, që nga lartësia duken e vizatohen ose në qiell ose në tokë. Prej këndeje dramaciteti i ndërrimit të pamjeve ndërmjet krahasimeve në nivel të përjashtësisë e të intimitetit: „tufa të mëndafshit t'artë“, “flakëron perëndimi”, “fusha të përhimë”, “male të ngrime”, gjithë sintagma poetike pa retorikë. Pastaj “klithma e natës”, dhe vargu i zbrazët, si figurë e heshtjes totale. E pikërisht këtu shfaqja dramatizuese:

Ndërsa dita e bardhë, e tretun dikund,

shigjeta të flakta mprehë errësinës me i rá

Pas kësaj, mbyllja e poezisë me figurat “terri sundon botën”, apo “Katundet e shtrime ... me andrrime” janë thirrje më të forta si bërtima.

Po ndalemi këtu për të theksuar një çështje poetike e pëртејpoetike të poetit. Esad Mekuli vjershat e para i shkroi e i botoi në gjuhën e huaj, mandej i botoi në gjuhën shqipe. Është shkruar e përkthyer i poezisë së vet. Këtu do kërkuar retorika e tij poetike, inverzionet sintaktike si çështje të përkthimit, fjalori i rrudhur, agramatikaliteti, rima e kërkuar, jospontane. Prandaj, kërkimet stilistike këtu marrin kohë të veçantë se duhet të përimtohen në variantet e poezive në të dy gjuhët.

4. E majta letrare

Vjershat e hershme të Esad Mekulit janë shkruar në vitet tridhjetë të shekullit njëzet dhe janë të krahasueshme me vjershat e vëllait të tij më të madh poetik, Migjenit, që janë shkruar e botuar në të njëjtën deçenie. Ato janë të krahasueshme edhe formalisht si “vargje të lira”, po më tepër tematikisht e për intencën autoriale, tendencën shkrimore. Një kulturë letrare elementare e të dy poetëve është bashkëkohëse me letërsinë sociale të sllavëve të Jugut në vitet tridhjetë. Aq më fort në nivel të ideve e ideologjisë sesa të formave. Te këto letërsi çështja e “të majtës letrare” u zhvillua si teori e shkrimit e si ide shoqërore deri në nivel të grindjes. Çështja ishte e shkrimit si dëshmi e një të tashmeje e si një vizion i një të ardhmeje. E nisur si rebelim letrar për t’u kurorëzuar në shkrim utopik duke kërkuar absolutin e përparimit dhe egalitetin si projeksion shoqëror, i përkthyer në tendence letrare.

Kjo ishte edhe utopia letrare e poetëve tanë, Mekulit e Migjenit. Pastaj vjen distopia. Esad Mekuli e provoi këtë (domosdoshmërisht) kah fundi i jetës. Po kjo është punë përtej veprës *Për ty*.

Kush mund të imagjinojë çfarë do t’ishte distopia e Migjenit mbas “Vargjeve të lira” në një shoqëri totalitare.

5. Fusnota

Në faqen e fundit të librit *Për ty* është një shënim që *Auktori* u drejton *Lexuesave*. Teksti është kaq dëftues e autoreferencial në gjuhë, dëshmi e qëllime, saqë është mirë të jepet i plotë dhe i pakomentuar.

LEXUESAVET

Në këtë përmbledhje kam vû kryesisht vjersha të botueme, shkruar gjatë periodes 1933-1953, kështu që ajo paraqet, pak a shum, njëfarë pasqyrimi të punës sime njëzetvjeçare në lamën e poezisë.

Mjerisht, më e shumta pjesë e vjershave që kam shkruar në periodën e paraluftës dhe asosh gjatë kohës s'okupacionit, kanë humbë. Midis vjershave të tretuna gjindet edhe përmbledhja e përgatitun "Shqiptari të kendou, o Metohi", që paraqitte cakun më të naltë të poezive të mija dhe, për më tepër, ishte një dokument jo i parandësi i kohës së paraluftës në Kosovë e Metohi; disa vjersha të kësaj përmbledhjeje (Të përsektuëm, Qëndro dhe Rrugës) që po botoj, janë gjetë rastësisht midis librave të mija shkollorë t'asaj periode.

Përmbledhjen e kam nda në tre kapituj: para luftës. gjatë pushtimit dhe mbas shpërimit — simbas kohës në të cilën janë shkruar vjershat.

Kapitulli i paraluftës ndahet në tri cikla dhe paraqet, në kuptimin më të gjerë të fjalës, një tanësi nga e cila, ndoshta, mund të kundrohen më së miri rritja dhe pjekuria shkallë-shkallë politike dhe poetike e autorit në kushtet e paraluftës. Këto janë vjersha të shkruara në ditët e zeza të robëris dhe të shfrytëzimit të pashpirt të Shqiptarëve në Jugosllavinë e vjetër, plot dhimbje dhe pezmatim, por edhe plot besim të pathyeshëm në ngadhënjimin e vllaznimit e të barazisë midis njerëzve dhe popujve. Këto vjersha janë shkruar, për shkak që dihen, në sërbište dhe kanë pë dritën - përveç, ciklit të tretë, (pa vjershën "Përshëndetje" që është botuar qysh më 1936 në revistën "Granit" e më vonë ribotuar në fletoren, "Beogradski student" më 1939) - në revistat për të ri në kohën e paraluftës: "Venac", "Jugoslovenski rasvit" (Beograd) dhe "Mladost" (Zagreb); në "Novi behar" (Sarajevo) dhe "Granit" (Podgoricë).

Vjershat tjera të shkruara gjatë okupacionit ose mbas shpërimit janë botuar, më të shumtën, në revistën "Jeta e re".

AUKTORI

ESAD MEKULI DHE “JETA E RE”

Njëra nga çështjet më të harruara dhe të lëna me një anë në studimet tona letrare dhe përgjithësisht në shkrimet tona për letërsinë, është çështja e marrëdhënieve të shkrimtarëve me pushtetin si nocion dhe me pushtetet si formacione politike, në kohë dhe rrethana të caktuara. Studimet tona e kanë lënë me një anë këtë problematikë, ndoshta për shkak se shqyrtimi i këtyre raporteve në njëfarë shkalle i ç’mitizon edhe figurat më të ndritura të historisë dhe të letërsisë sonë, ndërkohë që vetë shkrimtarët tanë të kohëve më të reja, kur flasin për këtë problematikë, dalin disi të zbuluar dhe në një pamje jo shumë të përshtatshme kundrejt qendrave të pushtetit dhe të vendimmarrjes. Raporte joletrare dhe jokrijuese me pushtetet, çfarëdo që kanë qenë ato, kanë pasur të gjithë shkrimtarët tanë, që nga fillimet e letërsisë sonë. Pra, shkrimtarët shqiptarë të secilës periudhë letrare, përveç letërsisë, i kanë shërbyer edhe dikujt tjetër, ndonjëherë një pushteti të tërë, ndonjëherë një qendre të rëndësishme të forcës apo të vendimmarrjes, ose ndonjë personi të vetëm, mbretit, liderit kombëtar, liderit partiak etj. Kjo, në njëfarë mase, bën të ditur se, historikisht, shkrimtarët tanë e kanë vënë letërsinë në shërbim të qëllimeve të tjera dhe se ideali i tyre krijues nuk ka qenë i mjaftueshëm për të përmbushur synimet e tyre jetësore.

Kështu, shkrimtarët tanë të letërsisë së vjetër i kanë shërbyer kishës me tërë qenien e tyre, ndërsa rilindësit zakonisht kanë bërë “jetë të dyfishtë”: në shumicën e rasteve kanë qenë luajalë ndaj sulltanit dhe gjithnjë në kërkim të një meceni që do t’i shpëtonte nga tutoria e tij. Sekush nga rilindësit e gjen shpëtimin te ndonjë forcë tjetër politike, e cila do ta zëvendësonte sulltanin jo vetëm si sundimtar “personal” por edhe kolektiv. Alternativën e tyre arbëreshët e gjejnë te Italia, e cila i financon me bujari projektet e tyre letrare dhe politike. Të tjerët vendosin marrëdhënie alternative: Konica me Austro-Hungarinë, por nuk ngurren t’i ofrojnë shërbime Turqisë, nëse revistën e tij e lejojnë të shpërndahet në territorin e saj, siç

dëshmohet nga një letër e Naimit dhe Samiut drejtuar Murat Toptanin, ndërkohë që vetë Naimi mbante pozitën e censorit në administratën e lartë në Stamboll. Disa nga rilindësit morën ofiqe dhe zunë pozita të rëndësishme në hierarkinë e Perandorisë osmane, të tjerët u lidhën me qendra të tjera të forcës dhe të vendimmarrjes. Ne, në shumicën e rasteve, i kemi përligjur lidhjet e shkrimtarëve tanë me këto qendra të forcës, me pushtetet dhe me regjimet, përveçse në disa raste, kur ato nuk na kanë shkuar shumë për shtat, individualisht por edhe si komunitet letrar dhe kombëtar. Në këtë pikë nuk besoj se kemi qenë gjithnjë parimorë, jo vetëm pse vlimet politike nëpër të cilat kanë kaluar shkrimtarët tanë kanë qenë të ngatërruara dhe qëndrimet e tyre shpesh të paqarta, por duke përdorur formulën e njohur të “interesit të përgjithshëm kombëtar” kemi amnistuar jo vetëm shkrimtarët për hir të veprës së tyre, por shpesh kemi amnistuar edhe veten tonë. Në këtë pikë, në trajtimin e shkrimtarëve tanë, kemi bërë shkelje të rënda etike. Ta zëmë, as në të shkuarën dhe as sot nuk sillemi njësoj si ndaj atyre që kanë mbështetur fashizmin, si ndaj atyre që kanë mbështetur komunizmin, ndonëse jemi krejtësisht të vetëdijshëm se në të dy rastet bëhet fjalë për diktatura antikombëtare dhe letrarisht të refuzueshme nga mendjet e lira.

Ky trajtim jo i drejtë vazhdon edhe në kohën më të re, kur raportet e disa individëve-shkrimtarë me pushtetin përligjen, kurse raportet e disa të tjerëve konsiderohen të papranueshme. Mendoj se sot, nga një pozitë e një lirie më të madhe të varshmërisë së individit nga pushtetet, mund ta themi qartë se të gjithë shkrimtarët tanë, përgjatë gjithë historisë dhe tani, nuk mund të thuhet se kanë pasur raporte dhe marrëdhënie për t’u krenuar me pushtetet, me regjimet, me ideologjitë dhe me prijësit, apo liderët. Në natyrën e shkrimtarëve do të duhej të ishte opozitarizmi, sepse asnjë pushtet, asnjë sistem, asnjë regjim nuk është aq i mirë dhe aq ideal sa të mos mund të bëhet edhe më i mirë. Dhe asnjë lider nuk është dhe nuk ka qenë aq i mirë, sa të bëhet “model krijues” për një shkrimtar. Të gjitha ideologjitë, të gjithë regjimet, të gjithë sistemet, të gjithë pushtetet janë kufizues dhe, pavarësisht se shkrimtarët mundohen t’i përdorin për qëllime të veta, në esencë ata i përdorin shkrimtarët dhe, në shumicën e rrethanave, i bëjnë të duken të shëmtuar dhe qesharakë.

*

Dua të ndalëm pikërisht në këtë pikë, edhe në rastin e Esad Mekulit dhe “Jetës së re”, të cilën ai e ideoi, e themeloi dhe e drejtoi për afro 25 vjet. Esad Mekuli u mbështet te parimi i njohur se pushteti dhe forca e tij duhej përdorur për qëllime më të larta. Ai kishte qenë pjesëmarrës i LNÇ-së, ishte komunist me bindje, madje nga ata komunistët që zhgënjehen, por nuk zmbarsen aq lehtë, siç kishte bërë miku i i tij i afërt, Hivzi Sulejmani. Me revistën “Jeta e re”, Esad Mekuli u bë themelues i letërsisë shqipe në Kosovë, të cilën, duhet ta pranojmë, nuk e themeloi duke u mbështetur në parimet e realizmit socialist, siç bënë bashkëkohësit e tij në Shqipëri, as duke u mbështetur në letërsinë e traditës, por mbi parimet kerlezhiane të letërsisë jugosllave, që mund të quhet një variant jugosllav i realizmit socialist, siç ishte varianti jugosllav i socializmit. Për të bërë një letërsi të këtillë në Kosovë, për t’ia vënë themelet një letërsie të këtillë, Esad Mekuli përballej me probleme të shumta. Mungesa e traditës letrare, ishte një faktor kufizues. Prapambetja e përgjithshme, veçmas prapambetja kulturore gjithashtu. Por ai kishte kundër vetes, në njëfarë mënyre, edhe klasën politike kosovare, dogmatike dhe të paarsimuar, e cila nuk i pranonte dhe i refuzonte në mënyrë kategorike standardet jugosllave të socializmit liberal. Për këtë klasë politike parimet krijuese që i kishte shpallur Kërlezha më 1956 ishin të largëta dhe të mjegullta dhe, po të zbatoheshin në Kosovë, në këndvështrimin e tyre ishin antiparti. Po në këto vite dhe në vitet më të vona ’60 dhe ’70, Esad Mekuli filloi të kishte kundër vetes edhe idenë e socializmit si proces botëror, jugosllavizmën e tij tashmë të luhatshme, por edhe konspiracione të ndryshme që për një kohë synuan ta bënin Beogradin dhe pastaj Prishtinën qendër të albanologjisë dhe të kulturës shqiptare; që shqiptarët e Jugosllavisë synonin t’i bënin komb më vete dhe gjuhën e tyre gjuhë më vete. Së voni ai filloi të kishte kundër vetes lexuesin e Kosovës, që nisi të edukohet nga letërsia e realizmit social-romantik të Shqipërisë, madje filloi të kishte kundër edhe integralistët jugosllavë, midis tyre shkrimtarë të shquar të letërsisë të sapo bërë të Kosovës, të cilët ende flitnin serbisht në mbledhjet e partisë në “Rilindje”. Në pikëpamje të ideve dhe të praktikës letrare, Esad Mekuli mbeti i pandryshuar: një “kërlezhian” i vitit 1956.

Në një rrethanë të këtillë, Esad Mekuli, për të bërë këtë letërsi, vuri

në veprim të vetmen gjë që kishte të pacenuar: besimin dhe idealin. Duke qenë luftëtar, duke qenë komunist i orëve të hershme dhe duke qenë i formuar në konstalacionin politik jugosllav, askush nga klasa politike e Kosovës nuk merrte guxim të dyshonte në përkatësinë e tij ideologjike dhe në idealizmin e tij. Këtë “kredi” që kishte te klasa politike e Kosovës, por veçmas te ajo jugosllave, ai e përdori për t’i tejkaluar shumë kufizime që i vendoste sistemi dhe ambienti politik i Kosovës. E bëri “Jetën e re” abetare për emancipim themelor, por edhe hapësirë për kultivimin e shijes letrare. Botoi traditën letrare, botoi shkrimtarë të Rilindjes, botoi edhe avangardën dhe modernitetin. Botoi shkrimet letrare të nacionalistëve, por edhe të luajalistëve ordinerë; botoi letërsi të realizmit socialist, të shkrimtarëve të Kosovës dhe të Shqipërisë, por botoi edhe tregimin modernist, anti-dramën dhe anti-romanin, dhe poezinë formaliste, madje edhe ekstremin e saj, poezinë “konkrete” dhe dadaiste. E bëri “Jetën e re” revistë letrare që mbështeti secilin krijues të hapësirës shqiptare në ish-Jugosllavi. I mbështeti të gjithë pa përjashtim, veçmas shkrimtarët e rinj. Vetëm se në këtë mbështetje dhe në këtë dominim të jetës letrare në Kosovë, “Jeta e re” krijoi monopol, krijoi kufizime, krijoi një kornizë të ngushtë, në të cilën nuk rrinte dot më letërsia të cilën vetë e kishte ushqyer. Nuk mund të them se ky ishte fataliteti i Pigmalionit, i cili rebelohet kundër krijuesit të tij, por më shumë mund të quhet fenomen i pritshëm, një pasojë e paevitueshme, të cilin një ditë do ta prodhonte pluralizmi i shkollave dhe i metodave, që njëkohësisht duhej të ishte edhe pluralizëm i mendimit dhe ideve. Kështu, nga fillimi i viteve ’70 dhe prapa, në njëfarë mënyre kundër “Jetës së re”, të tillë çfarë e kishte bërë Esad Mekuli, u ngritën pothuajse të gjithë, të rinj dhe të vjetër, shkrimtarë të njohur dhe të tjerë më pak të njohur, me mbështetje ose pa mbështetje politike. Ndonjëherë krijohej përshtypja se monopoli letrar “Jeta e re” nuk ishte vetëm pengesë për frymëmarrje të lirë të letërsisë, por ishte edhe luftë për prestigj, për dominim, luftë brezash. U krijua përshtypja se brezi që kishte ardhur në letërsinë e Kosovës pas Esad Mekulit e kërkonte për vete “Jetën e re”, si simbol të një sundimi letrar dhe të forcës hipotetike të kulturës dhe të letërsisë. Revistën që ishte bërë simbol i letërsisë në Kosovë, nga mesi viteve ’70 e mori në dorë brezi i dytë i shkrimtarëve, por nuk arriti të bënte asgjë, përveçse ta çmontonte monopolin e saj dhe vetë revistën ta bënte të parëndësishme, duke e zhven-

dosur qendrën e dominimit dhe të monopolit letrar nga “Jeta e re” te Redaksia e botimeve të “Rilindjes”.

Ndërsa Esad Mekuli, edhe pas “Jetës së re”, mbeti ai idealisti i vjetër, i cili i fiton një sërë betejash, por e humb betejën më të madhe, betejën me idealizmin e vet.

METAFORË IDENTITETI

Poezia e Esad Mekulit

Para se të jetë poezia e Esad Mekulit metaforë identiteti, vet ai, me veprimtarinë letrare ka qenë simbol historik i identitetit të shqiptarëve të Kosovës dhe të trevave të tjera verilindore. Poezitë e tij, të shkruara dhe të botuara fillimisht në serbokroatisht, në pamundësi të gjuhës amtare, pohonin talentin e një shqiptari, që u flet të tjerëve për dinjitetin dhe të drejtën e gjindjes së vet në gjuhën e tyre, një dukuri e njohur në letërsinë shqipe në periudhën e Rilindjes Kombëtare, e përsëritur këtë herë në Rilindjen e dytë të Kosovës. Me vëllimin në shqip *Për ty* (1955), nis letërsia bashkëkohore e këtij mjedisi, që do të bëhet degë kryesore e trungut të letërsisë shqipe. Duke qenë kryeredaktori i parë i *Rilindjes* (1945) dhe i *Jetës së Re* (1949), kryetari i parë i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës (1970), pra, përurues i shtypit politik dhe letrar, i institucionit shkencor e artistik më të lartë, me ndihmesat dhe personalitetin është bërë edhe një lloj simboli i tyre.

Ideja e pohimit të identitetit, që përshkon lirikën dhe përbën sistemin motivor e strukturor më veprues të saj, është shprehur në trajta të ndryshme, retorike, metaforike, simbolike, alegorike, me përparësi të trajtave metaforike. Madje, edhe në poezitë ideologjike, si dhe në botën e ideologjizuar, hapen dritare për ta shpalosur. Pohimi i identitetit, zakonisht, merr shkas nga rreziku për ta tjetërsuar atë, prandaj, ajo, shpesh, për nga brendia, struktura, mënyra e komunikimit me lexuesin, është e llojit dramatik, me konflikt, herë në sipërfaqe, herë në thellësi të metaforave e të simbolikës. Në poezitë e njohura *Mos më thirr me emën t'huej* dhe *Shiftar mos më thuej* trajtohen dy anë të të njëjtit problem, përpjekjet për ndërrimin e emrit, që i përcakton identitetin e origjinës e të qeniesisë, dhe klasifikimin racist ndaj tij si kategori shoqërore e ulët, e përbuzshme. Janë poezi retorike të

kundërshtimit të fortë ndaj rrezikut të tjetërsimit, të kthyer në leitmotiv dhe të mishëruar që në titujt, me pjesëzën mohuese *mos*, të ngritur në urdhër nëpërmjet shoqërimit me pikëçuditëse. Ato i kundërvihen realitetit shoqëror, jashtë tekstit. Subjekti lirik, i njësuar me poetin, është midis këtij realiteti të njëmendët, rrezikues dhe idealizmit ideologjik të bindjes së tij. Për të shprehur brendinë e ngjeshur dhe domethëniet e hapura janë përdorur përftesa poetike të disallojshme: ligjërimi lirik i drejtpërdrejtë, trajta monologjike, monologu i dialogizuar, po ashtu, dhe shenja pikësimi të disallojshme: pikëçuditëse (nga pesë herë në secilën), pikëpyetje, pikëpyetje dhe pikëçuditëse bashkë, vizë dialogu të munguar, vizë bashkuesetire, tri pikat e heshtjes, pika, presja, pikëpresja.

Në poezinë *Mos më thirr me emën t'huej*, incipiti me pyetjet e vargëzuara *A jam a s'jam dhe çka jam?! lidhin tekstin me kontekstin shoqëror, të cilin ajo e afron dukshëm. Rreziku qeniesor është shtruar në formën e pyetjes hamletiane A jam a s' jam, jo se dyshon në të qenmen e vet dhe as të tjerët për të, por për ta provuar para tyre dinjitetshëm dhe sa më bindshëm nëpërmjet mospranimit dhe kundërshtimit. Pikëçuditësja pas pikëpyetjes te vargu çka jam?! shpreh habi të madhe. Kur mirëdihet prej gjithkujt se çfarë është, kërkojnë ta shpallin tjetërsoj, siç nuk është, që ai e quan me emën t'huej. Ligjërimi fillon me pjesëzën mohuese mos, e cila përsëritet në krye të tri strofave nga katër gjithsej, si dhe në vargun e parafundit. Mohimi nëpërmjet saj, i kthyer në leitmotiv, në variacionet e tekstit ndryn edhe mospranim, revoltë e kundërshtim.*

Në strofën e parë *Mos trokit në portën e vjetër*, mos përsërit të kaluarën është një prapaktim i padëshirueshëm në kohë dhe në marrdhënie me atë që i drejtohet, shkaktarin. Subjekti lirik jeton në të sotmen me qëndrime e përjetime të sotme: *asht hapun porta ime/dhe zemra ime asht çelë*. Mjedisi shoqëror dhe zemra e tij e kanë pranuar tjetrin, shkaktarin. Tjetri, jeton në të sotmen me bëmat dhe përjetimet e vjetra: *troket në portën e vjetër*, që, nënkuptohet, dikur ka qenë e mbyllur, pa komunikim. Prej metaforës *Mos trokit në portën e vjetër*, që është bota përreth, mjedisi, i pandjeshëm, në strofën pasuese, kalohet në metaforën *plagët e vjetra mos i nguc*, duke i bartur në trupin e ndjeshëm njerëzor a të shoqërisë. E shkuara ka qenë e ndeshjeve, e plagëve. Cilësori të vjetra nuk është thjesht për lashtësinë e tyre. Më tepër ka domethënien e gjendjes së

plagëve. Janë të pambyllura, të pashërueshme, të përjetshme. Ngucja, ringjallja e tyre e frikëson subjektin lirik, prandaj, kalon në tone lutëse për mos t'u kthyer e shkuara. Zemërimi, revolta e papërmbajtshme e çvesh ligjërimin prej metaforave, duke e zbritur në shprehjen e drejtpërdrejtë. *Plagët e vjetra* konkretizohen më tej, me *mos më thirr n'emën t'huej*. Përpjekjen për ta tjetërsuar nuk e pranon, e kundërshton në formë prerë. Tri strofat që fillojnë me *mos*, përmbyllen me pikësimin e urdhërores (!).

Gjendjet mendimore dhe emocionale janë të ndryshueshme, këmbëhen me një regjistër të larmishëm: dyshim, habi, lutje për t'i prirë e mira, lutje prej frikës mos të ndodhë e keqja, besim, revoltë, ironi, mospranim urdhërues, sepse, marrdhëniet e tij me atë që i drejtohet janë kundërvajtëse, të ndërlikuara. Ai i drejtohet një Ti-je, i afërt në kohësi, në të tani-shmen, dhe në hapësirë, sikurse parakupton veta e dytë. Gjithashtu, është mungues dhe i pashfaqshëm, nuk i përgjigjet dialogut të hamendësuar. Përgjigje janë besimi, shpresa, bindja utopiste e vet subjektit lirik. Marrëdhëniet me të janë paradoksale, në rrafshin abstrakt, të kohë-hapësirës, dhe në rrafshin konkret, shoqëror. Nga njëra anë, është shkaktari i rrezikut të tjetërsimit të tij, *e thërret në emën t'huej*, dhe, nga ana tjetër, udhëheqës dhe atë, *dora që i prin dhe e përgdhel*. Mendimi duket se mbërrin në barazpeshë, në pikën zero. Pavarësisht prej përjetimeve të dhembshme, poeti nuk shkulet nga bindja ideologjike, nga utopia larg realitetit, edhe kur qeniesia, identiteti i tij është i rrezikuar, por u mëshon të dy fijeve, pa lëshuar as njërën, as tjetrën. Në këtë rast, është i dyzuar, pa rrugëdalje. Ndërsa, në ballafaqimin kontrastues midis realitetit, njëmendësisë së asaj që ndodh dhe bindjes utopiste, dëshirës e shpresës së tij, kahja anon nga mospranimi, revolta, ndalimi urdhërues. Dy strofat e para janë ndërtuar në formë kontrapunkti. Përbri rrezikut dhe kërkesës për të mos trokitur në portën e vjetër, për mos t'i ngucur plagët, mos t'i thirrur me emën të huej, janë vargjet e besimit entuziast:

në këtë ditë

t'pranverës sime; asht hapun porta ime

dhe zemra ime asht çelë... ; me dorën tande

që prin e përgdhel!,

që është dora e Ti-së, shkaktarit të tjetërsimit. Dy strofat e fundit, e treta dhe e katërta, nuk janë në formë kontrapunkti. Në to ka vetëm kundërshtim të prerë dhe ironi. Ti-së i theksohet, se ai e di fare mirë cili është subjekti lirik, dhe në atë emër t'i thërrasë:

-O, ti di

Çka jam!

Atë, atë ma thuej....

Poezia përmbillet me urdhërore të prerë:

Mos më thirr

me emën t' huej!

Ka mundësi edhe për një lexim tjetër, me kahje mendimi të hapur. Bëmat e papajtueshme të dorës, që *prin e përgdhel*, që *dritë e lumni dhuron*, dhe, njëherësh, e thërret *me emën t' huej*, marrin kuptim ironik e paradoksal. *I prin dhe e përgdhel* për ta shpënë te *drita dhe lumnia* e tjetërsimit.

Në poezi të tjera metaforat janë më abstraguese, të ngritura deri në simbole. Poezia *Në grykë* strukturalisht dhe kuptimisht është një triptik me pjesët: 1. Bistrica; 2. Pisha në shkamb; 3. Dy shqiponja, në të cilin peizazhi lirik ndërthurret me lirikën përsiatëse. Në të spikasim disa nga tiparet më cilësore të stilit të tij, thuktitia e shprehjes, dramatizmi i brendshëm, shenjëzimi karakterizues i kursyer i rrethanave të jetës e të mbijetesës, duke funksionalizuar katër objekte: Shqiponja, Njeriu shallbardhë, Bistrica (lumi), Pisha mbi shkamb, të shkruar me shkronjë të madhe, që i shndërron në emra të përveçëm, me përfaqësim në shkallare sipërore.

Pamja natyrore, që përshkruhet është Gryka e Rugovës, ndër peizazhet më të bukur të hapësirës shqiptare. Qielli, një kupolë apo kambanë madhështore, që mbyll horizontin në tri anë, ana e katërt është rrjedha e lumit. Pylli tri faqesh, që duket se zbret prej qiellit në tokë, me një majë shkëmbore të frikshme, thuajse, do të zejë poshtë, kur kalon rrugës. Bistrica gurgulluese, që i jep jetë luginës dhe më tej fushës. Peizazhi natyror nuk është zgjedhur për bukurinë, por për simbolikën gjeo-historike të betejave kundër pushtuesve, që janë zhvilluar në Grykën e Rugovës, dhe mundësitë metaforizuese, që ka shfrytëzuar poeti për të ndryrë në to

domethënie të gjerë. Prandaj, bukuria e tij është ravijëzuar fare pak, me përdorimin një herë të fjalës *e bukur* për natyrën, edhe kjo pas cilësorit *e vrazhdë*. Ngjyrat e çelta, me dritë e të gëzueshme, që nxitin emocione pozitive janë katër lloje, në përmasën hapsinore 8; *e blertë*, 2 herë, pishë e blertë- gjallëri, jetë në lulëzim të përhershëm; *e kaltërta*, 1 herë, naltësitë e kaltërta; *e bardha*, 2 herë, njeriu shallbardhë dhe 2 herë te metafora bora; ndonëse, me ngjyrë të papërcaktuar, mund të përfshihet tek e çelta, edhe *qiellës së paanë*, duke qenë, se *e paanë*, mund të jetë pa re. Këto janë ndërfutur në ngjyrën *e përhimtë*, të shkambit të përhimtë, të përdorur 9 herë; 2 herë graniti, që është lloji i shkambit; 1 herë rasa e shkambit; 1 herë guri, vetëkuptohet, po i përhimtë. E përhimta është në përmasën hapsinore 14. Përpjestimi midis ngjyrave të kundërta është 8/14. Tablonë e zotëron ngjyra e errët, e ndërmjetme, midis të bardhës dhe të zezës, e cila mund të marrë drejtim për nga e bardha, sikurse mund të marrë drejtim nga e zeza, simbolikë dramatike, konflikti, gjithsesi, me horizont të hapur, me *qiellë të paanë* dhe naltësi të kaltra.

Me lumin, që bren shkëmbin, dhe prej aluvioneve ka mbathur Rrafshin e Dukagjinit, me pishën, që ka çarë shkëmbin është lufta për jetën prej zanafillës së planetit të tokës, në parahistori. Lirika nuk është thjesht e llojit të quajtur të peizazhit, me përshkrim asnjans, sikurse është veçori e tij. Përshkrimi i natyrës, marrëdhëniet midis objekteve, të vlerësuara prej subjektit lirik janë metafora të jetës dhe të përpjekjeve njerëzore. Lumi i Bistricës është *shirit i gjallë, përpjekje e shkujve me ngadhnjye, dëshmitar i qëndresës, klithmë e fuqishme e jetës*.

Pisha në shkamb, në njësinë e dytë të triptikut, *që ka lëshue rranjë*t, ngjan të jetë simbol i jetës në kushte e rrethana skajshmërisht të vështira. Cilësori *e gjallë*, në vargun përmbyllës *Pisha e gjallë në natyrën shkambore*, e afron me njeriun e gjallë, gjindjen, bashkësinë e gjallë, qark të cilës *ulërojnë ernat e tërbueme*, që ndërmendin ujqit e tërbuar, dhe *bora peshon*, është e rëndë. Në fund të vargut janë pikat e heshtjes, duke e lenë të hapur leximin për të nënkuptuar domethënie të ndryshme.

Në njësinë e tretë poetike shfaqet njeriu shallbardhë, me qëndrime qeniesore/ekzistenciale dhe shqiponja, që janë të barazvlefshëm. Shallbardhi është përkatësisht rugovasi me shallin e tij dallues. Në nëntitullin e saj

të dy quhen shqiponja, dhe, më tej, *banorë të pandamë të këtyne shkambijve*. Prania e tyre, tanimë, identifikon jetën njerëzore, të përcaktuar si jetë e njeriut shallbardhë, në tokë, dhe e shqiponjës, barazvlerës i tij, në qiell. Brenda konceptit të pikturës, subjekti lirik e zhbiron botën e tyre nëpërmjet syve në retinën e të cilëve janë të ngrira rrethanat e të shkuarës fare të afërt, në trajta metaforike: *retë e gjuhëzat e borës së vjeme*, dimër i rëndë, *dhe/shkuma e Bistricës*, që ka vëshuar, një rrezik përmbytjeje.

Po në retinën e syve, përkundër rrethanave të rënda, është *vendimi* i tyre: *me qenë, me qëndrue*, i cili metonimikisht nënkupton mosqenien, largimin, rrjedhje historike e njohur, e krijuar për pakësimin e shqiptarëve. Fjala *vendim* përafron një marrëveshje, besëlidhje, përbetim të përbashkët të një forumi, bie fjala, kuvendi, që ka të drejtën të marrë vendime. Në kohësi, *vendimi* nuk është as i vjetmi, as i sivjetmi, por, i pa papërcaktuar, ndryshe, i përgjithësuar, edhe me trajtat foljore: *me qenë, me qëndrue. Me qenë* është e njëllajtë *me qëndrue*, dhe anasjellas, *me qëndrue* do të thotë *me qenë*. Qeniesia e tyre është e kushtëzuar, nëse do të qëndrojnë aty ku janë, simbolizuar me Grykën e Rugovës. Në këtë gjashtëvargsh, rrethanat e vështira, arsyet përse është marrë vendimi *me qenë, me qëndrue*, janë shprehur në mënyrë të drejtpërdrejtë: *kundër ashpërsisë së rrethit, kundër skamjes e vorfnisë*.

Pas tyre, rishfaqet si leitmotiv Shqiponja, Njeriu shallbardhë, Bistrica dhe Pisha mbi shkamb, këtë herë, mishërim i fuqisë së gjallesës së natyrës e të jetës njerëzore, natyrë në të cilën janë në harmoni vrazhdësia dhe bukuria. Trevargshi përmbyllës është një sentencë filozofike *Jeta asht luftë e papreme për hapsi, për gjallnesë*. Jeta e kthyer në luftë për hapësirë dhe mbijetesë, sikurse dihet, ka qenë dukuria themelore historike, veçanërisht, që kur kanë filluar përpjekjet për formimin dhe shtrirjen e shtetit shqiptar.

Te *Bjeshkët e Nemuna* shqiptari njëjtësohet me malin, një konstante simboliko-metonimike e njohur e poezisë shqipe. Për të parë ndërlidhjen e brendshme të mbarë poezisë shqipe bashkëkohore, edhe nëpërmjet kësaj konstanteje, fillimisht, nisur nga titulli, me të mund të pranëvihen poezitë *Bjeshkët e Namuna në dimër, Alpet në dhjetor*, poema e mirënjohur *Përse mendohen këto male* të Ismail Kadaresë. Dy poezi kanë objekt figurimi

Bjeshkët e Nemuna. Edhe *Alpet në dhjetor* kanë po ato, sepse, në gjeografi, emri i tyre po zëvendësohet me Alpet Shqiptare. Shëmbëlltyra legjendare e arketipit të shqiptarit, që kishte mbërritur në bashkëkohësi në mesin e shekullit XX, te *Përse mendohen këto male*, duket se ka zbritur nga Bjeshkët e Namuna/Alpet Shqiptare, vendi i eposit shqiptar dhe i kreshnikëve të tij. Në tërësinë e figurimit të malit, tërheq vëmendjen për ta shpjeguar poetizimi nga autorë të ndryshëm i Bjeshkëve të Nemuna/ Namuna, të kthyer, gati, në kult.

Esad Mekulin, në pamje të parë, e shqetëson emërtimi i tyre me mallkim. *Përse të nemuna?! Ismail Kadareja* e shpreh tërthorazi shqetësimin prej emrit. Pa e përmendur mallkimin e tyre, kërkon ta fshijë atë, duke i përshkruar me bukuri të jashtëzakonshme, të paarritshme si një Olimp. Përse i shqetëson emri përçmues dhe kërkojnë ta përgënjeshtrojnë, duke i poetizuar? Shqiptari i veshur me cilësitë e malit “të mallkuar” dhe anasjellas përngjason me teoritë raciste kundërshqiptare, nënvleftësuese e përçmuese ndaj tij. “Çmallkimi” i tyre është “çmallkim” i tij. Arsytet e njëmendta të zgjedhjes së Bjeshkëve të Namuna janë të tjera, të botë-kuptimit, mënyrës së përjetimit dhe të krijimit.

Gjeografët i përshkruajnë kështu: *Bjeshkët e Nemuna*, trevë e madhe malore në Shqipërinë Veriore që zë gjysmën P të Alpeve Shqiptare, e njëjtë nga shtrirja gjeografike me Malësinë e Madhe...B. N. vazhdojnë edhe në Kosovën P, si dhe në pjesën JP të Malit të Zi (Plava dhe Gucia). Emërtimi B.N. në studimet e gjeografëve dhe në përdorimin e përgjithshëm ka ardhur duke u zëvendësuar më emrin “Alpe” (Alpet Shqiptare)...B.N. të Kosovës, zona malore më e madhe dhe më e lartë e Kosovës në pjesën P të saj, kufi me Shqipërinë dhe Malin e Zi, vazhdim i drejtpërdrejt orografik i B.N., që shtrihen brenda territorit të RSH...Relievi tepër i thyer, thuajse i pakalueshëm, klima shumë e ashpër... vështirësitë e përballimit të jetës në ato vise mund të shpjegojnë edhe cilësimin e tyre si “të Nemuna”. (*Fjalor Enciklopedik Shqiptar* 1, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2008, faqe 261-262)

Poezitë dallohen për thukëtinë e shprehjes. Njëra është 20 dhe tjetra 40 fjalë.

Bjeshkët e Nemuna

Shkëmb i gjallë. Beden. Fortesë

E fisit...Përse të nemuna?!

Mu si ato qëndruan me nderë e besë

Shekujve kreshnikët tanë, burra!

(Esad Mekuli *I varuri i këndon lirisë*, poezi të zgjedhura, zgjedhi e përgatiti Ali Podrimja, Toena, Tiranë, 2006, faqe 63).

Bjeshkët e Namuna në dimër

As zog, as vetëtimë

Gjékund syri s' has.

Ngrirë gjithçka. Ëndërr

Veshur në kuarc.

Si në hotelet e shtrenjta

Ku shtegtari s'hyn,

Shiu dot s'i afrohet

Luksit alpin.

Shkëmbinj si tempuj

Nën re, mbi re.

Një varrezë bubullimash

Kujdes, nën këmbë ke.

1980

(Ismail Kadare *Ca pika shiu ranë mbi qelq*, dyzet poezi të zgjedhura, parathënia nga Ali Podrimja, Onufri, Tiranë, 2003, faqe 78).

Tek të dyja është poetizuar paarritshmëria, pjesë e madhështisë së tyre. Përveç *bjeshkëve*, objekte figurimi të përbashkëta janë, po ashtu, *shkëmbi/shkëmbinj* dhe *njeriu*. Paarritshmëri-paprekshmërinë e natyrës Esad Mekuli e përcjell tek vepra e njeriut, në ndërlidhjen e pandashme të tyre, për ta ngritur në shkallaren e qëndresës historike, të brezave në

shekuj. Lënda e bjeshkëve është- *shkëmb i gjallë*, e pakapërcyeshme dhe e pazhbëshme, dhuratë e natyrës. Menjëherë, i ndërprerë nga pika, pa fjalë tjetër midis, metonimia e shkëmbit shndërrohet në *beden* dhe *fortesë*, simbole, që shkrijnë veprën mbrojtëse të natyrës dhe të njeriut, ndër të cilat përparësi merr ajo e njeriut, sepse është *e fisit*, e familjes së madhe të një gjaku dhe mbiemri, e ndërtuar prej tij. *Bjeshkët prej shkëmbi, bedeni, fortesa, burrat* përbëjnë paprekshmëri-qëndresën. Burrat janë të përcaktuar me bëma e tipare dalluese. Bëma kryesore historike e tyre: kanë *qëndruar, në shekuj, mu si ato* (bjeshkët). Tiparet janë sintetizuar me cilësorin *kreshnikët*, shoqëruar me pronorin e vetës së parë në shumës, *tanë- kreshnikët tanë*, që i përkasin bashkësisë së subjektit lirik, të njësuar me poetin. Qëndresa është e *kreshnikëve tanë, burra*, trima të mëdhenj dhe me shpirt fisnik, të mbajtur mend për bëmat. Të qëndruarit ka qenë *me nderë*, nuk kanë lejuar të prekej e drejta e tyre, dhe *besë*, të lidhur për jetë a vdekje për ta mbrojtur atë, dy tipare themelore identitare. Ruajta e besës, në këtë kontekst, afron edhe ruajtjen e identitetit, besnikërinë ndaj vetes, traditës, të parëve. Shëmbëlltyra identitare e shqiptarit në poezinë e Esad Mekulit është arketipike, historike legjendare.

Në poezinë e Ismail Kadaresë parësore është madhështia e pashkelshmëri- paarritshmërisë së tyre. Për këtë Bjeshkët e Namuna shëmbëllohen në një stinë, në dimër, që e madhështon paarritshmërinë dhe bukurinë e tyre, kur gjallesat nuk e përballojnë dot: *as zog...gjëkund syri s' has*. Edhe *shiu*, dukuri e rëndomtë, e zakonshme për relieve të ulët *dot/s'i afrohet luksit alpin*. Ngjitja, apo, qenia në ato bjeshkë është luks e privilegj, vetëm për dukuri të jashtëzakonshme. Madje, nuk ka *as vetëtim*a, një përjashtim i natyrës. *Shkëmbinjtë si tempuj, / nën re, mbi re*, janë të shenjtëruar, të ndërtuar nga natyra e të ruajtur nga Zoti. Mirëpo, ka patur *bubullima*, që ndërmendin bubullimat e luftës në kulmin e betejave. Ato kanë qenë në të shkuarën dhe të shumta, aq sa me to është krijuar një *varrezë bubullimash*, tanimë, jo aktive. *Një varrezë bubullimash*, edhe si shprehje, përngjason me varrezat e heronjve, e cila, përbri tempujve, është e mbrojtur nga dora e Zotit. Natyra, dukuritë atmosferike, mbetjet e tyre janë të përshtatshme për ngjarje dhe heronj mitikë e legjendarë, të cilët, analogjia e natyrës me historinë sikur i shpërfaq në sfond. Mrekullitë e Bjeshkëve të Namuna i kupton dhe i përjeton bashkëkohësi, subjekti lirik, i njësuar me poetin, dhe

miku, apo kolegu i tij, vizitor/turist. Këta janë mbi *varrezën e bubullimave*, madhërim i pasardhësit të të sotmes. Subjekti lirik, i gjithëdijshtëm, i tërheq vëmendjen mikut, koleg: *Një varrezë bubullimash/kujdes, nën këmbë ke*. Në një nga leximet, tërheqja e vëmendjes mund të jetë për mos të shkelur mbi varrezën e shenjtëruar të bubullimave. Shëmbëlltyra e identitetit të *Bjeshkët e Namuna në dimër* e Ismail Kadaresë është ahistorike, e përjetshme, mitike legjendare. Ajo përftohet tërthorazi nga madhështia e mjedisit natyror.

Përfundim: Metafora e identitetit, e shqiptuar së pari prej Esad Mekulit, ka qenë bërthama autentike më e domosdoshme, që, me mënyra e trajta të ndryshme, nga ato tradicionale e deri te modernet e modernistet, është përfutur dhe zhvilluar, në përgjithësi, në poezinë shqipe të shkruar në këtë mjedis, duke u shndërruar në konstante thelbësore të saj, sikurse është në mbarë poezinë shqipe, të mëparshme dhe bashkëkohore. Shqiptimi i parë, ka raste, që, edhe po të jetë modest, aq më tepër kur ndiqet e zhvillohet nga shumë zëra të tjerë, shpesh shndërrohet në simbol. Edhe metafora e identitetit është shndërruar në simbol.

I SHKRIMTARIA

Shkrimtaria e ideologjia kthehen në tautologji, kur kërkohen të shkrimtarët veprimtarë socialë, sepse *shkrimtaria* e veprimtarit bëhet me projeksione apo me copa veprimi. Kështu, Esad Mekuli shenjohej si shkrimtar i lidhur me ideologjinë (sociale), ndërsa ky shenjim do evidenca e prova, duke nisur nga kush është Esad Mekuli (kulturalisht).

I njohur edhe si Sat Nokshiqi e Sat Hoxha, Esad Mekuli u lind në Plavë, më 1916. Poet e përkthyes, një nga themeluesit e drejtuesit e jetës kulturore e letrare të Kosovës pas Luftës së Dytë Botërore, redaktor i revistës letrare kult *Jeta e re*. Fitues i disa çmimeve të rëndësishme letrare.

Mekuli nuk u shkollua për letërsi, por u kthye në (veprimtar) letrar të përhershëm. Njihet si një nga etërit letrarë të Kosovës, si njeriu që ka botuar krijimet e veprat e para të autorëve të Kosovës e një nga themeluesit institucionalë të letërsisë shqipe të Kosovës, edhe pse vetë nisi të shkruajë e të botojë në serbisht.

Kështu shenjohej humanisti Esad Mekuli, i cili humanizmin e mendon dhe e kthen në shërbim, ndërsa përcaktimin ideologjik e politik e manifeston si iluminizëm të lidhur me kategori të barazisë e të përparimit social e nacional.

Këto janë shenja biografike të Mekulit me të tjerët, meqë një shkrimtar veprimtar si ai, biografinë e ndërton me të tjerët. Vepra e Mekulit letrare lexohet nën shenjat e temave sociale e ideologjike, të cilat në jetë kthehen në biografi me të tjerët, pra në biografi të veprimtarit social e kulturor.

Shenjat e tilla *biografike* e *bibliografike* e hapin autorin që shkrimin e njeh si veprim me funksion në jetën kolektive, shkrimtarin e veprimtarin e skemës së njohur shqiptare që shkrimtarët i kthen në veprimtarë politikë. Por, Mekuli s'është vetëm shkrimtar i doktrinës, meqë idetë e ideologjia e

veprës së tij, bashkë me veprën kulturore, kthehen në një iluminizëm social, në të cilin veprimi është më i fortë se doktrina, ndërsa shkrimi më i butë sesa ajo. Përfundimisht, vetë termi *shkrimtari* shenjon diskurse përtej letërsisë dhe çon te jeta sociale institucionale e Kosovës së shekullit të Mekulit.

II IDEOLOGJIKA

Ideologjika është term që shenjon projektionin ideologjik në krijimet apo në interpretimet letrare e që, kur kthehet në sistematikë, merr shenja të një metode. Kështu, ideologjika ka shenjat e metodës së krijimit apo të interpretimit të letërsisë, kur shkrimtari konceptohet si veprimtar e shkrimtaria si dëshmi e veprimit. Kjo duket sa herë që forcohet tendenca e shkrimit, si te vepra e Mekulit, e cila është projektuar si veprim i kthyer në diskurs, ndërsa veprimi mendohet e projektohet si iluminizëm, ideologji e barazisë e, përfundimisht, mbetet një utopi, meqë diskurset e tilla duan ta ndryshojnë jetën dhe vetëm në fund e mësojnë se jeta është më e ashpër se të gjitha diskurset. Përfundimisht, ideologjika, në kuptimin që i japim në rastin e Mekulit, bën bashkë letërsinë e ideologjinë, të lidhura në mënyrë metodike në veprën letrare, si *shkrimtari*. Një vepër e tillë hap çështje themelore për statusin e letërsisë dhe për funksionin e saj, meqë, në fillim e në fund, asaj i përshkruhet status veprimtarie pragmatike e funksion i prerë social.

Ideologjika, nga vetëdije e tendencë, kthehet në shenjë themelore të poetikës, sidomos kur e përsërit vetë autori në diskurse që shpjegojnë veprën e tij e artin, si te teksti programatik i Mekulit, i botuar në numrin e parë të revistës *Jeta e re* (korrik 1949), apo te Kujtimet e vona të tij. Kjo do të thotë se Mekuli si metodë leximi të veprës së tij e propozon atë që quajmë ideologjikë, duke e njohur më parë si shenjë themelore të saj.

Nën këto shenja, si thuret vepra e Mekulit përkrah dhe e kryqëzuar me ideologjinë, si e projekton atë, si e thotë shkrimtari mësimin dhe si e kthen në veprim?

Vetë pyetjet e shenjojnë një vepër iluminizmi social, të lidhur me jetën e shqiptarëve me të tjerët, në *bashkësinë politike* të menduar si finalitet e që

u provua si utopi finale. Kjo është vepra e veprimtarit social, të lidhur me epokën, shenjat e së cilës kthehen në referenca themelore të veprës, kur thuret poetika apo kur thuhet *mësimi*.

Na duket e rëndësishme të nënvizojmë se iluminizmi i veprës së Mekulit s'është *mendimtarí*, por *ideologji* veprimi që vepra e kthen në *ideologjikë*. Vepra e tillë bëhet dëshmi e kohës, hapet me të gjitha shenjat e zisë sociale e nacionale, kthehet në dëshmi të kryengritjes e mbyllet me gëzimin për triumfin e ideologjisë së barazisë. Duket paradoksale që vepra mimetike e Mekulit feston për jetën e barabartë dhe për të barabartët, kur vetë jeta shenjon e shkallëzon, pra bën hierarkitë. Kështu, utopia kthehet në fikSION dhe shpëton copëza të veprës së Mekulit, ashtu që të duket shkrimtaria poetike e të tërhiqet ngadalë ideologjia. Projektioni ideologjik i autorit është *zgjedhje*, që do të thotë se ai feston vërtet, meqë beson vërtet. Se ideologjia u provua si utopi dhe vetë u kthye që ta rrënojë atë që kishte projektuar, shkon përtej veprës së Mekulit dhe e provon se jeta përherë është tjetër nga vepra, edhe kur kjo krijon iluzionet më të forta të reales e të identifikimit me jetën (kolektive).

Ideologjia që projektton e përfiton vepra e Mekulit ka rrënjë sociale dhe propozohet si ideologji nacionale, në paradigmen e njohur të rrafshimeve të internacionales. Në frymën e asaj ideologjie, klasët dallojnë njerëzit, pjesa më e madhe hyn në klasën që vuan dhe kjo shenjohe si padrejtësi e diferencimit, ndërsa rrafshimi i klasëve bëhet tendenca ideologjike themelore që shtrihet në gjithë shekullin e tij të krijimit.

Duke luajtur me figurat e Mekulit: vepra e tij nis me *shqiptarin që vajton* e thuret nga *shqiptari që këndon*. Kënga hapet në rrathë, së pari për “jetën e re”, pastaj për copa të kësaj jete, të lidhur me arsimimin e me emancipimin. Kështu, vepra merr shenjat e utopisë totale, meqë do të jetë dëshmi totale e jetës. Vetë pretendimi e, më fort, tendenca për të dëshmuar janë përcaktime ideologjike, në trajtën: letërsia e thotë jetën si dëshmi dhe vetë kthehet në mësim për “jetën e re” që shenjon ideologjinë apo utopinë themelore të veprës poetike e të veprimit social e politik të Esad Mekulit. E gjithë kjo shenjohe e anticipohet te vepra e parë poetike e tij, *Për ty* (1955), e eksplikohet më tej në faqet e veprës së tij, madje në tituj si: *Dita e re* (1966) apo *Rini e kuqe* (1984) e *Drita që nuk shuhet* (1989). Kështu,

ideologjia thur figurat e veta, të njënjëshme me diskursin e saj publik e social, ndërsa poeti rrudhet vargjeve, kur në vetmi e thotë *Mallin për të pambërrijshëmen* apo kur thur *Kangën intime*.

Raporti i shkrimtarisë me ideologjinë ndërliqësohet e provohet nga biografia e Mekulit që lidh veprën e veprimin në bibliografi, nga veprat poetike, kryevepra e tij, nga jeta e tij kulturore letrare, e hapur dhe e provuar në radhë të parë me revistën *Jeta e re*, nga kujtimet e nga mësimet, ndërsa prova më e mirë e këtij raporti bëhet me anë shembujsh.

III VEPRA

Shkrimtaria e Esad Mekulit hapet me vjershat e botuara në vitet '30 të shekullit XX, në serbisht, dhe lidhet në vepër që nga viti 1955, kur doli *Për ty*, vepra themelore e Mekulit, e cila u shkrua e u provua në variante përgjatë shekullit krijues të tij. Këtë e evidenton bibliografia, ndërsa e provon vepra letrare faqe pas faqeje.

Vepra poetike e Mekulit lidhet në titujt: *Për ty* (1955), *Dita e re* (1966), *Avsha Ada* (1971), *Vjersha* (1973), *Brigjet* (1981), *Rini e kuqe* (1984) e *Drita që nuk shuhet* (1989). Në faqet e kësaj vepra hapet Mekuli shkrimtar, me sensibilitetin e tij, me shenjat e formimit letrar e kulturor, me pikëpamjet sociale e ideologjike, në fillim e në fund me idetë që shkrimtarin e çuan te veprimi politik. Kështu, vepra kthehet në *biografi* që merr, ruan e hap Esad Mekulin shkrimtar e njeri, meqë poetika e provon se shkrimtari jeton ashtu si e ndërton vepra e tij, ndërsa, duket paradoksale që ai e ndërton veprën, që do të thotë e zgjedh dhe e ndërton jetën.

Vepra themelore e Esad Mekulit është *Për ty*, ndërsa më e njohura *Brigjet*, e para si *anticipuese* e veprës poetike në tërësi, ndërsa e dyta si *përfaqësuese* e shekullit të tij letrar. Në këto dy skaje lexohet poeti Esad Mekuli, kur ai i kthehet vetes dhe kur merr të gjitha shenjat e veprimtarit. E lakuar në tituj, tema e poetikë, e kurorëzuar si ideologjikë, vepra letrare e Mekulit, me shenjat e mimetikës letrare e sociale, bëhet përfaqësuese e një tipi literature. Këto shenja, këtu si kudo, kthehen në evidenca të provuara kur hapet vepra, ndërsa i anticipon kryevepra e tij.

Poezia e Mekulit hapet me tema personale e sociale, të parat të praruara në diskurs atributiv e deskriptiv, ndërsa të dytat të shenjuara nga një ekspresionizëm tipik i epokës. Pastaj, kthehet në kushtrim e thyhet në mësim ideologjik, që ndonjëherë bëhet edhe politik, gjithnjë me bazë të një iluminizëm social e socialist, i lidhur me “kohën” e me “jetën e re”.

Figura e Mekulit e teksteve personale e deskriptive është e krijuar, e shënuar me metafora, ndërsa të tekstet e tjera kthehet në krahasim e deklaratë që figurën e zbret në idenë fillestare (ideologjike).

Format poetike janë të matura e të prera, madje dhe në trajtë tingëllime, e tekste që, në vend të matjeve, ndjekin frazën poetike.

Leximi zbulon se për poezinë e Esad Mekulit themelore janë temat e jo format, meqë ajo njeh normën e ideologjisë. Këtu hapet drama e poetit përballë mësimi letrar e ideologjik, meqë dhe diskursi i përshtatet temës e ideve, ndërsa poeti identifikohet me sensibilitetin e tij e ashtu subjektivitet.

Këto shenja i shfaq vepra e tij dhe i provon të lidhura kryevepra. Ndërsa, si zgjedhje e aksiologji personale do të shenjonim poezitë personale e deskriptive të Mekulit, për sensibilitetin, diskursin, figurën e, përgjithësisht, për *poiesis*-in e tyre.

IV KRYEVEPRA

Për ty është vepra e parë poetike integrale e kryevepra e Esad Mekulit, e botuar më 1955 dhe e plotësuar përgjatë viteve (më 1963 e 1967), përfundimisht e kthyer në vepër jetësore. *Për ty* hap temat e para të Mekulit dhe shenjon temat e fundit të tij, pra temat e përhershme. Ajo hap këngën e vajit, në shenja ekspresionizmi, e zbulon këngën e festës, si zbulesë të “jetës së re”. Diskursi i parë nxin “jetën e vjetër” e mbyllet në lavd të “jetës së re”. Kështu, *Për ty* anticipon veprën e Mekulit për nga sensibiliteti, tematika, diskursi e poetika në përgjithësi, prandaj Mekuli poet lexohet kur lexohet *Për ty* në të gjitha variantet.

Për ty e provon sensibilitetin e temat personale të Mekulit, shenjat e një ekspresionizmi social, me poezitë e hershme të tij, që këputen në kushtrimin e këngën e entuziazmit për “kohën e re”. Këto janë edhe shenja

tematike të veprës që, në faqet e reja të *Për ty* (1963 e 1967) dhe në vepra të tjera të Mekulit, provohen si konstanta poetike.

Këto shenja hapin sërish çështjen e raportit të shkrimtarisë me ideologjinë, kur kërkohet poeti i parë, apo veprimtari i fundit Esad Mekuli. Shndërrimi i tillë bëhet përmjet thyerjes e këputjes, ashtu si kënga intime këputet në këngë lavdi, me shenjat sociale, ideologjike e politike të “kohës së re”. Raporti bëhet më i ndërliqshëm, kur Mekuli e ruan sensibilitetin poetik, edhe kur *poiesis*-i reduktohet e ideologjia mësohet. Prerja e madhe ndodh në rrafshin e *statusit* të tekstit, kur ideologjia jepet si mësim dhe aty poeti i hap rrugë veprimtarit përgjithmonë.

Poezia personale e deskriptive e Mekulit është më poetikja, e shkruar herët, me figurat e mallit e të humbjes, me shenjat e elegjisë e të kujtimit, e shenjuar me *Mallin për të pambërrijshëmen*, si kurorë e mungesës së përrjetshme. Po, se poezia, paradoksalisht, fiton kur fitojnë mungesat, ndërsa festa kthehet në veprim.

Ndërsa, poezitë e shenjës ideologjike e ndajnë të sotmen nga e djeshmja, përmjet thyerjes finale, si dritën nga errësira. E sotmja ka shenjat e barazisë ndërmjet njerëzve e popujve dhe, e lidhur me shenjat ideologjike, ajo duhet ta shenjojë kontekstin. Ideologjia e lidhur me kontekstin merr shenjat e politikës e poezia e jep në figura mimetike, të cilat duan të jenë përfaqësuese.

Për ty është dëshmia e kënga autentike e Mekulit, e kthyer në festë për popullin e tij në “ditën e re”, të shenjuar nga “barazia” e nga “përparimi”. Kur entuziazmi e ideologjia kthehen në politikë, *poiesis*-i reduktohet përfundimisht, meqë teksti kthehet në pozicionim politik që përshkruan apo që do veprimin politik. Gjithë kjo e zbulon poetin Mekuli te vjershat personale e idealistin social te kënga e fitores dhe e përparimit, e cila, vërtet, thur ideologjinë si utopi, ashtu që vetë letërsia të provojë se konsakrimi ideologjik është utopik. Ky është mësimi themelor i veprës së Mekulit, kur e lexojmë sot, ndërsa vetë vepra donte të provonte të kundërtën. Pse ndodhi kjo? Sepse ekzistenca nuk njeh finalitet ideologjik, ndërsa letërsia e mbron veten, ndoshta më shumë kur reduktohet e kur rrezikohet.

Për ty hapet me poezinë *Popullit tim*, që shenjon tematikën e poetikën, madje politikën e veprës së Mekulit, e mbyllet me poezinë *Gjykimi*, si

kurorë e programit ideologjik të veprës, ndërsa ndërmjet strukturohen tërësitë tematike, sipas kohës: *Në hijen e robnís (1933-1940)*, *Flamujt e shpaluem (1941-1944)* dhe *Jeta e re (1945-1953)*.

Nga strukturimi i tillë i veprës, vërejmë lidhjen e poezive me kohën e shkrimit, lidhje që veprën e bën të kohës, në referencialitetin e shpallur të së majtës letrare, e cila shkrimin e koncepton si veprim e veprimin e kon-sakron si doktrinë. Shenjat e tilla të strukturimit, pra të poetikës, e shenjat tematike të kohës, pra të politikës, vetë Mekuli i lidh në shënimin *Lexuesavet* që shoqëron *Për ty* e të cilin duhet ta lexojmë nga fillimi edhe këtu:

Lexuesavet

Në këtë përmbledhje kam vû kryesisht vjersha të botueme, shkruie gjatë periodës 1933-1953, kështu që ajo paraqet, pak a shum, njëfarë pasqyrimi të punës sime njëzetvjeçare në lamën e poezís.

Mjerisht, mâ e shumta pjesë e vjershave që kam shkruie në peri-odën e paraluftës dhe asosh gjatë kohës s'okupacionit, kanë humbë. Midis vjershave të tretuna gjindet edhe përmbledhja e pregatitun "Shqiptari të kendon, o Metohí", që paraqitte cakun mâ të naltë të poezive të mija dhe, per mâ tepër, ishte një dokument jo i parandësi i kohës së paraluftës në Kosovë e Metohí; disa vjersha të kësaj përmbledhje (Të përsktuem, Qëndro dhe Rrugës) që po botoj, janë gjetë rastësisht midis librave të mija shkollore t'asaj periode.

Përmbledhjen e kam nda në tre kapituj: para luftës, gjatë push-timit dhe mbas shlirimit - simbas kohës në të cilën janë shkruie vjer-shat.

Kapitulli i paraluftës ndahet në tri cikla dhe paraqet, në kup-timin mâ të gjanë të fjalës, një tanësi nga e cila, ndoshta mund të kundrohen ma së miri rrija dhe pjekunija shkallë-shkallë politike dhe poetike e auktorit në kushtet e parlufhtës. Këto janë vjersha të shkrueme në ditët e zeza të robnís dhe të shfrytzimit të pashpirt të Shqipëtarëvet në Jugosllavín e vjetër, plot dhimbje dhe pezmatim, por edhe plot besim të pathyeshëm në ngadhnjimin e vllaznimit e të barazís midis njerëzve dhe popujve. Këto vjersha janë shkruie, për

shkaqe që dihen, në sërabishte dhe kanë pá dritën - përveç, ciklit të tretë, (pa vjershën „Përsëhndetje” që ást botue qysh më 1963 në revistën “Granit” e má vonë ribotue në fletoren “Beogradski student” më 1939) - në revistat për të rij në kohën e paraluftës: “Venac”, “Jugoslovenski rasvit” (Beograd) dhe “Mladost” (Zagreb): në “Novi Behar” (Sarajevë) dhe “Granit” (Podgoricë).

Vjershat tjera të shkrueme gjatë okupacionit ose mbas shlirimit janë botue, ma të shumtën, në revistën “Jeta e re”.

Auktori

Botimet e plotësua të *Për ty* e dëshmojnë se kjo vepër e përqendron gjithë shkrimtarinë e Mekulit tematikisht e poetikisht, si përfaqësuese themelore e ideologjikës së tij. Kështu, *Për ty* e shenjon shekullin letrar të Mekulit, me sensibilitetin, format e poezisë e me temat dhe lidhet si vepër e ideve themelore të tij.

V DRITA QË (NUK) SHUHET

Drita që nuk shuhet është vepra e fundit e Mekulit, botuar më 1989, me vjersha, me pak përjashtime, të shkruara përgjatë viteve '80. Një autor mimetik si Mekuli i provon e i pohon me çudi thyerjet e jetës së përbashkët në *shoqërinë* e idealit të tij, por një autor mimetik e vrasin fatet më shumë se të tjerët. Kështu, Mekuli, idealisti i parë, kthehet në dëshmues të fundit, në vjershat e tij për Dritën që (nuk) shuhet.

Drita që nuk shuhet është figura e lirisë, që na kthen në origjinë të veprës së Mekulit, kur ideali thuhet si idealitet, pra si i mundshëm, e jeta thyen kahun ashpër. Ndërsa, mësimi themelor është universal: nuk ka finalitet dhe situatat përsëriten përtej një kohë e një vendi. Kështu, në universalitetin tipik, figura e Dritës që nuk shuhet, kthehet në figurë të Dritës që shuhet dhe merr në vete idealin që rrezikohet e humbet, bashkë me figurat themelore të tij.

Thyerjet e ashpra e kthyen idealin në moskuptim, ndërsa poezia bëhet pyetje që shpreh humbjen, çudinë e moskuptimin përnjëherë, në trajtën

Pse? Pyetja lidhet me çudinë se pse *veprat* përcillen me pikëpyetje dhe se pse pikëpyetja e madhe i vihet ideologjisë së “Botës së Re”, “të lirë” e “të barabartë”. Pikëpyetja shkon deri në rrënjë të kësaj ideologjie, kur preket origjina e saj, revolucioni:

PSE?

*Oj,
pse
të dyshohet
në ata
që aq herë -
ngjarjeve në va,
dhanë
dëshmi
se ishin
luftëtarë
për Botën e Re -
Liri
e Barazi
(Ose,
ndoshta,
mos po ngjan
se njëmend -
“Revolucioni
fëmijët e vet
i han!”)*

Thyerja përzier kohët, ndodhitë duken si ëndërr, drita mbledhet e shuhet ngadalë, nën të vërtetat e rënda:

*Ja ku jam, Karagaçit - i zgjuar, e si të ëndërroja:
 Athua dikush, prapë, njerëzit panjerëzisht i ndan
 kur horizontet, rishtas, dëshirova t'i zbuloja -
 si atëherë kur, në ëndërrime, në rrugë shqetësimi të pamë,
 në lojë djaloshare kur me shpirt të ftonim,
 kur me afsh rinor të donim, të kërkonim...*

Por, figura themelore e poezisë, në universalitetin e saj, e shenjon mësimin për lirinë si dritë të jetës e të ekzistencës, Dritë që nuk shuhet, që kthehet sërish, edhe kur humbet e tretet. Paradoksalisht, poezia vetë e lë figurën dhe e thotë mësimin e vjetër, si të ri, pra të përhershëm:

*Revolucioni i Kuq pleqëroi:
 - Liria nuk falet!
 Ajo është dritë që nuk shuhet.
 Është jeta vetë...
 Përpara! Liri e dije kurrë nuk mjafton!
 (Kuptuam. Thashë: Njeriu gjithmonë për ta lufton).*

VI JETA E RÉ

(Numri i parë)

Numri i parë i revistës *Jeta e re*, i korrikut të vitit 1949, është thelbësor, si numër i identitetit të saj, shenjat e të cilit lidhen me natyrën dhe strukturën e revistës e që janë ruajtur përgjatë dekadave. E *skajuar* si revistë “kulturo-arsimore” e “me tipare thjesht letrare”, *Jeta e re* hapej si dritare kulturore e shqiptarëve të Kosovës, kur ata nuk kishin institucione nacionale të kulturës.

Shenja e parë identitare kulturore e revistës është gjuha shqipe, pastaj tekstet shqipe e tekstet e përkthyer, të gjitha të lidhura numër pas numri, deri më sot, si traditë e rëndësishme letrare e Kosovës. *Jeta e re*, revista që

botoi letërsinë shqipe që nga numri i parë e sistematikisht, u kthye në një shkollë të madhe letrare të Kosovës, në të cilën lidhen autorë themelorë të shekullit letrar të Kosovës.

Për ta shenjuar e për ta kujtuar revistën, është e udhës që të japim një pjesë të bibliografisë së numrit të parë, i cili, nga fillësë, u kthye në program pune e në një traditë letrare: *Fjala e redaksisë*, Sat Nokshiqi: *Dy poetë dhe luftëtarë të mëdhej*, Esad Mekuli: *Mbi letërsinë dhe punën letrare*, Zekeria Rexha: *Dy fjalë mbi prishjen e gjuhës sanë*, Mark Krasniqi: *Pranverës*, Lorenc Antoni: *Folklori muzikuer në Kosovë e Metohi*, Oton Zhupançiq: *Rrëfimi*, Vladimir Nazor: *Qarri i vetmuem*, Mbi “Kangët e Ali Binakut”, Naim Frashëri: *Bukurija*, Hilmi Agani: *Detyra e maturës*, Enver Gjerqeku: *Shkollës së re* etj.

Edhe kjo evidencë e shenjon natyrën e numrit të parë të *Jetës së re* dhe atë si institucion që do të japë jetën letrare në një ambient, me autorë shqiptarë, si poeti nacional Naim Frashëri, folklori e folklori muzikor shqiptar, me autorë shqiptarë bashkëkohës dhe me autorë jugosllavë të kujtuar e të përkthyer, si Zhupançiqi e Nazori, pastaj me tema e çështje që shkojnë përtej letërsisë, në kuptimin e parë, e që shenjojnë fushën e arsimit, si fushë iluminizmi social e nacional.

Kjo shtrirje, ngadalë, u kthye në lëndë letrare, letërsi shqipe e përkthime, traditë *Jeta e re* e ruan edhe sot. Kështu kuptohet se, bashkë me traditën e *Jetës së re*, është trashëguar edhe synimi themelor i saj, publikimi i letërsisë shqipe, shoqëruar nga tekste të letërsive të tjera dhe nga mendimi kritik letrar.

Vetë emërtimi *Jeta e re* shenjon traditë emërtimi që çon te *Vita nova* e Dantes, apo kthen tek ideologjia iluministe e “jetës së re” në “kohën e re”. Që të dyja shenjojnë faqet e revistës së re të “jetës së re”. Figura e Jetës së re merr në vete entuziazmin ideologjik e social për “jetën e re”, të “një-rëzve të rinj” e “të barabartë”, në një bashkësi që lidhet mbi parimet e internacionales. Por, *Jeta e re* ndërtoi në Kosovë edhe një traditë nacionale dhe, derisa në Shqipëri u këput një traditë, në Kosovë po ndërtohej tradita e parë sistematike letrare e lidhur me politikën e kulturës dhe me institucionet e vendit.

Numri i parë i revistës përmban edhe dy tekste programatike, njëri i

publikuar në emrin e Redaksisë së revistës dhe tjetri i Esad Mekulit, i titulluar *Mbi letrësinë dhe punën letrare*, të cilat e përcaktojnë natyrën e revistës, si dhe hapin horizontin estetik letrar të epokës. Teksti i Redaksisë është thirrje për bashkëpunim me revistën, nën titullin *Punëtorë intelektualë, të gjithë ju që merreni me letërsi dhe punë kulturore!* dhe mbyllet me markën sociale e kulturore të entuziazmit: “Pra, në punë!” Ndërsa, teksti i Mekulit shpall programin letrar të revistës, gjithnjë duke patur parasysh një kontekst social, i cili mendohet si përcaktues edhe i jetës letrare. Mekuli citon e pranon se letërsia është një soj ideologjie dhe se e paraqet dijen mbi jetën. Kështu, edhe para saj shtrohen detyra e detyrat e lidhura kthehen në një program të propozuar për “letërsinë e re” të “jetës së re”, të njohur si “kombëtare për nga trajta” e “socialiste për nga përmbajtja”. Mekuli saktëson se edhe ky program letrar lidhet drejtpërdrejt me “kushtet objektive”, të identifikueshme me ambientin social e ideologjik.

Teksti i Mekulit është një mësim letrar, me referencë teoritë letrare ideologjike, me autoritet themelor Timofejevin, dhe kthehet në një çelës për ta lexuar veprën letrare të tij, si një vepër që, në terma të epokës së saj, është e “angazhuar”, pra me funksion përtej letërsisë, e shtrirë në jetën sociale. Nëse kjo është e mundur apo një utopi, përbën çështje tjetër, por shenjohej si fundamentale edhe për këtë rast.

Letërsia si program ideologjik e social, pra e reduktuar edhe në program politik, do të kthehet në pragmatikë, në mësim social, por fiksioni është imagjinatë e gjuhë dhe mësimi i saj njeh të mundshmen letrare e jetësore si të mundshme të diskursit letrar, ndërsa njohja letrare, e lidhur me të mundshmen, bëhet universale, e kërkuar dhe e provuar përtej një situatë e një ambienti.

Vepra e Mekulit do funksionin pragmatik të letërsisë dhe vetë tradita e veprave të tilla e provon se letërsia ecën krah pragmatikës e jetës, duke u ngjarë atyre, por pa u identifikuar. Kjo traditë u kthye në traditë të një utopie të provuar me vepra e me autorë, e cila vetë e provon të jetë kthyer në iluzion të funksionit pragmatik.

Nëse jo *mësim*, ky do të jetë një *shenjim*.

VII PROVA E LEXIMIT

Provën e leximit e jep vetë poezia e Mekulit. Ndërsa, *shembujt*, si prova të zgjedhura, lidhen me pëlqimet e kërkuesit, ashtu që të dialogohet në prerjet e leximit me tekstet e Mekulit. Por, si çdo zgjedhje, edhe kjo shenjon e hap leximin e ri. Ndërsa, e përqendruar, me figurat, imagjinimet e projeksionet e ideve, vepra e Esad Mekulit lexohet te *Malli për të pambërrijshëmen*, poezia më e bukur e tij.

MALLI PËR T'PAMBËRRIJTSHËMEN

*RÊT luejnë n' naltësi si qingjat n' kodrina,
ndërsa malli për t'pambërrijshëmen ndryhet n' mue:*

*Dishroja me u kapë në vallen e rêve kuqlue
e me fluturue në t' shkëlqyeshmet naltësina
me gëzimin e kangës baritore...*

*E kur hana luginave ia beh n' shpejtí
dhe toka natën n' dishrim thërret,
si rrezet e argjendta mbi kallí -
të shkoj
e t' vizitoj
skajet e dhimjes e vendet ku ndjeva ankthet.*

*Vaj! Me u kapë n' vallen e rêve n' kuqlime
zemra me t' dhanun do t' më dishronte -
që rinija t' gërthasë 'i herë mâ me gëzime
dhe mall i zemrës s' vuejtun t' gufonte.*

- Por, pse zemra tingllon përmallshëm si zâ n'drithtim
dhe droja kaplon thellë zemrën e shpirtin tim?!

Kur dishroj aq rêt mbi qytet me i soditë,
ndërsa malli për t'pambërrijtshëmen m'kapë, m'shafitë.

Tematika e veprës së Mekulit, si bosht ideologjik apo si rrjet temash, e si “tendencë për të ndikuar” provohet e përqendruar te poezia e tij më e njohur, *Popullit tim*, ndërsa lidh në një vend sensibilitet e ideologji te *Kangë intime*.

POPULLIT TIM

DESHTA, shum kam dashtë - dishrue,
që me kangë të trimnoj, me fjalën tande të ndrydhun
të ngrej fuqit prej gjumit...

Këndova (dhe kur m'ishte ndalue)
se edhe për ty, të përbuzun, do të vinte lirija

Këndova - mbi ditët fatlume, që do të lejshin
n'agim të liris për ty me popuj këtu e ngjeti,
mbi forcë të bashkimit mbarë...

mbi zotsin e mshehun tande
- unë, biri yt besnik dhe - poeti.

Po! N'errsín e shtypjes së randë sa shkambi
ndëgjove thirrjet që të bana me dalë n'dritë...
Pse për liri - me tjerë -

ke dhanë dhe ti
djers' e gjak... si etnit.

*Ke dhanë, i dashtun... Dhe sod, në liri,
 kur thembra e gjaksorit s'na shkelë dhe dora pa
 pranga mbeti,
 me ty këndoj mbi fuqin e ngjallun
 nën yllin që na prîn
 - unë, biri yt besnik dhe - poeti.*

KANGË INITME

Sehadetit, shoqes sime

1.

*FLOKËT tashmâ m'u zbardhën,
 kaloi e marra riní -
 e unë ende s'të gjeta!
 Mbi flatra të vjetëve
 e t'andrrave -
 zbulova kudo
 vetëm nga një pjesë tandën:*

*në qeshjen e Gjuljanës, nën muret e lashta të Sienës,
 rinija jote e çkujdesun më buzëqeshi;
 në synin e kaltërt t'Anicës - studente
 - mâ të kaltërt se deti - Opatís,
 unë njomsinë tande gjeta...
 (o, n'ata sy pasqyrohet shpirti!);
 dhe kumbimin e zanit tand - si vala kur vërshen
 si gurgullim i shadervanit në mbramjen e qetë verore -
 e ndjeva në Eskisheher, në bregun e Detit te zî.
 (Më bâhej, o bullgaresha Vankë,
 se selvijat prâjnë shushurimën e deti heshtë,*

bylbyli ndalet në rremb - i dejun prej fjalës sate!);
 dhe hirin e ecjes s'ate, hieshín e trupit tand
 - o, gjít tuej që rrahim me shpërthye
 këmishën e hollë me majën e thimthave) -
 pashë para kasollës në një katund brí Peje.
 (Argjeshka e dathun prej Qyshku,
 kumrí e vendit tem,
 kush kish mujtë bukurín me ta përshkrue!)...

Flokët tashmâ m'u zbardhën,
 kaloi e marra riní...
 Mbi flatra të vjetëve
 e t'andrrave
 kaq herë zbulova në tjera
 ty - shoqe t'andrrueme,
 ty - të vetmen - që me sy t'ambël më shiqon
 e m'përkëdhel me zâ që n'zemër prek.

2.

TË sòdis -
 Suedeze e bukur
 dhe m'kujtohen sytë e saj
 të kaltërt e t'kthjelltë si liqeni Ohrit
 kur uji âsht i qartë
 dhe në të çdo gjâ pasqyrohet;
 dhe shoh flokët e saj
 si kallijt e artë t'Dukagjinit
 kur nën erë valojnë;
 dhe buzët e saj
 që çelin si gonghe

tue pëshpëritë emnin tem...

Pse e dij:

*ajo është lule e pastër
e fushave tana -
dashunija për popullin tem,
për atdheun tem.*

Stokholm, 1953

3.

*MËNGJES vjeshte dhe dhom'ë ftoftë.
Ti më buzëqesh nga piktura:
- Mirë mëngjesi!*

*Dhe sikur t'ish pranverë -
dhoma është plot me diell,
me ty...*

*Pranë të kam -
më përkdhel me shikim:
- Mirë mëngjesi!*

*- O, kur do t'ndiej zanin tand
midis këtyne mureve vetmitare
dhe dorën tande të nxehtë
mbi krahët e mij!?*

4.

*NË vjeshtën e jetës sime,
në vetmin time*

*prune dhuratat e para
të gëzimit
pranveruer:
pranë teje
jeta m'u bâ dy herë mâ e bukur
(se vetëm së bashku
me grue
njeriu bâhet - Njeri!)*

*Bashkëshortja ime flokëverdhe,
grueja ime e dashtun!*

*Erdhe...
Nuk na zunë në djep
e nuk të dhanë për pare -
që mbas kanunit të t'parëve
të bâhesh robnesha ime -
të lindish fëmij
e të vujsh midis katër mureve...*

*- Jo. Se unë jam Njeri i rí
dhe ti - Femën e ré,
Shqipëtare e lirë, krenare,
e barabartë me të gjithë!*

*Erdhe...
Në vjeshtën e jetës sime,
prune dhuratat e para
të gëzimit
pranveruer.*

Bibliografia

Jeta e re, Lidhja e Shoqnive Kulturo-Arsimore për Kosovë e Metohi, Prishtinë, nr. 1, korrik 1949

Për ty, “Mustafa Bakija”, Prishtinë, 1955

Për ty (botim i dytë i plotësuar), “Rilindja”, Prishtinë 1963

Për ty (botim i tretë i plotësuar), “Rilindja”, Prishtinë, 1967

Dita e re, “Pionieri”, Prishtinë, 1966

Avsha Ada, “Rilindja”, Prishtinë, 1971

Vjersha, “Rilindja”, Prishtinë, 1973

Brigjet, “Rilindja”, Prishtinë, 1981

Rini e kuqe, “Rilindja”, Prishtinë, 1984

Drita që nuk shuhet, “Rilindja”, Prishtinë, 1989

Malli për të pambërrijtshmen, ASHAK, Prishtinë, 2006

I varuri i këndon lirisë, “Toena”, Tiranë, 2006

Poezi, “Faik Konica”, Prishtinë, 2006.

MIGJENI I ESAD MEKULIT

Poezia e Migjenit u përkthye relativisht vonë në gjuhën serbokroate. Përkthimi i parë i plotë i takon Esad Mekulit dhe shtëpisë botuese *Jedinstvo* të Prishtinës. Shumë kohë para këtij botimi, që i përket vitit 1968, Esad Mekuli kishte provuar t'i jepte lexuesit të kësaj gjuhe dy poezi të Migjenit, *Parathânja e parathânjeve* dhe *Kangët e pakëndueme*, të dyja botuar në *Knjževne novine* të Beogradit, gjegjësisht më 1958 dhe më 1959¹. Më vonë, më 1961, disa poezi të Migjenit (*Kanga skandaloze*, *Lutje*, *Vetmia e Dy buzë*) qenë botuar në periodikun *Stremenje* të Beogradit, përkthyer nga Mihajlo Zvicer dhe Ekrem Kryeziu².

Përkthimi i Esad Mekulit përmban vetëm poezitë, ashtu siç i kishte botuar Migjeni vetë, paraqitur me të njëjtin titull dhe në gjuhën tjetër, *Slobodni stihovi*. Këtij botimi, krahasuar me atë të vetë Migjenit (*Vargjet e lira*, 1936), që mund të konsiderohet i autorizuar; dhe me atë të Gjovalin Lukës (Migjeni, *Vepra*, 1954), i mungojnë katër poezi: *Rima e tretun*, *Shpirtent shtegtarë*, *Dy buzë* dhe *Mbas tryezës*. Përkthyesi nuk jep shpjegim pse këto poezi i ka lënë jashtë vëllimit. Ndërsa cikli *Kangët e fundit* është shtuar i plotë dhe me të njëjtën renditje si në botimin e vitit 1944.

Një përkthim i plotë i veprës së Migjenit, duke përfshirë dhe prozat, me titullin *Prekinuta melodija* (*Melodi e këputun*), marrë prej poezisë homonime të autorit, u bë vetëm një vit më vonë, më 1969, nga Hilmi Taçi (Hilmi Taçi) dhe shtëpia botuese *Rad* e Beogradit, në serinë *Reč i misao* (*Fjalë dhe mendim*).

Mund të quhet një përkthim relativisht i vonët, duke qenë se poezia e Migjenit në rusisht ishte botuar për herë të parë qysh në vitin 1954, nën kujdesin e poetit dhe studiuesit David Samoilov dhe të Roza Koçit, me ti-

¹ Esad Mekuli (prevod.), *Pogovor në Slobodni stihovi*, *Jedinstvo*, Priština 1968, s. 84.

² Idem, *ibid*.

tullin *Vepra të zgjedhura (Izbrannoje)*. Botimi rusisht pati nxitur edhe përkthime në gjuhë të tjera, duke përfshirë letonishten, gjuhë në të cilën e pati kthyer dhe botuar në Riga më 1958 pikërisht ai që e njohim si karakter të ironizuar në romanin e I. Kadaresë *Muzgu i perëndive të stepës*, Jeronims Stulpāns. Në italisht Migjeni ishte përkthyer e botuar në tërësi, me titullin *Poesie e prose*, qysh në vitin 1962, nga Jolanda Kodra. Në rumanisht gjithashtu Grigore Brâncuș e kishte përkthyer më herët (1967) autorin e novelave të qytetit të veriut, duke e botuar në kuadër të letërsisë universitare, me titullin *Fructul oprit (Mollë e ndalueme)*. Edhe në shqip, në Beograd, Migjeni qe botuar qysh në vitin 1963, nga enti i teksteve shkollore të Serbisë.

Migjeni i Esad Mekulit është me interes studimor jo vetëm sepse njihet mirë roli i tij si një prej ndërmjetësve më të suksesshëm të letërsisë shqipe në serbokroatisht e anasjelltas. Mund të thuhet se kanë qenë me fat shkrimtarët dhe poetët shqiptarë që u përuruan në këtë gjuhë përmes tij: Besim Bokshi, Ismail Kadare, Azem Shkreli, Ali Podrimja, Fahredin Gunga, Enver Gjerqeku, Rexhep Qosja, për të përmendur vetëm disa prej tyre.

Serbokroatishten Esad Mekuli e kishte pasur gjuhë krijimtarie për afro dy dekada, përgjatë viteve 1930-1940. Përkthimet nga kjo gjuhë e bënë atë një emër shumë të rëndësishëm jo vetëm për lexuesin shqiptar në Kosovë. Gjatë gjysmës së dytë të shekullit të kaluar, për lexuesin në Shqipëri, në kushtet e kontrollit të plotë të librit në gjuhë të tjera, përkthimet e *Rilindjes* ishin një dritare me shumë rëndësi. Përmes kësaj dritareje, përmes përkthimeve të Esad Mekulit, ky lexues njohu, sido që në kushte të vështira, Petar Petrović Negoš-in, Ivo Andrić-in, Branislav Nušić-in, Meša Selimović-in, Miroslav Krleža-n, për t'u mjaftuar vetëm me disa prej emrave të mëdhenj të bibliotekës *Mekuli*, siç do të mund ta quanim trashëgiminë e tij në fushë të përkthimeve serbokroatisht-shqip e anasjelltas³. Duhet pohuar se edhe vetë autoriteti i emrit të Esad Mekulit si përkthyes në frontespicin e librave të përkthyer e lehtësonte sadopak hyrjen e këtyre botimeve në bibliotekat e Tiranës.

Përmes përkthimit *Slobodni stihovi* të Esad Mekulit bëhet e mundur të verifikohen në një mënyrë tjetër, përmes tekstit dhe me mjete të mirëfillta

³ Për më shumë: Fadil Grajçevci, *Vepra letrare e Esad Mekulit dhe kritika e saj*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë 2013, f. 273-281.

letrare, raportet autor-përkthyes e krijues-rikrijues dhe më tej edhe të bëhen vëzhgime prapavajtëse për pozicionet e hershme historiko-letrare të Migjenit dhe Mekulit në lidhje me njëri-tjetrin. Pikërisht ky është qëllimi i kësaj trajtëse, objekti i së cilës nuk është përkthimi në vetvete dhe cilësia e tij.

Paralelet midis dy poetëve, që për më shumë se një gjysmë dekadë jetuan në bashkëkohësi krijuese, në rrafshin e motiveve dhe të shqetësimeve, në prerjen tematologjike dhe në vokacionin poetik, kryesisht në rrafshin përmbajtësor-ideologjik, janë bërë me kohë qartësisht të njohura prej studiuesve shqiptarë në Kosovë. Përkundër një tradite studimesh të jetëshkruesve dhe botuesve të Migjenit në Tiranë, në Kosovë e prej studiuesve shqiptarë në Perëndim, me kohë janë shtruar gjithashtu pyetjet nëse vepra e tij ishte në rrjedhat e modernitetit të letërsisë shqipe, të surrealizmit, të ekspresionizmit⁴, madje dhe të dekadentizmit⁵. Për veprën e Esad Mekulit, prirja e studimeve ka qenë më shumë krahasimtare, para së gjithash me Migjenin. Duket, për lehtësi terminologjike, nyjat ndërldhëse mes tyre janë quajtur ndonjëherë thjesht *përkime* apo *koincidenca*⁶. Po nuk mund të përjashtohet që kjo terminologji të ketë qenë e ndikuar edhe prej njëfarë druajtjeje ndaj termit *ndikim*.

Nëse poezia e hershme e Esad Mekulit dhe ajo e Migjenit janë të afërta *për koincidençë*, thjesht për shkak të kronologjisë, çështja do të ishte shumë e thjeshtë dhe pa ndonjë interes letrar, sepse rastësitë nuk luajnë ndonjë rol për lexime krahasimtare. Në këtë rast kalendari dhe të dhënat jetëshkrimore gjithashtu nuk do të përbënin argument as për t'i bashkuar të dy me *Brezin e viteve 1930*⁷, që është më shumë një nocion letrar se sa historik. Dhe për t'u sjellë më shkencërisht në lidhje me këtë çështje na vjen në ndihmë *Migjeni* serbokroatisht i Esad Mekulit. Përkimet, rastësitë

⁴ Ali Aliu, *Tregimi shkurtër i viteve tridhjetë (A mund të flitet për ekspresionizmin e Migjenit?)*, në *Rrjedhave të letërsisë*, bot. Rilindja, Prishtinë 1977, f. 7-24; Hysni Hoxha, *Lirika e Migjenit dhe ekspresionizmi*, në *Jeta e re*, nr. 3, Prishtinë 1984, f. 425-435.

⁵ Arshi Pipa, *Le mythe de l'Occident dans la poesie de Migjeni*, Sonderdruck aus., Südast-Forschungen, Bd. XXX / 1971, f. 157; Giuseppina Norcia, *Sulla poesia di Migjeni*, në *Albanistica*, nr. 2, ediz. Herder, Roma 1994, f. 291-302.

⁶ Idem, *Rreth koincidençave dhe ndikimeve*, po aty, f. 77 e vijim.

⁷ Idem, f. 81.

dhe *koincidenat*, ngjashmëritë *pa ditë njani për tjetrin*⁸, vihen në dyshim nëse shtrojmë pyetjen: *Migjeni* i përkthyer në gjuhën serbokroate, duke kërkuar një përgjigje brenda tekstit, i afron apo i përdallon ata të dy, krijimtarinë e tyre në vitet 1930?

Këtu meriton të përmendet një fakt tjetër shenjues jetëshkrimor dhe letrar i Esad Mekulit. Pas Migjenit, në vitin 1982, ai përktheu dhe botoi shqip, me *Jetën e re*, që e kishte drejtuar për disa dekada me radhë, një tjetër poet shumë të afërt për të dy: sllovenin Srečko Kosovel. Nuk i njohim arsyet pse nuk zgjodhi të përkthejë vëllimin *Pesmi*, me të cilin jo vetëm Migjenin, por dhe atë vetë, e lidhte shumë krijimtaria e fazës më të hershme, shpesh e quajtur edhe *migjeniane*, por *Integralet*, poezitë e mbetura në dorëshkrim, që do t'i takonin më shumë fazës së dytë, asaj të rrjedhës *cons*, siç preferohej të quhej *konstruktivizmi*⁹, botuar shumë kohë pasi Migjeni ishte ndarë nga kjo jetë. Po aq të mjegullta janë arsyet pse përkthimi shqip i Srečko Kosovel-it rrallë herë përmendet në kontributet e shumta të Esad Mekulit si një *medium i shkëlqyer* midis dy gjuhëve dhe dy sistemeve letrare¹⁰. Këtyre tre poetëve: Migjenit, Srečko Kosovel-it dhe Esad Mekulit, në kërkimet e sotme historiko-letrare të disa studiuesve të huaj, u përafrohet jo pa arsye edhe Giuseppe Ungaretti, poeti italian që më vonë mërgoi prej futurizmit në hermetizëm¹¹.

A e njihnin njëri-tjetrin Migjeni dhe Esad Mekuli? Që të pohohet se Esad Mekuli dhe Migjeni u shfaqën si individualitete krijuese *pa ditë njani*

⁸ Rexhep Qosja, *Dialogje me shkrimtarët*, bot. Rilindja, Tiranë 1979, f. 247.

⁹ Cronia, Arturo, *Storia della letteratura serbo-croata*, secondo edizione, ediz. Nuova Accademia Editrice, Milano 1956; gjithashtu David Brooks, *Srečko Kosovel - Life and Poetry*, in Srečko Kosovel, *The Golden Boat: Selected Poems of Srečko Kosovel* (translated by Bert Pribac & David Brooks), edit. Salt publishing, London 2008, 2011, p. 3-15.

¹⁰ Fadil Grajčevci, *Përkthimet në shqip, në Vepra letrare e Esad Mekulit dhe kritika e saj*, bot. i Institutit Albanologjik të Prishtinës, Prishtinë 2013, f. 274-278.

¹¹ Stephen Schwartz, *Under Empty Skies Falconers Weep, A Personal Survey of Modern Verse in Ex-Yugoslavia and Albania*, Part II, in *Contemporary Poetry Review*, July 2010; idem, *Migjeni dhe Fishta*, në *Fakti*, 25 prill 2003, f. 4.

për tjetrin¹², duke kuptuar me këtë vetëm një njohje të njëanshme, të mëvonshme, retrospektive, pas Luftës së Dytë Botërore? Për t'i dhënë përgjigje kësaj pyetjeje nuk mjaftojnë hamendjet. Bashkë me to dhe më shumë se ato duhen faktet jetëshkrimore dhe ato letrare. I njëjti arsyetim qendron edhe për pyetjen nëse Migjeni e kishte lexuar apo nuk e kishte lexuar poezinë e sllovenit Srečko Kosovel (vëllimi i tij *Pesmi* u botua në Ljubllanë në vitin 1927). Përgjigjja mund të ishte bindëse vetëm nëse do të provohej prej dëshmish letrare.

Është e vërtetë që *Vargjet e lira* të Migjenit u ndaluan (më saktë, u konfiskuan). Por po aq e vërtetë është se të gjitha poezitë e këtij vëllimi ishin botuar ndërkaq në revistat e kohës (*Illyria*, *Shkëndija*, *Bota e re*, *Përprjekja shqiptare*), disa prej të cilave njiheshin edhe prej shkrimtarëve përparimtarë të ish-mbretërisë serbo-kroato-sllovene. Jetëshkruesit puritanë të Migjenit, në mënyrë ahistorike, ia kanë spastruar të shkuarën prej miqësive që kishte pasur qysh në vitet e formimit si seminarist, duke e lënë në një rreth të ngushtë veprimtarësh me orientim bolshevik-kominternist. Por faktet janë ndryshe. Ndër të tjera, në vitet kur shkruante *Vargjet e lira*, Migjeni kishte miqësi me kompozitorin e njohur kroat *Kosta Manojlović*, njohës i muzikës tradicionale shqiptare, autor i *Pesme zemlje Skenderbegove* (*Këngë të tokës së Skënderbeut*) - përzgjedhje e gjashtë pjesëve për kor mbështetur në motive të këngëve popullore shqiptare (*zbirka od 6 horova komponovana po albanskim narodnim pesmama*, 1933)¹³. Një prej miqve të afërt të Migjenit nga radhët e klerikëve dhe teologëve ishte Levko Arsovski, i cili luajti rol parësor për organizimin dhe zhvillimin e punimeve të kuvendit të parë kishtar-kombëtar maqedon më 1945 (*prvi makedonski crkveno-narodni sabor*, *Skoplje 4 marta 1945*), gjithashtu dhe për

¹² Rexhep Qosja, po aty.

¹³ K. Manojlović e njohu edhe drejtpërsëdrejti botën shqiptare gjatë Luftës së Parë Botërore, duke qenë në përbërje të ushtrisë serbe (*za vreme prvog svetskog rata, 1915. sa srpskom vojskom prelazi Albaniju*). Ishte a slav monk, mbante ligjërata universitare në teologji dhe u mor gjerësisht me muzikën popullore shqiptare. Shih tek Eno Koço, *A Family of Songs: Reflections of Albanian Urban Lyric Song in Mediterranean*, in: *The Mediterranean in Music: Critical Perspectives, Common Concerns, Cultural Differences*, USA, Sacrecrow Press, 2005, p. 30.

themelimin e fakultetit teologjik (*Bogoslovski Fakultet*)¹⁴. Petro Janura, në studimin e tij monografik për Migjenin, duke sistemuar të dhënat e jetës së tij në vitet e seminarit, pasi veçon si ndër më të afërmit miq të tij Pandi Papanastastin dhe *Petar Kadić*-in, përmend gjithashtu edhe seminaristët Tihomir Antić, Jovan Velimirović, Branislav Kovačevski, Nikola Popovski, Božidar Stanković¹⁵. Shumë të dhëna që qenë bërë të njohura në studimet shqiptare në kapërcyell të dy kohëve (1992), duke iu referuar buri-meve arkivore të panjohura, tashmë janë provuar edhe prej studiuesish të tjerë. Migjeni njihje poezinë e mjekut Stefan Stefanović, që sundohej prej mitit niçean të Mbinjeriut. Në mjediset e seminarit diskutonte me miqtë e afërm rreth krijimtarisë së Miloš Crnjanski-t, në kontekstin e rrymave letrare të kohës: surrealizmi, dadaizmi, futurizmi. Migjeni e ndiente veten pranë poetëve të kohës, si Vukasović, Spiridonović-Savić, i cili konsiderohej si Rilke i ish-mbretërisë serbo-kroato-slllovene¹⁶. Ndërsa Arshi Pipa më vonë do të këmbëngulte se edhe *poetika programatike e Migjenit, e mbështetur mbi vargun e lirë*, ishte një ndikim prej Miroslav Krleža-s¹⁷.

Migjeni nuk ishte pa lidhje me sistemin letrar që zhvillohej në ish-Jugosllavinë e parë, ai jetonte me shqetësimet e letërsisë sociale-qytetare ish-jugosllave. Esad Mekuli gjithashtu jo: përgjatë dy dekadave me radhë krijimtaria e tij është e lidhur me gjuhën serbokroate. Në një farë mënyre, më 1955, kur botoi vëllimin *Për ty*, mund të thuhet se e rikrijoi, duke vijuar të njëjtën traditë të De Radës, traditën e auto-përkthimit. Gjatë viteve 1930 e më vonë vjershat e këtij vëllimi ai i kishte botuar në periodikë letrarë në gjuhën serbokroate. Letërsia jugosllave e asaj kohe jo vetëm që nuk ishte e huaj dhe e largët për të, por dhe i kishte krijuar miq e shoqëri. Nuk është e rastit që ftesës së tij për të protestuar kundër marrëveshjes Stojadinović-Ataturk për shpërnguljen e shqiptarëve (myslimanëve) iu bashkuan anëtarë malazezë, kroatë e serbë të shoqatës ku bënte pjesë. Srećko Kosovel, për të njëjtat arsye, për aq kohë sa jetoi e krijoi, u gjend midis dy gjuhësh, midis

¹⁴ Veljko Đurić Mišina, *Letopis srpske pravoslavne crkve 1946-1958*, Beograd, 2000-2002, s. 1306-1393.

¹⁵ Petro Janura, *Migjeni*, botim i *Flakës së vëllazërimit*, Shkup 1982, f. 21.

¹⁶ Rinush Idrizi, *Migjeni*, shtëpia botuese *Enciklopedike*, Tiranë 1992, f. 72-74.

¹⁷ Arshi Pipa, po aty.

dy sistemesh letrarë. Dhe sistemi i dytë ishte i përbashkët për të tre: gjuha serbokroate dhe letërsia sociale që zhvillohej në këtë gjuhë.

Migjeni, Esad Mekuli dhe Srećko Kosovel nuk kanë jetuar si ishuj të vetëveçar. Shkallët e vërtetueshme të një ndërtekstorësie që tejkalon frymëzimin, motivet, temat, shqiptimin e protestës qytetare, dëshmojnë se rastësitë nuk janë dhe aq rastësi. Dhe në këtë rast *Migjeni* i Mekulit merr një vlerë tjetër, sepse është *tekst i përbashkët*, i krijuesit dhe i rikrijuesit. Përveçse poetë të dy popujve të vegjël, përveçse të formuar në shkollë e gjuhë që mund të mos ishin të zgjedhurat e tyre në shumë pikëpamje; dy të parët fatkeqë jo vetëm në kontekstin e shoqërive ku jetuan, por dhe në jetën vetjake: tuberkularë dhe jetëshkurtër; përveçse poetë të të sunduarve, të skamnorëve dhe të të përbuzurve të shoqërisë; përveçse poetë të qytetit dhe të protestës, të tre shkruanin edhe në gjuhën serbokroate, të tre lexonin letërsi ruse dhe kishin lidhje të provuara me atë që njihet si *futurizëm i majtë*, *левый футуризм*, *futuristi di sinistra*, siç i kishte përkufizuar Leon Trotsky qysh më 1923¹⁸. Autobiografizmi, rrjedhat letrare dhe mjediset gjuhësore homoglotike ku jetonin, orientimi i përbashkët në poetika dhe parime estetike, mund të kenë qenë faktorë përafrues po aq sa dhe njohja në distancë e tyre, si *njohje leximesh*.

Pohimi se Migjeni dhe Esad Mekuli u gjendën pranë njëri-tjetrit *pa ditë njani për tjetrin* vjen në kundërthënie me pikëpamjen se Migjeni dhe Mekuli ndërkohë ishin *përfaqësues të një brezi krijues*, të një brezi jo në vështirimin kronologjik, të kohës së shfaqjes, por të orientimit estetik dhe qytetar.

Përafëritë në tekst, në motive dhe në frymëzim midis Migjenit dhe Esad Mekulit janë vënë re me kohë prej studiuesve. *Migjenin dhe Esad Mekulin i veçonin temat sociale dhe revolta*¹⁹. *Milosh Gjergj Nikolla është kryesues i letërsisë sociale në letërsinë e re shqiptare*²⁰. Ata ishin *dy poetë të një kombi*, që i afrohen aq shumë shoqi-shoqit përkah trajta e vokacionit

¹⁸ Лев Давидович Троцкий, *Формальная школа поэзии и марксизм*, në *Литература и революция*, Moskva 1923.

¹⁹ Ali Podrimja, *Poeti i guximit njerëzor*, në Esad Mekuli, *Malli për të pambërritshmen*, bot. i ASHAK, Prishtinë 2006, f. 6.

²⁰ Esad Mekuli, vep. cit., s. 83.

dhe mënyra e soditjes së realitetit mu për shkak se vetëdijën e tyre e drejton zhvillimi historik shoqnor dhe imperativi psikologjik, i krijuem mbrenda asaj atmosfere sociale²¹.

Sa i takon frymëzimit, shqetësimeve, zotimit qytetar, kuptimit të jetës, përmbajtjes sociale, frymës së protestës dhe fuqisë së idealeve për një shoqëri tjetër, të njëjtat përafëri mund të vërtetohen edhe midis vëllimit *Pesmi* të Srečko Kosovel-it dhe vëllimit *Vargjet e lira* të Migjenit.

Duke e vështruar ndërtekstorësinë e këtyre dy vëllimeve vetëm në shkallën e strukturës, përmendim fillimisht se që të dy i kanë ndërtuar librat e tyre të parë të ndarë në katër pjesë, të paraprirra nga një poezi e vetme. Të dy i quajnë krijimet e veta *kangë/këngë* dhe jo *vjersha/poezi*. Të dy shkruajnë për të shprehur mospajtimin me realitetin, refuzimin e mënyrës së rregullimit të shoqërisë, kërkimin e një bote më të drejtë, qortimin e së keqes. Të dy gjysmën e veprës së tyre nuk arritën ta shohin të botuar sa ishin gjallë: Migjeni *Novelat e qytetit të Veriut* dhe Srečko Kosovel *Integralet*.

Poezia e Migjenit dhe ajo e Esad Mekulit, ashtu siç është vënë re me të drejtë nga studiuesit, bashkohen edhe në figurshmëri. *Shumë censura që u janë bërë krijimeve të tyre kanë diktuar përdorimin e shpeshtë të reticencës, pauzës*²². Migjeni dhe Mekuli janë të vetmit poetë të traditës letrare shqiptare që përdorin parantezën brenda vargut, në formën e mendimit në kllapa ose të fjalisë së ndërmjetme (të ndërkallur), që konsiderohen jo vetëm shqiptime të thjeshtligjërimit, mjete të narracionit prozaik, por madje atentate vrastare për poetikën dhe retorikën, shkatërrimtare për vargun klasik. Mendimi në kllapa tek Mekuli shfaqet qysh në vitin 1934, me poezinë *Prej fëminisë*, pastaj po në ato vite me poezinë *Gjykimi*, për të mos iu ndarë deri në fund të jetës, me poezinë *Popullit tim; Në liqenin e zanave; Kangë intime; Plepat me jetë fëshfërijnë; Verë, mesditë; Butrinti; Grykëza* (1986); *O vlla, me sharrë në krah; Okupacioni; Në rrugën e jetës*²³. Mi-

²¹ Rexhep Qosja, po aty, f. 247.

²² Xhavit Aličkaj, *Përkimet letrare ndërmjet Esad Mekulit dhe Migjenit*, në *Fjala*, nr. 20/1984, f. 4.

²³ Esad Mekuli, vep. cit.

gjeni dhe Mekuli shkojnë deri tek *deestetizimi i vargut klasik*, ose tek *vargu estetik*, që nis me përemrin lidhës *i cili*, apo tek vargu që ndan arbitrarisht nyjën e mbiemrit prej mbiemrit vetë, duke e lënë në vargun paraardhës:

MIGJENI

Ka ardhë një kohë

në të cilën njerëzit po kuptohen fare mirë

për me ndërtue Kullën e Babilonit

Parathânja e parathânjeve

Tash shëgjetat e flakta të shprehjes s'uej zharitse

drejtoni kah qiella, në ball të hyut a dreqit

i cili fatin t'onë mbytte në mnijë të vet përpise

Zgjimi

Pranë saj zemra liget

Zemra e një plaku

i cili del te praku.

Shkëndija

Thellë në veten t'eme flejnë kangët e pakëndueme

të cilat ende vuetja as gëzimi s'i nxori

të cilat flejnë e presin një ditë ma të lumnueme

Kangët e pakëndueme

Detajet janë ato që mund t'i japin përgjigje pyetjes se nga ç'burim erdhën përkimet në krijimtarinë e dy poetëve: ose nga njohja e drejtpërdrejtë, ose nga një orientim i përbashkët estetik, për shembull, nga futu-

MEKULI

Prej shkopit t'nanës së zemrueme,

të motrës apo xhaxheshës,

mbi t'cilat kish ra barra e randë e jetës.

Prej fëminisë

Më kujtohet: porta e oborrit tonë ka

qenë ma e nalta n'lagje,

Por shumë e vjetër, pak e shtrembnueme,

me pullazin mb'lue prej myshku,

nën t'cilin ishte si n'ndonji dhomë t'vogël.

Po aty

E ti, sikur të ishte dhënë i tëri pas saj: posa

nis Dielli

të nxehë - vë çallmën e përhirtë të reve që, **të**

dashurën ta mprosh: kurse retë mirënjohëse ...

Alltau

Vetëm nga vjeshta e vonë dhe dimri, sa degët

zhvishen, shpërthejnë reflekset e rrezeve **të**

praruara të diellit e ato të argjendta të hënës.

Drejt diellit

rizmi²⁴, i cili e kishte në traktatin e vet ikjen prej klasikes, prishjen e gramatikës, shkatërrimin e rimës. Në këtë rast do të deideologjizohej edhe kuptimi tradicional i vargut të lirë si shprehje proteste politike tek të dy poetët, duke e vendosur atë në kuadër të teknikave dhe parimeve poetike.

Migjeni dhe Srečko Kosovel, në anën tjetër, kanë një prerje të dukshme ndërteksti, që, përveç strukturës së dy vëllimeve poetike të tyre, vijon dhe me titujt e poezive dhe përmbillet me fjalët-çelësa. Prej një krahasimi të thjeshtë mund të dalë se shpesh herë titujt e *kangëve* në *Pesmi* të Srečko Kosovel dhe në *Vargjet e lira* të Migjenit janë ose të njëjtët, ose konceptualisht të njëjtët, ose, së paku, figurativisht të njëjtët:

Srečko Kosovel, *Pesmi*

Balada, poezia e vetme jashtë katër cikleve.

Melanholija - Melankolia

Pesem o vrenju - Këngë për vlimin

Predsmrtnica - Para vdekjes

Ekstaza smrti – Ekstazë vdekje

Beli Krist – Krishti i bardhë

Vstajenje, smrt - Ringjallje, vdekje

Opolnoči - Mesnatë

Sredi noči – Në mesnatë

Tih vječer - Natë e qetë

Molitev – Lutje

Pesem ponižanih – Kënga e të poshtëruarve

Psalm - Psalm

Migjeni, *Vargjet e lira*

Parathânja e parathânjeve, poezia e vetme jashtë katër cikleve; krhs

Kanga që s'kuptohet

Nën flamujt e melankolisë

Zgjimi, Kanga e dhimbës krenare

Vuejtja

Vetmija, Resignata, Hidhet e përhidhet

Dy natyrat e Krishtit, Shpirtent shtegtarë

Kangët e ringjalljes

Një natë

Një natë pa gjumë

Dy buzë

Lutje

Kanga e të burgosunit, Poema e mjerimit

²⁴ Për lidhjet e Srečko Kosovelit me futurizmin dhe qendrimin e tij kundër zenitizmit shih ndër të tjera Janez Vrečko, *Srečko Kosovel in evropska avantgarda*, në *Kosovela poetika* (ured. Janez Vrečko, Boris A. Novak, Darja Pavlič), posebna številka, Ljubljana 2005, s. 45-51; po aty, Darja Pavlič, *Kosovel in moderna poezija: analiza podobja*, s. 31-32.

Sonet smrti – Sonet për vdekjen	Zgjimi
Novoletni sonet – Sonet për Vitin e Ri	Kangët e pakëndueme
Ne toži, drug – Mos padit, shok ²⁵	Sonet pranveruer
	Mbas tryezës

Nëse krahasimi do të zbritet në shkallën e fjalëve-çelësa, atëherë tre poetët do të bashkoheshin në një çerdhe identifikuese jo vetëm si poetë socialë, por dhe si krijues me prirje drejt një poetike të përbashkët: *kangë, vdekje, natë, dhunë, pranverë, zgjim, ringjallje, vlim, njeri, fat, shenjë, lypës, të mjerët, të untit, të poshtëruarit, melankoli, vuajtje, të pakëndueme, e pambrrijtshme*.

Migjeni, Srećko Kosovel dhe Esad Mekuli, edhe në qoftë se nuk e kishin njohur apo lexuar njëri-tjetrin, ishin brenda së njëjtës rrjedhë, që zakonisht identifikohet si letërsi sociale, por, në rastin e Ballkanit, do të ishte më mirë të veçohet për çka nuk ishte. Të tre këta poetë refuzuan në mënyrë të vendosur dhe prerazi një prej zhvillimeve kulturore më të çuditshme dhe më retrograde të asaj kohe në këtë pjesë të Europës, *zenitizmin*, prirja më antieuropeiste e gjysmës së parë të shekullit XX, që mbështetej në konceptin se qytetërimi i Perëndimit i kishte ezauruar mundësitë e veta, madje se qytetërimi si i tillë nuk kishte më mundësi progresi, prandaj kulturat fshatare dhe periferike duhet të zgjoheshin dhe të shpëtonin të ardhmen²⁶. *Madame Europe* nuk ishte gjë tjetër veçse një shembëlltyrë e disfatës. Perëndimi nuk kishte ç’jepte më. Bota kishte nevojë për një *manifest të shpirtit dhe mendimit barbar*, që të sundonte gjithë kontinentin (*manifest varvarima duha i misli na svim kontinentima*)²⁷. *Duart lart, antibarbarë! Duart lart, antizenitistë (Ruke u vis antivarvari! Ruke u vis antizenitisti!)*. Agresiviteti i lëvizjes më të madhe antieuropiane në Ballkan arriti deri tek kjo thirrje. Zenitizmi u paraqit madje dhe

²⁵ Të gjitha citimet janë si në botimin: Srećko Kosovel, *Pesmi*, Ljubljana 1927.

²⁶ Për qendrimin që dëshmoi letërsia dhe kultura shqiptare ndaj zenitizmit antieuropeist shih tek Arben Xhaferi, *Zenitizmi dhe neo-shqiptarizmi*, në *Mendimi shqiptarë dhe shkolla shqipe*, bot. i Qendrës së Studimeve Albanologjike, Tiranë 2009, f. 37.

²⁷ Ljubomir Micić, *Manifest varvarima duha i misli na svim kontinentima*, izd. Zenit, br. 38, Beograd 1925.

si formë origjinale e futurizmit. Për fat të mirë, në Shqipëri nuk pati ndonjë gjurmë të zenitizmit, aq më pak në formën e një antieuropeizmi programatik, si ai i zenitistëve, shpallur pikërisht kur mendimtarët europeistë kishin themeluar konceptin e *Paneuropës* (Aristide Briand, Romain Rolland, Robert Schuman).

Sa i takon ndonjë zhgënjimi a shkrimi ndaj Europës, shprehur edhe në formën e protestës kundrejt saj, sidomos në *Lahutën e Malcës* të At Gjergj Fishtës, këto gjithashtu nuk kanë lidhje me zenitizmin, por me fatin e ndëshkuar të shqiptarëve në kohën kur ata kërkonin shtetin e tyre kombëtar.

Migjeni, po ashtu dhe Srečko Kosovel e Esad Mekuli, shkuan deri në pragun e humbjes së besimit tek individ. Dhe kjo i çoi gjithashtu edhe tek denoncimi i dekadencës së Perëndimit²⁸. Por në asnjë rast, *idealet negative* dhe *ritmet e ulta* që përmendte E. Koliqi qysh më 1934 nuk e larguan nga dashuria njerëzore: *Ky kangtar djaloç, me zemër të ndrydhur në një përshtirni shoqnore, mund të na falë kur t'a gjejë kthielltin e trajtës e zotnimitin e landës - një kangë shpërblyese dashunijë njerzore*²⁹. Për Koliqin, ajo pjesë e veprës së Migjenit, që mund t'i japë vend në *letërsinë mikpritëse shqiptare*, nuk qëndron aq në poezinë e tij **të vrullshme** me *sfond social*, sesa për disa **ritme të ulëta (intime)**, të cilat të kujtojnë Corazzinin, ku shprehet **ankthi** për shkrirjen e ngadaltë të *linfave vitale* që, duke i holluar ndjesitë, i zbulon bukuri shkëlqyese, të papara më parë, të botës nga e cila është e dënuar të *shkëputet shpejt*³⁰. Koliqi e përfronte poezinë e Migjenit me disa *elementë të rrymës intimiste jugosllave* të njohur si rryma e *pisateli ranoçarani*, apo e *poetëve të zhgënjyer*, që të kujtojnë *brezin e humbur*, thelbi i të cilit ishte shpallja e disfatës së individit si dështim i shoqërisë.

²⁸ Dritëro Agolli, *Очерки и рассказы революционного албанского писателя Мидьени - Skicat dhe tregimet e shkrimtarit revolucionar shqiptar*, tezë diplome mbrojtur nga autori në Universitetin e Petersburgut më 1957, parashypje e Akademisë së Shkencave, Tiranë 2016, f. 34; gjithashtu Shaban Sinani, *Migjeni i Dritëro Agollit*, po aty, f. 115 e vijim.

²⁹ Ernest Koliqi, *Në lulishten letrare*, bot. në *Illyria*, 1934, f. 3.

³⁰ Ernesto Koliqi, *Evoluzione storica della lirica albanese*, në *Shëjzat - Le pleiadi*, Roma 1962, f. 12.

Por ky zhgënjim nuk u përkthye asnjëherë në antieuropeizëm dhe ca më pak në mit të barbarisë e në lartësim të kulturave fshatare e periferike. Gjithnjë sipas Koliqit, mosbesimi i poetit në fuqinë e njeriut dhe pikëpyetjet e tij për përballjen e tij me fatin janë *tipare të ngjashme me poezinë mesianike futuriste ruse*³¹.

Edhe Arshi Pipa, që ngulmoi për një karakter të dukshëm dekadent të poezisë së Migjenit, dekadencën nuk e shihte si dështim të Perëndimit, përkundrazi, Perëndimi ishte mit themelor i tij³². Mesianizmin dhe të ashtuquajturin *ideal negativ* të poezisë së Migjenit, që shpesh identifikohet edhe me mënyrën borgjeze të jetesës³³, që nga E. Koliqi, deri tek A. Pipa, e kanë cilësuar tipar të futurizmit. As Migjeni, as E. Mekuli, as S. Kosovel; me gjithë pesimizmin e tyre, në kufijtë e dëshpërimit, nuk e barazuan *depressionin e madh* të kapitalizmit të viteve 1929-1932 me dështimin përfundimtar të shoqërisë dhe të qytetërimit dhe as rrezikun që i kërcënohej botës prej fashizmit dhe nazizmit nuk e konsideruan si fatalitetin e pashmangshëm të njerëzimit. Të tre vuajtën për njeriun, paditën gjendjen, paralajmëruan të keqen, por njëherësh i pari priste *Mbinjeriun*, i dyti *tri shtatat e shenjta* dhe i treti përkryerjen, *Ecce homo*.

Tashmë ka dalë para studimeve edhe pyetja se deri në ç'skallë tre poetët ishin aq të ngjashëm me njëri-tjetrin edhe për shkak të orientimit traktativ të tyre drejt futurizmit. Për S. Kosovel-in, çështja është më e thjeshtë: vëllimi postum *Integrale* e qartëson kryekrejt lidhjen e tij me futurizmin, në formën e protestës ndaj gramatikës dhe rendit gjuhësor në përgjithësi. Tani vjen pyetja nëse ato dhjetëra e dhjetëra gabime dhe pasiguri gjuhësore që ka vënë re Petro Janura (në fjalorin e shmangieve vëre-

³¹ Idem, *Le nuove correnti della letteratura albanese*, në vep. cit., f. 225-226: *Zanafilla, përreth 1935-1936, e rrymës letrare që theksoi motivin social derisa arriti në një dhunë të tërbuar verbale, që shumë premtuese dhe tërheqëse. Një nga zërat më domethënës është ai i Migjenit.*

³² Arshi Pipa, vep. cit., f. 157: *Qëndron fakti se elementët krepuskolarë dhe dekadentë ekzistojnë në poezinë e Migjenit, të cilat duhet të merren parasysh nëse duam të kuptojmë mirë kompleksitetin e "këngëve të Perëndimit".*


³³ Paolo Chiarini (a cura di), *Introduzione*, në *Caos e geometria: per un regesto delle poetiche espressioniste*, ediz. *La Nuova Italia*, Firenze 1964.

hen mbi 300 raste) tek Migjeni janë, siç është pohuar, çështje e kompetencës gjuhësore, gabime teknike të rëndomta, apo janë qendrimet futuriste të vetëdijshme ndaj *robërisë* dhe *arrogancës diktatoriale* të rendit gjuhësor³⁴. E njëjta pyetje do të shtrohej edhe për poezitë e Esad Mekulit në serbokroatisht, por për të marrë një përgjigje të argumentuar do të dilte e nevojshme të verifikohej dhe shkalla e prekjes së tekstit gjatë autopërkthimit të vjershave më të hershme, ardhur shqip në botimin e vitit 1955 në Prishtinë, me përmbledhjen poetike titulluar *Për ty*.

Migjeni i Esad Mekulit mund të shërbejë si një prej çelësave për të deshifruar fazën më të hershme të krijimtarisë së tij. Në përkthimin e vitit 1968 ai nuk ndoqi traditën e përkthimeve të mëhershme, që qenë thuajse të gjitha të shoqëruara me shenjime shpjeguese, me karakter orientues - në mos edhe detyrues - për një mënyrë të disiplinuar leximi, me përjashtim të atij të vitit 1936. E. Mekuli nuk ndoqi as rrugën e Gjovalin Lukës, as atë të Skënder Luarasis, as David Samoilovin a ndonjë model tjetër. Edhe me këtë fakt, me heqjen dorë rreptësisht prej traditës së botimeve të anotuara, E. Mekuli tregoi një raport personal me poezinë e Migjenit: për shumëkënd ajo mund të kishte nevojë për kontekst, shpjegime, informacion shtesë, por për atë vetë jo. Ndaj dhe u mjaftua vetëm me një skicë fare të shkurtër të profilin të poetit, gjithsej dy faqe, në fund të vëllimit, ku, ndër të tjera, njofton se kishte menduar për një përkthim të tij qysh në fundin e viteve 1950.

³⁴ Stephen Schwartz, *Migjeni dhe Fishta*, në *Fakti*, 25 prill 2003, shkruan: *Migjeni (1911-1938) është themelues i stilit modernist i shqipes, një bashkëkohor i çmuar, në kontekst rajonal me Srećko Kosovelin - eksperimentalistin më të guximshëm mes poetëve të sllavëve të jugut. Që të dy kanë vdekur të rinj. Të dy kanë shumë gjëra të përbashkëta dhe ndajnë shumë gjëra në aspektin biografik dhe letrar, me poetët e tjerë avangardë, të cilët u paraqitën në botë gjatë asaj kohe. Ata përpiqeshin të rrotullojnë të gjitha vlerat ekzistuese, të shkruajnë kundër çdo kanuni dhe konvente letrare dhe t'i rrëzojnë barrierat ndërmjet mendimit dhe gjuhës, ndërmjet ëndrrës dhe realitetit. Migjeni dhe Kosoveli ndërkaq qëndrojnë të ndarë nga të tjerët, për dy shkaqe. Shkaku i parë është se ata e paraqitën modernizmin në letërsinë e tyre në mënyrë të vrazhdë. As shqiptarët e as sllovenët nuk kishin kaluar nëpër fazat intervenuese të simbolizmit, si dhe llojeve më gjentile të eksperimenteve estetike. Shkaku i dytë është se ata kishin një sukses të jashtëzakonshëm në bashkëdyzimin e avangardës me ndjenjën e rafinuar të gjuhës.*

Përkthimi i Esad Mekulit, duke i shpëtuar kurthit të robërimit të tekstit përmes interpretimit jashtëtekstor, siç ishte trashëguar në botimet e mëparshme të Gjovalin Lukës dhe Skënder Luarasit, por dhe në përkthimin e David Samoilov-it, nuk u shpëton dot ndërkaq disa leximeve ideologjike. *Parathânja e parathânjeve* përkthehet *Predgovor predgovora - Hyrja e hyrjeve*, ndërkohë që kuptimi i poezisë është *Profecia e profecive – Proročanstvo proročanstva*. Në shumicën e rasteve ndiqet i njëjti përdorim ideologjik i shkronjës së madhe, për të mbitheksuar në një lexim të orientuar diçka që nuk buronte nga vetë teksti: **Jetë e Re** (*Da našim guslama Novom Životu pesme da se poju, Neka ce čovjek rodi*); **Dielli** (*a mi volimo ljubavlju koja Sunce čini milije, Pisma mladosti*); **Epope, Ditë e Re** (*Da Novi Dani izgreju / Da stvori Epopeju, Neka ce čovjek rodi ...*); **Njeri i Ri, Epokë e Re, Kohë e Re**. Paralelisht, Esad Mekuli rikthen përdorimin e shkronjës së madhe për *Hyj* dhe *Perëndi*, penguar nga një drejtshkrim gjithaq ideologjik (*I do vrha Njena, do samo vrha trona – Predgovor predgovora; Pod nogama pazblešnelog Boga, Pisma bede*). Në këtë rast mund të ketë ndikuar si ndërhyrja e botuesve të Tiranës (në dorëshkrimin e Migjenit duket qartë ndërhyrja e një dore redaktuese për shumicën e rasteve të përdorimit ideologjik të shkronjës së madhe), ashtu dhe ajo që Ali Podrimja do ta quante *mashttrim ideologjik* të vetë përkthyesit.³⁵



Ndërhyrje drejtshkrimore në poezinë e Migjenit *Të lindet njeriu*.

³⁵ Ali Podrimja, vep. cit., f. 7.

Bibliografi:

- AGOLLI, Dritëro, *Skicat dhe tregimet e shkrimtarit revolucionar shqiptar*, tezë diplome mbrojtur nga autori në Universitetin e Petersburgut më 1957, përkthim shqip, parashlypje e Akademisë së Shkencave, Tiranë 2016.
- ALIÇKAJ, Xhavit, *Përkimet letrare ndërmjet Esad Mekulit dhe Migjenit*, në *Fjala*, nr. 20/1984.
- ALIU, Ali, *Tregimi shkurtër i viteve tridhjetë (A mund të flitet për ekspresionizmin e Migjenit?)*, në *Rrjedhave të letërsisë*, bot. Rilindja, Prishtinë 1977.
- BIHIKU, Koço, *Mbi veçoritë artistike të krijimtarisë së Migjenit*, në *Studime filologjike*, nr. 3-4, Tiranë 2000.
- BROOKS, David, *Srečko Kosovel - Life and Poetry*, in Srečko Kosovel, *The Golden Boat: Selected Poems of Srečko Kosovel* (translated by Bert Pribac & David Brooks), edit. Salt publishing, London 2008, 2011, p. 3-15.
- CRONIA, Arturo, *Storia della letteratura serbo-croata*, seconda edizione, ediz. Nuova Accademia Editrice, Milano 1956.
- FETIU, Sefedin, *Vepra e Migjenit dhe kritika e saj*, bot. Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë 1984.
- GRAJÇEVCI, Fadil, *Vepra letrare e Esad Mekulit dhe kritika e saj*, bot. i Institutit Albanologjik të Prishtinës, Prishtinë 2013.
- HOXHA, Hysni, *Lirika e Migjenit dhe ekspresionizmi*, në *Jeta e re*, nr. 3, Prishtinë 1984.
- IDRIZI, Rinush, *Migjeni*, shtëpia botuese Enciklopedike, Tiranë 1992.
- JANURA, Petro, *Migjeni*, botim i *Flakës së vëllazërimit*, Shkup 1982.
- JORGU, Kristaq, *Mbi identitetin etnik të Millosh Gjergj Nikollës – Migjenit, përmes një leximi të ri të poezisë “Kangë më vete”*, në *Përpjekja*, nr. 25, Tiranë 2008.
- KOÇO, Eno, *A Family of Songs: Reflections of Albanian Urban Lyric Song in Mediterranean*, in *The Mediterranean in Music: Critical Perspectives, Common Concerns, Cultural Differences*, USA, Sacrecrow Press, 2005.
- KOLIQI, Ernest, *Evoluzione storica della lirica albanese*, në *Shëjzat -Le pleiadi*, Roma 1962 f. 12.
- KOLIQI, Ernest, *Le nuove correnti della letteratura albanese*, në *Saggi di letteratura albanese*, ediz. Olschki, Firenze 1972.
- KOLIQI, Ernest, *Në lulishten letrare*, në *Illyria*, 1934.
- KONSTANTINOVIĆ, Zoran, *Expressionism and the South Slavs*, në *Expressionism as an International Phenomenon* (edit. by Ulrich Weisstein), Paris-Budapest, Akadémiai Kiadó 1973.

- KOSOVEL, Srečko, *Pesmi*, Ljubljana 1927.
- MARKOVIĆ, SLOBODAN Ž., *Ekspresionizam ali modernizam*, në *Književni pokreti i tokovi između dva svetska rata - Lëvizjet dhe rrymat letrare mes dy luftërave botërore*, izd. Obelisk, Beograd 1970.
- MEKULI, Esad (prevodilac), *Pogovor në Slobodni stihovi*, izd. *Jedinstvo*, Priština 1968.
- MEKULI, Esad, *Malli për të pambërritshmen*, bot. i ASHAK, Prishtinë 2006.
- MICIĆ, Ljubomir, *Manifest varvarima duha i misli na svim kontinentima*, izd. *Zenit*, broj. 38, Beograd 1925.
- MIŠINA, Veljko Đurić, *Letopis srpske pravoslavne crkve 1946-1958*, Beograd-Knin, 2000-2002.
- NORCIA, Giuseppina, *Sulla poesia di Migjeni*, në *Albanistica*, nr. 2, ediz. Herder, Roma 1994.
- PAVLIČ, Darja, *Kosovel in moderna poezija: analiza podobja*, në *Kosovela poetika* (ured. Janez Vrečko, Boris A. Novak, Darja Pavlič), posebna številka, Ljubljana 2005.
- PIPA, Arshi, *Historija e dhimshme e "shpirtit të ri"*, në *Kritika*, nr. 4, 1944.
- PIPA, Arshi, *Le mythe de l'Occident dans la poesie de Migjeni*, Sonderdruck aus, Südast-Forschungen, Bd. XXX / 1971.
- PODRIMJA, Ali, *Poeti i guximit njerëzor*, në: Esad Mekuli, *Malli për të pambërritshmen*, bot. i ASHAK, Prishtinë 2006.
- QOSJA, Rexhep, *Dialogje me shkrimtarët*, bot. *Rilindja*, Tiranë 1979.
- SCHWARTZ, Stephen, *Migjeni dhe Fishta*, botuar në *Fakti*, 25 prill 2003.
- SCHWARTZ, Stephen, *Under Empty Skies Falconers Weep, A Personal Survey of Modern Verse in Ex-Yugoslavia and Albania*, Part II, in *Contemporary Poetry Review*, July 2010.
- SINANI, Shaban, *Migjeni i Dritëro Agollit*, në Dritëro Agolli, *Skicat dhe tregimet e shkrimtarit revolucionar shqiptar*, parashtypje e Akademisë së Shkencave, Tiranë 2016.
- SUTA, Blerina, *Pamje të modernitetit në letërsinë shqipe: proza e shkurtër e Koliqit, Kutelit dhe Migjenit*, bot. *Onufri*, Tiranë 2004.
- VREČKO, Janez, *Srečko Kosovel and the European avant-garde*, *Primerjalna književnost*, nr. 28, Ljubljana 2005, Special Issue.
- VREČKO, Janez, *Srečko Kosovel in evropska avantgarda*, në *Kosovela poetika* (ured. Janez Vrečko, Boris A. Novak, Darja Pavlič), posebna številka, Ljubljana 2005.
- XHAFERI, Arben, *Zenitizmi dhe neo-shqiptarizmi*, në *Mendimi shqiptare dhe shkolla shqipe*, bot. i Qendrës së Studimeve Albanologjike, Tiranë 2009.

ТРОЦКИЙ, Лев Давидович, *Формальная школа поэзии и марксизм, пё Литература и революция*, Moskva 1923.

ESAD MEKULI: VERBI POETIK SI BURIM
SOCIO-IDEOLOGJIK**1. Konceptet opozitare**

Kahershëm është nisur dhe vijon edhe sot debati për mundësitë apo pamundësitë, imanencën apo redundancën që verbi poetik, në planin klasik të vrojtimit, të këtë funksionin e ngurtësimit, përçimit dhe të rikujtimit të *ideve e mendimeve njerëzore* dhe njëkohësisht të ruajë *estetikën* e ngulmuar artistike si burimësi të ëndërrimit njerëzor, e cila buron në laboratorin krijues të autorit dhe synon në *mallin për të pambërrijshmën*, të përdorim një varg të Esad Mekulit. Këto dy opozita brenda vet fenomenit të letërsisë shndërrohen në kokëçarje permanente akademike.

Pra, pyetja bëhet më e qartë kur kërkohet të kuptohet nëse letërsia bartë ide dhe se kur i bartë ato a shndërrohet në pragmatikë funksionale, e cila synon shërbimin e zgjedhur ndaj një kauze, në të shumtën doktrinare. Po në kuadër të shërbesës letrare a ka estetikë e spirit që kapërcen funksionin? Pra, këto dy opozita, së paku opozita në dukje, i përfaqëson bindshëm opusi krijimtar poetik i Esad Mekulit.

Sipas një konceptimi historik e sociologjik, pra të shfaqjes dhe të formësimit të Esad Mekulit poet, mund të themi se verbi i tij përmban shenjë e kohës, e cila përbashkon luftën për idealet e lirisë, dëshminë për situatën e rrethanat sociale e politike, (si lamentim poetik) dhe luftën për mirëqenien si rrëfim utopik. Pra, nga këto koordinata mund të hetojmë funksionin, madje insistimin autorial të shkrimtarisë me funksion së paku etik, që verbi poetik të jetë shenjë e rrethanave dhe e evoluimit social. Por, në kuadër të këtyre koordinatave a ka *suplement poetik*, i cili e kap lexuesin në *katarzën* e tij? Le të shohim pas një përvijimi sistematik të veprës së këtij poeti! Por, para se të analizojmë poezinë e tij me sistematikën e *close reading*-ut, të themi disa fjalë për autorin, mbi parimin e *legjitimitit* të interpretimit.

2. Autori e rrethi

Esad Mekuli i lindun në Plavë, (1916) i shkolluar në vendlindje, pastaj në Pejë, Sarajevë, Beograd e Zagreb, ku specializoi në fushë të veterinës, erdhi në Prishtinë si udhëheqës i Institutit të Veterinës, punë që e bëri deri në vitin 1960. Pra, shkollimi i tij kapi një pjesë të mirë të truallit jugosllav. Ishte udhëheqës në gazetën shqipe *Rilindja*, pastaj, bashkë me Zekeria Rexhën, themeloi revistën letrare *Jeta e re* për t'u inkuadruar mëpastaj në redaksinë e *Enciklopedisë* së Jugosllavisë për Kosovën (1978). Pra, *biografemat* e udhës së tij akademike e lidhin fort me hapësirat e formimit të tij. Kjo lidhje e kushtëzoi që në rini të kyçet në formacionet e ndryshme revolucionare për ta nisur kështu udhën e formimit të bindjeve të veta ideologjike, të majta, të cilat nuk i braktisi kurrë, madje edhe atëherë kur po luhateshin ato! Mund të themi se u formua si një *komunist idealist*, i ngjashëm me Hivzi Sulejmanin, i cili dhembje permanente kishte mungesën e shkollimit dhe të emancipimit të popujve. Duke e ndjerë thellë peshën negative të paditunisë, Esad Mekuli mund të cilësohet si një *neo-iluminist komunist* i kërkimit të barazisë së shkollimit dhe të lirisë për të gjitha etnitë e kësaj hapësire ballkanike!

Në shkrimin e verbit poetik u nis i ri, me botimin e vjershave nëpër revistat jugosllave që proklamnin të renë revolucionare për t'u etabluar si autor i poezisë me veprat *Për Ty* (1955), *Dita e re* (1966), *Avsha Ada* (1971), *Brigjet* (1981), *Drita që nuk shuhet* (1989). Që nga titulli i parë *Për Ty* deri në të fundit *Drita që nuk shuhet* simbol i tij mbetet *fryti i revolucionit*. Duke pasur nderin dhe përgjegjësinë që të jetë ndër latuesit e parë të verbit poetik në hapësirën e Kosovës dhe të hapësirave shqiptare në ish-Jugosllavi, Esad Mekuli u vu në cakun e një kritike afirmative, e cila veprën e tij e krahasonte dhe e përngjasonte me veprën e autorëve botërorë të *qartësisë letrare*, siç cilësoheshin Majakovski, Lorka, Jesenini etj., si dhe mjaft analogji u tërhoqën edhe në raport me poezinë e Migjenit. E vërtetë, Esad Mekuli nuk e nënkuptonte verbin poetik pa qartësinë e tij! Afirmacioni i kritikës letrare ndaj verbit poetik të Mekulit duket se përmbante dy elemente interesante: ishte modë e vlerësimit të shprehjes së “pastërt” letrare dhe të paekuivokshme, madje kritika e kohës manevronte

me autorët e afërsisë me bindjet e majta apo që presupozoheshin të tilla dhe nuk largohej nga nderimi i *personae auctoriale*, pra nga autori empirik Esad Mekuli, i cili edhe e motivonte këtë simpati ngase ishte njëri nga dashamirësit më të mëdhenj të shumë brezave letrarë, të cilët i ndihmoi në udhën e tyre krijuese e formuese. Këtu duhet të shenojmë kujdesin e tij me botimet në revistën letrare *Jeta e re*, të cilën e shndërroi në medium të tri dimensioneve themelore: botimin e veprave të autorëve të rinj, kulturimin nëpërmjet dijeve teorike-letrare të kohës si dhe nëpërmjet përkthimeve të shumta, të cilat i bënte ai vetë me një zell e durim të pashoq!

3. Prizmi i tashëm kundrues i poezisë së Esad Mekulit

Është fenomen i njohur se veprat letrare lexohen ndryshëm në kohë të ndryshme, duke ruajtur domethënien që u jep autori, ndërsa duke mundësuar kuptimet (si interpretim hermeneutik) që ua jep lexuesi. Sipas *domethënies së autorit*, pra Esad Mekulit, vepra letrare poetike duhet të jetë identifikim me thjeshtësinë! Populli e do gjuhën e thjeshtë, konkrete, vajtimin për hallet e tij, kujdesin ndaj zhvillimit dhe emancipimit, mbrojtjen nga agresionet e ndryshme, pra *kronikën poetike*, e cila verbin poetik e mendon si medium të bindjeve personale karshi udhës së pakthyeshme të popullit. Bindjet e Mekulit ishin fisnike, por gjithnjë në kuadër të utopisë së vëllazërimit e përparimit të popujve nëpërmjet dritës që sjell revolucionin si luftë ndaj së vjetrës penguese, sidomos të vjetrës politike. Dhe është tërësisht normale që kur në qeniën njërëzore thadrohet fort dëshira për të renë, e vjetra duhet të mbulohet, varroset e sa më shpejt të harrohet. Kështu që, domethënia e autorit për krijimtarinë poetike plotësohet tashmë edhe me synimin dhe ngulmimin e harresës ndaj së djeshmes dhe sforcimin e bindjes së poezia duhet të niset sot e këtu dhe të përcjellë me ngulm përparimin e njeriut të ri! Sipas kësaj del se kjo ide për shkrimin poetik, pra thjeshtësia stilistike dhe kujdesi misionar për shenjimin e fryteve të revolucionit, shndërrohet në obsesion ideologjik të vrojtimit të botës ku tashmë edhe verbi poetik burimësinë e ka në psikenë auctoriale ideologjike. Mbi parimin se bota duhet të jetë ashtu siç thotë pikëpamja ime ideologjike, gjithsesi se, nëse synim poetik është bota e pasqyruar apo populli, edhe poezia

duhet të bartë idetë e doktrinës të cilën e dua. Në këtë prizëm poezia për Esad Mekulin merr tipare pragmatike, edukative ideologjike e gjithsesi është funksionale duke e formuar vetëdijshëm emrin e hartuesit të tyre si *autor ideolog*.

Kur lexohet sot poezia e Esad Mekulit, duke pasur në mendje dome-thëniet e autorit, por edhe kuptimet që mund t'ia japim ne, padyshim se në mendje na hyn historia e zhvillimit të letërsisë shqipe në Kosovë si dhe e letërsisë shqipe në përgjithësi. Me barrën e ndryshimit të vetëdijes letrare, por edhe të ndërrimit të sensibilitetit artistik, gjithashtu edhe me largësinë nga preokupimet e kohës së shkrimit të tyre, kuptimi i sotëm për këtë poezi është i ngjashëm me *kujtesën e fëmijërisë*! Kujtesa e fëmijërisë gjithnjë është e këndshme, madje e nevojshme, mirëpo nuk mund të mohohet asesi procesi ireversibil biologjik, i cili fëmijërinë e sheh me simpati duke e ruajtur me nostalgji. Por, pasi që autori ynë Esad Mekuli kurrë nuk i ndërroi bindjet e fëmijërisë së tij poetike, mund të themi se në habinë e të tij të vazhdueshme me to *vdij i ri*, pra me bindjet personale se revolucioni është *Drita që nuk shuhet* (1989). Ky venerim i figurshëm vlen vetëm nëse fokusi ynë kap zhvillimin evolutiv të letërsisë së Kosovës dhe nuk zgjerohet në traditën e përgjithshme të letërsisë shqipe, sepse Esad Mekuli ruan epitelin e autorit *sui generis*, pra të autorit që ka markën e vet të pakrahueshme e ndërndikuese me autorët e traditës letrare shqiptare.

4. Veprat

Vepra me poezi *Për Ty* e botuar në vitin 1955 posedon poezitë përkushtuese të poetit karshi popullit të robnuar, por në esencë bëhet pak problematik saktësimi se cili është populli i Mekulit, populli si kategori etnike apo populli si nocion abstrakt apo revolucionar! Përkushtimi poetik vërehet qysh në vargjet nistore të tipit *me ty këndoj mbi fuqinë e ngjallun nën yllin që na pri' - unë biri yt besnik dhe - poeti* duke sforcuar poezinë e angazhuar apo kronikën e revolucionit. Dhe *ylli priu* në luftimin e vobektësisë dhe planifikoi emancipimin, për të merituar shumë poezi të kësaj natyre nga kronikani i tij poetik Esad Mekuli. Poezia nistore paraqet vuajtjen, mjerimin, vobektësinë dhe mungesën e lirisë, të cilat gjithsesi se do t'i

zhdukë revolucionit, i cili paraqitet me poezitë vijuese të luftës për ta çrrënjësuar psikenë e tij si *fëmijë i mjerimit*. Poezitë e luftës janë lavdet për heronjtë e vëllazërimit të popujve, të cilat amalgamohen me poezitë e paraqitjes së fryteve të revolucionit popullor, sidomos në fushë të emancipimit dhe të kërkesës për të drejta elementare të shqiptarëve në hapësirat ish-jugosllave. Meqenëse poezia mendohej si medium dhe autori i saj kishte zë jehues në nomenklaturën revolucionare janë utilitare poezitë e tij kundër shpërnguljes së shqiptarëve në Turqi, qoftë si thirrje ndalese apo lamentimi për fatkeqësinë nacionale. Sidomos kur nga habia portreton varjen e shqiptarit si pasojë e dhunës gjatë aksionit të armëve të vitit 1954 te poezia *I varuni i këndon lirisë*¹ ku çuditërisht i varuri kërkon më shumë liri, por kursesi nuk fyen apo refuzon sistemin! Autori nuk dyshon në bindjet doktrinare të tij edhe kur ato bëhen shkaktare të vrasjeve shqiptare. Të shtojmë këtu se në të njëjtën gjendje del edhe Hivzi Sulejmani te romani *Njerëzit II*, ku megjithë evidencat për vrasje masive të shqiptarëve, intenca e tij e shtyn të shohë përpara në realizimin e projektit të tij revolucionar.

Mbi këtë ide, e cila shndërrohet në ideologji, Esad Mekuli shkruan poezitë vijuese te vepra *Dita e re* (1966) në të cilën ku vëmendje të posaçme i kushtohet poetizimit të përparimit rinor, edukimit shoqëror, qoftë edhe si ideo-identifikim me rilindjen e natyrës, ku figurë themelore bëhet stina e pranverës si simbol i ringjalljes, për ta formësuar ditën e re, si maksimum themelore për ta harruar të vjetrën.

Në udhën e tij poetike vjen vepra me disa poezi *Avsha ada* (1971), me subtitullin *Vjersha nga ishulli*, ku vargu i Mekulit kap dy elemente themelore: *rrëfimin* dhe *përshkrimin*, dukuri kjo e prozës letrare. Në të 11 vjershat e kësaj përmbledhjeje, dominon ideja e gjetjes së harmonisë ndërmjet kulturave në *pikëprerje*, qoftë edhe duke e marrë si simbol ishullin turk të detit Marmara, i cili shikuar nëpër histori të konflikteve kishte përjetuar përplasje të shumta të civilizimeve. Mbi idenë e pajtimit të përbotshëm, qoftë edhe si ide e interesimit revolucionar për universalitetin e idesë së vëllazërimit e të bashkimit të popujve, Esad Mekuli viziton, përshkruan

¹ Duhet të theksojmë se vepra poetike e Esad Mekulit me titull *Për Ty* është botuar më 1955 dhe ka pasur edhe së paku dy ribotime të tjera, në vitin 1962 dhe 1967. Vjersha me titull *I varuni i këndon lirisë* është botuar në ribotimin e vitit 1967 të veprës *Për Ty*.

dhe sugjeron. Pra, poezia e tij edhe kur ka për temë natyrën, ekzotikën e hapësirën e huaj, gjithsesi se shoqërohet me idetë, të themi, humaniste të autorit për pajtimin e kulturave divergjente, por gjithnjë mbi filozofinë permanente të harrimit të së kaluarës për hir të së ardhmes prosperuese.

Një veti e përhershme e këtij autori është rishkrimi dhe ribotimi i vjershave, me synimin për të latuar edhe më tej vargun poetik. Pra, në udhën e tij krijuese poetike kemi veprat *Vjersha* (1973) dhe *Brigjet* (1981), të cilat nuk sjellin ndonjë ndryshim tematik, stilistik apo të themi shpërthyes poetik në krahasim me veprën pararendëse të tij. Me këtë rast duhet të vërejmë se, duke pasur gjithnjë në mendje gogolin ideologjik, i cili gjithsesi duket se të këtë qenë vrojtues, Esad Mekuli shkruan poezitë për kauzën e shqiptarëve vetëm për aq sa e lejon pikërisht *lëshimi pe* i gogolit. Mbi këtë “liri” hetojmë rikthimin e poezive kundër shpërnguljes së shqiptarëve, poezitë e ri-lavdërimit të heronjëve të komunizmit, poezitë njoftuese të udhëtimit në Shqipëri, ta zëmë për Butrintin si antikë e Kukësin e ri si zhvillim industrial, për t’iu rikthyer me ngulm fenomeneve e ideve të formimit të tij, të njeriut që duhet të besojë në idetë e majta edhe kur ato sfidohen nga forcat e brendshme ireversibile, të cilat gjithsesi se sjellin habi. Por, çuditërisht habia e Mekulit nuk zgjat shumë, sepse mbulohet nga ideja e perparimit si absolut ideologjik.

Pikëpyetja që del këtu dhe që e arsyeton etiketën se Esad Mekuli mund të cilësohet *autor ideolog* ndërlidhet pikërisht me një etiketë tjetër e vënë kjo ndaj poezisë së tij, pra e asaj se ky autor cilësohet si *poet i popullit*, një emërtim ky i pazakontë për kulturën literare, madje edhe vlerësuese letrare. Megjithatë, nëse e pranojmë emërtimin e tillë si të mirëqenë, pra Esad Mekuli - *poet i popullit*, atëherë pyesim ne, i cilit popull?! Ishin popull i tij shqiptarët e vrarë në vitet 20-të të shekullit të kaluar, të cilët u masakruan nga yrfitë serbe nëpër të gjitha fshatrat e Kosovës? Ishin popull i tij shqiptarët që u vranë jo larg vendlindjes së tij, në Tivar, për të cilët nuk dihet nëse shkroi ndonjë varg? Ishin popull i tij studentët e 68-tës e të 81-shit, të cilët u vranë e u dhunuan asfalteve të Prishtinës? Ishin popull i tij shqiptarët e kalbur nëpër burgje jugosllave që nga Goli Otoku e deri te Smërkovnica e Mitrovicës vetëm pse nuk pranonin idetë jugosllave? Ne jemi të vetëdijshëm se nuk kemi aq të drejtë të kërkojmë në letërsi për gjërat që nuk janë shkruar, për gjërat që nuk janë

etabluar në format e shkrimit. Por mendojmë se epiteti poet i popullit do të duhej të mirrte një përcaktues, pra Esad Mekuli del të jetë poet i popullit të menduar ideologjik.

Dhe të menduarit e popullit ideologjik nuk e lë të shohë popullin tjetër, duke e ndjekur kështu kursin e poezisë së tij, e cila deri në fund nuk largohet nga elozhi për revolucionin. Kjo filozofi më së miri argumentohet kur merret në lexim vepra e tij e fundit *Drita që nuk shuhet* (1989), e cila sa i përket ideve dhe stilit nuk dallon nga veprat paraprahe, qoftë edhe atëherë kur hetojmë poezitë e habisë dhe të dyshimit për çarjen e revolucionit. Por, është e habitshme se edhe kur nis shprishja e sistemit, Esad Mekuli nuk çlirohet nga ai për ta menduar si një fat personal të lirit nga barra e tij ideologjike. Esad Mekuli sikur vajton prishjen e tij duke e parë revolucionin si projektim utilitar në ardhmëri. Biri besnik i idesë së tij e mbron atë, qoftë edhe kur gradualisht ajo (ideja) e barazisë është në frymën e fundit.

Kur jemi te kjo permanencë e bindjeve të tij ideologjike, të cilat e kanë diktuar edhe verbin e tij poetik, duhet të përmendim edhe një vjershë të tij si ilustrim të qartë të kontinuitetit autorial në mendimin se poezia duhet të këtë funksion shoqëror, madje të jetë produkt i qartësisë së idealeve të menduara, të cilat duhet të ruhen në çdo situatë.

Ne, shikuar në rrafshin sociologjik të vrojtimit, e dimë se, në vitin 1971, një grup autorësh, të cilët nuk pajtoheshin me thatësinë dhe qartësinë e realizmit socialist, i cili qoftë si model jugosllav apo edhe i importuar nga Shqipëria po shfaqej në letërsinë e Kosovës, shkruan një tekst problematizues me titullin *Vox Clamantis in Deserto*, ku kërkonin më shumë simbolizëm e liri krijuese në rrugën letrare të Kosovës. Esad Mekuli, duke ruajtur bindjet e tij letrare të qartësisë, kësaj kërkesë estetike i përgjigjet me një poezi, më të njëjtin titull *Vox Clamantis in Deserto* me subtitullin *Të humburit në shkretëtirë... synimesh*, ku kemi vargjet fundore të tipit: ... *Vallë prapë natë Shkretëtirë/Ndër ne?/Errësirë Errësirrë Errësirrë/ Hata!/ E luftë luftuam (për ke?!)/E gjakun derdhëm (për çka?!).*² Moskuptimi i Esad Mekulit hetohet në dy elemente themelore: frika nga “errësira” krijuese, e cila do t’ia mjegullojë poetikën e verbit të qartë sugjerues, pra

² Esad Mekuli: *Poezi*, Faik Konica, Prishtinë, 2006, f. 310.

do ta zvetënojnë poetikën funksionale letrare dhe frika se nëpërmjet shpërthimeve risore në letërsi, si kërkesë për liri krijuese, do të shembeshin edhe idetë për barazinë e popujve sipas mësimave të revolucionit.

5. *Suplementi*

Pikëpyetja themelore që nxjerr lexuesi nga poezia e Esad Mekulit, vrojtuar në prizmin e ri, ka të bëjë me çështjen nëse literariteti i saj nuk qëndron në bindjen tërësore të tij ideologjike, por në vargun apo në disa elemente tipike estetike letrare, të cilat në krahasim me tërësinë, mund të cilësohen si *suplement letrar poetik*. Ndoshta ia vlen shkrimi dhe botimi i një numri të madh të poezive vetëm për një varg?! Për hir të suplementit letrar dhe për ta vlerësuar ndjeshmërinë poetike të Esad Mekulit do të veçonim vargun e tij te vepra *Për Ty, malli për të pambërrijshmen*, i cili qëndron fuqishëm në estetikën dhe filozofinë universale artistike. Në rininë e tij, Esad Mekuli e ndjente dhe e kuptonte si arti letrar është një formë e veçantë e *endërrimit*, e cila sado që mund të realizohej nëpërmjet vargut nuk e përmbush mallin për arritjen e idealitetit, i cili jeton në “mbretërinë” e mistershme të hapësirës së pambërrijshme, e cila me gjithë faktin se del të jetë primordialitet njerëzor, mbetet në misterin e vazhdueshëm të largësisë. Estetikën themelore poezia e Esad Mekulit e fiton edhe te vargjet e poezive që kanë për motiv natyrën të përthyer me ndjesimet humane të shpirtit rinor. Pra, mund të themi se Esad Mekuli rri më afër estetikës poetike në vjershat e para të tij, të cilat u shkruan në gjuhën serbe dhe u botuan nëpër revistat e hapësirës ish-jugosllave. Kjo jep edhe evidencën se rritja ideologjike del të jetë në disfavor të rritjes estetike poetike.

6. *Ndikimi*

Duke e parë poezinë si medium të emancipimit dhe të këndimit përparimtar, Esad Mekuli veproi fuqishëm në kulturimin e hapësirës letrare të Kosovës. Angazhimi i tij social e ideologjik ndikoi në jetësimin e poezisë së angazhuar të Kosovës, e cila u realizua fuqishëm nga autorët e tjerë të

Kosovës sidomos në vitet 50-të dhe 60-të, duke sprovuar dhe provuar trajta më të ndërliqshme të vargnimit poetik. Tashmë krijuesit e rinj (për kohën) kishin një model pajtimi apo mospajtimi, i cili ndikonte në rritjen mendimtare për poezinë shqipe në Kosovë. Ata që e donin *përshtatjen* me vijën ideologjike nëpër udhën historike të Kosovës kishin model poezinë e Esad Mekulit duke avancuar në poezinë e tyre vetëm në plotësime të ndjeshme motivore e stilistike. Ndërkaq, ata që kërkonin autonomi më të madhe në thellësinë e krijimtarisë poetike hynin në lojën normale të refuzimit për ta bërë të dallueshme poezinë shqipe të Kosovës nga afilacioni i ndjeshëm me bindjet ideologjike, madje duke e çuar deri në nivel të *refuzimit*. Pra, poezia e Esad Mekulit pati një ndikim të fuqishëm kulturor duke qenë themel i poezisë shqipe në Kosovë. Ky ndikim motivohej edhe më tepër kur dihet se hapësira shqiptare e Kosovës jetonte në vetminë e saj dhe kishin mbetur thuajse pa asnjë mbështetje nacionale sa i përket rritjes e konsolidimit të saj kulturor, social e politik. Në nisjen vetmitare të Kosovës, Esad Mekuli ishte prijatar e zë i fuqishëm i përparimit.

Bibliografia:

1. Aristoteli: *Poetika*, Rilindja, Prishtinë, 1984
2. Eric Donald Hirsch: *Validity of Interpretation*, New Haven & London, 1967
3. Esad Mekuli: *Avsha ada*, Rilindja, Prishtinë, 1971
4. Esad Mekuli: *Brigjet*, Rilindja, Prishtinë, 1981
5. Esad Mekuli: *Dita e re*, Rilindja, Prishtinë, 1966
6. Esad Mekuli: *Drita që nuk shuhet*, Rilindja, Prishtinë, 1989
7. Esad Mekuli: *Për Ty*, Mustafa Bakija, Prishtinë, 1955; Ribotimet, 1963 dhe 1967
8. Esad Mekuli: Poezi - *Vepra complete*, Faik Konica, Prishtinë, 2006
9. Esad Mekuli: *Vjersha*, Rilindja, Prishtinë, 1973
10. Nysret Krasniqi: *Letërsia e Kosovës 1953-2000*, AIKD, Prishtinë, 2016
11. Platoni: *Shteti*, Libri X, Rilindja, Prishtinë, 1984

PËRCJELLJA E POEZISË SË ESAD MEKULIT NË KRITIKËN LETRARE - SI KOHERENCË VLERASH

Është e njohur tashmë se ajo krijimtari letrare, e cila vazhdon të qar-kullojë edhe përtej jetës së autorit - në proces verifikimi e vlerësimi vijues, do të thotë, se ajo mbetet një vepër që mbart vlera dhe prandaj zotëron privilegjin të vazhdojë komunikimin me lexuesin e saj.

Nga konsultimi me kritikën letrare, e cila ka përcjellë krijimtarinë (kryesisht atë poetike) të Esad Mekulit, na rezulton që të jenë përmbi 100 shkrime e studime. Sigurisht që është një numër i konsiderueshëm ky, po të kemi parasysh receptimin përgjithësisht elitar që e ndjek poezinë, rrethanë kjo, që ndikon e implikon gjithsesi, për inerci, edhe në raportet e kritikës me të. Rreth 20 prej këtyre teksteve kritike, janë publikuar në përmbledhje studimesh e revista letrare - edhe pas ndarjes nga jeta e autorit (1993), kryesisht të botuara ato në Kosovë, por një pjesë edhe në Shqipëri. Përcjellja vijuese e kritikës mbi këtë krijimtari, e dëshmon pra, potencën apo valencën estetike të këtij profili krijues – që mbetet pa mëdyshje, she-një e dalluar në kontekstin e poezisë shqipe të shek. të '20-të. Por ndërkaq, në këtë vëmendje koherente të kritikës, vrejme edhe gjestin e saj skofiar të *hirit të mirënjohjes* (po të huazonim një shprehje të Lasgushit), për t'i njohur, për t'i çmuar e për t'i vitalizuar ato kontribute letrare – që ishin the-meluese në një epokë të caktuar.

Në rendin e kritikës, poezia e Esad Mekulit është vlerësuar si artikuli-m *thyerjesh* të ndjeshme, të natyrës estetike dhe etike (A. Podrime), me spikamën e entuziazmit - por të formatuar si *qëndresë* (J. Buxhovi), si poeti që merret me të vërteta egzistenciale të *fatumit* kolektiv (R. Musliu), si rrënues mitesh të rrejshme dhe ndërtues i miteve realë e kurajues (Fadil Grajçevci), si krijuesi që e nisi krijimtarinë letrare larg orkestrës poetike shqipe – por jo i ndjerë vetmitar prej saj (R. Qosja), përkundrazi, që arriti të

bëhej një nga zërat e dalluar të mbarë sistemit të saj polifonik dhe, për më tepër, që do të merrte natyrshëm atributet e një autoriteti fort të besuar e të respektuar letrar, në hapësirën tjetër letrare – në atë pjesë matanë Shqipërisë politike. Prej këtij autoriteti të pacelebruar në protokoll, por të pranuar me miradije të vullnetshme, do të merrnin përkrahje e këshilla urtësie një radhë krijuesish, të cilët, do të afirmoheshin e do të bëheshin individualitete të shquara, nëpër kohë e gjenerata të ndryshme.

Në këtë rast, do të ndaleshim të sillnim në vëmendje përcjelljen që i ka bërë poezisë së E. Mekulit revista e njohur *Shêjzat*, e cila drejtohej nga E. Koliqi e M. Camaj dhe që siç dihet, dilte në Itali (1957–1978), duke arritur të ketë brenda 20 vjetësh, një koleksion me plot 19 numra të saj, përfshirë këtu edhe botimin e fundit përkujtimor - kushtuar Koliqit (1978), të ndarë nga jeta më 1975. Veçanërisht Koliqi, rezulton të ketë treguar vëmendje të posaçme për letërsinë shqipe që zhvillohej në Kosovë, duke e ndjekur sistematikisht atë, qysh nga fillimet e saj. Madje, në fundin e viteve '50 ai botoi në revistën e tij edhe një studim të gjerë të titulluar: *Dhjetëvjetori i së përkohshmes Jeta e re (Shêjzat*, nr. 11-12/1959), ku merrte në shqyrtim procesin letrar të zhvilluar në Kosovë, në harkun e viteve '50, me prirjet dhe individualitetet që kishin nisur të spikasnin.¹ Dihet se botimet letrare të kësaj kohe, këtu janë të pakta, por Koliqi ka intuitën të dallojë buisjet dhe vlerat e pritshme, që koha e mëpasme i dëshmoi. Në këtë studim, bën përshtypje sidomos, një kapitull i titulluar me konotacion parashikues: *Letërsi e re në brumosje*, ku përvijohet besimi i tij inkurajues se, ajo krijimtari, që sapo ka nisur (citoj): *Asht një botë poetike n'agim, një letërsi e re në trajtim, në brumosje... Në magjet hyjnore të Zanavet po gahet...* Vështirë t'i gjendet një model i ngjajshëm kësaj fraze/paradigme të fundit (*Në magjet hyjnore të zanavet gahet...*), për nga vlerësimi i lartë e me aq stimë, që i bëhet rolit të letërsisë, konkretisht në kontekstin real të Kosovës, si një mision thuajse i thirrur prej destinatës hyjnore.

Shtruhet pyetja: çfarë e shtynte Koliqin dhe ku mbështetej ai, drejt këtyre parashikimeve të tij kaq bindëse, apo kaq optimiste, po të kemi parasysh se në Kosovë, botimet letrare të kësaj kohe, janë të pakta dhe pothuaj ende të papërcjella nga kritika?

¹ Shih: *Kritika letrare në Shêjzat*, Y. Çiraku, E. Plaku, Albas, 2014

Si ndjekës dhe njohës i vëmendshëm i realiteteve shqiptare e më gjerë, Koliqi, me sa duket e kishte mirë parasysh se në Kosovë, ndonëse mund të egzistonin sfida e vështirësi/pengesa të natyrave të ndryshme për krijuesit, atje gjithsesi, rezultonte të kishte liri estetike, për të ndjekur e për të aplikuar në krijimtarinë e tyre modele nga më të avancuarat, e deri ekipe- rimente shkollash e drejtimesh letrare. Dhe këtë realitet letrar, në raportin e saj me sistemin tërësor të letërsisë shqipe, ai e shihte si mundësi kompen- simi e ekuilibrimi, krahasuar me kufizimet dhe atrofizimet që krijonte në Shqipëri orientimi obligues/detyrues - për zbatimin në letërsi të doktrinës dogmatike të realizmit socialist. Në këtë kontekst rrethanash kontraverse - për tërësinë e një letërsie, duket se ai konstaton që kjo krijimtari, e cila po nis të krijohet në Kosovë, fatmirësisht, nuk po bie në moçalet e roman- tizmit të tejkaluar dhe, sidomos e kryesisht tek poezia, që është edhe lloji më i lëvruar kësaj kohe, vren sipas rastit: jehona të futurizmit, të ekspre- sionizmit, surealizmit, ku drejtimin shpirtëror dhe stilistik e orienton, si- kundër shprehet ai: *veç një Verb urdhmuar rilindjeje...* Dhe e përcakton konkretisht profilin e Esad Mekulit, si poet i energjisë dhe i ndjelljes së rilindjes, ku poezitë dominohen nga ritmi fonetik, që ndihmon për t'i potencuar tonet apelonjëse të stilit koral, por që dëshmon edhe një grafikë vlerash ngjitëse, sidomos në zotërimin e gjuhës poetike.

Siç vren Koliqi, ky poet *...është në gjendje m'e stolisë kângën e vet me tingujt mâ të lëmuet...* Dhe koha e mëpasme do ta konfirmonte këtë para- shikim të tij optimist, optimizëm që nxitej e buronte prej zemre sigurisht, por para së gjithash, merrte shkas e vinte prej realiteteve letrare, të cilat po formatoheshin stilistikisht prej kësaj hapësire. Dhe kjo ndodhte, pasi Koliqi i ndiqte sistematikisht ato zhvillime letrare dhe njëherazi, me një lloj misioni përkujdesës prej mecenati të përkushtuar - vërtet prej së largu, nga ku qendronte i detyruar, si njeriu *i larguar/i përjashtuar* - siç e kishin shpallur të vetët, por që ai vet, ishte i vendosur të mos ndahej dot kurrë prej tyre, prej të vetëve, qoftë edhe përmes letërsisë.

Në mesin e poetëve të rinj, që shpalosin shkëndija vlerash poetike si: Din Mehmeti, Hivzi Sulejmani, Mark Krasniqi, Enver Gjergjeku, Azem Shkreli, Murat Isaku, Besim Bokshi, Fahrudin Gunga, Muhamet Kërveshi etj. dhe që këtë gjeneratë krijuesish ai do ta pikturojë me tis metafore si *Vallja e poetëve*, Koliqi do të dallonte, pra veçmas, Esad Mekulin. Ai e

përcakton/vlerëson atë si korife të kësaj valleje, i bindur ndërkaq, të bëjë sqarimin se në republikën e *stërlirë* të letrave, nuk ka grada të vulosura hierarkike, pasi e ka fort mirë parasysh se çdo krijues, tek e fundit, është vlerë në vete, me autonomi dhe unikalitet estetik. Të bën përshtypje hiperkualifikimi i lirisë (kujtojmë përcaktimin: letërsia si *republikë e stërlirë e letrave*), konceptuar si një situatë normale që duhet të funksionojë doemos në fushë të letërsisë, si garanti bazik për nxitjen dhe prosperitetin e saj. E sigurisht, ky gjykim përthyeret në atributet e asociacionit alegorik, i cili, i shkonte për shtat situatave të rënda me të cilat ndeshjet letërsia shqipe, kryesisht në Shqipëri. Por brenda lirisë funksionale në letërsi dhe bonsensit për të çmuar kontributet vetiake, ndërkaq, kurrsesi nuk mund t'i iket anash relievit të saj, që krijohet prej garës krijuese dhe që vet ky Olimp letrar, bëhet pastaj shtysa e pandërprerë e asaj gare, e cila nuk mund e nuk duhet të shuhet dot kurrë. Në këtë kontekst, Mekuli vlerësohet me tone të larta venerimi, si poeti i parë i *ndjelljes* së rilindjes së një letërsie. Pra, ai ka fituar atributin e prijësit dhe kjo nuk ka ardhur rastësisht, por sepse ka dëshmuar se ai është (citoj): *Shumë i përgatitun si letrar, i begatun me ide a shllime të hovshme, e përdor artin poetik, si vegël ndërtuese në lamin shoqnuer...*² Madje Koliqi konstaton e bën vlerësime, do të thoshim nga ato të rendit të parë, se: aty tingëllojnë klithma mesianike e kushtime sociale, agime këndellëse të një *madhënie* (madhështie) biblike, jehona të trajtave korale të Uollt Uitmanit ..., të cilat, do të gjykonim se mund të bënin secila në vete, teza/argumente intriguese studimi.

Koliqi ka bindjen se Esad Mekulit dhe poetëve të tjerë, që kishin nisur të shfaqeshin përmes botimeve të tyre (citoj): ... *po u buzëqeshë prej s'largu Lavdija e majeve të Parnazit*. Dhe, duke e parë këtë rrjedhë letrare të krijuar në Kosovë si gjymtyrë të së tërës, nënvizon se ajo letërsi e re për nga koha e lëvrimit - por mjaft vitale për nga prirjet e reja estetike që po projekton, është e *ruajtun nga Ora e amshueme e Fisit* – që do të thotë se vlerësohet/përcaktohet pa mëdyshje, sikundër ajo edhe është: pjesë e pandarë e EtnoUnikumit letrar shqiptar.

Mund të konkludojmë se këto vlerësime të Koliqit për E. Mekulin, marrin rëndësi nga shumë anë. Ato janë modeli i kritikut le ta themi *mili-*

² E. Koliqi, V. 5, Konica, 2003, f. 348

tant, i cili, ka kërshërinë dhe vullnetin e pandalur/sistemor, për ta ndjekur procesin letrar në të gjitha skajimet. Për më tepër, për të arritur të dallojë/veçojë krijuesin, në këtë rast E. Mekulin, i cili, jo vetëm shfaq talentin e tij, por u bë nga ana tjetër, gjerator inkurajues e nxitës për krijuesit e tjerë. Dhe Koliqi, i lajmëroi me ngazëlli këto sinjale, duke i afirmuar qysh në krye të herës, me pritshmëritë e sigurta të risive të tyre konceptuale e stilistike, të cilat, nuk do të vononin të shfaqeshin në meset letrare të Kosovës. Dhe kjo siguri e tij, kishte të bënte, me sa duket, me besimin që i vinte prej atij instikti të bekuar, që ia jepte aureola e shkrimtarit dhe e personalitetit të shquar, sikundër ai vet kishte dëshmuar të ishte.

ESAT MEKULI DHE LETËRSIA SHQIPE E
VITEVE '70

Tema ime **Esat Mekuli dhe letërsia shqipe e viteve '70**, presupozon një shqyrtim figurës letrare të poetit tonë në kontekst të kohës së apostrofuar në titull, ku kryqëzohen dhe kulmojnë vlerat e pakontestueshme të një vargu individualitetesh letrare shqiptare, kur poeti e rrumbullakësoi profilin e tij letrar. Krahas tre librave poetikë, **Për ty, Brigje dhe Afsha Ada**, të botuara para viteve '70, gjatë dhe pas atyre viteve, që marrë në përgjithësi, nuk paraqet më tepër se një libër të trashë poetik, Esat Mekuli nuk ka botuar më vonë pothuaj asgjë, pos ndonjë poezie të rrallë. Kjo i bie se poeti ka shkruar pak, diçka si edhe Lasgush Poradeci e Migjeni, por vlerat e poezisë së tij mund të vlerësohen lehtë, ndryshe nga këta poetë, kurse për këta poetë kanë shkruar dhe shkruajnë së rreshturi edhe sot. Në të vërtetë, kritika letrare e kohës, kahmot e ka thënë mendimin e saj për këtë poezi. Për poezinë e poetit është shkruar më shumë se pothuaj për çdo krijues tjetër të Kosovës. Në kohën kur u botuan poezitë e poetit, kritikët letrarë e shquanin aktualitetin dhe angazhimin e madh të autorit ndaj rrethanave kohore, kështu që mendimi i tyre përherë ishte në kolizion me atë kohë dhe në përgjithësi ishte në superlativ. Arsyeja është, sepse ajo poezi ishte përgjigje rrethanave politike të asaj kohe, të kohës së para Luftës së Dytë Botërore, gjatë dhe pas saj, prandaj ato s'ishin larg vetë ideologjisë së asaj gjuhe dhe të atij verbi poetik. Në shtypin e kohës, ka shkrime e mendime të ndryshme për poezinë e poetit, dhe kritikë të ndryshëm, shqiptarë, jugosllavë dhe të huaj, flisnin pozitivisht për poezinë e poetit, natyrën teorike të saj, vlerave të saj. Krahas shqip, poezitë e poetit qenë prezentuar dhe përkthyer edhe në gjuhë të ndryshme të hapësirës së Ish Jugosllavisë dhe ato sot gjenden të prezantuara nëpër antologjitë më në zë të kohës, me përkthime të mrekullueshme që s'ishin vetëm të arealit sllav, por edhe të gjuhëve tjera të shtetit që s'është më.

Me një fjalë, ndryshe nga krijuesit e tjerë, për Esat Mekulin shkruhej shqip dhe në gjuhë të tjera, dukshëm më shumë se sa për të gjithë të tjerët. Tash kjo ngjet sikur janë thënë të gjitha dhe s'ka më çka të thuhet, pos që të përsëriteshim, edhe pse diktuar nga aktualiteti, gjërat mund të thuheshin edhe ndryshe, me metoda më të reja që shkenca e letërsisë prin me përvoja dhe ekspertiza teorike që ne akoma nuk i njohim. Për kërkuesin tuaj, unë këtu më poshtë do të orvatem të flas për Esat Mekulin në relacion me disa autorë të tjerë shqiptarë që krijojnë në kohën e emblematike të viteve '70. Kjo dekadë, pra vitet '70¹, mendoj unë, është pika më neutral-gjike e kulmimit të letërsisë shqipe që me shumëçka përkon dhe mund të krahasohet me letërsinë shqipe të viteve '30, pa marrë parasysh rrethanat fare të ndryshme. Në atë kohë, në vitet '70 pra, mbledhen dhe gërshetohen shkrime nga më të ndryshmet të disa gjeneratave dhe kjo paraqet një konglomerat stilësh, pothuaj të papërsëritshme, ku mund të shihet e veçanta e atyre krijuesëve, që këtu edhe stili dhe diskursi i autorit tonë. Tani kur autori ynë nuk është më dhe kur vepra e tij gjendet në fazën e një "fjetjeje" estetike, mendoj se poeti s'meriton të harrohet, por të vazhdojë të jetë objekt trajtimi ku studjuesit mund t'i masin vlerat e tyre të vërteta, pa emocionet e vlerësimit entusiast, kurtuaz, siç kish ndodhur më parë, por të shquhen vlerat, cilësitë dhe risitë e saj, duke folur edhe për mangësitë eventuale, sidomos kur e marrim parasysh utopinë e kohës, kohën e vëllazërim-bashkimit të rrejtshëm etj. Të flitet për poezinë e autorit me vlerat e saj të pakontestueshme, të spjegohet konteksti kohor me spjegim adekuat, shoqëruar me prezantimin gjithnjë dinjitoz të shkrimtarit, i cili rrin si refuzues i vërtetë i sfidave të kohës që s'është më, e me këtë opinionin lexues të bindet me zërin e arsyes së shëndoshë.

¹ Sintagma **letërsi shqipe e viteve '70**, më poshtë në trajtesën time përdoret si sinonim kulmimi të një lëvizjeje letrare që e presupozon atë letërsi që nismën e ka rreth dy dekada më parë e që kulmon në dhjetëvjetëshin si edhe në sintagmë, por që vazhdon të zhvillohet edhe më tej. Pos përkufizimit kohor të atij dhjetëvjetëshi që realisht zgjat më shumë se dhjetë vjetë, u kërkoj falje lexuesëve për mosmarrëveshje që mund të lindin gjatë receptimit të kësaj sintagme si referencë ku *koha* dhe *hapësira* e letërsisë shqipe, aso kohe zhvillohej e ndarë, ashtu siç objektivisht edhe kishte lindur, kurse përdorimi im është jondaras.

Realisht, në gjithë historinë e zhvillimit, letërsia shqipe shkëlqimin e vet e arrin dy herë: në vitet '30 dhe në vitet '70 të shekullit të kaluar, dhe kjo ndodh në rrethanat e dy krizave më të mëdha botërore, herën e parë mes këtyre dy luftave botërore dhe dy dekada pas Luftës së Dytë Botërore. Herën e parë, në vitet '30, është koha e atmosferës më morbide të të dy ideologjive supreme, fashizmit dhe komunizmit, që po luftonin për ngadhënjim, garonin që ta mbisundojnë botën mu atëherë kur populli shqiptar po përjetonte krizën më të thellë sociale dhe kur njerëzit vdiqnin rrugëve nga uria. Herën e dytë, në vitet '70, në kohën kur pas ngadhënjimit të komunizmit kur shqiptarët ranë që ta shijonin “mollën e ndaluar” të diktaturës: dhunën, represionet dhe censurën e fjalës së lirë. Në rrethanat që tashmë dihen, letërsia shqipe zhvillohej e ndarë, me dy formate stilistike: e para, në shtetin ëmë, si letërsi tërësisht e ideologjizuar, që duke dëshiruar ta krijojë prototipin e njeriut të ri, e krijon një të vërtetë të paqenë, objektivist të pamundshme për kohën, krejt groteske sot, dhe tjetra, në pjesën e dytë të atdheut: një letërsi me pak ngjyra ideologjike, por shumë “e vështirë” për receptim, të menduar e të shkruar nën mengesat e një autocensure, me një të vërtetë të mbyllur hermetikisht për lexuesin, por që ishte e vetmja gjuhë komunikimi në mungesë të lirisë së fjalës.

Letërsia e viteve '30 ka një varg individualitetesh letrare të veçanta, të verifikuar në rrafshin kombëtar. Sikundër dihet, At Gjergj Fishta, Fan Stilian Noli, Lasgush Poradeci, Migjeni, Ernest Koliqi, Et'hem Haxhiademi etj., në veprat e tyre e pasqyrojnë realitetin ashtu siç ishte: një shoqëri me përplasje të thella ekonomike. Ja paradoksi: mu në flakë të kësaj letërsie, për herë të parë ndjehet pluralizmi stilistik letrar shqiptar, në të cilin njëkohësisht krijojnë *romantikë, realistë, realistë klasikë, realistë kritikë, pseudoklasicistë, simbolistë* etj. që në fakt, variojnë me stile nga më të ndryshme të shkrimit. Pas Luftës së Dytë Botërore, pas shndërrimit të gjithë letërsisë në sociologji, dy dekada më vonë, në vitet '70, mjeshtërisht dhe me shumë sakrifica të shkrimtarëve, ky trend letrar ringritet duke e rivënë pluralizmin stilistik atje ku kishte qenë që në kohë të midis dy luftave, tani duke transformuar dhe modifikuar edhe formacionet stilistike të shkrimit. Në veprat letrare të shkrimtarëve Jakov Xoxa, Martin Camaj, Dritëro Agolli, Ismail Kadare, Rexhep Qosja, Anton Pashku, Ali Podrimja, Teki Dervishi, Vath Koreshi, Xhevair Spahiu, Beqir Musliu,

Moikom Zeqo, Zejnullah Rrahmani etj. në vitet '70, krahas *realizmit socialist*, tipik për shkrimtarët që krijojnë brenda shtetit amë, sërish rivedoset pluralizmi stilistik i letërsisë shqipe, i bartur tani në Kosovë me rrymimet: *realizmi klasik*, *simbolizmi*, *impresionizmi*, *ekspresionizmi*, *syrealizmi* deri te *postmodernizmi*, që kritika e kohës i identifikon si hermetizëm, por që në fakt ishte lëvizje avangarde që krijon art të mirëfilltë letrar që gjer sot akoma ka mbetur i pastudjuar.

Nismëtar e bard i letërsisë së sotme shqiptare të Kosovës me kuptimin e plotë të fjalës, prej duarëve të të cilit parakaluan pothuaj të gjithë krijuesit e të gjitha gjeneratave të shkrimtarëve, Esat Mekuli ka shkruar pak. Megjithatë, nëse heqim një paralele krahasimi të atyre krijuesëve që kanë shkruar pak por që qëndrojnë në fron të vlerave që kanë, siç janë psh. Lasgush Poradeci ose Migjeni, me gjithë respektin, vendi i autorit tonë nuk është i atij niveli. Nëse Lasgush Poradeci e Migjeni në vitet '30 kishin shkruar shumë pak, por që me meritë paraqesin figurat qendrore të historisë së letërsisë shqiptare, si kulme letrare të pazëvendësueshme, është sepse Lasgush Poradeci është themelues i *simbolizmit* dhe i *poezisë së pastër* shqipe, kurse Migjeni themelues i *realizmit kritik*. Ndërkaq Esat Mekuli, nga ana tjetër, nga poezia që është fahu i tij i angazhimit, me gjithë gjeninë dhe vlerat e pakontestueshme që ka, është e pamjaftueshme të radhitet në mesin e shembujve si më lart, pos nëse ia atribuojmë meritat me të cilat nuk do t'ia nderonin profilin krijues. Fill pas luftës e deri në vitet '70, nga gjiri i një rrethi të gjerë krijuesish të Kosovës që nisën të shquhen si vlera të pakontestuar letrare e që sot çmohen si *simbolistë*, *ekspresionistë*, *impresionistë*, *syrealistë* deri edhe *posmodernistë*, Esat Mekuli është nismëtari i gjithë letërsisë së Kosovës dhe vazhdues i shkollës letrare sociale të Migjenit. Ndërkaq, emrat Jakov Xoxa, Martin Camaj, Dritëro Agolli, Ismail Kadare, Rexhep Qosja, Anton Pashku, Ali Podrimja, Teki Dervishi, Vath Koreshi, Xhevair Spahiu, Beqir Musliu, Moikom Zeqo, Zejnullah Rrahmani etj. që në ato vite emblematike e ngjisin letërsinë shqipe drejt majës së piramidës që sot është vlerë mbarëkombëtare, bëjnë që vepra e Esat Mekulit të na duket e minimalizuar dhe të na duket vetëm vlerë nderi e jo vlerë të konkuron me mega veprat e këtyre autorëve.

Tema Esat Mekuli dhe letërsia shqipe e viteve '70, duke u nisur

nga poezitë e autorit, dhe sidomos nga bagazhi i madh i shkrimeve të shkruara për të në kohë kur ai ishte gjallë, sidomos duke e parë heshtjen e kritikës përpos ndonjë shkrimi të rrallë, mbase për shkak të ndryshimeve të mëdha që kanë ndodhur këtyre dekadave të fundit, ngjet sikur Esat Mekuli u harrua. Realisht, emri i autorit s'rrësht së lakuari me pietet edhe sot nëpër antologjitë dhe tekstet shkollore dhe universitare ku përpiluesit vazhdojnë së foluri pro figurës së tij letrare sipas planprogrameve, por kritika letrare sikur ka mejtur për të. Me këtë rast, sa për ilustrim do ta kisha përmendur Martin Camajn, krijuesin dhe poetin të cilin Esat Mekuli e kish patur bashkënmëtar të veprimtarisë kur ai, Martin Camaj pra, në Prishtinë i kish botuar dy librat e tij të parë poetikë. Krahassimi është paradoksal, gjersa sot Marin Camajn e kemi në gojë përditë, dhe pa masë gëzohemi për vlerësimet që i bëhen atij edhe pse posthum, organizohen simpoziume, bëhen studime shkencore, botohen complete letrare të autorit etj., Esat Mekulin sikur e kemi harruar. Pa një qëllim matjeje të vlerave që kanë këta dy krijues, disproporcioneve që kanë njëri-tjetri, e quajta paradoksal sepse nga të gjitha librat e Esat Mekulit, po t'i krahasojmë me dyzinën e librave të të tri gjinive letrare të Martin Camajt, kuantiteti që flet për epërsinë shumë të madhe të të dytit ndaj të parit, me automatizëm me asgjë nuk garanton për kualitetin e krahasimit. Sepse, as shija e masës së madhe të lexuesëve dhe as shkrimet e shumta kritike që shkruhen sot për akëcilin krijues, nuk garantojnë për jetëgjatësinë e veprës së tyre letrare, sepse vetëm sovranit kohë është gjykatësi më i mirë që do ta japë përgjigjen e vërtetë.

Meqë Esat Mekuli ishte vetëm poet, jo rastësisht temën time dua ta reduktoj drejt krahasimit të figurës së poetit vetëm me vargun e poetëve të tjerë që lindën falë revistës letrare **Jeta e Re** të cilën e drejtoi ai që nga fillimi, për të thënë se veprat e tyre më të mira poetike, prozaike e dramaturgjike, u krijuan pikërisht falë përkrahjes morale të poetit. Kur e krahasojmë diskursin e autorit me ata të Enver Gjerqekut, Murat Isakut, Din Mehmetit, Azem Shkrelit, Adem Gajtanit, Fahredin Gungës, Rahman Dedjes, Ali Podrimjes, Besim Bokshit, Qerim Ujkanit dhe poetëve të gjeneratës më të re siç janë poezia e Teki Dërvishit, Beqir Musliut, Musa Ramadanit, Eqrem Bashës, Nexhat Halimit, Sabri Hamitit, Shaip Beqirit etj. pa i numëruar edhe dhjetëra të tjerë, me laryshinë e madhe të stileve të shkollave të ndryshme letrare që ata krijojnë, me oscilime të këtyre diskur-

seve, ajo që na shkon mendja menjëherë kur e bëjmë krahasimin, është se të gjithë këta krijues, për pikë neuralgjike e kanë vatrën, pra autorin, dmth. mësimet e shkollës së autorin tonë, Esat Mekuli, te poezia e tij e angazhuar. Edhe pse të gjithë vetveten e tyre, pra stilin e tyre të shkrimit, nuk e parallogarisin stilin dhe diskursin e Esat Mekulit, pra edhe pse shumica prej këtyre krijuesëve heret e kanë braktisur mësimin e mësuesit, pra duke mos krijuar poezi të angazhuar por poezi të paangazhuar, kurse disa prej tyre madje edhe duke krijuar shkollë vetanake letrare çfarë i bën krejt të mëvetësishëm që aspak nuk përkojnë me të, me Esat Mekulin pra, megjithatë, në embrion, në zanafillë e kanë prautorin. Që këtu, figura letrare e Esat Mekulit bëhet emblematic për të gjithë krijuesit shqiptarë të Kosovës së viteve '70, sado që ai mund të jetë tejkaluar nga disa krijues dhe filli i nismave të atyre krijuesëve mund të mos duket fare, shkrimi i tij do të ndjehet si vlerë letrare konstante estetike. Kështu, distanca e “fjetjes” së gjatë të veprës letrare të Esat Mekulit, nuk na jep të drejtën ta harrojmë atë. Prandaj, nga një fjalë e urtë latine e cila thotë – jepini Cezarit atë që është e Cezarit, më lejoni ta bëj parantezën time: jepni Esat Mekulit atë që është e Esat Mekulit. Edhe atë, jo për hir të karizmës së emrit të tij, por për hir të vlerës që ka ajo vepër, sado e paktë që të jetë ajo.

STUDIME, ARTIKUJ

Shkumbin MUNISHI, Prishtinë PIKËPAMJET DHE QËNDRIMET NDAJ SHQIPES TE SERBËT E KOSOVËS

KDU 811.18-26
811.163.41-26

ABSTRAKT

Në këtë punim trajtohen pikëpamjet, qëndrimet dhe karakteri i komunikimit i folësve të serbishtes me folësit e shqipes. Punimi bazohet në një anketim sociolinguistik të kryer në lokalitetet me shumicë serbe në afërsi të Prishtinës. Gjetjet tregojnë se njohja e shqipes nga serbët e Kosovës është e paktë dhe me prirje drejt zhdukjes. Aq më tepër, domenet e caktuara të kontaktit midis folësve të serbishtes dhe atyre që shqipes janë reduktuar ndjeshëm. Anketimi ka treguar se serbët nuk do ta refuzonin komunikimin me shqiptarë, por nuk duket që shqipja e ka fituar ende prestigjin në raport me serbishten të serbët e Kosovës, përkundër ndryshimit të rrethanave politike e sociokulturore. Megjithatë, duke se shqipja gradualisht është duke e imponuar prestigjin e saj dhe se një proces i tillë duket që ka filluar për shkak të epërsisë demografike të shqiptarëve.

Fjalët kyçe: *serbishte, shqipe, domen, politikë gjuhësore, planifikim i statusit*

1. HYRJE

Në vazhden e hulumtimeve të kryera me folës të shqipes lidhur me procesin e zhdukjes së dygjuhësisë shqip-serbisht në Kosovë dhe raporteve midis këtyre dy gjuhëve (Munishi 2011, 2014), e kemi parë të udhës që një hulumtim i tillë nuk mund të jetë i plotë dhe shterues pa i parë edhe qëndrimet e serbëve të Kosovës lidhur me shqipen dhe raportet me të. Raportet dhe qëndrimet reciproke ndaj gjuhëve gjithëherë janë komplekse dhe të shtresëzuara sipas parametrave të ndryshëm sociolinguistikë. Të tilla janë edhe raportet midis shqipes dhe serbishtes në Kosovë, të cilat janë zhvilluar dhe kanë evoluar në rrethana të ndryshme historike. Këto rrethana, sidomos ato politike, kulturore e administrative, gjatë shekullit XX e kanë favorizuar serbishten në raport me shqipen në Kosovë. Raportet midis gjuhëve në situatat e dygjuhësisë e shumëgjuhësisë janë ndërtuar në premisat e ideologjisë së gjuhëve standarde, duke u vendosur në rrafshin

gjuhë standarde kundrejt gjuhëve minoritare (Gall 2006). Kjo gjë ka ndodhur për shkak se që në periudhën e Romantizmit gjuha standarde është parë si tipar ndër më kryesorët i kombit dhe i shtetit kombëtar. Në këtë perspektivë janë ndërtuar edhe raportet midis serbishtes dhe shqipes, në veçanti pas Luftës së Dytë Botërore në kuadër të ish-Jugosllavisë. Këto raporte të serbishtes dhe të shqipes duhen parë jo vetëm si raporte të kontaktit gjuhësor, por edhe si raporte të konfliktit gjuhësor (Munishi 2010a).

Në rrethanat që u përmendën, serbishtja në raport me shqipen gjatë shekullit XX ka qenë gjithmonë në situatë më të favorshme, duke qenë jo vetëm gjuhë me prestigj, por edhe *lingua franca* e ish-Jugosllavisë. Për këtë arsye bilinguizmi shqip-serbisht në Kosovë ka qenë gjithnjë asimetric, në kuptimin që shqiptarët kanë folur shqipen dhe serbishten, ndërsa serbët kanë përdorur shqipen shumë më pak. Në rrafshin e statusit të gjuhëve në Kosovë, sidomos në vitet 70-80 të shekullit XX, ndonëse shqipja dhe serbishtja kishin statusin e gjuhëve zyrtare (Ismajli 1991), megjithatë serbishtja, ose siç quhej në atë kohë serbokroatishtja, ishte gjuhë me prestigj për shkak të epërsisë politike e kulturore të bashkësisë së saj folëse në kontekstin jugosllav. Me fjalë të tjera, kishte një shpërputhje midis planifikimit të statusit dhe realizimit të funksioneve të gjuhës për të cilat flet Mackey (1989). Pra, në raportet e fuqisë së gjuhëve, serbishtja kundruall shqipes ka qenë në pozitë shumë më të favorshme politike e sociokulturore.

Pas vitit 1999 këto raporte kanë ndryshuar në mënyrë drastike. Pas përfundimit të luftës, në Kosovë u vendos Misioni i OKB-së (UNMIK), ndërkaq më 2008 Kosova u shpall shtet i pavarur dhe sovran, aktualisht i njohur nga 112 shtete të botës dhe anëtar i shumë organizatave ndërkombëtare. Në rrethana të reja politike, kulturore e administrative dhe sidomos për shkak të faktorit demografik, duke qenë se shqiptarët përbëjnë mbi 90% të popullsisë së Kosovës (regjistrimi i popullsisë 2011), kanë ndryshuar edhe raportet e fuqisë dhe të prestigjit të gjuhëve në Kosovë. Edhe pse në proceset e planifikimit të statusit të gjuhëve në Kosovë shqipja dhe serbishtja kanë statusin e barabartë të gjuhëve zyrtare në Kosovë, aktualisht, shqipja është gjuhë me më shumë fuqi e prestigj në raport me gjuhët e tjera, rrjedhimisht edhe në raport me serbishten, për shkak të faktorit demografik, i cili dikton edhe faktorët e tjerë politikë, ekonomik e kulturorë (Ismajli 2003; Munishi 2006, 2009, 2010b; Rugova 2012). Këta faktorë

ndikojnë drejtpërdrejt në raportet midis bashkësive folëse përkatëse dhe midis gjuhëve që i flasin ato. Në këto rrethana që u përshkruan, jemi përpjekur të shohim se cilat janë pikëpamjet e serbëve të Kosovës për shqipen dhe për raportet me të. Hulumtimi që kemi kryer për këtë çështje nxjerr në pah disa gjetje e konstatime me interes që do të paraqiten më poshtë.

2. HIPOTEZAT DHE METODOLOGJIA

Ky hulumtim është kryer në përfaqje me hipotezat, rezultatet dhe përfundimet që i kemi sheshuar në dy hulumtimet paraprake të kryera me folës të shqipes lidhur me njohjen e serbishtes dhe domenet aktuale të kontaktit midis folësve të shqipes dhe atyre të serbishtes (Munishi 2011, 2014). Anketimet që i kemi kryer më 2011 dhe 2014 janë mbështetur në disa hipoteza që i kemi marrë për bazë edhe në rastin e këtij hulumtimi me serbë. Së këndejmi, kemi identifikuar së paku pesë hipoteza fillestare për ta mbështetur hulumtimin.

E para, dygjuhësia e folur shqip-serbisht dhe anasjelltas në Kosovë është në zhdukje e sipër, sidomos te brezat e rinj, fëmijët dhe adoleshentët, tashmë është zhdukur.

E dyta, disa domene të komunikimit, siç janë fqinjësia dhe shkolla, për një masë të madhe të serbëve po ashtu janë zhdukur.

E treta, sa u përket vatrave aktuale të kontaktit, ato janë zhvendosur nga qendrat e mëdha urbane drejt zonave që gjenden në kufij të pikëtakimeve midis zonave të banuara me shqiptarë e zonave të banuara me serbë.

E katërta, denduria e kontakteve të zakonshme e spontane kushtëzohet nga intervalet e kontakteve midis folësve të shqipes dhe të serbishtes që duket të jenë të shkurtra, po dhe me shkëmbime gjuhësore të kufizuara.

E katërta, kodi gjuhësor i ndërmjetëm që përdoret për shkak të mosnjohjes së gjuhëve respektive është ai i anglishtes, por edhe me forma të tjera të përzierjes së gjuhëve dhe me forma të komunikimit paralinguistik.

E pesta, ndonëse nuk shprehen paragjykimet e hapura negative për folësit e gjuhëve përkatëse, megjithatë nuk vërehen interesime për t'i mësuar gjuhët reciproke.

Duke u nisur nga këto hipoteza tashmë të trajtuara në hulumtimet me folës të shqipes, kemi kryer anketime me qytetarë serbë të Kosovës,

kryesisht me ata që banojnë në fshatrat e banuara me serbë në afërsi të Prishtinës. Anketimet me qytetarë serbë janë kryer gjatë muajit nëntor dhe në pjesën e parë të muajit dhjetor të vitit 2015. Personat me të cilët janë zhvilluar anketat kanë qenë kryesisht banorë serbë të komunës së Graçanicës dhe fshatrave që i përkasin kësaj komune, siç janë Llaplje Sella dhe Preoci. Kryesisht kemi përdorur anketa me shkrim dhe me pyetje të tipit të mbyllur, në mënyrë që respondentët t'i mbajmë të fokusuar në çështjet më kryesore që kanë qenë me interes për këtë hulumtim. Modeli dhe pyetjet e anketës që janë përdorur në këtë hulumtim janë pothuaj identike me ato që janë përdorur më parë në anketat me shqiptarë. Në përgjithësi, janë anketuar 61 respondentë, folës të serbishtes, nga të cilët 46 kanë qenë meshkuj dhe 15 femra, ndërkaq përzgjedhja e mostrave ka qenë kryesisht e rastit.


3. REZULTATET DHE GJETJET

Pyetja e parë që u është bërë të anketuarve, sikurse edhe në anketimet me shqiptarë, ka pasur për qëllim të hulumtojë se sa e njohin dhe e flasin gjuhën shqipe serbët e anketuar. Pyetjes *Da li pričate albanski jezik?* (a e flitni gjuhën shqipe – përkthimi sh.m.)¹, asnjë i anketuar nuk i është përgjigjur se e flet shqipen shumë mirë. Nga numri i përgjithshëm i të anketuarve, 16.39% janë përgjigjur se e flasin mirë, ndërsa 54.09% dhe 29.5% janë përgjigjur që ose nuk e flasin shqipen mirë, ose nuk e flasin fare. Këto të dhëna tregojnë se edhe te serbët njohja e shqipes është mjaft e kufizuar dhe është në zhdukje e sipër. Kjo ndodh, sikurse edhe te shqiptarët, sidomos te brezat e rinj. Arsytet për këtë dukuri janë të shumta, por arsyeja më kryesore ka të bëjë me faktin se aktualisht shqipja nuk mësohet në shkollat në gjuhën serbe dhe ky është mbase faktori më kryesor që ndikon në mosnjohjen e gjuhës. Po ashtu, më sipër u tha se në të kaluarën, në situata të një bilinguizmi asimetrik në Kosovë, serbishtja ishte gjuhë me prestigj dhe serbët nuk kanë shprehur ndonjë interesim të theksuar për ta mësuar dhe për ta folur shqipen. Duket që as sot nuk ka ndonjë shtysë të fuqishme që i nxit ata ta mësojnë shqipen.

¹ Pyetjet që janë përdorur në anketë dhe përgjigjet janë paraqitur në gjuhën origjinale, ndërkaq të gjitha përkthimet e pyetjeve dhe rezultateve janë bërë nga autori.

<i>Da, pričam veoma dobro (po, e flas shumë mirë)</i>		<i>Priçam dobro (e flas mirë)</i>		<i>Ne pričam dobro (nuk e flas mirë)</i>		<i>Ne, upošte ne priçam (jo, nuk e flas aspak)</i>	
M	F	M	F	M	F	M	F
0	0	9	1	29	4	8	10
0		10		33		18	
0%		16.39%		54.09%		29.5%	

Tabela 1




Grafiku 1

Pyetja e dytë që ua kemi bërë të anketuarve është ndërlidhur me dendurinë e komunikimit eventual të folësve të serbishtes në gjuhën shqipe. Të dhënat që kemi marrë nga dy anketimet me shqiptarë (2011, 2014) kanë dhënë tregues të qartë se denduria e ndërkomunikimit midis folësve të shqipes dhe të serbishtes ka rënë ndjeshëm. Pyetja tjetër që ua kemi bërë folësve serbë ka qenë: *Koliko često vam se desi da komunicirate na albanskom jeziku?* (sa shpesh ju ndodh të komunikoni në gjuhën shqipe). Në bazë të rezultateve që i kemi marrë del se 9.83% kanë komunikim pothuaj të përditshëm në shqipe, ndërsa 19.67% kanë deklaruar se komunikojnë shpesh. Në anën tjetër, 31.14% të respondentëve kanë deklaruar se komunikojnë nganjëherë në gjuhën shqipe, ndërsa në dy grupe të tjera kemi nga 19.67% të të anketuarve që kanë deklaruar se në shqipe, aq sa arrijnë ta flasin e kuptojnë, komunikojnë rrallë ose kurrë. Grupet e të anketuarve që kanë deklaruar se flasin shqip shpesh kanë qenë kryesisht serbë që punojnë bashkë me shqiptarë në institucione publike të Kosovës.

Gotovo svako-dnevno (pothuaj përditë)		Često (shpesh)		Ponekad (nganjëherë)		Retko (rrallë)		Nika (asnjëherë)	
M	F	M	F	M	F	M	F	M	F
5	1	9	3	16	3	9	3	7	5
6		12		19		12		12	
9.83%		19.67%		31.14%		19.67%		19.67%	

Tabela 2



Grafiku 2


Disa nga pyetjet e tjera në vazhdim të këtij hulumtimi kanë pasur të bëjnë me domenet eventuale të kontakteve midis folësve të shqipes dhe të serbishtes. Hulumtimet me shqiptarë kanë dëshmuar se domenet e kontaktit midis folësve të shqipes dhe folësve të serbishtes janë reduktuar ndjeshëm. Hulumtimi ka dëshmuar se kjo ndodh edhe me serbët dhe se kontaktet e tyre me shqiptarë në disa domene pothuaj janë zhdukur.

Fqinjësia si domen i kontaktit midis folësve të shqipes dhe folësve të serbishtes, që dikur ka qenë një vatër e rregullt e kontaktit, tashmë pothuaj është zhdukur fare. Pyetjes *U susvedstvu u kome živite da li imate kontakte sa onima koji pričaju albanski?* (në fqinjësi ku jetoni a keni kontakte me folës të shqipes) vetëm 13.11% i janë përgjigjur se kanë kontakte të përditshme. Në anën tjetër 27.86% janë deklaruar se kanë nganjëherë kontakte, 29.5% kanë thënë se kanë kontakte shumë rrallë dhe 21.31% kanë thënë se pothuaj asnjëherë nuk kanë kontakte. Disa prej tyre (8.19%) janë shprehur

se më parë kanë pasur kontakte, por jo më. Në këtë grup kanë qenë disa persona që kanë deklaruar se para vitit 1999 kanë banuar në Prishtinë.

<i>Da, imam svakodnevne kontakte (po, kam kontakte të përditshme)</i>		<i>Imam kontakte ponekad (kam nganjëherë kontakt)</i>		<i>Veoma retko imam kontakte (kam kontakte shumë rrallë)</i>		<i>Gotovo nikad nemam kontakte (pothuaj asnjëherë nuk kam kontakte)</i>		<i>Pre sam imao kontakte ali više ne (më parë kam pasur kontakte, por jo më)</i>	
M	F	M	F	M	F	M	F	M	F
7	1	12	5	18	0	4	9	5	0
8		17		18		13		5	
13.11%		27.86%		29.5%		21.31%		8.19%	

Tabela 3



Grafiku 3

Këto të dhëna dëshmojnë qartë se fqinjësia si domen i kontaktit midis folësve të serbishtes dhe atyre të shqipes pothuaj është zhdukur fare. Kontaktet eventuale në fqinjësi ndodhin vetëm me folës të paktë të shqipes që kanë shtëpitë e tyre në afërsi të qendrave ku janë kryer anketime, sidomos në kufijtë e këtyre qendrave me lokalitetet në afërsi në të cilat banojnë shqiptarët.

Një domen tjetër në të cilin po ashtu është reduktuar kontakti midis folësve të serbishtes dhe atyre që shqipes është edhe vendi i punës, apo


vendi i studimeve. Të dhënat që i kemi marrë në pyetjen lidhur me kontaktet në vendin e punës tregojnë që 18.03% kanë kontakt të përditshëm dhe në këtë grup hyjnë kryesisht folës të serbishtes që punojnë në institucione e media publike të Kosovës, të cilat i kanë selitë e tyre në Prishtinë. Po ashtu, një pjesë e të anketuarve kanë deklaruar se kanë nganjëherë kontakt (19.67%), ndërkaj pjesa e mbetur e të anketuarve kanë deklaruar se kanë kontakte shumë rrallë (31.14%), ose nuk kanë pothuaj asnjëherë kontakt (22.95%). 8.19% e të anketuarve janë shprehur se më parë kanë pasur kontakte me folës të shqipes në vendin e punës, por që nuk kanë më. Në këtë grup hyjnë kryesisht të anketuar më të moshuar që dikur kanë punuar bashkë me shqiptarë.

<i>Da, imam svakodnevnne kontakte (po, kam kontakte të përditshme)</i>		<i>Imam kontakte ponekad (kam nganjëherë kontakt)</i>		<i>Veoma retko imam kontakte (kam kontakte shumë rrallë)</i>		<i>Gotovo nikad nemam kontakte (pothuaj asnjëherë nuk kam kontakte)</i>		<i>Pre sam imao kontakte ali više ne (më parë kam pasur kontakte, por jomë)</i>	
M	F	M	F	M	F	M	F	M	F
9	2	9	3	19	0	6	8	3	2
11		12		19		14		5	
18.03%		19.67%		31.14%		22.95%		8.19%	

Tabela 4

Edhe këto të dhëna që janë të ilustruara në grafikun e mëposhtëm tregojnë se vendi i punës si domen i kontaktit është reduktuar në masë të madhe, për të mos thënë është duke u zhdukur fare. Padyshim, lëvizjet demografike pas vitit 1999 janë shkaktari kryesor për zhdukjen e kësaj vatre të kontaktit të folësve të serbishtes dhe folësve të shqipes, e cila dikur ka qenë një vatrë e qëndrueshme dhe mjaft prodhuese e këtyre kontakteve. Sot, kontakti më i zakonshëm i serbëve të Kosovës ndodh në institucionet shtetërore të Kosovës dhe në media publike në të cilat punojnë ata bashkë me shqiptarët, të cilët janë shumicë. Ndonëse ka kuota të përcaktuara për punësimin e komuniteteve pakicë, numri i serbëve të punësuar, sidomos në institucione të nivelit qendror, mbetet ende i vogël, por me një tendencë rritjeje graduale. Mbase me kalimin e kohës dhe me rritjen e numrit të të

punësuarve serbë në institucione publike të Kosovës do të rritet edhe denduria e komunikimit në këtë domen të kontaktit, edhe pse është e vështirë të parashikohen zhvillimet e ardhshme.



Grafiku 4


Pyetja e fundit që ua keni bërë të anketuarve e që ka pasur për qëllim t'i hetojë domenet e kontaktit midis folësve të serbishtes dhe atyre të shqipes ka qenë pyetje e drejtpërdrejtë se në cilat vende u ndodh folësve të serbishtes që të kenë eventualisht kontakt me folësit e shqipes. Si domene kryesore që i kemi përcaktuar si vatra të kontaktit kanë qenë kryesisht ato që i ka përcaktuar Fishman (1971), me pak modifikime për t'i reflektuar ndryshimet shoqërore që kanë ndodhur në dekadat e fundit. Si domene janë përcaktuar: fqinjësia, vendi i punës, tregu (i ashtuquajtur i pazari), qendrat tregtare dhe supermarketet. Të dhënat që kemi marrë tregojnë se fqinjësia (3.27%) dhe tregu (1.67%) janë domene në të cilat kontaktet janë reduktuar shumë. Siç ka treguar edhe hulumtimi me shqiptarë (2014), qendrat tregtare dhe supermarketet janë vendet në të cilat ndodhin kontaktet më të shpeshta midis folësve të shqipes dhe të serbishtes, ndonëse intervalet e ndërkomunikimit janë të shkurtra. Një qytetar nga Fushë Kosova,

një nga Çagllavica dhe një tjetër nga Graçanica kanë deklaruar se kanë kontakte në të gjitha vendet. Në anën tjetër, tre gazetarë, një respondent tjetër gazetar i moshës 35 vjeçare, një gazetar tjetër 30 vjeçar dhe një gazetarë 32 vjeçare kanë deklaruar se ka kontakte në fqinjësi, në punë dhe në qendra tregtare e supermarkete.

Është me rëndësi të vihet në pah se kontaktin më të shpeshtë me shqiptarë e kanë serbët që banojnë në Fushë Kosovë dhe Çagllavicë, të cilat janë praktikisht lokalitete ku serbët dhe shqiptarët banojnë në afërsi me njëri-tjetrin.

<i>U susedstvu (në fqinjësi)</i>		<i>Na radnom mestu (në vendin e punës)</i>		<i>Na pijaci (në treg)</i>		<i>U trznim centrima i supermarketima (në qendra tregtare e supermarkete)</i>		<i>U svim gore navedenim mestima (në të gjitha vendet e përshkruara sipër)</i>	
M	F	M	F	M	F	M	F	M	F
2	0	7	4	1	0	31	10	5	1
2		11		1		41		6	
3.27%		18.03%		1.63%		67.21%		9.83%	

Tabela 5



Grafiku 5


Pyetjet e fundit të kësaj ankete kanë pasur të bëjnë me mënyrën dhe gjuhët eventuale me të cilat do të komunikohet folësit e serbishtes me ata të shqipes, si dhe me qëndrimet e serbëve ndaj gjuhës shqipe. Pyetja e radhës që u është bërë të anketuarve serbë ka qenë e natyrës hipotetike, me qëllim që ta shohim qëndrimin e të anketuarve lidhur me komunikimin dhe kodet që do t'i përdornin eventualisht në komunikim me folës të shqipes. Pyetjes *Ako vam se desi da se sretnete sa nekim koji za maternji jezik ima albanski, na kome jeziku bi eventualno pričali sa njim?* (nëse ju ndodh të takoheni me dikë që gjuhë amtare e ka shqipen, në çfarë gjuhe do të flisnit eventualisht me të), vetëm 14.75% i janë përgjigjur se do të flisnin në shqipe dhe vetëm 6.55% janë shprehur se nuk do të komunikohet fare me folës të shqipes.

<i>Pričao bih na albanskom (do të flisja në shqipe)</i>		<i>Pričao bih na srpskom i očekujem da ce i sagovornik pričati na srpskom (do të flisja në serbisht dhe do të prisja që edhe bashkëbiseduesi të flasë serbisht)</i>		<i>Pričao bih na engleskom ili na nekom drugom jeziku (do të flisja në anglishte)</i>		<i>Ako je potrebno mešao bih jezike i komunicirao bih sa gestikulacijama (nëse është e nevojshme do t'i përzija gjuhët dhe do të komunikoj me gjeste)</i>		<i>Ne bih pričao uopšte (nuk do të flisja fare)</i>	
M	F	M	F	M	F	M	F	M	F
8	1	17	4	6	4	12	5	3	1
9		21		10		17		4	
14.75%		34.42%		16.39%		27.86%		6.55%	

Tabela 6

Numri më i madh i të anketuarve është deklaruar se do të flitnin serbisht dhe do të pritnin që edhe bashkëbiseduesi t'u flasë serbisht. Të tjerët janë deklaruar se ose do të flitnin në gjuhën angleze, ose do t'i përzienin gjuhët apo do të përdornin forma paralinguistike për të komunikuar nëpërmjet gjesteve. Të dhënat dëshmojnë se të serbët shqipja ende nuk e ka fituar epitetin e gjuhës me prestigj, por duket qartë se një proces i tillë ka filluar. Arsyeja kryesore përsëri është e natyrës demografike. Shqiptarët si popullsi shumicë absolute kanë në dorë instrumentet e pushtetit institucional dhe rrjedhimisht duke e përdorur shqipen i japin asaj prestigjin e

duhur dhe ky prestigj reflektohet pastaj edhe në raport me gjuhët e tjera të komuniteteve pakicë. Një tjetër element me rëndësi që na del këtu ka të bëjë me faktin se edhe te serbët nuk duket që mbizotëron refuzimi absolut për të komunikuar me shqiptarë. Ndonëse hetohet një refuzim i heshtur për të komunikuar në shqipe, megjithatë numri i atyre që janë shprehur se nuk do të komunikojnë fare me shqiptar është mjaft i vogël.




Grafiku 6

Të dhënat pak a shumë të ngjashme sikurse në pyetjen paraprake na dalin edhe kur të anketuarit i kemi pyetur drejtpërdrejt se çfarë mendimi kanë për gjuhën shqipe. Kështu, 14.75% janë shprehur se shqipja u pëlqen dhe se duan ta flasin, ndërsa 16.39% kanë deklaruar se u pëlqen, por nuk dinë ta flasin dhe se do të donin ta mësonin. Në anën tjetër, pjesa më e madhe e të anketuarve (62.295) kanë shfaqur indiferencë duke u shprehur se nuk kanë ndonjë mendim për gjuhën shqipe. Sikurse përqindja që del në

pyetjen e mësipërme lidhur me moskomunikimin me shqiptarë, e njëjta përqindje del edhe tek ata që janë përgjigjur se shqipja nuk u pëlqen fare.

<i>Svidja mi se i želim da pričam (më pëlqen dhe dua ta flas)</i>		<i>Svidja mi se ali ne znam da pričam i želeo bih da naučim (më pëlqen, por nuk di ta flas dhe do të doja ta mësoja)</i>		<i>Nemam neko mišljenje (nuk kam ndonjë mendim)</i>		<i>Ne svidja mi se (nuk më pëlqen)</i>	
M	F	M	F	M	F	M	F
7	2	7	3	29	9	2	2
9		10		38		4	
14.75%		16.39%		62.29%		6.55%	

Tabela 7



Grafiku 7

4. PËRFUNDIME

Rezultatet dhe gjetjet kryesore të këtij anketimi të kryer me serbë të Kosovës, kryesisht të lokaliteteve serbe në afërsi të Prishtinës, kanë mjaft pika të përbashkëta me dy anketimet e mëhershme të kryera me shqiptarë më 2011 dhe 2014. Këto gjetje kanë vërtetuar hipotezat paraprake të parashtruara në fillim të këtij punimi.

Rezultatet që i kemi marrë nga ky anketim tregojnë qartë se edhe te serbët e Kosovës, njohja e gjuhës shqipe është duke u zhdukur. Kjo ndodh sidomos te brezat e rinj që nuk e mësojnë shqipen në sistemin arsimor dhe ky është faktori më kryesor që ndikon në mosnjohjen e gjuhës shqipe te serbët, sidomos te fëmijët dhe të rinjtë. Njohja dhe përdorimi i shqipes dalin më të konsoliduar te folësit e serbishtes që janë të moshave më të vjetra dhe te ata që punojnë në institucionet publike të Kosovës.

Dukuria tjetër që bie në sy është rënia e theksuar e dëndurisë së komunikimit midis folësve të serbishtes dhe atyre të shqipes. Komunikimi më i shpeshtë midis folësve të serbishtes dhe atyre të shqipes ndodh në hapësirat e institucioneve publike, ndonëse edhe aty ka nevojë të matet gjatësia e intervaleve të këtij komunikimi. Në përgjithësi, mund të konstatohet se ndërkomunikimi midis folësve të serbishtes dhe folësve të shqipes ndodh rrallë dhe është mjaft i kufizuar.

Gjetja tjetër mjaft domethënëse që përkon edhe me rezultatet që i kemi marrë në hulumtimet me shqipfolës ka të bëjë me procesin e zhdukjes së domeneve të kontaktit midis folësve të serbishtes dhe atyre të shqipes. Ky proces është ndikuar në masë të madhe nga lëvizjet demografike që kanë ndodhur në Kosovë pas vitit 1999. Një pjesë e konsiderueshme e serbëve, të cilët kanë jetuar në qytetet e mëdha të Kosovës ose janë shpërngulur nga aty, ose janë zhvendosur në vendbanime kryesisht rurale të banuara me shumicë serbe. Për pasojë, domenet e dikurshme të zakonshme të kontaktit, siç janë fqinjësia dhe vendi i punës apo i studimeve, janë reduktuar në masë shumë të madhe. Vatrast më të shpeshta të kontaktit që dalin në këtë hulumtim janë qendrat tregtare e supermarketet.

Sa u përket qëndrimeve ndaj komunikimit eventual midis folësve të serbishtes dhe atyre të shqipes dhe kodit gjuhësor që eventualisht do të parapëlqej të përdorej, të anketuarit serbë janë shprehur se në raste të tilla ose do ta përdornin serbishten, ose do ta përdornin anglishten, apo edhe do t'i përzierin kodet duke përdorur edhe forma paralinguistike për të komunikuar. Shqipja nuk del të jetë gjuhë e parapëlqyer e komunikimit, por edhe nuk janë hetuar shprehje mbizotëruese të refuzimit të komunikimit të folësve serbë me ata shqiptarë. Edhe sa i përket qëndrimit ndaj gjuhës shqipe, përdorimit dhe mësimi eventual të saj, të anketuari serbë

kanë shprehur kryesisht indiferencë ndaj shqipes, por qëndrimet negative ndaj saj janë shprehur në masë të vogël.

Krejt në fund, mund të konstatohet se aktualisht te serbët dhe te shqiptarët njohja e gjuhëve reciproke del mjaft e kufizuar dhe është futur në një proces të zhdukjes së plotë. Arsyet kryesore të këtij procesi janë të shumta dhe ndërlidhen me faktorë demografikë, politikë e arsimorë. Aktualisht nuk ka përpjekje shoqërore të bashkësive gjuhësore përkatëse për ta ndryshuar këtë gjendje dhe me këtë ritëm që po vazhdon ky proces, në Kosovë bashkësitë gjuhësore të shqiptarëve dhe të serbëve do të jenë njëgjuhëshe dhe të izoluara nga njëra-tjetra, me dënduri të kufizuar të komunikimit reciprok. Kjo situatë bëhet edhe më paradoksale kur kemi parasysh se kemi të bëjmë me dy gjuhë, të cilat e kanë statusin e gjuhëve zyrtare në tërë territorin e Kosovës. Gjendja mund të ndryshohet vetëm nëse ka përpjekje serioze politike që, përkundër refuzimit aktual, gjuhët zyrtare të bëhen lëndë të detyrueshme në shkolla dhe të mësohen si të tilla nga nxënësit e të dyja bashkësive etnike në Kosovë.

REFERENCAT

- Fishman, Joshua (1971). Raporti në mes mikrosociolinguistikës dhe makrosociolinguistikës në studimin kush flet cilën gjuhë me kënd dhe kur, në: Sociolinguistics, Edited by J.B. Pride and J. Holmes, Penguin Books, First Published 1972; shih edhe në Vesel Nuhui, Ndikimet ndërghjuhësore, Rilindja, Prishtinë, 1990, f. 181-209.
- Gall, Susan (2006). Contradictions of standard language in Europe: Implications for the study of practices and publics. *Social Anthropology* 14. European Associations of Social Anthropologists. Pp. 163.181.
- Ismajli, Rexhep (2003). Standarde dhe identitete. Dukagjini. Pejë.
- Ismajli, Rexhep (1991), Gjuhë dhe Etni, Rilindja, Prishtinë.
- Mackey, William F. (1989). Determining the Status and Function of Languages in Multinational Societies, Status and Function of Languages and Language Varieties, Walter de Gruyter, Berlin – New York.
- Munishi, Shkumbin (2014). Zhdukja e dygjuhësisë shqip-serbisht në Kosovë. Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare 33/1. Prishtinë.
- Munishi, Shkumbin (2011). Probleme të zbatimit të dygjuhësisë shqip-serbisht në Kosovë. Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit – konferencë shkencore. ASHAK. Prishtinë.
- Munishi, Shkumbin (2010a). Konfliktet dhe kontaktet gjuhësore. Seminari Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare 29. Prishtinë.
- Munishi, Shkumbin (2010b). Planifikimi i statusit të gjuhëve në Kosovë. Pozita e sotme e gjuhës shqipe në Mal të Zi në krahasim me atë në përgjithësi (sesion shkencor i organizuar më 19.12.2010 në Ulqin, Art Club, Ulqin, Mali i Zi).
- Munishi, Shkumbin (2009). Barazia e gjuhëve në Kosovë dhe perspektiva evropiane. 1. Uluslararası Balkanlarda Tarih ve Kültür Kongresi. Bildirler Kitabı (Kongresi I Ndërkombëtar Ballkanik). 10-16 Mayıs, 2009. Kosova. Priştine.
- Munishi, Shkumbin (2006). Probleme të shqipes standarde në Kosovë. ZeroPrint. Prishtinë. 2013.
- Rugova, Bardh (2012). Pozita dhe statusi i shqipes kundruall gjuhëve të tjera të Ballkanit. Shqipja dhe gjuhët e Ballkanit – konferencë shkencore. ASHAK. Prishtinë.

ENDONIME DHE EKZONIME PËR SHQIPTARËT DHE FQINJËT

(Rezultate të ekspeditës kërkimore në Zhupë, Gorë dhe Opojë, 2012-2013)

Titulli i kësaj trajtëse është i lidhur me dy përvoja kërkimore e studimore të realizuara në periudhën 2010-2013:

1. Në përbërje të ekspeditës tematike etnologjike *Të jetuarit në kufi*, të organizuar nga Qendra e Studimeve Albanologjike (QSA), në rajonin e Zhupës dhe në atë të Gorës e Opojës, në jug të Prizrenit;

2. Si këshillues i jashtëm i *Census Albania 2011* (pjesërisht dhe i *Rekos 2011*) për referimin dhe agregimin terminologjik të vetëdeklarimeve të qytetarëve për kombësi, gjuhë e besim, së bashku me prof. Alessandro Gori, specialist i besimeve në *Università degli Studi di Firenze*, dhe prof. Patrick Simon, antropolog, i *Centre d'études européennes*.

I.

Në pjesën e parë u referohemi kërkimeve të drejtpërdrejta në terren, në një rajon ku jetojnë *ishuj të vegjël popullsisht më së paku dygjuhëshe*, ku, në dhjetëvjetëshin e fundmë, me pavarësimin e Kosovës si shtet, kanë dalë *probleme të vetëpërcaktimit*, që, në vështrim të parë, mund të shihen dhe si *shenja të një krize identiteti*.

Në konceptin fillestar, ekspedita kërkimore kishte për qëllim që të verifikonte se çfarë ka ndodhur në njësitë etnografike tradicionale në kushtet e veprimit ndarës njëshekullor të kufirit politik-shtetëror, me krijimin e dy Malësive të Gjakovës, dy Malësive të Dukagjinit, dy Dibrave, dy Hasëve. Por më pas koncepti u zgjerua dhe u bënë kërkime edhe për efektin e gjuhës kufitare dhe të dygjuhësisë. Në këtë kuptim, kërkimi mori dhe një përmasë të receptimit të këtyre bashkësive etnike përmes *pasqyrës së gjuhës së tjetrit*.

Kërkimet e mia në terren gjatë ekspeditave duhej t'u referoheshin pyetjeve për *etnonimet në gjuhën e tjetrit*, të njohura si *ekzonime* dhe

etnonimet e zhvilluara së brendshmi, të përkufizuara si *endonime*, kryesisht në mjedise bilinge ose së paku me njohje të dy gjuhëve, veç dy krahinave të përmendura, edhe në komunën e Rahovecit e në atë Mamushës, ku vitet e fundme është promovuar një bashkësi turke. U bënë kërkime për katër e më shumë shkallë emërtime shqiptarë, si apelime të *karakterit historik-asnjës, përdallues-përçmues, zyrtar dhe emfatik-vlerësues*. Ky përkufizim i argumentit të kërkimit mundësoi që pyetja për etnicitetin e këtyre bashkësive të lihej anash për ndonjë ekspeditë tjetër. Sa i takon kohës së kalimit prej arkeonimeve tek etnonimi, prej ekzonimeve tek etnonimi i ri, duhet të ketë ndodhur kur etnonimi i vjetër u bë i pamjaf-tueshëm për të cilësuar shqiptarët dhe lindi nevoja e një vetidentifikimi të ri, që jo rastësisht përkon me kohën e homogjenizimit kombëtar.

Kjo ishte një çështje shumë e vështirë për t'u anketuar, për arsye sepse ende nuk ekziston një klimë deklarimi të lirë dhe ka shumë prani deformuese jashtëndikuese, pa folur për pengesa të tjera që kanë të bëjnë me shkallën e vetënjuhjes dhe me mirëbesimin me të anketuarit.

Si rezulton emërtimi i shqiptarëve në gjuhën e tjetrit në rajonet ku u bënë kërkime? Për t'u përgjigjur kësaj pyetjeje u jemi drejtuar dy ligjerimeve, të kulturës shkrimore-tradicionale dhe të asaj të gjallë gojore. Dëshmitë gojore janë gjetur kryesisht prej anketuesish të rivizituar, sepse në bisedat fillestare pohimet kanë qenë thuajse gjithnjë deklarative. Prej kërkimeve u verifikua ky përshkallëzim emërtime, shprehje mënyrash etnike të sjelli, të njohura si ligjërim etnografik në popullsinë sllavishtfolëse:

1. Etnonimi historik mesjetar i shqiptarëve, siç dihet, prej kujtesës dokumentare, në formën *Rabanjb, Rabanija, rabani, rabënëski*, është dëshmuar herët prej studiuesish albanologë të mirënjohur, si L. Thalöczy, Milan pl. Šufflay e C. Jireček. Ndërsa në kujtesën e gjallë popullore prej kujtesës së pashkruar bartur prej folësve të sotëm sllavishtfolës, në formën *Rabania, rabani, arbanaška zemlja, arbanaška vjera; arbanaški zakoni*, në qarkun e Bregalnicës në Maqedoni para nesh e kanë identifikuar studiues serbë e maqedonas, të cilët përmes këtyre emërtimeve kanë shpjeguar përmbajtjen e emërtimeve toponomastike në hapësira të prekjës historike të shqipes dhe gjuhëve sllave. Në stilin shkencor *arbanaška – арбанаишки* në vend të *albanci* është zëvendësim i plotë sinonimik edhe sot: *Исмаил*

Кемал је наложио избеглим арбанаџиким прваџима. Në emërtimet toponomastike *Arbanas* dhe variantet e tij gjen përhapje në një shtrirje shumë më të gjerë se hapësira e sotme e shqiptarëve në Ballkan:

- *Arbanas*: Kërçovë, Krushevo, Manastir, Shtip, Shkup (vendbanime në rajonet e tyre);
- *Arbanasa*: Priljep (në rajonin e përmendur);
- *Arbanash* - *Arbanaš*: Nish, Prokuplje, Kurshumli (fshatra në këto rajone);
- *Arbanashki* - *Arbanaški*: Kërçovë, Shtip (si më sipër);
- *Arbanashka* - *Arbanaška*: Kumanovë (si më sipër);
- *Arbanashik* - *Arbanašik*: Vranjë (si më sipër);
- *Arbanasinofc* - *Arbanašinovc*: Priljep (si më sipër);
- *Arbanë* (dhe *Qafa e Arbanës*): fshat në afërsi të Tiranës;
- *Arbën* (toponim): Lezhë, Mirditë, Kurbin.

Gjatë ekspeditës së vitit 2012, të rikthyer në fshatin e largët malor Manastiricë të Zhupës, gjatë anketimit të z. Rafija Banovi, i lindur më në korrik të vitit 1930, i pashkolluar, ndonëse ka mësuar fare pak shkrim e këndim si autodidakt, për herë të parë dhe të vetme gjetëm etnonimin *rabanë*, *rabani*: *Mi nismo naslednici arbanasi, mi smo naslednici rabani* - *Ne nuk jemi pasardhës të shqiptarëve, por të rabanëve*. Sipas subjektit të intervistuar, ishte krejt e gabuar të pretendohet prej nesh që të zbulohet ndonjë lidhje midis banorëve të fshatit Manastiricë, ku mbiemrat e sotëm (Koliqi, Kuliqi) të kujtojnë Shkodrën, sepse *arbanasi i rabani ni su isti*, *rabanë* e shqiptarë nuk janë një: *Rabani mrtvi su od vreme Đurađa Kastriota*.

Kujtesës së pashkruar i vjen në ndihmë mikrotoponimi *Raban*, një fshat në krahinën jugore të Shqipërisë *Shqerri*, emrin e së cilës studiuesit priren ta shpjegojnë me *Sclavonia*, etnonimi i sllavëve të jugut në *interpretatio latina*, në këtë rast i ruajtur prej një periudhe kur rotacizmi ishte ende një proces i pambyllur. Sa i takon mundësisë historike të depërtimit të sllavëve gjatë dyndjeve të mijëvjeçarit të parë deri në thellësi të tilla jugore pasuria gjuhësore e shqipes sjell si dëshmi praninë e emërtimeve, *jashtë hapësirës jetike shqipfolëse*, ndër arvanitët e Greqisë dhe arbëreshët e Italisë, si: *shkinisht, shkienisht, shklerisht, sklerishte, shklerisht*, jo vetëm për të identifikuar gjuhën serbe (a bullgare), por dhe si emërtim i *gjuhës së tjetrit*.

2. Etnonimi zyrtar *Albania, albanci*, është i njohur si emër etnik prej të gjitha grupeve sllave ose bilinge, pavarësisht burimit historik të tyre,

që u anketuan: në Gorë e Opojë, në Zhupë (*Prizrenska Župa*) e gjetiu. Folësit e brezit të vjetër me *Albania, albanci* Shqipërinë si shtet dhe bano-rët e saj. Për shqiptarët e Kosovës etnonimi mbishquhet: *naši albanci*, në rastin më të mirë, por dhe *južnoslovenski albanci*.

3. Etnonimi përdallues-divergjues *shiftari, shiptari, shqiptari* përdoret edhe sot shqiptarët e ish-Jugosllavisë, më së pari për ata të Kosovës.

4. Etnonimi përçmues-kakofemik i burimit osman *arnaut/arbauti, arnautska naseljenje, isterivanje arnauta*, që u përdor edhe në gjuhën e ligjërimeve të lartë si ai politik-diplomatik, është dhe sot i gjallë. Shqiptarët, duke përfshirë dhe *qytetarët turqelinj* të Prizrenit, këtë emërtim e quajnë fyes, pavarësisht se prej ç'gjuhe vjen.

5. Ekziston dhe një formë drejtimi nderues, një emërtim që mund të quhet eufemik: *komše, daj, daje*. Kjo është shkalla më e madhe e afërisë që mund të shprehë përmes apelimit një serb për mikun e tij shqiptar, jo për shqiptarët në përgjithësi: *Ako mi ne vjerujete, zvati ujak daje Rexha - Nëse nuk më besoni mua, mund të pyesni me telefon dajën Rexhë* (Stredska e Zhupës). Gjatë kërkimeve tona u vërejt se më lehtësisht një serb (ose një sllavishtfolës tjetër dhe më lehtë) mund të pranojë thirrjen nderuese për mikun e tij shqiptar se anasjelltas.

7. Me interes gjuhësor dhe etnologjik mund të çmohet fakti që në epikën popullore historike serbe ruhet një gjurmë e dallimit etnokrahinor dhe etnogjuhësor për *shqiptar-gegë*, si në dy këngët historike kushtuar Marko Boçarit: *Vdekja e Marko Boçarit (Смртта на Марко Боچار)* dhe *Kapedan Gjorgji (Капидан Ѓорѓи)*, që i pati mbledhur më 1908 P. A. Lavrov në viset e Maqedonisë dhe i pati botuar më 1920. Në këngën nr. 77 të koleksionit të tij, titulluar *Përmbledhja e Verkoviç-it: I, Këngë popullore të bullgarëve maqedonas*, gjenden dhe dy vargjet e mëposhtme:

Ча Шкодрали нашиа најди, Çfarë e gjeti pashën shkodranli,
Са дванајсе хиљади Гега Арнаути Me 12 mijë gegë arnautë.

Përdallimi i *shqiptarit gegë* prej shqiptarëve në përgjithësi në letërsi gjendet, sido që rrallë edhe në arumanisht dhe rumanisht, si rasti i poemës historike *Voshopolea* kushtuar katastrofës që i ndodhi qytetit të Akademisë së Re në gjysmën e dytë të shekullit të 18-të, në të cilën shqiptari shkaktar i djegies së qytetit në të gjitha kontekstet është *gegë a gegë i mallkuar*. Sipas

gjasave, këtë përdallim e ka përçarur në rumanisht kujtesa historike e arumunëve të Shqipërisë:

Me katër gegë një arumun po ndeshet

E tillë luftë nuk është e lehtë.

Pastaj të mallkuarit gegë ngjyejnë

Me radhë, dyqanet me katran.

Dhe në mëhallë duan gegët të shkojnë

Ku shtëpitë u duken si pallate.

Studiuesi grek Konstantinos N. Sathas, në ciklin e këngëve greqisht shkruar prej Haxhi Shehretit të Delvinës për Ali pashë Tepelenën, gjithashtu e gjen në gojën e popullit makrotoponimin *Gegëria* - *Gekarià* – Γκεκαριά. Dy emërtime të tjera makrotoponimike: Toskëri (Τοσκαριά) e Labëri (Λαμπεριά), gjithashtu në greqishten gojore dalin në kohën e revolucionit të vitit 1827, krahas me emrat e kapedanëve arvanitas e suliotë.

Etnonimi *Gegëria* (*Gekarià* - Γκεκαριά) në poemën *Alipashaida* të Shehretit të Delvinës.

Gjatë dy ekspeditave të zhvilluara në mjedise gjuhësore kufitare shqiptaro-sllave ose dygjuhëshe së paku, duke e njohur këtë fakt të kulturës librore, e kërkuam në mënyrë të veçantë këtë mbitheksim të etnonimit të shqiptarëve në gjuhë të fqinjëve veriorë, por për të gjithë bashkëbiseduesit: goranë, torbeshë, maqedonas, serbë, *gegë* apo *shqiptar gegë* nuk kishte asnjë kujtim.

Kjo na shtyu të kërkojmë nëse emërtimi *gegë* është tejkaluar dhe brenda shqiptarëve si përveçim etnokrahinor historik, por, ndryshe nga ç' prisnim, rezultoi se emërtimi përdoret edhe sot, është i gjallë madje edhe në disa stile të ligjërimit publik zyrtar, pikërisht për të krijuar dallimin midis krahinës dhe atdheut: *Ustallarët e Reformës janë treguar dorërendë mbi Gegninë, duke shartuar një padrejtësi të re politike, padrejtësi që arrin kulmin me vrasjen politike që i bënë Dukagjinit, duke e zbuar përfundimisht nga harta politike një krahinë qindravjeçare 100 karatshe shqiptare.*

Sa u takon dallimeve të serbëve dhe kroatëve sipas të folmeve dhe

ndarjeve etnokrahinore (*čakavsko narečje, kajkavsko narečje, štokavsko narečje, torlačko narečje*), për këto nuk gjetëm përgjigje jo vetëm tek shqiptarët, por dhe tek vetë bashkësitë sllave në Kosovë, duke përjashtuar rastet e njerëzve të shkolluar.

8. Kërkimi ynë për emërtimin *kosovar* përgjithësisht gjeti refuzim, si nga shqiptarët, ashtu dhe nga grupimet sllavishtfolëse, me një dallim të vogël: më lehtë mund të pranohet prej shqiptarëve dhe pakicave ishullore se prej serbëve, të cilët e konsiderojnë fabrikim. *Kosovar*, në gojë të serbëve, do të thotë serb i Kosovës: *kosovari su naši srbi*.

Në vitin akademik 2012-2013, Universiteti i Prishtinës, megjithëse në rubrikën për kombësinë të formularit të regjistrimit të studentëve të rinj e kishte vendosur në krye emërtimin *kosovar*, asnjë student nuk u regjistrua si i tillë. Shqiptarët e Kosovës e pranojnë emërtimin *kosovar* për shtetësi, por jo për etnicitet. Në regjistrimin e fundmë të popullsisë në Kosovë *Rekos 2011*, megjithëse *kosovar* tashmë është bërë një term ndërkombëtarisht i njohur, rezultoi se thuajse askush nuk dëshoi të regjistrohej si i tillë, megjithëse u dalluan si grupime etnike të faktorizuar edhe *goranët* dhe *ashkalinjtë*, një grupim rom i dallueshëm prej të tjerëve kryesisht prej një antinomie fetare dhe deri diku edhe gjuhësore, si *romë shqipfolës*. Në të kundërtën, gjatë regjistrimit të fundmë të popullsisë dhe banesave në Shqipëri (*Census Albania 2011*) vetëdeklarimi *kosovar* për etnicitetin u vërtetua mjaft frekuent, por jo aq sa vetëdeklarime të tjera mbi baza etnokrahinore, si *lab, çam, gegë, malësor*.

Tab. 3.13 – Popullsia rezidente sipas përkatësisë etnike/kulturore, gjinisë dhe moshës

MOSHË		PËRKATËSIA ETNIKE/KULTURORE											Gjithsej
		Shqiptar	Serb	Turk	Boshtjak	Rom	Ashkali	Egjiptian	Goran	Të tjerë	Preferojnë të mos përgjigjen	Nuk janë në dispozicion	
Gjinësej	0-4	138,651	1,596	1,502	2,028	1,191	2,100	1,213	810	126	74	444	149,735
	5-9	149,933	1,658	1,400	2,094	1,100	2,061	1,409	806	153	88	214	160,916
	10-14	166,154	1,525	1,515	2,191	1,067	1,902	1,445	760	123	81	163	176,926
	15-19	164,135	1,915	1,594	2,352	901	1,628	1,250	792	127	91	147	174,932
	20-24	151,471	2,074	1,597	2,099	756	1,368	1,033	743	129	65	132	161,467
	25-29	131,946	1,981	1,529	2,026	631	1,159	903	711	176	63	143	141,268
	30-34	122,240	1,616	1,400	1,845	578	1,046	775	685	186	62	109	130,542
	35-39	116,913	1,468	1,357	1,823	524	974	710	766	205	77	95	124,912
	40-44	100,680	1,534	1,182	1,941	453	747	549	712	199	76	69	108,142
	45-49	87,723	1,632	1,125	2,015	368	622	566	665	171	50	51	94,988
	50-54	73,793	1,714	1,130	1,711	347	551	495	641	151	38	54	80,625
	55-59	59,465	1,570	1,142	1,399	325	476	350	582	146	34	50	65,539
	60-64	48,311	1,380	815	1,087	218	309	286	428	135	33	46	53,048
	65-69	40,323	1,104	591	937	139	215	217	345	116	20	49	44,056
	70-74	30,350	1,225	382	932	119	141	168	341	92	29	28	33,807
	75-79	19,675	942	290	607	67	64	109	274	70	16	28	22,144
	80+	15,106	598	187	446	40	73	46	204	47	13	18	16,778
	Gjithsej	1.616.869	25.532	18.738	27.533	8.824	15.436	11.524	10.265	2.352	912	1.840	1.739.825

Të dhënat përfundimtare të përbërjes demografike dhe të strukturës demoetnike të popullsisë në Kosovë.

Mund të supozohet se tek *Të tjerë* ka dhe të regjistruar si *kosovarë*, por kjo nuk gjen mbështetje prej të dhënave të shpeditës. Në fakt, në këtë pamje të strukturës demoetnike në Kosovë sot kanë luajtur rol përgjigjet orientuese të pyetësorit *Rekos 2011*, i cili, në rastin e *Census Albania 2011*, qe pa asnjë denominacion të gatshëm për zgjedhje. Për t'iu përgjigjur kësaj strukture demo-etnike flamurit të Kosovës do të duhej t'i shtoheshin së paku dy yje, por kjo nuk do të ndodhte për ndonjë stabilizim a preferencë të emërimit *kosovar*. Të dhënat e kërimit në terren, të krahasuara me ato të regjistrimit zyrtar të përgjithshëm të popullsisë dhe banesave në Kosovë realizuar në vitin 2011, provojnë dështimin e disa sprovave dhe debateve për të farkuar një komb *kosovar* dhe një identitet të përveçëm të shqiptarëve të Kosovës, që i brendashkruhet etnicitetit *shqiptar*, por njëherësh bën dallim prej tij dhe propozohet për endonim të ri.

TO WHICH ETHNIC OR CULTURAL BACKGROUND DO YOU BELONG?

According to the Kosovo Constitution, the enumerated person may choose not to declare.

1	☐	Albanian
2	☐	Serb
3	☐	Turkish
4	☐	Bosniak
5	☐	Roma
6	☐	Ashkali
7	☐	Egyptian
8	☐	Goran
9	☐	Other (specify) _____
10	☐	Prefer not to answer

Pjesa e gatshme e pyetësorit të *Rekos 2011* për etnicitetin.

Në kushtet e privilegjimit kushtetues të pakicave të çfarëdoshme: etnike, kulturore, fetare, si mundësi e vetme për të krijuar besimin se Kosova është shtet i të gjithë banorëve të saj; nga kërkimi në terren, kryesisht prej njerëzish të ditur, rezulton dhe një opozicion minimal i panjohur më parë: *kosovar* - *kosovarli*, që në vlerësimin tonë rezulton artificial. Më të zellshmit, për arsyetimin e këtij opozicioni si antinomi historike, i drejtohen edhe këngës popullore:

Mos m'i lidhni syt' me shami,

Se jam shqiptar, kosovarli.

Në traditën e hershme etnofolklorike këtë dyvargësh kemi mundur ta gjejmë vetëm në këngën historike *Sefë Kosharja*, *i pari i fisit*, në dy variante. Në të dy variantet ndihet ndikimi i kulturës së shkruar. *Jam shqiptar, kosovarli*, ndërfitet i gatshëm si varg klishe, pas gjase ardhur prej lexi-

meve librore, në kontekste të ndryshme të së njëjtës këngë, në fillim dhe në fund të rapsodisë, pa pasur ndonjë funksion përdallues ndaj etnonimit *shqiptar*, përveç një ngjyrese mbitheksuese të tij:

I. Sefë Kosharja i pari i fisit

Hije t'paska maja e plisit!

- Hije m'ka o shok't e mij,

Kam dhanë jetën për liri!

Kam dhanë jetën për liri,

Jam shqiptar kosovarli!

II. Nuk jeton shqipja pa bij,

Nuk gjallnon ajo pa liri.

Nuk duron shqipja robëri,

O jam shqiptar kosovarli!

Në të dyja rastet vargu nuk ka kontekst zanafillës të vetin, që të mund të dëshmonte se vjen prej rapsodit popullor. Ardhur prej letërsisë, vargu gjendet dhe në krijime të sotme poetike, kryesisht në një formë të lirikës atdhetare që rishfaqet prej dekadës së fundme të shekullit të kaluar, me shpërbërjen e ish-Jugosllavisë:

Mos m'i lidhni sytë,

Mos, more, me shami,

Se jam zog shqiptari,

Jam kosovarli!

Për shkak të ngatërimit të nocionit të shtetësisë me kombësinë, më shumë prej entuziazmit të realizimit të një ëndrrë të hershme për shtetësi, është shfaqur prirja që denominimit *kosovar* t'i njihet kuptimi kategorial i etnonimit: Nëse shikojmë rrugëtimin historik të tij, etnonimi '*kosovar*', deri në fillim të shekullit XX, ka mundur të barazohet me etnonimet e krahinave etnografike ... Por pas shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë dhe pushtimit të Kosovës nga shteti serb, etnonimi '*kosovar*' nga shqiptarët e Shqipërisë së lirë ka përfshirë banorët shqiptarë të mbetur nën ombrellën e mbretërisë serbo-kroato-slllovene që quhej Jugosllavi. Edhe në raste të tilla është

thirrur në ndihmë kënga popullore (*jam shqiptar e kosovar*) si argument historik-kulturor.

Përpyekjet për të faktorizuar një shenjë etnodalluese midis *shqiptarit* dhe *kosovarliut* lidhet kryesisht me kulturën fetare dhe ndoshta dhe me njëfarë simpatie, që i përgjigjet ndikimit të projektit të njohur të neotomanizmit. *Kosova është Turqi, Turqia është Kosovë*, deklaroi kryeministri turk Recep Tayyip Erdoğan gjatë një vizite në Prizren në vitin 2013. Shfaqja e emërimit *kosovarli* ka lidhje dhe me inkurajimin e këtyre sentimenteve prej së jashtmi.

Në rastet kur mundëm të krijojmë mirëbesim tek bashkëbiseduesit, qofshin shqiptarë, qofshin sllavë, emërtimi *kosovar* u krahasua me emërtimin *jugosllav* dhe u ironizua si *produkt i një bashkim-vëllazërimi të ri nën përkujdesjen ndërkombëtare*.

Sa u takon etnonimeve të popujve sllavë të Jugut në gojë të shqiptarëve, këto janë më të reduktuara. Në thjeshtligjërim sundon etnonimi zanafillës historik *shka/shkie* dhe *shqa/shqe*, që kupton të gjithë sllavët e Ballkanit dhe në ndonjë rast merr dhe konotacionin *i krishterë*. Gjen rezistencë përpjekja për të bërë dallimin midis *serbëve* e *malazezëve*, të cilët janë njësoj, *shkie*. Boshnjakët nuk kanë lënë ndonjë mbresë historike të dhunshme tek shqiptarët, por dhe ata shpesh mbulohen me etnikun *shkie*, dhe si argument përmendet shprehja frazeologjike gjysmë turke, gjysmë serbisht, por që citohet si një idiomë e gatshme edhe prej shqiptarëve: *zullum krk bošnjaka - kërdua e 40 boshnjakëve*, një ngjarje lufte e grabitjeje e periudhës së Lidhjes së Prizrenit në Rugovë. Prej më të shkolluarve *shqa* e *shkie* janë zëvendësuar me *sllav*, dhe ky si emërtim gjithëmbulues. Brezat më të rinj përdorin *jugosllav* ose *ish-jugosllav*.

Për *torbeshët*, *goranët*, *boshnjakët* e Zhupës thuhet se janë të gjithë *shqiptarë që flasin sllavisht*. Vetë *goranët*, megjithëse flasin mirë shqip, mohojnë të jenë shqiptarë, por me vështrimin e serbëve nuk janë sllavë. Është e njohur polemika e futbollistit *goran Miralem Sulejmani*, sot lojtar i *Benfica-s*, kur luante me *Partizanin* e Beogradit. Kur tifozeria kundërshtare, për ta fyer, ia zëvendësoi emrin dhe e thërriste *shiftar*, ai u përgjigj: *Ja nisam shiftar, ja sam goran*. Por kjo nuk luajti asnjë rol zbutës tek tifozeria serbe.

Nëse ngulmohet me kujdes e gjithnjë në kushte konfidence, nga të anketuarit shqiptarë mund të pranohet një dallim midis serbëve e malazezëve, për të arritur deri tek kuptimi i ngushtë, *shqa/shka* i kuptuar për *serb*. Nuk gjetëm emërtime për kroatë e sllovenë, përveçse në gjuhën e literaturës. Vllahët nuk i identifikojnë dhe vetëm kur përmendet forma sllave e emërtimeve të tyre, *vllasi*, kujtohen.

Emërtime të sllavëve të jugut përmes gojës së shqiptarëve:

1. Shkja, shkje (për të gjithë sllavët e jugut, por jo për bullgarët dhe sllavë të tjerë, dhe për serbët më vete).
2. Sllavë, jugosllavë (për të gjithë).
3. Boshnjakë (edhe për myslimanë, torbeshë, goranë).
4. Crnogorac, malazias, malazez.

Shkalla më e lartë e afinitetit të një shqiptari me serbin shprehur përmes apelimit ishte *komshi*, ose *këta që na kanë ra për hise*. Në biseda më të thelluara kemi mbërritur deri tek pohimi: *Shqiptarin tim e ka falë Zoti, por shqiptarët në përgjithësi janë të ligj, i bëjnë të gjitha të zezat*; po ashtu (afërsisht) dhe prej shqiptarëve për serbët, shprehje e një largimi të vogël prej stereotipeve të hershme ballkanike.

Përgjithësisht prej shqiptarëve të intervistuar nuk pranohet kurrësi që midis serbëve e shqiptarëve të ketë ngjashmëri të kushtëzuara prej kontaktit historik dhe zhvillimit në fqinjësi, për shembull që *lahuta* të jetë e ngjashme me *guslën*. Por, në kontekste situative, mund të shkohet deri në pohimin e kundërt:

P.: A i ngjan gusla e serbëve lahutës shqiptare?

Përgj.: *I ngjajke, po na shqiptarët gusllës nuk i biem.*

P.: Nuk i bien se nuk del kanga apo se ndryshon nga lahuta?

Përgj.: *Nuk i bien se na kemi lahutën tonë.*

P.: Po mos me e pasë lahutën, a këndohet kënga e Mujit dhe Halilit me guslë?

Përgj.: *Tash qysh me të thanë. Ky Sylë Kajtazi ka qillue njiherë me një malazias. Edhe ky kishte gusllën e po i bijte. I bijte e i knojke. Po qysh me ndigjue. Ato kangët e malaziasve i vrasin e i presin shqiptarët si kosa në livadh. Sylë Kajtazi e ndigjoi malaziasin, po s'kishte lahutë me vete. Qysh me ia ba. Qe po i thotë malaziasit: 'Sielle, bre zotni, atë send këtu, ama mue se boll shqiptarët i kie pre, e s'ban pa i*

pre edhe unë do krenë shkjesht!’ Edhe i ra gusllës shqiptarisht, knoi kangë krahine, i preu krenët e shkjeve edhe ia dha gusllën të zotit. I knojke edhe me gusllë se s’durojke, jo se guslla asht njisoj si lahuta.

Megjithëse, siç u pohua, në statistikimin përfundimtar të popullsisë sipas vetëdeklarimit etnik në *Rekos 2011* duket se ka një prirje konvergjente, përveç dallimit të *ashkalinjve* prej *romëve* dhe *egjiptianëve* për shkak të besimit, në anketimin tonë sundoi prirja e vetëdallimit, që shprehet dhe në titullin e kësaj trajtese: *Naši smo, da nismo našinci, Naši smo, da nismo isti*. Torbeshë, goranë, boshnjakë, folës të sllavishtes arkaike të Rahovecit, bashkohen prej gjuhës dhe besimit, por nuk e pranojnë të jenë të një burimi. Në pikëpamjen gjuhësore, përveç rastit të zhargonit të muratorëve të Zhupës dhe Gorës, që, me gjithë studimet e realizuara, ruan ende një hermetizëm tradicional, të folmet e tjera mund të cilësoheshin me termin *patois*.

Në mjedisin ku bëme kërkime, për popullsinë sllavishtfolëse të rajoneve të ishullzuara, rezulton kjo pamje:

Nr.	Emërtime vetëquajtëse (endonime) në Zhupë, Gorë e Opojë
1.	Naši, našinci, našnici
2.	Bosanac
3.	Bošniaci
4.	Bošniaci turcin
5.	Bošniaci ungari
6.	Bošniaci bugari
7.	Musulmani
8.	Goranci
9.	Torbeši
10.	Makedonac
11.	Kosovar: <i>mirë, po e lamë kështu</i> (nënkupto: <i>si e doni ju</i>)
12.	Emërtimi <i>pomacë - pomacët - помаци</i> (maq.), <i>πομάκοι</i> (gr.), <i>помаки</i> (bullg.), <i>pomaklar</i> (turq), një emërtim për <i>bullgarët</i> (dhe sllavët muhamedanë), nuk na u përmend nga asnjë subjekt i intervistuar.

Kjo shumësi e larmi etnonimesh: *eufemike, përçmuese-kakofemike, neutrale, historike, romantike, zyrtare, arkaike*, ishte vështirësi objektive në arkivimin e të dhënave të kujtesës gojore popullore, si të shqiptarëve, dhe të të tjerëve. Këtyre etnonimeve u përgjigjen një mori nismash, projektesh dhe shoqatash jashtëvarësie ose jashtëndikimi, me favore ekonomike dhe juridike.

Ky çintegrim i vërtetuar prej kërkimeve gjatë ekspeditës ka shpjegim jo vetëm me inkurajimin ligjor të minoriteteve, por dhe me arsye historike. Në periudhën jugosllave, dy *kombësitë e fabrikua*ra: *kombësia jugosllave* dhe ajo *myslimane*, shërbenin si një mbulesë e mjaftueshme formale për grupime të tilla etnike e fetare ishullore, që nuk i përgjigjen as *statusit të enklavave*. Shpërbërja e ish-Jugosllavisë së tretë shtroi para tyre pyetjen: *Çfarë jemi?* Një proces riidentifikimi çoi deri në njohjen formale të një kombësie të re në Kosovë, të *kombësisë gorane* (*gorani*, *goranci*), tashmë e zyrtarizuar; si dhe të një *kombësie* tjetër, të imponuar prej numrit relativisht të vlerësueshëm të të vetëdeklaruarve: *torbesh*, *torbeši*, *sllavë muslimanë* që nuk pranojnë të identifikohen me asnjë nga kombësitë e vjetra të ish-Jugosllavisë.

Nga kërkimet tona për etnicitetin e grupimeve të tilla në Zhupë e Opojë doli se njerëzit e shkolluar janë në kërkim të një identiteti, kryesisht *prej dallimit me tjetrin*; një *identifikim negativ*, që i përgjigjet pyetjes *çfarë nuk jemi*: *Ja ne govori albanskom, zato ni sam albanac; ja ni sam pravoslav, zato ni sam srb. Šta ja sam? Ne imam drugo puta samo bosanac, ali musliman: Unë flas serbisht, por nuk jam i krishterë, prandaj nuk jam serb; unë jam mysliman, por nuk flas shqip, prandaj nuk jam shqiptar; ç'mund të jem tjetër, veçse boshnjak?*

Sa i takon *gjuhës*, vazhdon të mbetet në përdorim identifikimi me: *naša*, *po naškom*; ose, tek më të shkolluarit, me *mi govorim slavsko*, *mi govorim južnoslavenski*. Ndërsa të folurit, duke përfshirë atë në shkolla, gjithnjë e më shumë shkon drejt një *zhargoni grotesk*, ku turqizmat, albanizmat dhe sllavizmat ndërliken ndonjëherë në mënyrë agramatikore, siç mund të vërehet nga kjo mënyrë paraqitjeje e temës *Mikroorganizmat* nga mësuesi në lëndën *biologji* në shkollën e fshatit Mushnikovë që u asistua prej nesh: *Mikroorganizmi su mali hajvančići. Kada su na trup čoveka, Zot na ruej, jo mikroorganizmi, da čovek može i mrtav biti.*

II.

Një proces i ngjashëm *çintegrimi e ripërcaktimi* deklarativ, por në ndonjë rast dhe përmbajtësor, në kushtet e shoqërisë së hapur, u dëshmu

dhe në rajone me popullsi kompakte në Shqipëri. Të ftuar që të përkufizojmë termat e referencës dhe kështu të lehtësojmë statistikimin e të dhënave për vetëdeklarimet e qytetarëve për etni, gjuhë e besim në *Census Albania 2011*, bashkë me dy kolegët që përmendëm, pa pasur akses në të dhënat numerike, fillimisht u gjendëm të befásuar dhe me pikëpyetje të rënda për proceset e ndodhura me identitetin shqiptar.

Megjithëse me një filtrim paraprak nga vetë specialistët e *Census*-it (që përjashtonte vetëm gabimet teknike), dhe me një filtrim të dytë të mbi 8000 emërtimeve diverse të rezultuara së bashku për tri deklaratimet, në fazën e parë gjendja ishte: 430 emërtime për kombësinë, 608 emërtime për besimin dhe mbi 159 emërtime për gjuhën.

Vetëdeklarimet në shifra: *Census Albania 2011*

8000 emërtime gjithsej	Pa filtrim	Gjendje e ndërmjetme (para agregimit)	Pas agregimit
Etniciteti	> 800 përcaktime	430 përcaktime	16 terma reference
Gjuha	> 400 përcaktime	159 përcaktime	16 terma reference
Besimi	> 800 përcaktime	608 terma	20 terma reference

Pamja e gjendjes së ndërmjetme për termat e vetëdeklarimit për etnicitetin për studiuesin e pamësuar me efektin e një nisme administrative të zbatuar në kushte paragjykimesh, mosbesimi dhe mbi të gjitha jash-tëndikimesh, ishte befasuese, për të mos thënë alarmante. Pa një shqyrtim analitik rast pas rasti dhe pa një përkufizim termash me rreptësi shkencore, cilido që do të njihej me pamjen fillestare të emërtimeve etnonimike vetë-quajtese, do të gjente një analogji situative me çka gjejmë në satirën e njohur të At Gjergj Fishtës në librin e tij *Metamorphosis* (1907):

*Ta dijë Shqypnija
Pra, sheklli marë,
Se mà mbas sodit
Un s'jam shqyphtar.
A ndit, zotni,
Qi rrini m'shka
Un mà me sodjet
Shqyphtar nuk jam.*

M'thirrni si t'doni,

Tham: Urdhno!

"Zulu" ma njitni...

Shqypitar, pòr, jo.

Emërtimet për përkatësi etnike dhe vetëdeklarime për gjuhë amtare e besim, në gjendjen para përkufizimit të termave, përbëjnë një rezervat të vërtetë për shqyrtime shkencore etnogjuhësore, etnopsikologjike, etnoidentifikuse; për studime rreth psikozave masive e komplekseve kombëtare; për rolin e ndryshëm që kanë në identitetin shqiptar dhe në identitetin e bashkësive të tjera që jetojnë në Shqipëri faktorët që e përbëjnë atë: gjuha, besimi, tradita, shkolla. Faktorët heterogjenizues dhe analiza shkencore e tyre lejojnë të kuptohet se pamjet romantike për shqiptarësinë, që ngrihet përmbi dallimin fetar, krahinor dhe kulturor, nuk janë aq të vërtetueshme prej gjendjes reale.

Procesi i shkencorizimit të termave të vetëdeklarimit etnik nisi me kategorizimin e disa faktorëve që dukshëm s'kanë të bëjnë thelbësisht me etnonimet: prej gabimeve teknike, deri tek ngatërrimi i kombësisë me shtetësinë, i kombësisë me vendbanimin (krahinën etnografike), i kombësisë me fenë. Një shumicë rastesh të vetëdeklarimeve etnike të baguara dalin jashtë objektit të kërkimit shkencor sepse janë thjesht përqeshje me procesin e regjistrimit për arsye të ndryshme: *viking* (nr. 26 në listën e emërtimeve), *nordik* (nr. 123), *kaukazian* (nr. 118), *internacional* (nr. 139), *diasporë* (nr. 165), *globalist* (nr. 171), *bahamas* (235), *boks* (242), *bota e 13-të* (nr. 244), *ekuatorian* (nr. 253), *grupi popullor* (nr. 266), *Guyana South America* (nr. 267), *pikturë* (nr. 323), *piano* (nr. 324), *sezionale* (nr. 325), *u përkas të gjithëve* (nr. 270), *indoeuropian* (nr. 271), *telenovelë* (nr. 368), *hakuna matata* (nr. 277). Mjaft prej tyre të kujtojnë "pagëzimin" e evropianëve migrues në mbërritjen e tyre të parë në SHBA në fillim të shekullit të 20-të në filmat humoristikë për historinë e mafias: *Pallto Armani Sicilia Cortese*, *Bluzë Versaçe Venezia Letizia*. E njëjta pamje ironizimi vërehet dhe në deklaratimet për gjuhë e besim.

Për një përfytyrim të përafërt të emërtimeve vetëquajtëse për etnicitetin në gjendjen para përkufizimeve mund të këshillohet një fragment nga tabela e përgjithshme e tyre, me shenjimet e mbajtura prej nesh (shih raportet e cituara Gori-Sinani) për qëllime vleftësimi ose anasjelltas, refe-

ruar termave të përkufizuar. Në shtyllën e parë gjendet statistikimi i denominimeve para filtrimit teknik, në shtyllën e dytë deklaratimet frekvente të qytetarëve, dhe në të tretën vlerësimi i specialistëve, orientimi tek termi i referencës dhe argumenti. Në një fazë të mëvonshme u hartuan kodet e referencës. Për vetëdeklaratimet për gjuhë dhe besim mund të shihen fragmentet në fund të studimit.

MARTIN	Not valid	Personal name
MELENASE	Check the record	Maybe <i>Greek, Helenase</i>
MINATORE	Not valid	Ironic
MINORITAR	Not valid	No ethnic group is mentioned
MJS	Not valid	Nonsense
MOHIKAN	Not valid	Ironic in the Albanian context
MOLDAVE	OK	
MUAÇEVIÇ	Not valid	Personal name
MUHAXHIR	Not valid	Arabic for emigrant, not ethnonim
MULAI	Not valid	Nonsense
MULAT	Not valid	Racial denomination
MURLAN	Not valid	Ironic: title of a film for children
MUSLIMAN	Not valid	Religion instead of ethnic group is mentioned
MUZIKA SPORTE	Not valid	Ironic
NAPOLI SELANIK GREQI	Not valid	Toponyms: ironic
NAURU	Not valid	Geographical term
NAVAHO	Not valid	Ironic in the Albanian context
NORDIK	Not valid	Geographical denomination
ORTODOKS	Not valid	Religion instead of ethnic group is mentioned
PERKAS	Not valid	Nonsense
PIKTURE	Not valid	Ironic
PIRUST	Not valid	Pre-Christian name of an Albanian tribe
POLINEZIANE	Not valid	Multiethnic area

Duke iu referuar vetëm disa prej etnonimeve të vetëdeklaruara, shenjohe mbi dhjetë etnonime krahinoriste vetëm për *çam*: *çam lab*, *çam thesprot*, *çam suliot*, *çam shqiptar*, *çam musliman*, *çam ortodoks*, *çam*

grek, çam Dodona, çam pellazg etj. Thuajse e njëjta larmi vërtetohet dhe për denominimet *lab*, *kosovar*, *malësor*.

Procesi i agregimit të mëtejshëm, me qëllim që të dhënat të mund të bëheshin të deklarueshme, qe mjaft i ndërlikuar. Përveçse për arsye objektive (pamundësia e dikurshme e vetëdeklarimit të lirë të bashkësive etnike e kulturore që nuk njiheshin me kushtetutë), u vërejt prirja e fraksionimit të etnicitetit *shqiptar*: **a.** Përmes dallimit rajonal (*çam*, *lab*, *lalë*, *malësor*, *mirditor*, *lumjan*); **b.** Përmes evokimit të emërtimeve romantike e historike (nga *pellazg*, *arian*, *zeusian*, *ilir*, deri tek *arbëresh*); **c.** Përmes specifikimit të kombësisë me një ndajshitesë referuar besimit (*shqiptar bektashi*, *shqiptar ortodoks*). Identifikimi përmes dallimit rajonal dëshmohej më dendur në shkallën e njësisë etnokrahinore se në atë të ndarjes së madhe në Toskëri e Gegëri, që kishte, deri në periudhën e Rilindjes, edhe pamjen e rivalitetit dhe të konfliktit, siç dëshmohej në një cikël të shkurtër këngësh me titull të përbashkët *Do vjersha për armiqësi ndë mest të toskëve dhe gegëve*, që i pati mbledhur Thimi Mitko dhe i botoi në *Bëletën shqiptëtare* (Aleksandri, 1878):



Krijimi i këtyre opozicioneve, megjithëse pengesat për konvergimin e vetëdeklarimeve u tejkaluan, mbetet një çështje e hapur për studime të antropologjisë sociale, të sociologjisë, demografisë, etnologjisë, sociologjisë së besimit, gjuhësisë etj. Por larinë më të madhe e gjejmë në denominimet për etnicitetin të pakicave kulturore. Nëse u referohemi etnonimeve të popullsisë që identifikohen prej traditës kulturore më shumë se prej asaj etnike, do të shërbenin për një paraqitje të plotë dy tabelat e mëposhtme, e para për mënyrën e vetidentifikimit të arumunëve të Shqipërisë dhe e dyta për vetidentifikimin e romëve. Por në fillim një njohje me tri

shkallë largimi prej etnonimeve terma prej popullsisë shumicë, asaj shqiptare:

Disa prej emërtimeve me shmangie të qëllimshme:

Nr.	Romantike	Ironike	Të paqena
2.	Arian	Alien	Wiking
1.	Autokton	Kaçak	Jugosllav
3.	Dardan	Murlan	Nordik
4.	Dodona	Bota e 13-të	Bavarian
5.	Epir	Enver	Internacional
6.	Etnia	Hindu	Tuareg
7.	Etnik	Babilonas	Martin
8.	European	Grupi popullor	Hindu
17.	Gold	Sezonale	Muhaxhir
9.	Ilir thesprot	Guyana South Amercia	Globalist
10.	Iliro-epirot	Honolulu	Human
11.	Indoeuropean	Muzika-sporte	Ballkanas
12.	Kelte	Minator	Shahin
13.	Kombësia	Milotiptar	I përgjithshëm
14.	Pirust	Mohikan	Aziatik
16.	Trojane	Piano	Caucasion

Me shumë interes paraqiten *endonimet* dhe *ekzonimet* e popullsisë me status pakice kulturore banuese në Shqipëri. Përveç ndërhyrjes së faktorëve politikë dhe gjeopolitikë, pamja e përgjithshme e emërtimeve vetidentifikuese të këtyre grupeve bën të qartë dhe një shkallë çfaktorizimi të bashkësive vetë, të identitetit të tyre; si dhe një mundësi mosnjohjeje dhe krize përcaktimi. Për etnikun *arumun*, siç paraqitet në pasqyrën e mëposhtme, u vërtetuan 22 emërtime, kurse për etnikun *rom* 25 emërtime:

Nr.	Vetëdeklarimi për <i>arumun</i> (Emërtime vetëquajtëse)	Vetëdeklarimi për <i>rom</i> (Emërtime vetëquajtëse)
1.	Arëmen	Amarandos grek
2.	Arrëmenj	Amaro divas
3.	Armeno-shqiptar	Arixhi
4.	Arumun	Cigan
5.	Copane	Cingarë, cincarë
6.	Çoban	Domë

7.	Frëshëriot	Egjiptiane-rome
8.	Grek-vlleh	Gabel
9.	Kllakos (gr. vllahos)	Gabi
10.	Kllamos (gr. vllahos)	Gatal, katal
11.	Kucovllah	Grek rom
12.	Ladin/latin	Katalanas
13.	Llacifac ("vllah-ci-face")	Kurbat
14.	Rëmenj	Kurbiman
15.	Rrëmenë	Kurb-i-mape
16.	Sarakaçanë	Lam
17.	Shqiptar-vlleh	Lojmë, lomë
18.	Shqiptar-vllah-grek	Ramanes, ramani
19.	Vllaho-kelto-roman	Rhomes
20.	Vllaho-maqedonas	Rolmes
21.	Vllahos	Romni
22.	Vllaho-shqiptar	Sintë, sindë
23.		Shqiptar rom
24.		Ugaros
25.		Gipsy

Në fazën parapërfundimtare, pasi u riorientuan drejt një termi reference vetëm ato përcaktime që ishin të padyshimta, pa nevojën e ndonjë interpretimi, *rezultuan 390 vetëdeklarime për etnicitetin, 141 vetëdeklarime për gjuhën dhe 487 përcaktime për besimin*. Duke gjykuar rast pas rasti, të dhënat mundësuan krijimin e kodeve, prej të cilëve po paraqesim kodin për etnicitetin:

1. *Albanian*.
2. *Greek (homogenos are included under this category)*.
3. *Macedonian (shule, nr. 204, as a derogatory name is not taken into consideration; nashke, nashki, nr. 43, is considered a certify denomination; нашите во Албанија / nashite vo Albanija too. The same position referred to kaj nas, linguistic denomination)*.
4. *Montenegrin (Vraka region, Rozafa Morača society)*.
5. *Aromunian (ethnonims vllah, çoban, aromun, rëmenj are included in this entry. When accompanied by the name of another ethnic group, these ethnonims are not taken into consideration. When these ethnonyms are accompanied by the name of a specific state, they are not taken into consideration)*.

6. *Roma* (under this label, all the recognized ethnonims referred to Roma people: roma, katalanas, kurbat, cigan etc. are included).
7. *Egyptians of Albania* (in consideration of the specific cultural position of this group, also pejorative denomination: *jevgj, magjyp*, are included).
8. *Bosnian*. Historically in Albania two or three villages in the region of Durrës are populated by Bosnians from the 18th century.
9. *Bulgarian*. In some popular songs collected by Sterio Spasse the slavs of Prespa are identified like *bugars*: *bugarskata zemja, bugarskata nevesta*.
11. *Serbian*.
12. *Arab*. The mention of the nationality of a specific Arab country (Syrian, Iraqi etc.) is not taken into consideration.
13. *Jew*. Are included other denominations too: *jude, jahudi, hebre, çifut*.
14. *Belorussian*. A group Belorussian soldiers supported King Zog in 1924.
15. Refused answer.
16. Not valid answers. 1. Nonsense. 2. Ironical. 3. No ethnic group is mentioned. 4. Citizenship instead of ethnicity. 5. Racial denomination. 6. Toponym. 7. Religion instead of ethnicity. 8. Probably Albanian with foreign citizenship. 9. Personal name. 10. Historical and geographical region.
17. Other ethnic groups (Permanent citizens of other countries).

Përmes emërtimeve etnonimike të shqiptarëve për veten, të shqiptarëve për popullsi të tjera banuese në Shqipëri (të njohura me ligj apo të vetëproponuara), të bashkësive etnike e kulturore për veten dhe për të tjerët, mund të hetohet më tej se çfarë ka ndryshuar në raportet e vetes me tjetrin, në sjelljen ndaj fqinjit, në përfitim të asaj ndjesie europiane që çon në ndryshimin e stereotipeve të vjetra ballkanike, si *empatia*. Ato janë një bazë të dhënash me rëndësi parësor për studime antropologjike dhe etnologjike; demoetnike dhe demofetare; onomastike dhe onomasiologjike.

Shtojca nr. 1
Nga vetëdeklarimet për besimin në fazën e ndërmjetme
(gjithsej 608 emërtime)

RASTAFARIAN	Not valid	Political cultural musical movement in Jamaica (maybe ironic)
REMENJ	Not valid	Heteronim of Aromun
ROME	Not valid	Ethnic group declared instead of religion
ROSHNIK I VOGEL	Not valid	Toponym
ROSKOVEC	Not valid	Toponym
RRETH STAVRE	Not valid	Toponym
RRISHT (maybe KRISHT)	To be checked in the record	Maybe Christian
RROMANAT	Not valid	Toponym
RRUMBULLAKE	Not valid	Toponym
RRUSHKULL	Not valid	Toponym
RUMUNE	Not valid	Ethnic group declared instead of religion
SALLMONE	Not valid	Nonsense
SATANISTE	Not valid	Not valid as religion; sect
SEFERAN	Not valid	Maybe Sefardic Jews?!

Shtojcë nr. 2
Nga vetëdeklarimet e filtruara për gjuhën në fazën e ndërmjetme
(gjithsej 159 emërtime)

BURUNDISHT	Deklarim i pavlefshëm, nuk ka gjuhë burundisht, ka frëngjisht, swahili dhe kirundisht
E PAPERCAKTUAR	Deklarim i pavlefshëm
FRASHTAN	Deklarim i pavlefshëm, nuk ka gjuhë të tillë, emër vendi
GAZKË	Deklarim i pavlefshëm, nuk ka gjuhë të tillë
GREKE RUMUNE	OK: arumanisht
GREQISHT EBRAISHT	Deklarim i pavlefshëm, nuk vërtetohet në Shqipëri një biglosi e tillë
GREQISHT SERBISHT	Deklarim i pavlefshëm, nuk vërtetohet në Shqipëri një biglosi e tillë
GREQISHT SHQIP	OK: bilingue, greqisht-shqip
HINDU	Deklarim i pavlefshëm, nuk ka gjuhë të tillë (hinduizmi është besim, jo gjuhë)
KANTONEZE	Deklarim i pavlefshëm, nuk ka gjuhë të tillë

KIRGIZXHE	Deklarim i pavlefshëm, nuk gjuhë të tillë, flitet turqisht
KOMSHE	Deklarim i pavlefshëm, nuk ka gjuhë të tillë
KUBANEZE	Deklarim i pavlefshëm, nuk ka gjuhë të tillë, flitet spanjisht
LETUANEZE	Deklarim i pavlefshëm, nuk ka gjuhë të tillë (lituanisht apo letone?)
LIVINE	Deklarim i pavlefshëm, nuk ka gjuhë të tillë
LLAÇE (VLLAHÇE)	OK: arumanisht
MALTEZE	Deklarim i pavlefshëm, cila nga dy gjuhët kushtetuese të Maltës?
NIGERIANE	Deklarim i pavlefshëm (nuk ka gjuhë nigeriane)
NUK ESHTE E AFTE	Deklarim i pavlefshëm
NUK FLET	Deklarim i pavlefshëm
QIPRO	Deklarim i pavlefshëm, nuk ka gjuhë qipriote
SHQIP RUMANISHT	OK: bilingue, shqip-arumanisht
TAMIL	Deklarim i pavlefshëm (janë katër <i>tamil</i> , në tre shtete, dhe një sistem shkrimi. Cila?!)
TROJANE	Deklarim i pavlefshëm, nuk ekziston
VLLAHE MAQEDONISHT	OK: arumanisht
VLLAHE SHQIP	OK: bilingue, shqip-arumanisht
ZAMBIANE	Deklarim i pavlefshëm (chewa, bamba, lunda, tonga, lozi, luvala, kaonde, nyanja?!!)
ZVICERANE	Deklarim i pavlefshëm (nuk ka gjuhë zvicerane: frëngisht, gjermanisht, anglisht, italisht, rëto-romanes?!!)
ÇAMERIA	OK: shqip (nuk ka gjuhë çame)

Shaban SINANI, QSA Tiranë

ENDONYMS AND EXONYMS OF ALBANIANS AND NEIBOURGHS

(Results of the expeditions in Zhupa, Gora and Opoja, 2012-2013)

Summary

The title of this paper is connected to two research experiences during 2010-2013:

a. Firstly, as part of the thematic ethnological expedition *Living without Borders*, which was carried out in the area of Zhupa and Opoja, in the south of Prizren (Kosovo);

b. Secondly, as an outside consultant for the process *Census Albania 2011* (partly, even *Rekos 2011*) for the terminological aggregation of the citizens' self-declarations about their nationality, language and religion. In the first part, I refer to inquiries in the land, in a region where small islands of at least bilingual populations live, which have had problems with self-defining.

In the Yugoslavia period, two *nationalities were fabricated: Yugoslavian and Muslim nationality*. They served as a sufficient formal coverage for such ethnic and religious island grouping, which do not even answer the *status of enclaves*. Decomposition of third ex-Yugoslavia posed a question to them: *What are we?* A process of re-identification led to the formal acknowledge of a new nationality in Kosovo, the Gorani nationality (*Gorani, Goranci*), which can be found officialized even in the standard questionnaire of Reko-2011; as well as another "*nationality*", imposed by the relatively ponderable number of the self-declared individuals: *Torbesh, Torbeši, Muslim Slavs* who do not accept to be identified with any of the old nationalities of ex-Yugoslavia. At the same time, the Egyptians of Kosovo split into two nationalities. Religion served as a point of opposition in this process: *Ashkali and Egyptians*. From our inquiries about the ethnicity of such groupings in Zhupa (*Župa*) and Opoja, it came out that educated people are in search of an identity, mainly from the distinction with the other, a negative identification that answers the question *what aren't we: I speak Serbian, but I am not a Christian, thus I am not Serbian; I am a Muslim, but I don't speak Albanian, so I am not Albanian; what else can I be but Bosnian (Bosanac, Bosanci, Bošnjaci)?* Meanwhile, the oldest part of the habitants is content with distinctions between dialects and traditional workmanships (we are bricklayers, we are craftsmen). People answered the question about the connections and relationships with a similar population: Goran, Bosnian, Torbesh (*Torbeši*), with the expressions: *Naši smo, da nismo našinci, Naši smo, da nismo isti*. However, about the language continues to remain in usage the identification with: *naša, po naškom*; or, at the most educated individuals *mi govorim slavsko, mi govorim južnoslavenski*.

Language islands and ethnological islands in Zhupa and Opoja are so numerous that even Bosnians themselves are not one, but several types, and the same can be said for Gorans. Meanwhile, the spoken language, including school, is continuously going toward a grotesque slang, as can be seen by the way of presenting the theme *Micropollutants* by a teacher in the class of Biology in the school of the village Manastirec (Gorë), where we assisted: *Mikroorganizmi su mali hajvančići. Kada su na trup čoveka, Zot na ruelj, jo mikroorganizmi, da insan može i mrtav bit.*

A similar process of formal, but even substantive disintegration and redefinition happened in the conditions of open society in regions with compact populations in Kosovo and Albania. Together with the researcher *Alessandro Gori* in *Università di Firenze*, and in a later phase, with the French anthropologist *Patrick Simon*, we were invited to *define the terms of reference* and thus to facilitate the statisticity of the data about self-declaration of the citizens about their ethnicity, their language and religion in *Census Albania 2011*. Despite a preliminary filtration by the specialists of *Instati* (which excluded only wrong interpretations by the *optical automatic reader and technical mistakes*), in the first phase the situation was as follows: over 800 denominations about nationality, over 800 denominations about religion and over 400 denominations about language. In the second phase, after having oriented toward a reference term only those definitions that were indisputable, that did not need an interpretation, *the results were: 430 self-declarations about ethnicity, 159 self-declarations about language and 608 definitions about religion*. The process of further aggregation with the purpose of making the data declarable was very complicated. There were found more than 30 forms in the ethnic grouping of *Arumanians* of Albania for the denomination *Çam* alone, which was declared to have *Albanian* ethnicity. Except for objective reasons (*former impossibility of free self-declaring of ethnic and cultural communities that were not acknowledged by the constitution*), the tendency of fractioning *Albanian* ethnicity was observed: **a.** Firstly, by means of regional distinction (*Çam, Lab, Lalë, Highlander, Mirditor, Lumjan*) ; **b.** Secondly, by means of evoking romantic and historic denominations (*Pellazg, Ilir, Arbëresh*); **c.** Lastly, by means of specifying the nationality with a noun which referred to religion (*Albanian Bektashi, Albanian Orthodox, even Albanian minority*). Even though the obstacles of converging self-declarations were surpassed, the creation of such oppositions remains an open issue for further investigations in social anthropology, sociology, demography, sociology of religion, linguistics and so on.

Bibliografi:

- ALEKSIĆ-PEJKOVIĆ, Ljiljana: *Naučni skup Srbije 1915. godine*, Istorijski institut, Beograd 1986, st. 302.
- BALA, Zenulla: *Shishtaveci: historia dhe tradita*, bot. Erik, Tiranë 2007.
- BALIU, Begzad: *Onomastika e Kosovës: ndërmjet miteve dhe identiteteve*, bot. Dituria, New York 2009.
- BOGA, Nida (Leonid): *Voshopolea*, Bucuresti, Dimândarea Parinteasca, 1994.
- COUROUCLI, Maria, *The Balkans, Ethnic and Cultural Crossroads: Educational and Cultural Aspects*, Council of Europe Press, Strasbourg 1997.
- ČUBRILLOVIĆ, Vaso: *Isterivanje arnauta*, Beograd 1937.
- ČUKIĆ, Dragan: *Kosovo: znamenitosti i lepote*, Priština 1971.
- CVJIĆ, Jovan: *Balkansko poluostrvo i južnoslavenske zemlje, osnovi antropogeografije*, tom I, Beograd 1922; tom II, Beograd 1931.
- DAVUTOĞLU, Ahmet: *Civilizational Transformation and the Muslim World*, Quill 1994; *Transformimi qytetërimor dhe bota islamike*, bot. Logos-A, Shkup 2005.
- DEMIRAJ, BARDHYL: *Kur etikët tregojnë: shqa,-u ndër shqiptarë*, në *Studime*, botim i ASHAK, nr. 16-17.
- DEMIRAJ, BARDHYL: *Shqiptar dhe Shqa*, bot. Naimi, Tiranë 2014.
- DÉRENS, Jean-Arnault & SAMARY, Catherine: *Goranci*, në *Les conflits yougoslaves de A à Z*, Éditions de l'Atelier, 2000.
- DETSIKAS (ΔΕΤΣΙΚΑΣ), Κώστας (Kostas): *Καραϊσκάκης: “Ο” γιος της καλογριάς*, Ηλιοτρόπιο, 2004.
- DOKLE, Nazif: *Bogomilizmi dhe etnogjeneza e torbeshëve të Gorës së Kukësit*, bot. Geer, Tiranë 2009.
- DOKLE, Nazif: *Goranske narodne balade*, Prizren 2012.
- ERDOGAN: ‘Kosovo Is Turkey’, in: *Monitor*, October 28, 2013.
- EVANS, Thammy: *Macedonia*, England 2009.
- GJORGIEV / ЃОРГИЕВ, Драги: *Османлиското наследство во Република Македонија: предност или хендикеп?*, në *Slavia Meridionalis*, tom XI, Institut Slawistyki, Polskiej Akademii Nauk, Warszawa 2011.
- GORI, Alessandro & SINANI, Shaban: *Case by Case - Ethnicity - Mother Tongue Language - Religion*; dokumente pune për *Census-Albania 2012*, gusht 2012, arkivi i INSTAT.
- GORI, Alessandro & SINANI, Shaban: *Ethnicity - Mother Tongue Language and Religions - explandes with interpretation*, dokumente pune për *Census-Albania 2012*, gusht 2012, arkivi i INSTAT.
- GORI, Alessandro & SINANI, Shaban: *Mission Report, 26-31 August 2012, Population and Housing Census, Albania 2011*. a project funded by the European Union, arkivi i INSTAT.
- HUSEIN / ХЮСЕИН, Мехмед: *Помаците и торбешите в Мизия, Тракия и Македония*, София 2007.
- IDRIZI, Sadik: *Aromunsko-vlaški tragovi u Gori*, Prizren 2008.
- IDRIZI, Sadik: *Gora daleka i sama*, Dragaš 2004.
- ISMAJLI, Rexhep, *Artikuj mbi gjuhën shqipe*, Prishtinë 1987.

- IVANOVA, Olga: *Rečnik na toponimite vo oblata po slivot za Bregalnica*, Skopje 1996.
- KAPITANOVA, Ana: "Kaj nas" - folësit e Boboshticës në kontakt me popullin autokton, në akte të Seminarit XXXI Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, nr. XXXI, Prishtinë 2012, f. 157-161.
- KOSOVO *Population and Housing Census 2011*, final results, main data, an EU-funded project managed by the European Union Office in Kosovo implemented by Istat, CIRPS-Sapienza University of Rome, ICON-Institut and Rrota, Prishtinë 2012.
- KRYEZIU, Selahedin: *Kush jam unë*, Prizren 1999.
- LAVROV (ЛАВРОВ), П. А.: *Сборник Верковича. I. Народные песни Македонских болгар*, Петроград 1920.
- LUTOVAC, Milislav V.: *Gora i Opolje: antropogeografska proučavanja*, Naučna knjiga, Beograd 1955.
- LUTOVAC, M.: *Gora i Opolje, naselje i poreklo*, knjiga 35, Beograd 1955.
- LLOSHI, Xhevat: *Etnonimi 'shqiptar' dhe mohimi i tij*, në *Universi shqiptar i librit*, nr. 3, 1998.
- MILANI, Prelë: *Ku jeni, Lekë Dukagjini ua vranë!*, botuar në të përditshmen *Sot*, 3 gusht 2014.
- MIRDITA, Zef: *Vlasi u historiografiji*, Hrvatski institut za povijest, Zagreb 2004.
- MOLHO, Anthony; BRACEWELL, Wendy; DRACE-FRANCIS, Alex; CURTO, Diogo Ramada; KONIORDOS, Niki (edit.): *Balkan Departures: Travel Writing from Southeastern Europe*, Berghahn Books, 2009.
- PEKMEZI, Gjergj: *Bleta shqypëtare (e përshkroi me shkrojla shqipe, e përktheu shqyp dhe e radhiti)*, Vjenë 1924.
- POPULATION and Housing Census, Albania 2011. *A project funded by the European Union*, Mission Report, 26-31 gusht 2012, Arkivi i INSTAT; kopje ruhet dhe në *Delegation of the European Union to the Republic of Albania*.
- PULAHA, Selami: *Popullsia shqiptare e Kosovës gjatë shekujve XV-XVI*, Tiranë 1984.
- REXHA, Iljaz: *Onomastika mesjetare arbane në arealin e Dardanisë*, Prishtinë 2005.
- SATHAS (ΣΑΘΑΣ), Κωνσταντίνος (Konstantinos) N.: *Ιστορικά Διατριβαί*, εν Αθήναις 1870.
- SCHMIDINGE, Thomas: *Gora: Slawischsprachige Muslime zwischen Kosovo, Albanien, Mazedonien und Diaspora*, Wien (Österreich) 2013.
- SEDAJ, Engjëll: *Etonimi arbëresh - shqiptar*, në *Bujku*, 15 janar dhe 3 shkurt 1996.
- SEJDIU, Shefki: *Enciklopedia e ndarjes: marrëdhëniet shqiptaro-maqedonase, konteksti i Enciklopedisë së Maqedonisë, në: Marrëdhëniet shqiptare-maqedone, konteksti i Enciklopedisë*, Prishtinë 2010.
- SINANI, Shaban: *Kosova në Shqipëri: shpërngulja dhe rikthimi*, në *Ura dhe kështjella*, Tiranë 2006.
- SINANI, Shaban: *Për një interpretim të të dhënave për emërtimet në procesin e vetëdeklarimit të kombësisë (ethnicity), gjuhës amtare (tongue) dhe besimit (religion)*; arkivi i INSTAT, 1-10 gusht 2012.
- SINANI, Shaban: *Shenjime nga ekspedita etnologjike "Të jetuarit në kufi"*, Manastiricë, Zhupë e Prizrenit, viti 2012, dorëshkrim.
- SINANI, Shaban: *Shpërngulje biblike dhe rikthim biblik*, në *Kultura popullore*, bot. i Akademisë së Shkencave, nr. 1-2, Tiranë 2001.
- SIRDANI, Marin: *Emni "shqypetar e arbnuer"*, në *Hylli i Dritës*, nr. 4, 1931.

- SPASSE, Sterio (collect.): *Narodne pesme od Mala Prespa, Albanija*, Institut Folklori "Marko Cepenkov", Skopje 1992.
- SHPUZA, Gazmend: *Nga arbëreshët, përmes epirotëve, te shqiptarët*, në *Universi*, 2002, nr. 2.
- THALÖCZY, L.; JIREČEK, C.: *Zwei Urkunden aus Nordalbanien*, në *Illyrisch-Albanische Forschungen*, I, 1916.
- XHUFI, Pëllumb: *Vëzhgime mbi emrin 'Shqipëri' dhe 'shqiptar' në Mesjetë*, në *Studime historike*, nr. 3-4, 2001.
- ZEMON, Rubin: *Historia e identitetit të ashkalinjëve*, botim i Këshillit të Europës, Divizioni i informatave Publike dhe Botimeve, Drejtorati i Komunikimit, Strasburg, pa vit botimi (por jo më vonë se viti 2010).
- ZIAGKOS (ΖΙΑΓΚΟΣ), Νίκος (Nikos) Γ.: *Η ανασταση των Σουλιοτων και ο Λαμπρος Τζαβέλλας*, Soulion 1964.

Brian D. JOSEPH, The Ohio State University
UNDERSTANDING GREEK
THROUGH ALBANIAN: THE CASE OF
PRO(S)PAPPOUS

KDU 811'14.04
811.18-26

Combing through lexicographical works often can yield a small gem that helps to illuminate a detail here or there about a word in another language. For instance, the form *strittavus* in a somewhat obscure Latin source (Paulus ex Festo), with its unexplained initial *s-* for what otherwise in Latin is *tritavus* ‘great-great-great-great-grandfather’, served as a basis for injecting some clarity, in my view, into the understanding of the development of the Albanian prefix *stër-* (*shtër-* in older sources, especially Meyer 1891, where it is written *šter-*) that occurs in kinship terms of generational distance, among other functions, e.g. *stër-gjysh* ‘great-grandfather’ (built on *gjysh* ‘grandfather’).¹

In the same way, a related Albanian word found in Meyer’s lemma for *gjysh* (for him: *güš*) serves as a basis for the explication of an oddity in a Greek dialectal form. In particular, he gives *trëgüš* alongside of *štergüš* for ‘great-grandfather’ as well as, for ‘Ururgr.’, i.e. ‘great-great-grandfather’, both what he cites as *katrëgüš* (equivalent to what would now be spelled *katrëgjysh*), and a form with an extra initial *s-*: *skatragüš*. It is this last pair of forms especially, if the *s-* form is real,² that provides the key to understanding the Greek form.

¹ I have written about the Latin and Albanian forms in two related papers: Joseph 2010 and Joseph 2012.

² Meyer’s source for this form is “Ro.”, i.e., Rossi da Montalto 1866. I am assuming that Meyer has cited this form correctly, though I do not find it in my perusal of Rossi; my concern here as to this form rests on the fact that for Italian “bisnonno” (‘great-grandfather’), Rossi gives a form < Sctragi8sc >, presumably standing for something that would now be spelled < shtragjush > (phonetically [ʃtra...]), and for Italian “trisavole, terzavolo” (‘great-great-grandfather’, based on *tre* ‘three’ and *terzo* ‘third’,

The Greek form in question is one that I encountered while doing fieldwork on the Greek of southern Albania in the past few years, namely *πρόσπαππος* ([*prósapos*]) ‘great-grandfather’, for what for the most part elsewhere in Greek, e.g. in the standard language, is *προπάππος* ([*propápos*]) or *προπάππους* ([*propápus*]).³ Descriptively, this Southern Albania Greek form signifies a kin term of generational distance and contains an extra *-s-* that is absent from comparable forms in other dialects. These facts ultimately become important in understanding how this form came to be.

The form with the *-s-*, *prospappos*, is not restricted to the Greek of southern Albania, as it is listed in one authoritative dictionary, that of the Triandafilidis Institute (Triandafilidi Instituto 1998). Interestingly, though, it is absent from another recent large dictionary (Babiniotis 1998), suggesting that it is not so widespread a variant.

The more broadly attested form, *propappo(u)s*, makes sense compositionally in that it is a compound built from a generational kin term, *pappous* (also *pappos*) ‘grandfather’, with a prepositional prefix *pro-*, meaning ‘before’, added on so as to give an extra degree of generational distance. Moreover, it fits into a very common pattern for the marking of degrees of ancestral remoteness found in several other Indo-European languages involving that very prefix; in Latin, for instance, there is *pro-auus* ‘great-grandfather’, built on *auus* ‘grandfather’, in Sanskrit there is *pra-pitāmaha-* ‘great-grandfather’, built on *pitā-maha-* ‘grandfather’, and in Slavic, e.g. Russian, there is *pra-ded* ‘great-grandfather’, with a long-vowel variant of the prefix **prō-* added to *ded* ‘grandfather’.

By contrast, the variant form *prospappos* does not show the same logic to its composition nor does it have the same claim to an Indo-European pedigree. Ostensibly, *prospappos* would appear to be built on *pappos*, but

respectively), Rossi gives < Stragi8sc >, presumably representing something like < stragjush > (phonetically [stra...]). Thus I worry that Meyer might have incorrectly taken < Sctragi8sc > to stand for his *skatra*..., though perhaps he inferred a form with [sk-] as a basis for the [j] indicated by Rossi’s spelling < sctra... > distinct from the [s] of his < stra... >); more investigation is needed here, to be sure.

³ Hereafter I cite the forms in a transliterated form.

the prepositional prefix *pros-* does not seem to be particularly appropriate for marking generational distance as it generally means ‘towards; near’. And, whereas there is at least one parallel in other Indo-European languages to its use in a term of generational displacement, specifically Sanskrit *prati-naptṛ-* ‘great-grandson’, built on *naptṛ-* ‘grandson’, where *prati* is cognate with Greek *pros*, from a Proto-Indo-European **proti*, it is not clear how widespread the use of **proti* is in this function; to judge from the forms cited here, it would appear to be far less common across the family than **pro*.

Thus, how might the variant form *prospappos* be explained? The entry in the dictionary of the Triandafilidis Foundation at the University of Thessaloniki (Triandafilidis 1998: 1147) says that it is due to folk etymology (“παρετυμ(ολογία)”) based on phrase *pappou pros pappou* ‘(handed down) by tradition’, literally “of-grandfather from grandfather”, also known in the form *apó páppou pros páppon* ‘from grandfather to grandfather’, in either case referring to the transfer across generations. Still, the question must be asked as to how one can get from such a phrase to a noun meaning another degree of generational displacement? Generations are involved in the meaning of the phrase, to be sure, the phrase is more about traditional transmission, so it is not clear how to get from it to the specific sense of *prospappos*.

I propose that Albanian kin terms of generational distance with an extra *-s-* provide a basis for understanding *prospappos*, and for the specific meaning that the form has. That is, just as according to Meyer, Albanian has both *katr...* and *skatr...* in such kin terms, I propose that there was a **spropappos* in Greek built to *propappos* in the same manner that Meyer’s *skatragüš* was built to *katregüš*.⁴ At that point, then, since **spro-* has no basis in any prefix in Greek, it was remade, in essentially a folk-etymological way,⁵ in such a way as to preserve the *pro-*, which was meaningful in

⁴ Even if the *katr-/skatra-* variation turns out to be a mirage (see footnote 2), the Albanian *shtër-* / *tre-*, as well as Latin *stri-* compared with *tri-* (cf. Meyer’s *šter-ġüš* / *tre-ġüš* but also Latin *tritavus/strittavus*), could indicate the availability of an *s-* versus Ø- model that could have been a suitable basis for the form **spropappos* supposed here.

⁵ I thank Bethany Christiansen of The Ohio State University for enlightening discussion on this very point.

the context of generational distance, and to preserve the *-s-*, but just in a different order. This process then yielded a form *pros* that made somewhat more sense within the Greek context - in that it matched an already-existing prefix - and thus gave the form *prospappos* with the meaning of *propappos*.

Admittedly both the ultimate source of the *s-* and its specific function are unclear. Still, given the occurrence of *prospappos* in the Greek of southern Albania, though presumably along with other regions,⁶ and given the specific occurrence of the initial *-s-* in Albanian terms semantically related to words like *propappo(u)s*, it is tempting to look to Albanian as a source for the introduction of this extra *-s-* into the Greek for a kinship term of generational displacement.

⁶ Clearly further research into the dialect distribution of this form is needed, so it is to be hoped that this note provides a stimulus in that direction.

References

- Babiniotis, Georgios. 1998. *Λεξικό της νέας ελληνικής γλώσσας*. Athens: Kentro Leksikologias.
- Joseph, Brian D. 2010. On Latin *(s)tritavus*. In *Studies in Classical Linguistics in Honor of Philip Baldi*, ed. by B. Richard Page & Aaron D. Rubin, 43-46. Leiden: Brill.
- Joseph, Brian D. 2012. The Etymology of the Albanian *stër*- Prefix. In *Festschrift për nder të 65 vjetorit të lindjes së Akademik Rexhep Ismajlit* [Festschrift in honor of the 65th birthday of Academician Rexhep Ismajli], ed. by B. Rugova. Prishtina, Kosovo.
- Meyer, Gustav. 1891. *Etymologisches Wörterbuch der albanesischen Sprache*. Strassburg: Verlag von Karl J. Trübner.
- Rossi da Montalto Ligure, Francesco. 1866. *Vocabolario Italiano-Epirotico con tavola sinottica*. Roma: Stamperia della S. C. de Propaganda Fide.
- Triandafilidi. 1998. *Λεξικό της κοινής νεοελληνικής*. Thessaloniki: Aristotelion Panepistimio tis Thessalonikis, Instituto Neoeellinikon Spoudon (Idrima Manoli Triandafilidi).

SHQIPTARËT DHE GJUHA E TYRE¹

§ 1. Kufinjt e sotëm të shqipes – § 2. Shtrirja e saj në mesjetë – § 3. A rrinin pararendësit e shqiptarëve qysh në lashtësi në Gadishullin e Ballkanit, apo janë ardhës më të vonë? Puqjet shqiptare-ilire e shqiptare-trakase në leksik dhe në fjalëformim. – § 4. Veçoritë fonetike të shqipes të krahasuara me ato të ilirishtes e të trakishtes – § 5. Përcaktimi i vendbanimeve më të mëdha në Gadishullin e Ballkanit – § 6. Vendbanimet paraballkanike. – § 7. Elementet paraindoeuropiane.

§ 1. Hapësira gjuhësore e shqipes ngërthen sot në brigjet e Adriatikut përafërsisht hapësirën midis gradëve 39 e 42 të gjerësisë (natyrisht pa sunduar vetë në viset kufitare), shtrihet në drejtim të VL deri në Kosovë dhe në pjesën perëndimore të Maqedonisë (Kumanovë, Kaçanik, Tetovë, Shkup, Manastir). Në këtë mes duhet pasur parasysh dallimin midis hapësirës kryesisht shqiptare dhe asaj gati si ishullore të hapësirës së zgjeruar gjuhësore. Kufiri lindor i së parës sajohet pothuaj nga një vijë në formë ylberi, e cila shtrihet nga Prishtina drejt Strugës në Liqenin e Ohrit – duke u lakuar në drejtim të perëndimit. Në drejtim të J. e të JL. kufiri i hapësirës kryesisht shqiptare shkon nga Saranda, përmes Delvinës e Konicës në bjeshkët e Gramozit, prej këtu kah Kosturi, në cepin jugor të Liqenit të Prespës, drejt Shën Naumit në fundin jugor të Liqenit të Ohrit. Linja Shën Naum-Strugë e përmbyll kufirin gjuhësor. Përgjatë shtetit amë ka vendbanime të reja, në krahasim me ato që u përmendën më lart, në Greqi (në Atikë, Megara, Beoti, regjionin e Helikonit; Argolis, Meseni; Salamis, Hydra, Spezia, Andros), pastaj në Itali të Jugut e në Sicili; në Bullgari (Arnautkëj), në ishullin Marnara në Detin Marmar, në Besarabi (Volkonești), në Dalmaci (Borgo Erizzo afër Zarës).

J. G. v. Hahn Alb. Stud.I (1853) f. 14 vv. Barbarich Albania 1905, Carta ethnogr.;

¹ Titulli i originalit: **Albaner** në Eberts *Reallexicon der Vorgeschichte*, Bd. 1 (1924), f. 84-93. Përktheu: Dr. Skënder Gashi.

Weigand Die Aromunen I (1895) f. 321; Mitt. Geogr. Gef. Wien 1878 Sax; Kiepert Ethnogr. Übers. d. europ. Or. 1876, neue Aufl. 1912; Petermanns Mitt 1913 f. 113 vv. f. 22 Cvijić v; Jokl in Streitbergs Gesch. d. idg. Sprachw. 1917 II/3 f.110; Über das alb. Volkstum in Griechenland: Z. f. allg. Erdk. 25 (1890) f. 402; Verh. Ges. f. Erdk. Berl. 15 (1888) f. 446 A. Philippsohn; Über die alban. Siedlungen in Italien: Idg. Jahrb. 2 (1914) f.1 vv.; KZ 51 (1923) f. 259 vv. Lambertz.

§ 2. Hapësira e banimit e shqiptarëve, siç u skicua më lart, ka pësuar gjatë shekujve të fundit një rrudhje të dukshme. Njoftimet nga burimet, emrat e vendbanimeve e të njerëzve lënë të kuptohet që hapësira gjuhësore e shqipes shtrihej gjatë mesjetës larg më në veri. Popullsia shqiptare kishte në rrethina të Raguzës, Kotorit, në cepin verior të Liqenit të Shkodrës, në pjesët jugore e lindore të Malit të Zi. Emrat e ruajtur të vendeve e lejojnë përfundimin se këtu kemi të bëjmë me shqiptarë dhe jo me një popull substratik, i cili do të ishte identik me shqiptarët. Popullsia shqiptare e pjesës verilindore të hapësirës së saj që u përmend më lart dëshmohet edhe në dokumentet shkrimore të manastireve serbe.

C. Jireček, Die Romanen i. d. Städten Dalm. I (1901) f. 41 f. Denkschr. Wien. Ak. 48; Srpski Ethnogr. Zborn. 17(1911) f. 350, 363, 399 Erdeljanović; Ung. Rundsch. f. soz. u. hist. Wiss. 5 (1916/17) f. 1 vv Šufflay.

§ 3. Problemi themelor i parahistorisë së shqiptarëve është: A ishin pararendësit e këtyre që në lashtësi banorë të Gdishullit të Ballkanit apo këta erdhën vetëm më vonë në pjesën lindore të këtij gadishulli të Europës? Një si shtojcë, kurorëz e kësaj pyetjeje do të duhej pra të gjurmohet tek lidhja e mundshme me popujt e lashtë të Ballkanit, pra me ilirët ose me trakasit. Që nga Hahn (*Alban. Stud. I* f. 213 v.) çështja që u shtrua në krye të kësaj pjese në kuptimin e pjesës njësi përbërëse me përgjegje alternative, duke qenë se në kohën historike nuk është dëshmuar asnjë dyndje, përveç asaj të sllavëve, është një mendim mbizotërues përkritazi me çështjen e shtruar. Mendim të kundërt, gjithsesi të përgjithësuar pa pas sjellë arsyeime të mbështetura, ka Pârvan (*Z. f. rom. Phil.* 26. Beih. [1910] f. 61 v.). Pikëpamjen sipas së cilës shqiptarët na qenkan një fis ilir i gjysmëromanizuar, ky dijetar (Pârvan) e ngre duke vënë në spikamë vëllimin relativisht të madh të pjesës shqiptare në formimin e serbo-kroatëve dhe të grekëve të rinj, pikëpamje kjo që kundërshtohet nga të tjerë: Shqiptarët, përpara sllavëve, na qenkan dyndur midis shekujve III e VI para Krishtit nga verilindja nëpër Transilvani në

drejtim të jugperëndimit dhe, si barinj nomadë, pa u pas hetuar, qenkan vendosur në viset jugore të Danubit. Në këtë mes dua t'i vë në spikamë faktet gjuhësore të cilat janë të përshtatshme, për ta mbështetur pikëpamjen e Pârvanit. Emri i qytetit të Shkodrës, në të folmen lokale *Škoder/Škodra*, ishte qysh tek Livius XXXIV 31 *Scodra*. Paravendimi që ky emër vendi ishte që nga koha pararomake dhe pa ndërprerje deri në ditë tonat në gojën e shqiptarëve nuk përputhet me rezultatet e fonetikës historike të gjuhës shqipe, sepse tingulli nistor i fjalës dhe grupi i patheksuar konsonantik dalin të jenë të trajtuar ndryshe nga ato komplekse tingullore në fjalët me prejardhje shqipe të bartura në vijimësi nga tradita). Edhe emri *Rogami*, *Rogame* i vendit (1. afër Shkodrës, 2. në pjesën e epërme të Luginës së Valbonës, 3. në formimin e mëtejshme m. *Rogomana* në Lumë në të njëjtin formim karakteristik fonetik: *g* ndërzanore), që ndeshet edhe në Mal të Zi (Kuç, Zetë), që gjithsesi nuk është sllav, flet kundër vazhdimsisë së pandërprerë të këtij emri nga shqiptarët. Megjithatë, formime ilire janë padyshim pikërisht emrat e lumenjve në rrethina të Shkodrës si *Barbana* (sot Bojana, shq.-shkodran. *Būn*) dhe *Clausala* (shq.-shkodran. *Drinas*). Nga ana tjetër, termat e krishterimit si *ūpešk(ε)f*, *pegere* janë dëshmi gjuhësore të krishterimit latin, ndërkohë edhe ilir, që i takojnë kohës parasllave dhe forma e kryehershme e fjalës së parë na shpie tek Dalmacia si burim i saj (Jokl *Lingu. kulturhist. Untersuchungen a. d. Ber. d. Alban.* 1923 f. 20 f., 132). E padëshmueshme është edhe pikëpamja që sjell Pušcariu si mbështetje për tezën e Pârvanit (poaty. f. 62. v.), sipas të cilit në huazimet latine të shqiptarëve po u hetuakan dy shkallë gjuhësore, konform zgjerimit të vazhdueshëm të territorit të tyre nga Dakia për në Illyricum (Mitt. Rum. Inst. Wien I [1914] f. 292-297 Spitzer). Problemi bazë i parahistorisë së shqipes mund të zgjidhet vetëm përmes studimesh të veçanta të lidhjeve të shqipes me gjuhët antike të Ballkanit. Një gjurmim i këtillë do të tregonte, nëse është e zgjidhshme çështja e substratit ilir apo trak, gjë që do të tregonte sa është me vend shtrimi i kësaj çështjeje. Për autoktoninë e lashtë të shqiptarëve në Gdishullin e Ballkanit mund të përmenden së pari emrat *Ἀλβανοί*, *Ἀλβανόπολις*, të cilët Ptolemaeus (III 13, 23) i përmend në hartën e tij të Botës midis Orestis dhe Almopern, dhe vazhdimi i tyre shqip *Arbeni*, *Arberi* (KZ 36 [1900] f. 299 f. Pedersen). Mirëpo, duke qenë se fjala bazë e këtyre dy emrave është e përhapur gjëregjatë nepër Europë dhe pas gjithë gjasësh

është me prejardhje paraindoeuropiane (*Albion, Alba Longa*) dhe se edhe prapashtesa është gjithashtu e dëshmuar jashtë ilirishtes e trakishtes, pesha e kësaj dëshmie zvogëlohet dukshëm.

a) Konkordancat shqipe-lashtoilire i kemi së pari nga brumi skajsh-mërisht i paktë leksikor, përkatësisht nga glosari i dëshmuar i ilirishtes së vjetër. (Numri i vogël i këtyre glosave natyrisht që e rrit forcën dëshmuese të konkordancave me shqipen). mesap. *βρέντιον κεφαλὴ τοῦ ἐλαφοῦ* shq. *brī*, rrënja *brin-* “bri, brini”; ilir. (oenotrisht*) *ρίνός ἀχλός* “errësirë, mjegull”, (*Schol. Od. E* 281) unë e afrojmë me shq. tosk. *re*, geg. *rë*, në monumentet gjuhësore të shek. 17. (psh. P. Bogdan, *Cuneus proph.* I 37 26) *ren* (Përkitazi me përkatësinë etnike ilire të Oenotrërëve khs. *Scala Umrisse d. ālat. Gesch. Eur. Rektoratsprogr.* Innsbr. 1908 f.48, 69). Këtu kemi të bëjmë me një fjalë me burim indoeuropian, por që devijon nga indoeuropianishtja e përbashkët; së këndejmi, kjo konkordancë duhet cilësuar si specifike. Më frytdhënës është grumbulli i emrave të vendeve dhe huazimet nga gjuhë të tjera. Emri *ἔλος Λούγεον* (Strabo VII 314) i liqenit të Cirknicës në regionin e Kuarnarit në afërsi të Trieshtës, s’është tjetër veçse fjala ilire që shenjon kënetën shq. *le-g-atë* “kënetë”: – (*IF* I [1893] f. 323 G. Meyer). Këto fjalë janë puro ilire, përkatësisht thjesht shqipe dhe njëkohësisht edhe indoeuropiane të pastra. Këtë e tregon, në dritën e emrit ilir *Ludrum* në Dalmaci në hyrje të Sevarovo blato (dmth. kënetë, ligatë) (Lokalizimi sipas Tomaschek, *Mitt. Geogr. Gef.* Wien 23 [1880] f. 502), nga ana e shqipes tosk. *l’um* “lym, baltë”, geg. *l’üm*, tosk. *l’er* “lym, baltë”. (Trajta e kryehershme **Lud(h)r-*, trajta shqipe e kryehershme: **lu-m*, **leu-d(h)r*), nga ana e gjuhëve të afërta lat. *lutum* dhe sidomos fjala gr. *λύμα λύθρον* “zgjyrë, lym” e cila përputhet me të mësipërmen edhe në rrafshin morfologjik. Këtu hyn sidomos dhe *le-g-atë*; *Λούγεον* (trajta origjinare **lu-g-*) një fjalë e kategorisë nominale të fjalëformimit që në shqipen është jo pak e preferueshme (Jokl *Lingu. kulturhist. Untersuchungen aus dem Ber. d. Alban.* 1923 f. 148 v.), *Aquae Balizae* në Panoni (CIL VI 3297), një fjalë thjesht ilire në dritën e dëshmisë së termës shëruese në këtë zonë që ishte në *pagus Jovista*: shq. *bal’të* “kënetë, lym” (edhe në dalmatishten e vjetër dhe në dialekte të tjera romane). *Metubarbis* (“midis

* Gjuha e fisit ilir të Eonotërve. Vër. e përkth.

ligatave, Mesligatë”) në Pannonia inferior (Plinius III 148) var. 1. *Metubarris*, ishull në hapësirën e rrjedhës së Savës së poshtme me tokë shprehimisht moçalore (*Hiulca palus*) dëshmohej si konkordancë specifike lashtoilire-shqipe nga krahasimi i përpiktë i të dy pjesëve të kësaj kompozite me fjalët shqipe *beṛak*, *beṛak* “bërrakë” që i takon një fisi të përhapur gjerë të indoeuropianishtes: sllav. *bara* “bërrakë”, ind. e vj. *bar-bará* emri i një lumi, greq. *βόρροπος* “baltë, lym” (*Izvestija otdél. rusk. jaz. Petersb.* 17/4 [1912] f. 228 v. Mladenov); *metu-* e afrojt me shq. *mjet* “mjet, mjedis, midis” me tenuesin e patheksuar si edhe greq. *μετά*. Karakteri prej kompozite i këtij emri dëshmohej me praninë e të dy fjalëve në hapësirat ilire: *Μέτουλον*, qyteti i japodëve *Μέτουλοι* (Appian Ilir. 19) (“të ndër-mjemetë”), *Σούβαρος* në distriktin Remesiana (Prokop), *Σύβαρις* burim në Ahaja. T-jë e patheksuar e pjesës së parë, përndryshe e dëshmueshme vetëm në greqishten, ia jep kësaj konkordance karakterin specifik. – *Malontina*, trajta më e vjetër nga burimet e shkruara, të shek. 10. e emrit të lumit malor *Maltein* në Kärnten (Carinthia II2 (1922) f. 3 Lesiak), *Malonturn*, *Maluntum* lima në regjionin Canale afër Raguzës në Dalmaci (Jireček *Romanen i. d. Städt. Dalm.* 1 [1901] f. 60), *Malutin Dô* (i sajuar gjithsesi nga **Malontin Dol*) çiflik malor i Piperëve të Malit të Zi (*Srpski Etnogr. Zborn.* 17 [1911] f. 359, Erdeljanović), *Μαλοῦς Μαλοῦντος* lum në Arkadia, vend në Trojë (sh. Illyrier), të gjithë të formuar me prapashitesën karakteristike ilire -*unto-*, i takojnë fjalës shqipe *mal* “mal”, rum. *mal* “bregdet, buzë lumi, kodër”, let. *mala* “skaj, breg lumi”. Mëtimi që këta apelativa t’i atribuohen paraindoeuropeanishtes (Oštir *Beitr. z. alarod. Sprachwiss.* I [1921] f.51) duhet të refuzohet, sepse ekzistimi i apofonisë përbrenda vetë shqipes në këtë familje fjalësh të përhapura gjerë (përkitazi me këtë khs. Jokl *Linguist.-kulturhist. Untersuch. a. d. Ber. d. Alban* [1923] f.162 v.) e tregon karakterin indoeuropian si edhe prania e tyre në veriun e Europës. Distinktivi shqip për vendbanimet primitive si tbanet e të ngjashme me to: *bunε*, që është një fjalë e pastër indoeuropiane, në dritën e dëshmisë së apofonisë- dhe të raporteve përbrenda fisit, vëllazërisë (*ban(ε)* “banesë”, *buj* “banoj, buaj”, (*SB Wien. Ak.* 168/1 [1911] f. 6 f. Jokl), reflektohet, sipas mendimit tim, si fjalë e huazuar, në hapësirat e serbokroatishtes si *buńa* “gropë, shpellë, kasolle primitive”, (Mažuranić *Prinosi za hrv. pravno-povj. rječn. sv.* 6 [1917], f. V. oklad m. Lit.), *buńac* në Dalmaci. “vath,

ahër”. Edhe në shumë emra vendesh si *Bunić* në krahinën e Likës, pra në tokat e liburnëve, *Buñak* në rrethina të Zagrebit, *Buñanci* në krahinën Toplica të Serbisë etj. si edhe në apelativat nga të cilat rrjedhin këta emra, që shtrihen edhe në bullgarishten, e gjejmë këtë fjalë, shtrirja e së cilës në gjithë hapësirën e serbokroatishtes, përfshirë këtu dhe cepin e skajshëm veriperëndimor, dhe tingulli fundor *ń* e bën të pamundshëm mendimin që kjo fjalë të jetë huazim i drejtpërdrejtë nga shqipja. Emri *Buni* i liburnëve (Plinius III ,39), një etnikon i formuar sipas modelit thjesht ilir (W. Schulze *Eig.* f. 541) pa ndonjë veçori shquese të kësaj kategorie me ndonjë emër ilir të qytetit, siç na del tek emri *Boŭνος* (me kuptimin “ardhacak”, khs. *Bunić* në pokëtë region), na e hap mundësinë për ta kuptuar historikun e të huazuarit të kësaj fjale. I shprehur së pari nga Tomaschek (*Mitt. Geogr. Ges. Wien* 23 [1880] f. 506) dhe i pranuar gjithandej është sqarimi i emrave *Dalmatia*, *Dalmatia*, *Delminiium*, *Δέλμιον*, tek Strabo VII 315 *πεδίον μηλόβοτον* (“Fushë që ushqen delet”) nga shq. *del’e*, *del’më*.

Shq. *pelk*, *pelgu* “pellg, pus me ujë amull” (e dëshmuar me *l* edhe në burimet më të reja shkrimore) e dalë nga **pelæg* **pelæg* dhe që mund të përcillet deri tek ilirishtja: *Πελαγόνες* e përmend Scymnus 403 si një popullatë fqinje me popullatën e Liburnëve të brigeve të Adriatikut. Territoret e tjera në të cilat dëshmohet emri *Πελαγονία* (afër Stobit, të quajtur edhe *Αυγκησις* e të tjerë, sh. Illyrier) kishin, sipas dëshmisë së emrave të vendeve, në kuadrin e popullsisë së përzier, gjithashtu edhe elemente ilire. Tek fije të lidhjes së shqipes e të ilirishtes na shpien poashtu, në njëfarë mase, si mbetje gjuhësore të ilirishtes, edhe emrat e ruajtur të hyjnive. Emri *Juppiter Menzana* i hyut të Salentinëve mesapë, të cilit i flijoheshin kuaj, bëhet i qartë përmes fjalës shqipe *mes*, *mezi* “i vogli i kalit dhe i gomarit” (trajta origjinare **menz-*, khs. rum. *mînz*, *mănz* “maz”) (KZ II [1862] f. 148 Stier). “mëzat, dem”.

Emri homonim i Dionisit tek paionët, lidhja farefisnore e të cilëve me pellagonët përkatësisht me ilirët është e dëshmuar mirë në antikë (Homer II. Φ152; Strabo VII 331 fr. 38, Appian *Ilir.*, 4) dhe është e dëshmueshme gjuhësisht dhe përmes onomastikës (sh. *Illyrier*): *Δύαλος* është, sipas mendimit tim, në lidhje me shq. **deĵ* “dehem” (**dkeu-njō*), *dehurë*, *de-t-un* “i/e dehur”, *dëiet* “rrjedh”, “shkrihet”, *dül* “dhjamë, dyll”. Sado të mangëta të jenë njohuritë tona për brumin leksikor të

lashtoilirishtes, aqë më të rëndësishme janë konkordancat e saj me shqipen, nga të cilat këtu mund të spikaten vetëm ato më të dallueshmet. – Po këtë pasqyrë të konkordancave shqipe-ilire na e ofron edhe fjalëformimi me -*e^xt-yo-* i emrave etnikë (ktetikët, përkatësisht emrat e banorëve) dhe nomina agentis në shqipen: *vendes*, shkodranisht *Beratës* “nga Berati”, *Bušatës* “nga Bushati”; *mulis* (: nga *muli*), *gakës* “vrasës” (: nga *gak*). Prapashtesa -*t-* është, në këtë funksion, e përhapur gjithandej në indoeuropianishten; zgjerimi i saj përmes -*io-* është karakteristik për shqipen, sepse në gjuhë të tjera (indoeuropiane) ka vetëm gjurmë të saj (më së shpeshti në greq. *δημόσιος* përkrah *δημότης* më të pakta në sllav.: sllav. e vj. kishtarë. *domašnyh* “i shtëpisë”, serbokr. *domaćin* me -*tjo-* paleosllave). Të njëjtin zgjerim të prapashtesës *t-* si në shqipen dhe të njëjtin funksion të dyfishtë e gjejmë edhe në ilirishten.: Në brigje të lumit *Urbanus* (*Urpanus*, sot *Vrbas*) të Panonisë ishte *Urbate* (Forbiger *Handb d. alten Geogr.* III 21877 f. 348). Trajta e sotme e emrit *Vrbas* = *Urbanus* të lumit na shpie tek. -*tj-* e ilirishtes së veriut: khs. *Voltietis* *CIL V* 2019 (Opitergium) *Volsetis* *CIL III* 3055 (Albona); dhe mbishkrimi *CIL III* 4251 i gjetur në Scarbantia në Panoni: P. Domatins P. [f.] *Tergitio Negotiator* na mëson, sipas mendimit tim, që tek *tergitio* ta shohim barasvlerën ilire të lat. *negotiator*, barasvlerë që ta sjell ndërmend fjalën bazë (: shq. *treg*) dhe formimin thjesht shqiptar. – Prapashtesa -*e^x-ste* (-*sta*, -*sto*), aqë karakteristike për formimin e emrave të vendeve në ilirishten, është në shqipen edhe sot si formans për shenjimin e hapësirave dhe të kolektivave si psh.: ilir. *Tergeste* (khs. më lart *Tergitio*), *Bigeste*, *Παρνοῦ-στα*, *Drivastum* – shq. *kopšte*, geg. *venešt*, vëšt, tosk. *verešt*, *vrešt*, *vëšt* (*IF* 36 [1916] f. 123 sh. Jokl). Në shqipen është dhe një prapashtesë e zvogëlisë, përkëdhelisë -(*ε*)š (*braš* “shalqi i vogël”: *brqj(ε)* “lungë, mullâ, tumor”, *vogelš* “bukur i vogël”: *vogel'ε*), që ka depërtuar edhe në rumanishten. (Jokl, *LKU* [1923], f. 23 ff. dhe referenca). Këtë prapashtesë të dalë nga -*is-yo* unë e lidhi me prapashtesën -*is*: të sjellë nga W. Schulze *Eig.* f. 40. ref. 5 (të dëshmuar edhe në trakishten e në galishten): *Voltisa*: *Votia*, *Volta*, *Ὀλτίσκος*. Sakohë që fundja, siç u përmend më lart, ilirishtja njeh përkrah *Δέλμιον* edhe një *Delminium*, shqipja na ofron dhe në këtë mes, me prapashtesën për sajimin e emrave kolektivë dhe të shumësit -*in* (nga -*iniō*, Jokl poaty. f. 192 v.): *kerminte* shm. i shquar i *krimp*, trajta e moçme *kopeštine*: *kopešte*, *delehe* “gëllenjë”

që na e bëjnë të mundshme t'i kuptojmë edhe formimet korrespondente të ilirishtes.

b) Në krah të konkordancave shqipe-ilire të sjella më sipër nga fusha e leksikut dhe e fjalëformimit, zënë vend po të njëjtat konkordanca të shqipes me trakishten. Nga burimet e drejtpërdrejta leksikore mund të nxirren edhe paralelet shqipe-trakase: dak. *μαντεία*, *mantia* (Dioskorides, Apuleius) “manaferrë, man” lidhet me shqip -geg. *mand* (ε), tosk. *m□n* “pema e manit, manaferrë”, (*Blätter f. lit. Unterh.* 1854 f. 411 ref. 2 Pott). Sqarimi që Tomashek *SB Wiener Ak.* 130/2 (1893) f. 28 e propozon për dak. *amalusta* “kamomile”: shq. *amele* “i/e ambël” + *usta* (*ōd-*) “që lëshon erë” duhet gjithsesi të arsyetohet si i pranueshëm. Emrin dakas të bimës gjerm. *Kardendistel* bot. *Dipsacus silvestris* = *Dipsacus fullonum*) Tomashek poaty. f. 26 me pëlqimin e Hirt *Indogerm* f. 593 e krahason me shq. *šk'er*, *tšjer* “kruaj”. Në rrafshin fonetik, mendimi i Tomashekut duhet plotësuar: dakishtja dhe shqipja puqen në diftongimin e vokalit *e* – (rrënja *sqer-*). Lëndë të tërthortë për krahasimet shq.-trak. sjellin edhe këtu emrat e vendeve. Nëse në veri të Nipserëve banonin *Τρανίψαι* (Xenophon *Anab.* 7, 2, 32) dhe Tomashek poaty. 131/1 (1894 f. 76 nga ky emër dhe nga *Τραμαρίσκα* e trajton tërthorazi një trak. *tra-*, unë i krahasoj këta me shq. paratonike *ter-* (*šter-*) “në anën tjetër, përtej, jasht, nëpër, kundër, përreth” që, gjykuar në tërësinë e fushave të përdorimit, përkundër pikëpamjes së G. Meyer-it, është një element vendës e jo italian i shqipes. Emrin dak. *Κάρποι*, të *Κάρπάτης ὄρος* Vasmer (*Roczn. slaw.* 5 [1912] f. 152) e lidh me të drejtë me shq. *karpe* “shkëmb, thep, sharrë”. Emrin *Δάτος* të vendit bregdetar të Edonëve unë e krahasoj me shq. *date* “vend” (forma origjinare: **dhā-tā* rrënja **dhē*), me ç'rast duhet pasur parasysh si puqjen në rrafshin fonetik ashtu edhe zhvillimin kuptimor përbrenda kësaj familjeje të fjalëve (*Δάτος* psh. si “vend” ose “qytet”, “qytetth”). E përbashkëta e përmendur trak.-shq. në pasjen e një parashtese që u përmend më lart nuk është e vetmja: shq. *per* (nga IE *pro*) “te, tek” (*perde* “pranë dheut, përtoke”, prej këndej *perdese* “thnegël, bubrrec” etj. me një kuptim të llojit të vet haset tek trak.-dak. *pro* një “copë guri”: dak. *προπέδιλα*, emri i bimës bot. *Potentilla repans*, sipas Theophrast 9 ,3,5 “rrënjë të thella në tokë”, sipas Plinius 25 9, 62 = *Chamaezelon* (“që synon dheun, tokën”), duhet të kuptohet, sipas mendimit tim, si *pro-pedi-la* “që është në dhe, në tokë”.

Tek prapashtesa ilire e shqipe *-is-* e zvogëlisë merr pjesë edhe trak: *Cot-iso*: *Cot-tus*, sh. më lart e dëshmuar si më lart për shq. e ilir. që si prapashtesë e përngjitur sajton emra të banorëve *-it-□o-*: Heroni *Briganitio* (*CIL VI* 2807), etnikon i *Brigana* në regio *Urdicensis* të Trakisë (Tomaschek poaty, f. 63).

Merre si ta marrësh, shihet që mbetjet gjuhësore të popujve të moçëm të Gadishullit të Ballkanit, si ato të ilirëve ashtu edhe ato të trakasve, janë të lidhura ngusht me gjuhën e shqiptarëve. Ky raport i dyanëshëm mund të sqarohet vetëm me mbarështrimin e raporteve midis ilirëve e trakasve (sh. Illyrier, Thraker). Se këto raporte nuk duhet parë në kontekstin e Dyndjes së Popujve (shek. 3.- 6.) në Gdishullin e Ballkanit, na mësojnë huazimet e shqipes nga greq. e vjetër, të cilat janë më të moçme se ato latine (*IF* 26 [1909] f.1 ff. Thumb) dhe midis tyre, sidomos shq. *mokere* nga greq. e vj. *μυχανή* (ose *μᾶχανᾶ*) tek Hesychu “gur mulliri” me vokalizmin pararomak të shqipes dhe me konsonantet në brendi të fjalës, që na shpie tek *χ* e greq. së lashtë si tingull fundor, që e arsyeton këtë përfundim në rrafshin kronologjik. Këtu duhet pasur parasysh, ç’është e drejta, edhe *voes*, *vodε* “vodhe, vodhëz, mushmullë”, nga greq. e vj. *oih* “vodhe, vodhëz”, (Jokl, *Lingu.-kulturhist. Untersuch. a. d. Ber. d. Alban.* 1923 f. 207).

Kretschmer Einl. f. 260 ff.; v. Šufflay (si më lart tek § 2); Patsch Histor. Wanderungen im Karst u. an die Adria 1922 f. 40 vv.

§ 4. Pas zgjidhjes së parapyetjes tani mund t’i hyhet retrospektivës së veçorive më të rëndësishme fonetike e gramatiktore të tjera të shqipes për të nxjerrë nga këto njoftime përkritazi me atdheun e moçëm të shqiptarëve. Shqipja është e grupit satem me *δ*, *d* për IE *ǵ* e *ǵh* me *θ* për IE *k̑*: *δemp*, *δembi*: sllav. e vj. kisht. *zqbъ*, ind.e vj. *jambha* “dhëmb”; *liðem*: lat. *ligare*; *aðεε*: lat. *acidus* etj. Të njëjtat raporte i gjejmë edhe në ilirishten dhe, sipas mendimit tim, edhe në hapësirën veriore e perëndimore të saj (më hollësisht sh. Illyrier): *Πίζων ποταμός* (lumë): shq. *rijeð* aor. *føda*; *Βέρζανα* kështjellë në Dardani (Prokop), arm. *berj* “lartësi”, ind. e vj. *brhánt-* “lart” etj. (Ribezzo, *La lingua degli ant. Messapii* 1907 f. 23 ref.1.); *Δίζηρος* lum ilir. (*Lykophron*) e familjes së fjalëve trake. *Δίζα* ind.e vj. *dēhī* “grumbulloj, pendë, digë, ledh” (rrënja IE *dhiǵh-*), *Andiz-etes* popull në Panoni (“banorë të kështjellës”). Se edhe trakishtja i ka ruajtur palatalet, tregon fjala e

përmendur pak më parë *δίζα*. Gjurmët e labiovelareve dëshmohen në shqipen ashtu që, *qu*, *gu* para *e*, *i* origjinare dalin si *s*, *z* (para vokaleve të fundme si *k*, *g*) (KZ 36 [1900] f.307 ff. Pedersen): *pese* (forma origjinare **penque*), *si* si (**quei*), *zjarm* (**guher-m*, arm. *jerm* “nxehhtë”); ndryshe akuzativi *ke* ndoshta (**quom*). Një parashkallë e kësaj gjendjeje: ruajtja e labiovelareve para vokalit të hapur, zhdukja e labialit është ilir.: *Aquincum* “furrë”: furrë me burimet e tij të ngrohta (sh. edhe Illyrier), *Aquilis* lum në Istri, anasjelltaz *garma* është variant dalmat i serbokroat. (Skok *Rad* 224 [1921] f. 115) = “shpellë”: forma origjinare, sipas mendimit tim, *g^hharmā* me një zhvillim kuptimor si sllav. e vj. kishtarë. *peštb* “shpellë”: e edhe “koftor, stufë”, serbokr. *pečina* “shpellë”: (*pekq*”pjek”:) dhe të një refleksi fonetik në sllav. si në *Škarda* nga *Σκαρδ-σνα* në esencë një gjendje e njëjtë, ruajtja e labiovelave është edhe në trakishten, së paku sakohë që kemi të bëjmë me tingujt fundorë të paaspiruar labiovelarë. Ka mënjanimë në hollësi të këtij rregulli. Dak. *κοαδάμα. ποταμογε-ίτων* emër i një bime ujore, sipas mendimit tim, forma origjinare. **q^uadhēm̃* “që banon në ujë” (më shumë për këtë sh. *Thraker*). *Ἀκνευσίον* (Prokop *De aedif.* ed. Haury f.123), dmth. **aq^u-en-is-*, trak. sipas dëshmisë së formimit. *Κοιμῆ-δαβα* *Quimedava* në rajonin e Remesianas që nga Tomashek (*SB Wiener Ak.* 131/1 [1894] f.85) u vendos te familja latine e fjalës *quietus* etj. Tingujt fundorë të aspiruar të labiovelareve, siç na mëson Dečev (*Godišn. n. Sof. Univ.* 18/4 [1922] f. 3 f.), në trakishten dalin si velare të pastra: *Γέρμη* “terme e nxehhtë” (**g^hherm-*), *γέντον* “mish” (**g^hhunt-*, khs. Tomashek poaty 130/ 2 [1893] f. 8) etj. (sh. *Thraker*). Sqarimi i Bariçit i emrit *Ζερμ-ζιργα* në Daki variant i *Gerrnizera* si *g^hhermi-* “nxehhtë” me palatalizimin e IE *g^hh* para *e* (*Zbornik Belić* [1921] f. 188) nuk është karakteristike për çështjen tonë, sepse po ky trajtim ndodh edhe me tingullin *g*-thjesht velar: *βρίζα* “thekën” nga **urugia* (*Bezz. Beitr.* 20 [1894] f. 121 G. Meyer). Përndryshe, shtesa labiale e *g^h* zhduket edhe në dialektet trake: *Γαληνός* vend bregdetar i Sithonëve unë e afroje me prus. e vj. *Galindo* krahinë në skajin e fundit të trevës, lit. *galas* “fund” (me *g^h* (khs. Gerullis *Die alt-preuß. Ortsnam.* 1922 f. 35). Karakteri satem i guturaleve palatale të shqipes, që sapo u konstatua më lart, duhet kuptuar si i drejtë ashtu që, *k̂*, *ĝ* përmbanin qysh në kohën e qenies së gjuhëve të mëvetshme një element përmbyllës. Këtë e dëshmon i njëjti trajtim i *k̂* dhe *q* para *t*: *drite* nga **d̥r̥k̂ -t-* (:

greq. e vj. *δέρκομαι* “shoh”, *darša* “ai pau”), nate: lit. *naktis* “natë”. Po këtë fenomen të natyrës fonetike të *ĥ*, *ĝ* duhet ta paravendojmë edhe për ilirishten dhe për trakishten: *Δέζαροι* një fis i Kaonëve: trak *δίζα*. edhe *δέζι* “kështjellë, kala”, ilir. *Δίζηρος* *An-dizetes*, dhe më tej emrat trakë *Δίγηρον*, *Βί-διγης* të kështjellave (të së njëjtës familje, me nazal, i takon edhe lat. *finco*); *Ἀγρίανες* (: IE *agros*, ind. e vj. *ágrah* “oborr”, greq. *ἀγρός* “arë”) fis i peonëve, *Ἀγραιοί* fis në Epir; *Πευκετίαντες* fis fqinj i Oenotrenëve (Hekataios), *Peucetii* në Iliri (Plinius), *Πεύκη* në territorin trak. (në vendlindjen e lumit Ister): greq.: *πεύκη* “pishë, bredh”, lituanisht *puszlis* “pishë, bredh”, forma origjinare **peuk-*; *-tt-* e indoeuropianishtes është reflektuar në shqipen me *së*: *pase* “pata, kam pasur”) nga **pot-to-* (KZ 36 [1900] f. 308 Pedersen); parashkalla e shqipes *s* mbase *tš* (Jokl *Lingu.-kulturhist. Untersuch. a. d. Ber. d. Alban.* 1923 f. 109, 266 f.). I njëjti reflektim është i dëshmuar edhe në dialektet e ilirishtes e të trakishtes: *Νέστος* lumë në Traki, edhe *Νέσσος* (rrënja. *net-*, greq. *νότιος* “i lagësht”). Tek grekët, *σσ* është refleks i një tingulli *tš-*, sipas dëshmisë tek emri *Πάσσαλοι* = ind. e vj. *pañcāla-* i një populli. (Wackernagel, *Altind. Gramm. I* [1896] f. 137). Nga tingulli origjinar u sajua, si pasojë e metatezës, *št* (e shkruar *στ*). Elemente të popullatës ilire kishte, siç e tregojnë emrat *Νεσσωνίς* në Tesali dhe emri *Nestus* i liqenit dhe i lumit në Dalmaci. Siç u theksua më parë, *kt* reflektohet në shqipen si *t*; parashkallën e pandehur *ht* mund ta marrim si të ilirishtes e të trakishtes: *Τιμαθοχίωμ* kështjellë në brigje të lumit *Timacus* (Prokop), *Νέσακτον* në Istri (Ptolem.), *Nesattium* (Livius); trak. *Αἰθί-παρος* kështjellë regjionale në Haemimontus* (“va në lartësi”): prus. e vj. *Aucki-garbin* etj. Grupi tingullor origjinar *sr-* pëson në shqipen një plotësim me *t*, kështu që prej këndej krijohet një *štr-* shm. *šterpiñ* “gjarpinj”) (**sɣpínj-*). Që këtë trajtim fonetik të këtij grupi e njeh edhe trakishtja, është punë që është hetuar qëmoti: *Στρώμων* emër lumi: rrënja. *sreu-* “rrjedh”; *Ἰστρος* nga **is-ro-*: kelat. *Isara*, ind. e vj. *iṣirá-* *h* “me shi, i/e freskët” (Much në Hoops *Reall.* 1 389). Në këtë mes bën të konstatohet që ilirishtja, edhe në këtë pikë, shkon krahas si me shqipen ashtu edhe me trakishten: *Ειστρις* ishull i Liburnëve ilirë (Skylax 21) (forma origjinare: **ē-sri -*, **ē-sɣ* “ishull”, përkatësisht gjerm. das Umfiössene “i shpërlarë, i stërpikur nga uji i detit “:

* Sot Stara Planina, në malin Ballkan në Bullgari. Vër. e përkthyesit.

rrënja **ser-* f “rrjedh”, si sllav. *ostrovъ* “ishull”, **o-sreu-*: rrënja *sreu-* f. “rrjedh”). -*pn-* është përfaqësuar në shqipen me -*m-*: *gume*, forma origjinare **sup-no-*, khs. lat. *somnus*, gr. *ὕπνος*. Ky tërnim tejet karakteristik fonetik është veçori edhe e ilirishtes: *Ἀμαντινοί*, *Amantes*, banorët panonikë të trevës midis Savës e Dravës (Rufus Epit. 7), pra të një treve tipike midis lumenjsh, janë “njerëz të lumenjve”, **ap-n-.ant* (ose **ab-n-.ant*). Fjala bazë e këtij emri që është farefis me lat. *amnis*, është ruajtur ende në shqipen: *amë* “shtrat lumi”. Jo më pak i spikatur është për shqipen është reflektimi i -*sm-* në -*m-*: *jam*, iuer. **esmi*; ky reflektim është dëshmuar edhe në trakishten: *διέσεμα* është emri dakas i bimës i shënuar nga Dioskorides, që në gjermanisht quhet *Himmelbrand*, *Königskerze*, bot. *Verbascum thapsus*”; unë e kuptoj këtë emër si *dies ema*, d.m.th. **dies eusmē* “Zeus” zjarr, bima gjerm. *Königskerze*, bot. *Verbascum thapsus*”. Tek *Εἰστρος* mund ta kemi edhe një tjetër paralele fonetike shqipe-ilire, të cilën e ndeshim edhe në trakishten: IE *r* është reflektuar këtu përmes *ri*: shqip *drite*, forma origjinare **dṛk-t-* sh. më lart; *ri* nga *r* edhe në emrat trakë e ilirë të popujve *Τριβαλλοί* dmth. *Tribal-* (me prapashtesën e ndeshur shpesh në emrat trakë e ilirë të banorëve -*al* e afërt me gall. *Atrebares*, got. *Þaurp* “çiflik”, lat. *trabs*, ndoshta “banor, i ardhur”), si tek emri ilir nga e njëjta rrënjë *Trib-ūnium*, tani Trebinje në Hercegovinë, prapashtesa e të cilit ka dalë nga -*ōn-* dhe në *Trib-ulium* në Liburni. – Më pak i rëndësishëm është, në rrafshin e konkordancave, përfaqësimi i zanores së reduktuar + *r*: *ur*; sepse ky fenomen hetohet vetëm si dialektor. – Në reflektimin e IE *ŋ*, sipas mendimit tim, shqipja dëshmon një dysi: *e* (*zet* “njëzet” **vikŋti*, *é-sel* “esull” = *e*; IE *ŋ* “un-” dhe *sil* “kaftjall, sillë”, Pedersen khs. *Kelt. Gramm.* 1 [1908] f. 45) dhe *en*, *un* (*mund*, *mend* “mundem”, forma origjinare **mŋ-dh-*: lat. *mens* etj., *nende* nga **nevŋ-ti* përmes **ne(v)ēnde*. Një dysi korrespondente dëshmohet edhe në trakishten, etj. ku përkrah një refleksi pa bashkëtingëllore hundore del edhe një e tillë me hundoren e ruajtur. *Διέσεμα* emri gjerm. *Himmelbrand* (**-eus-mŋ*) i bimës që u trajtua pak më sipër. Mbi ndryshimin midis *e* dhe *a* tek lëkundjet edhe përbrenda një fjale në vetë burimet e shkruara, që duhet kuptuar vetëm si lëkundje grafike, nuk bën të shihet ndonjë mbështetje. Bashkëtingëlloren e ruajtur hundore e tregon emri *Κανδάων* ose *Κανδαῖος* i hyjnisë, sipas Lykophron (937, 938, 1410) dhe distinktivin Schol. të trak. *Ares* në

Krestone, forma origjinare $\hat{k}(u)\eta$ -dhəu – (sh. *Thraker*) dhe fjalën γέντον “mish” $*g^u\eta$ -t-) e përmendur më sipër e mbase edhe glosa: μανδάκης δεσμὸς χόρτον: Μενδίς Βενδίς është rrënja. **bhendh-* “lidh”. Hetohet pra nga njëra anë, se si në shqipen ashtu edhe në trakishten, dallimet e hetuara midis gjuhëve të tjera indoeuropiane midis pozitës para-sonantike dhe vendit fundor të η dhe të asaj parakonsonantike, nga ana tjetër, është zhdukur dhe se përfaqësimet janë të shumta e të ngatërruara. Për ilirishten që, për shkak të mbetjeve të pakta gjuhësore të saj, çështja e paraleleve të ngjashme nuk mund të ndërmerret, sepse në këtë gjuhë ruajtja e nazalit nuk është vetëm paravokalike, porse edhe pasvokalike: Άναπος lum i vogël në Akamani dhe tek Sirakuza (“i pa ujë”), *Anaxus* lumth në Veneti (me të njëjtin kuptim që lidhet me $*aq^u$ - *Can-davia* ($*\hat{k}u\eta$)). Kur shqipja për të IE o ka një *a*, kjo nuk do të thotë që kjo konkordancë e saj me ilirishten perkatësisht me trakishten nuk duhet parë si diçka me peshë të madhe. Kjo sepse në këtë pikëpamje ka lëkundje, siç duket, edhe në disa dialekte të ilirishtes e të trakishtes; të dhënat nga antika pikërisht përkitazi me hijezimin vokalik janë tejet të dyshimta për t’u marrë si të sakta. Varianti trak. *Κόρπιλοι* nuk bën të veçohet nga *Κάρποι* i dakishtes. Antroponimi *Βύζος* është identik me *Βύζας* përkrah *Porolissuin* (në Daki) i cili ndeshet në trajtën *Παράλίσσον*, civ. *Paralisensium*; dhe përbenda vetë ilirishtes përballë dalmat. *Solentia* qëndron emri mesap *Salentini*. Përkundrazi, relevante është rrethana që reflektimi vetanak i diftongjeve *u-* (*au-* *a*, *eu* – *e*) në shqipen që i heq rrënjët qysh në ilirishten, përkatësisht në trakishten. Άρουπῖνοι në trevën të japodëve ilirë (Strabo) quhen edhe Άρουπῖνοι (Appian), *Βαῦστα* mesapë quhen edhe *Basta*, si edhe *Δαύνιον τεῖχος* -ët trakë që më vonë quhen *Δάνειον*. Për emrin dakas të bimës *διέσεμα* bot. *Verbascum thapsus* ($*dies\ eusum\eta$) u fol më lart. Rezulati përmbledhës, përfundimtar i studimit të veçantë gramatikor e lejon konstatimin që: shqipja është në lidhje birësie si me ilirishten ashtu edhe me trakishten.

§ 5. Në dritën e këtij rezultati mund të kërkohet përgjegjja përkitazi me çështjen e atdheut të kryehershëm të shqiptarëve në Gadishullin e Ballkanit. Nga territori i sotëm i shqiptarëve në hapësirën veriperëndimore mohohet për shkak të *Škodra*(ε), si vazhdim shqiptar i *Scodra* (sh. më lart. § 3), sakohë që koha e reflektimit fonetik të këtij toponimi kombinohet me të dhënat historike: Bregu i Adriakut nuk ishte trevë e kryehershme banimi e

shqiptarëve. Kjo rrjedh nga rrethana që terminologjia detare e shqipes është një përzierje e laryshme huazimesh (Jokl *Lingu.-kulturhist. Untersuch. a. d. Ber. d. Alban.* 1923, f. 161). Një indic tjetër negativ është numri relativisht i vogël i huazimeve lashtogreke të cilat, bashkë me rrethanat e tjera, sidomos pse pjesë të hapësirës shqiptare, të cilat sot janë në kontakte intensive me Greqinë e me greqishten, të shihen si një rritje e re. Nga ana tjetër, në kuptimin pozitiv duhet parë rrethanat që: një trevë ku puqeshin ilirë e trakë; një trevë që, pas përhapjes së gjuhës latine jashtë Italisë ende ishte në qarkun e romanizmit nën të cilin kishte rënë relativisht heret (Konkodrancat e elementeve latine të shqipes me ato të sardishtes.: *Lit. -Bl. f. germ. u. roman. Phil.* 1918 f.130 M. L. Wagner; Për përcaktimin e lashtësisë së elementit latin në shqipen: *Mitt. Rumän. Inst.* Wien I [1914] f. 32 Meyer-Lübke; *Arh. za arban. star.* [1923] f. 41 f. Jokl). Kjo trevë ishte, gjithsesi, në afërsi të djepit të rumanishtes (i cili as vetë nuk është i përcaktuar saktësisht); i cili, nga ana tjetër, (sh. më lart. § 3) nuk i ka shpëtuar krejtësisht ndikimit të greqishtes. Të gjitha këto veçori duhet të jenë zhvilluar në ndonjë trevë në pjesën verilindore të hapësirës ballkanike të ilirëve, përkatësisht në Dardaninë e lashtë. Në të mirë të kësaj mund të sillen arsytet gjuhësore: trajta e sotme serbe e formës së vjetër *Naissus*, qytet i madh i Dardanisë, *Niš* tregon me hiferezën e vokalit të paratheksuar ndërmjetësimin gjuhësor të shqipes *Niš*: *Naissus* shqip. *pül* (**peül*): lat. vulg. *pa(d)ūle*. Rezulton pra përfundimi që para sllavëve në trevën e *Naissus* (Nishi) (që as sot nuk është larg nga hapësira kompakte e shqipes) banonte një popullatë farefis me shqiptarët e sotëm. Nga trajtimi i mësipërm (§ 4) i veçorive karakteristike të shqipes, në toponimet e kësaj treve mund të rihasen psh.: që para vokalit të hapur (*Κοιμῆδαβα*), *kt* në *ht*, *t* (*Τιμαθοχίωμ*: *Timacus*), *au* në *a* (: *χαχαλία* emër i një bime malore, sipas Apuleius 8 emër dardan, të cilin unë e konsideroj si **kauk-al* nga **kauk-*, *Καύκ-ωνες* got. *hauhs* “vë diçka lart” dhe si të zgjeruar me prapashtesën. -*al-* që formon emra banorësh). Karakteri ilir i kësaj treve shihet nga formimet e emrave si *Βεμιάστες*, *Βαραχτέστες* (me prapashtesën *st-*); nga ana tjetër, nuk mungojnë elementet trake në toponimi: *Αἰαδάβα*, *Κοιμῆδαβα*, *Ὀδρίουζο*.- Koha kur pararendësit e shqiptarëve arritën në këtë atdhe të moçëm ballkanik mund të përcaktohet bukur mirë me mjete gjuhësore; kjo është më e vonshme se ajo kur një kalim i kapshëm fonetik i

elementeve IE të gjuhës e përfshiu kalimin e: *sk-* në *h-* para vokalit të mbyllur. Kjo sepse në Dac. mediterr. (Dardania) gjejmë *regio Scodriensis* (khs. *SB. Wiener Ak.*, 131 [1894] f. 83 Tomaschek), kësisoji pra një emër që puqet me atë *Scodra* (Shkodra). Marrë përgjithësisht kemi të bëjmë, sipas mendimit tim, me një grup paraindoeuropean të emrave (khs. etrusk. *Scutrius*, emri modern i toponimit *Scotriano* W. Schulze *Eig* f. 383 ref. 2, 416 ref. 5; sh. *Thraker*). – Përfundimi i rezultuar këtu puqet me mendimin e Jirečekut (*Gesch. d. Serben* I [1911] f.152), sipas të cilit pararendësit e shqiptarëve gjatë dyndjeve të popujve u përhapën nga viset malore midis Dalmacisë e Danubit në drejtim të jugut. Këtu u synua vetëm edhe përcaktimi më i përafërsishëm i hapësirës.

Hirt në Beiträge z. alt Gesch. u. Geogr. Festschrift f. H. Kiepert 1898 8. 179-188;
Jireček Gesch. d. Serben.; Illyr.-alban. Forschungen hg. v. Thalloczy I (1916) 8. I
 vv. *Jireček*.

§ 6. A mund të dëshmohon vendbanimet paraballkanike të shqiptarëve? Kjo çështje është, sipas trajtimeve të deri tashme, e lidhur me vendbanimet paraballkanike të ilirëve e të trakasve, prandaj edhe do të shko-klohet përbrenda këtij kuadri. Sido që të jetë, këtu duhet pasur parasysh edhe disa të dhëna nga vetë gjuha shqipe. Si mbështetje nuk mund të merret kalimi në *a* i IE *o*, sepse (§ 4) këtu kemi të bëjmë me një veçori të dialekteve ilire e trake. Në konsideratë duhet të merret rrethana që, disa shprehje shqipe në gjuhën profesionale të bujqësisë, të pyllit, të përpunimit të drurit, të përpunimit të tamlit dalin si puqe të veçanta me gjuhët indoeuropiane të Veriut (balat., sllav., germ.): shqip *l'ande*, *l'endë* “lëndë ndërtimi” lit. *lentà* Brett (Lit. -BI. f. germ. u. rom. Phil. 12 [1891] f.241 Meyer-Lübke); shq. *l'ug* (përkatësisht *lu-g-*) “koritë, lug, ulluk druri, lug mulliri” gjerm. e vj. e veriut. *lú-đr*, “trung i zguruar lisi, magje mulliri” (Jokl, *Lingu.-kulturhist. Untersuch. a. d. Bereiche d. Alban.* 1923 5.147 v.); *vjel'* “vjel rushin”, *vište* “të lashta në fushë” (**vel-st.*) lit. *Valýti* (*G. Meyer Et. Wb. d. alban. Spr.* 1891 5.4.75, Jokl poaty, f. 214); shqip. *veš* “rush”, përkatësisht fryti, *višarak* “i frytshëm”, lit. *vašius* “fryti”, (Jokl poaty.); shq. -geg. *rq*, *rqni*, tosk. *rendes* (dmth. *ren-d-es*) *Lab-* gjerm. e l. e mesme “vrapoj” *Lab*; shq. *štall'b* *Lab.* *mëštílem* – gj. e vj. IE veriore. *Stallra*, homeland. *stollen* “mbështillem” (Jokl. poaty. f. 272 ff.) etj. Kësaj duhet shtuar një varg konkordancash specifike morfologjike midis shqipes dhe këtyre

gjuhëve IE perëndimore; të cilat unë i shkokloj në një shkrim të veçantë. Edhe një konkordancë e çuditshme, deri tani e pahetuar, midis shqipes dhe gjuhëve fino-ugrike ndihmon kështu në sqarimin e paravendimeve përkitazi me atdheun parabolkanik të shqiptarëve: shq. *pištar* “vendi ku ruhet rrshina e pishës, gjerm. “Spleißenhalter” (*piše*, përshkrimi i objektit dhe etimoni tek Nopcsa *Haus u. Hausrat im kath. Nordalb.* 1912 f. 61, i pasaktë G. Meyer poaty. 340) përputhet plotësisht me fin. *pihti* “forceps”, *pärepшти* gjerm. Spleißenhalter, mordvin. *peš* gjerm. Spleißenhalter, forma origjinare e fjalëve fine: **pišti*. Ky shembull nuk është i vetmi i këtij lloji, sadoqë këtu nuk mund të tregohet; kjo bëhet e kuptueshme në dritën e disa rrethanave të lidhura me ndikimet që trakishtja i ushtroi mbi botën gjuhësore fino-ugrike (sh. *Thraker*).

§ 7. E sigurt mund të merret që mbetjet e një popullate paraindoeuropiane u thithën nga pararendësit e shqiptarëve kur ata i banuan viset e tyre në Ballkan. Për këtë përfundim na japin të drejtë disa fakte gjuhësore që na janë përcjellë edhe nga antroponimia, sadoqë nuk mund të tumiren mendimet e përhapura të Oštirit (poaty, passim), sipas të cilave një pjesë fort e madhe e leksikut të shqipes na qenka me prejardhje nga petrefaktet paraindoeuropiane. Këto krahasime janë nxjerrë nga aplikimi i gjuhësisë fino-ugrike, përkatësisht si rezultat i zgjerimit të nocionit të një ndryshimi të një shkalle të paraindoeuropianishtes (që dmth. një ndryshim të konsonanteve në mesore e edhe në ato nistore, varësisht nga vendi i theksit në fjalë e poashtu edhe të theksit në fjali), dhe kështu të një nocioni aplikueshmëria e të cilit kushtëzohet nga njohja e theksit. Në të vërtetë, nuk ka pasur një kësi njohje. Të gjitha argumentet e sjella, të cilat operojnë, si gjithmonë, me gjuhët, raportet e farefisnisë së vetë atyre, duhet të dëshmojnë, sillen vetvetiu në rreth të mbyllur. – Vëmendje të veçantë meritojnë disa toponime në atë hapësirë të cilën e trajtuam si pikënisje të shqiptarëve në Ballkan, *Naissus*, *Νοῦσσα* (Prokop.), *Idimum* (khs. *Ida*, prapashtesa si në mesap. -ilir. *Δάζιμος*, *Δάζος* pastaj edhe *Idassa* në Liburni), *Scodra* (sh. §5). Artikulimi i mëvetshëm i tingujve fundorë të shqipes, *b*, *d*, *g* mund të merren për Lenes të shurdhëta, që sidomos në grupet *br*, *dr*, *gr* shkakton lëkundje të shpeshta në të shkruar (*pr*, *tr*, *kr*), lejojnë që këto të sillen në lidhje me konsonantizmin e etruskishtes: etrusk. *pepna* reflektohet në lat. *Bebenius*, *turte* si *Durdenius* (W. Schulze *Eig.*

passim). Me prejardhje paraindoeuropiane do të jenë edhe disa shfaqje nga fusha e kulturës historike dhe nga ajo e folklorit, si sistemi vigesimal i metodës së numrave, pastaj shtrurja e burrit në shtratin e lehonës* (Paudler poaty, Jokl *Lingu.-kulturh. Untersuch. a. d. Ber. d. Alb.* 1923 f. 10 vv.).

Oberhummer Die Balkanvölker Vorträge des Ver. z. Verbreit. naturw. Kenntnisse in Wien 57/11 (1917) f. 279 v., 320 v.; Ung. Rundsch. f. soz. u. hist. Wiss. 5 (1916/17) v. 24 v. Šufflay; Oštir Beiträge z. alrod. Sprachw. I (1921) passim; Narodna Starina 3 (1922) f. 211 vv. Županić; Arch. f. Anthrop. 45(1919) f. 122 v. A. Haberlandt u. V. Lebzeler; Pittard Les peuples des Balkans 1916 f. 77 vv; Anthropol 12-13 (1917/18) 8.641 vv. Paudler; Weninger në Festschr. Oberhummer 1919 f. 238 vv.

* Në rrethina të Elbasanit, zakoni i shtrirjes së burrit në shtrat, si të ishte ai lehona që e lindi fëmijën, është quajtur *mërkosh*. Vër. e përkth.

ALEGORIA NË LETRAT NGA BURGU: ART APO ENIGMË

1. Hyrje: letra nga burgu, një letërsi dhe sfondi politik

Prej Luftës së Dytë e këndej regjimi jugosllav ka burgosur dhe i ka dënuar me vite të shumta burgu shumë intelektualë shqiptarë, kryesisht të rinj, për veprimtari politike për lirinë e Kosovës e të shqiptarëve. Këta të burgosur, sidomos pas revolucionit të vitit 1981, përdorën çfarëdo mundësie për të bartur te publiku idetë dhe konceptet e tyre politike, etike, letrare e jetësore nga burgu. Si është thënë edhe më herët, si duket ata e kanë konsideruar këtë bartje të mesazheve si një dërgesë për historinë dhe, poende, si një mjet për ruajtjen e shpirtit e të mendjes së tyre.¹ Në këtë përsiatje burg-histori është krijuar një prej margaritarëve të çmuar të letërsisë shqipe, letërsia nga burgu. Mjafton të përmendim emrat e disa shkrimtarëve dhe veprat e tyre të shkruara në burg për t'u pajtuar me konstatimin: Merxhan Avdyli, Ismail Sylja, Hydajet Hyseni, Visar Zhiti, Zyhdi Morava etj. Në këtë përsiatje midis jetës-historisë dhe vdekjes është krijuar edhe ajo letërsi që në shqip quhet letërsi dokumentare, apo **non-fiction literature**, në anglisht. Janë shkruar ditarë burgu, kujtime nga burgu, por mbi të gjitha kanë mbijetuar dhe triumfuar **letrat nga burgu** (epistolari). Kjo, vetëm për një arsye administrative: administratorët e burgjeve, mesatarisht një herë në gjashtë muaj asgjësonin gjithçka që të burgosurit politikë shqiptarë kishin shkruar. Shpëtonin vetëm ato që ata kishin arritur t'i fshihnin dhe, letrat familjare të dërguara në shtëpi për anëtarët e familjeve. Familjet i kanë ruajtur ato letra (sipas tregimeve të familjarëve, ato kanë gëzuar statusin po thuajse të totemit) dhe, një pjesë e vogël e tyre, nën përgatitjen dhe

¹ Kosumi, Bajram, *Letërsia nga burgu/kapitull më vete në letërsinë shqipe*, Toena, 2006.

redaktimin e Merxhan Avdyli të të Bajram Kosumit, janë botuar në vitin 2004 në librin antologjik *Letra nga burgu/ Libri i censuruar*. Përgatitësit e këtij libri, duke zgjedhur letra për librin, kanë pasur në duar disa qindra letra të tjera, një pjesë e të cilave, për besimin e tyre, me vlerë shumë të madhe, e të cilat ende nuk janë publikuar.

Ky libër është objekt studimi në këtë artikull, nga aspekti i ligjërimit, pra përdorimi i një kodi të veçantë gjuhësor, e që është shprehësia alegorike. Duke qenë se këto letra kanë kaluar nga dhënësi të marrësi nëpër një kanal administrativ, të quajtur censurë, atëherë ligjërimi alegorik duket i detyrueshëm. Kjo e vë në pikëpyetje vlerën letrare të këtyre letrave. Teza themelore e këtij artikulli është nëse ligjërimi alegorik në letrat nga burgu, si dhe të gjitha elementet gjuhësore të cilat ndërtojnë këtë ligjërim, format dhe modelet e realizueshme të këtij ligjërimi, është zgjedhje e detyrueshme apo zgjedhje e dëshiruar? Më imtësisht:

1. një, nëse ligjërimi alegorik është çështje e imponimit të rrethanave ku janë shkruar këto letra dhe se gjuha e errët e alegorike ka shërbyer vetëm për të fshehur mendimet e synuara?;
2. dy, nëse ky ligjërim dhe kjo gjuhë kanë shërbyer për qëllime estetike, pra përdorim i gjuhës në një model në mënyrë që komunikimi të kryejë edhe funksionin estetik?;
3. dhe tre, ky ligjërim e ko gjuhë kanë shërbyer për të dy qëllimet, edhe për të fshehur mendimet e mesazhet e synuara por edhe për të krijuar funksion estetik?

Nëse pyetja e parë hipotetike vërtetohet, atëherë nuk ka letërsia çka u kushton kujdes këtyre letrave. Ndërsa në dy pyetjet e tjera hipotetike, letërsia duhet t'i trajtojë këto letra si materiale letrare.

2. Zhanri dhe struktura tekstore

Koncepti **letërsi epistolare** është i gjithë pranueshëm në shkencën letrare, po aq sa është i pranueshëm është edhe koncepti **letra nga burgu** (ang. *The Prison Epistles, Letters from Prison*). Në aspektin zhanror letrat nga burgu, si entitet letrar, janë publikuar qysh në Bibël. Në traditën e

komentimit të Biblës ky koncept e ka një kuptim edhe më të saktë.² Shumë studiues³ pohojnë që disa nga letrat e Shën Palit, si *Letra për Bashkësinë e Efesit*, *Letra për Bashkësinë e Kolosit*, *Letra për Filomenin* dhe *Letra për Bashkësinë e Filipeve* janë shkruar në burgjet e Romës, diku kah viti 60-62⁴ dhe janë dërguar jashtë përmes vizitorëve që kanë shkruar ta shohin Shën Palin në burg. Shën Pali e fillon *Letrën për Filomenin* ashtu si është shkruar letra nga burgu për shekuj me radhë:

“Pali, i cili gjendet në burg për hirë të Jezusit, Mesisë dhe vëlla Timoteu, ia drejtojnë këtë letër Filomenit...”

Dhe e mbyll letrën:

“Të përshëndet Epafra, i cili është me mua në burg për hir të Jezusit, Mesisë. Gjithashtu të bën të fala Marku, Aristarku, Dema dhe Luka, bashkëpunëtorët e mi.”⁵

Ka një ngjashmëri me këtë letër të Shën Palit, në aspektin zhanror, të letrave nga burgu në fund të shekullit XX, të shkruar prej të burgosurve politikë shqiptarë. Prandaj nuk ka asnjë arsye të mos përdoret po ky koncept, pra letra nga burgu, edhe për letërsinë shqipe.

Letrat nga burgu kanë, si tash e dy mijë vjet, të njëjtën formë zhanrore dhe strukturë tekstore:

- një hyrje që shërben si përshëndetje (zakonisht një deri në dy paragrafë)
- pjesa e mesit (trungu) e letrës, ku trajtohet një a më shumë tema, dhe
- pjesa përmbyllëse e letrës që shërben sërish si përshëndetje.

² Shih: *Mercer Dictionary of the Bible*, by Watson E. Mills (Author, Editor), Edgar V. McKnight (Editor), Roger A. Bullard (Editor), Mercer University Press, 2001, pg. 713.

³ Dennis Hamm, SJ, *Philippians, Colossians, Philemon*, Published by Baker Academic, 2013. Gene Taylor, *The Prison Epistles of the Apostle Paul/ Ephesians, Colossians, Philippians, Philemon*, <http://www.centervilleroad.com/>.

Bob Utley, *Paul Bound, the Gospel Unbound: Letters from Prison (Colossians, Ephesians and Philemon, then later, Philippians)*, 1998.

⁴ Bob Utley, *Paul Bound, the Gospel Unbound: Letters from Prison (Colossians, Ephesians and Philemon, then later, Philippians)*, 1998 (përkthimi serbisht në: [www.Poslanice iz zatvora - Free Bible Commentary](http://www.Poslanice_iz_zatvora_-_Free_Bible_Commentary_f_128), f. 128).

⁵ Letra drejtuar Filimenti, 1 dhe 23.

Pjesa e parë dhe e fundit, tematikisht, janë më të pa rëndësishme, sepse janë ligjërime përshëndetëse dhe gjuha ka funksion fatik (sipas R. Jakobsonit), por në aspektin fatik, pra çfarë mesazhesh përshëndetëse dërgohen, kjo ka rëndësi për studim. Midis këtyre dy pjesëve, hyrjes dhe përfundimit, hyrjet janë më të gjata dhe më të pasura tematikisht e stilistikisht:

“Mitrovicë, më 5.1.1983

Babë, mirëdita!

Së pari shëndet të mirë në vitin që hymë! Pak ditë më parë, nga ju mora një letër dhe kuptova që jeni mirë. U gëzova shumë, siç do të gëzoheni edhe ju nga kjo letër imja me të cilën ju bëj me dije se gjendem me shëndet të mirë, e pa probleme.”⁶

Por, të shumtën e herëve, hyrjet edhe pse duken ligjërime përshëndetëse, ose një ndjenjë personale, shërbejnë si formulë për të hyrë në diskutime të temave të ndryshme dhe janë të organizuara sipas kodit etik të shqiptarëve. Ja një shembull se si tematika personale ndërlihet pahetueshëm me tematika publike:

“Pozharevac, maj 1990

Tungjatjeta të gjithëve!

Qe një kohë bukur të gjatë nuk ju kam shkruar, besoj se mund ta merrni me mend se pse nuk kam shkruar. Ndoshta i vetmi arsytim që nuk kam shkruar një kohë të gjatë është se pikërisht koha nëpër të cilën veç sa kemi kaluar dhe në të cilën po kalojmë nuk ka qenë fare kohë e shkrimit. Nuk e di se çfarë kuptimi kanë fjalët në këtë kohë kur në një mënyrë ose tjetër të gjitha gjërat po dihen, kur po pritët të vendoset fati ynë në përgjithësi. Zaten, fati ynë (i keq deri tash) është vendosur sa e sa herë nëpër zyra e salla të huaja, por të gjitha ato vendime kanë mbetur vetëm në letra, në kohën kur e vërteta jonë po shkruhet me gjak, edhe në lëkurën tonë, edhe në dheun tonë.”⁷

Ose, hyrjet ndërlihen drejtpërdrejt me një temë, një përshkrim i situatave të ndryshme mjedisore, njerëzore dhe shpirtërore, ose thjeshtë janë tekste që ndërlihin një konverzacion të filluar më herët e të ndërprerë (psh: në letrën që mora nga ju më shkruanit....; ose: në letrën e fundit ju thashë se...).

⁶ Letra nga burgu/libër i censuruar, 2004, f. 369.

⁷ Letra nga burgu/libër i censuruar, 2004, f. 323.

Edhe pjesa e fundit e letrave nga burgu, përfundimi i letrës, është ligjërim përshëndetës, gjuhë me funksion fatik, por në marrëdhënie me hyrjen, kjo pjesë është më e shkurtër:

“Pozharevc, më 3.2.1985(...)

Sahadetes: Ty të them vetëm kaq: mirupafshim!

Naimit: Bëhu djal i mbarë!

Dritëron e përqafoj fort.

Keni të fala edhe nga shokët.

A. Zhitia”⁸

Nganjëherë përfundimi shprehet me një fjali të vetme: “Të do fort motra jote, Myrvetja”

3. Tematika e letrave nga burgu

Pjesa kryesore e letrave nga burgu, si në çdo epistolar tjetër, është pjesa e mesit, ajo ku është koncentruar semantika e tekstit. Kjo është pjesa ku zhvillohen tema e motive, ide e koncepte, të cilat dalin jashtë kufijve personal të autorit, ndryshe nga pjesa e parë dhe e fundit ku teksti është tërësisht personal dhe autori e zotëron dhe e udhëheq tekstin.

Edhe në këtë artikull, analiza tematike dhe stilistike është përqendruar te kjo pjesë, pa e përjashtuar edhe pjesën e parë e të fundit, aty ku dominon funksioni fatik i gjuhës, sepse ky funksion shpesh ka rëndësi të veçantë në situata apo edhe në civilizime të ndryshme.⁹

Më poshtë do të bëjmë një përkufizim të temave të trajtuara në letrat nga burgu. Tematika e këtyre letrave, pavarësisht se ato janë tekste personale, po thuajse gjithmonë tejkalojnë kufijtë personalë. Kjo ndodhë shpesh edhe në ato tekste ku flitet për veten e parë, pra i burgosuri rrëfen dicka për veten e tij, përsëri tematika është jo personale. Mënyra alegorike e të komunikuarit e ndihmon këtë de-personalizim të tekstit personal. Këtu janë numëruar vetëm temat e përgjithshme, të përsëritshme, dhe nuk është ndje-

⁸ *Letra nga burgu/libër i censuruar*, 2004, f. 36.

⁹ Marina Katnic-Bakarsic, *Stilistika*, Naucna i Univerzitetska Knjiga, Sarajevo, 2001, f. 18.

kur rruga e Bob Utley-t, i cili numëron çdo motiv si temë të letrave nga burgu të Shën Palit.¹⁰

Metateksti ose tekst për tekstin. Është një prej temave të preferuara; diskutohet për vetë shkrimin e letrave, autorët tregojnë situatat kur shkruajnë apo kur nuk mund të shkruajnë (*"Para nja një ore isha shumë i nxehtë për të shkruar një letër pak a shumë "të flakët", por nuk e di se si më kaloi kjo dëshirë posa e mora lapsin."*)¹¹ Në këtë temë mund të kup-tohen edhe nxitjet që autorët ua bëjnë bashkëbiseduesve që të lexojnë, ose shpjegimet e tyre se çfarë janë duke lexuar, pse dhe si etj. kështu, Ahmet Qeriqi bisedon me të bijën për letërsinë shqipe, më shumë në aspektin edukativ, duke i shpjeguar asaj motive, koncepte apo interpretime të ndryshme të autorëve, të cilat ajo i lexon.

*"Mendimi se Migjeni u lajmërua atëherë kur letërsia shqiptare ishte në krizë, nuk është aspak i vërtetë. Mirëpo, Migjeni solli në letërsinë tonë të kohës një frymë të re krijuese..."*¹²

Vuajtjet e pafundme dhe mësimi me to. Vuajtjet që ofron burgu, edhe pse lihen në heshtje, ato duken në tekst. Por, më shumë duken vuajtjet e tjera, ato të shqiptarëve, qoftë për arsye politike apo sociale apo ekonomike.

*"Kemi kaluar deri më tani shumë e shumë të liga, mundime e halle, vuajtje e mall të pashuar për njëri-tjetrin, e si duket duhet t'i vëmë edhe një gur tjetër zemrës."*¹³

Censura. Është temë e përhershme e letrave nga burgu. Kur e patëm përgatitur librin *Letra nga burgu/libër i censuruar*, (2004), Merxhan Avdyli dhe unë, patëm vendosur një kriter: do të botonim vetëm ato letra të cilat kanë kaluar nëpër censurën zyrtare jugosllave. Dihet, kishte letra të cilat kishin arritur të dilnin nga burgu edhe fshehurazi, por ne vendosëm në favor të tyreve të cilat ishin censuruar, për të parë se çfarë force shprehëse dhe çfarë guximi prej mendimi kishin ato tekste. Ato letra, më shumë se

¹⁰ Bob Utley, *Paul Bound, the Gospel Unbound: Letters from Prison (Colossians, Ephesians and Philemon, then later, Philippians)*, 1998 (përkthimi serbisht në: www.Poslanice iz zatvora - Free Bible Commentary, f. 6-7).

¹¹ *Letra nga burgu/libër i censuruar*, 2004, f. 37.

¹² *Letra nga burgu/libër i censuruar*, 2004, f. 49.

¹³ *Letra nga burgu/libër i censuruar*, 2004, f. 52.

një epistolar i zakonshëm, ishin një sfidim i pushtetit jugosllav dhe i censurës së tij. Në asnjë rast, në gazeta, në libra apo në çfarëdo teksti të publikuar jashtë burgut në Kosovë, nuk kishte tekste me mendime e koncepte aq të guximshme e anticipuese sa në këto letra nga burgu.

Disa nga letrat “censurohen” (dmth. hidhen a grisen) edhe nga shërbëtorë të vegjël të pushtetit, si nëpunës postash, njerëz të pushtetit në katunde etj. Sherif Konjufca i quan këta “munafikë”, ndërsa Daut Xhemajli një pjesë të një letre ia shkruan pikërisht këtij njeriu:

“O njeri i përhirtë! Ti që po e merr letrën time, për ta dërguar në shtëpinë time, e që nuk po e dërgon, të lutem unë ty kontrolloje pak atë farë kokën tënde, se më duket që të ka zënë myk. Ti duhet ta dish që letra e huaj nuk cilet, por nejse, ti e çele. Ama duhet ta dërgosh në vend të adresuar, e jo ta mbash për vete. E familja e presin atë. Kaq kam për ty... Këtë ta shkrova ty që e ke zakon të marrësh letra të huaja, e nëse e merr edhe këtë, të lutem lexoje deri në fund dhe vëre gishtin në kokë.

Daut Xhemajli”¹⁴

Pasiguria për komunikimin, apo frika nga moskomunikimi. Pothuajse në çdo letër nga burgu shfaqet frika nga ndërhyrjet dhe ndërprerjet e komunikimit përmes letrave, nga vonesat e shumta në dërgimin dhe marrjen e letrave. Si duket censorët shtetërorë kanë krijuar një makineri të tërë dhe kanë krijuar strategji për ta penguar këtë letërkëmbim. Përkundër kësaj frike, letrat kanë vazhduar të shkruhen.

“Kam shumë për të shkruar, por kam dro se letra kurrë nuk do t’u bie në dorë.”¹⁵

Vdekja. Është temë e shpeshtë, duke qenë se burgu është hapësirë ndëshkimi dhe shëndeti i të burgosurve është çdo ditë i rrezikuar, poende vetë jeta e tyre. Në anën tjetër, burgu ka krijuar një ndarje të gjatë midis të burgosurit dhe familjes së tij, dhe kjo detyrimisht që e bën shëndetin e të dy palëve një prej tematikave të letrave nga burgu. Në disa raste, kjo temë është paradoksale:

“Të dashurit e mi,

Sot, me hidhërim të madh, mora lajmin për fatkeqësinë e motrës Elife. Si rrufe nga qielli më goditi ky lajm i zi e ai rast i kobshëm. (...)

¹⁴ Letra nga burgu/libër i censuruar, 2004, f. 133.

¹⁵ Letra nga burgu/libër i censuruar, 2004, f. 109.

Jam i dëshpëruar shumë pse nuk më keni njoftuar me kohë! Pse, atëherë më vini në vizitë? Çka don të thotë për mua fshehja e rasteve të tilla? Sa t'ju besoj fjalëve tuaja? Çka mendoni kur veproni kështu, kundër dëshirës sime? Pse?! Pse?! Pse?!''¹⁶

Ja një tjetër përjetim i vdekjes, i shprehur nga Mehmet Hajrizi:

“Novi Sad, më 28.2.1988

E dashur motër, të dashur vëllezër,

Kur mora lajmin e hidhur për vdekjen e babait tonë të shtrenjtë, menjëherë i shkrova një letër nënës dhe një tjetër juve. Tashti e kuptova se nëna nuk e paska marrë letrën time.

E morëm telegramin në të cilin na njoftoni se paska vdekur edhe nëna jonë e dashur, pa kaluar dy javë nga vdekja a babait.”¹⁷

Tematika psikologjike e burgut. Në shumë letra trajtohen aspekte të ndryshme psikologjike e sociologjike të burgut: marrëdhënia i burgosur politik-burg; shoqëria e të burgosurve politikë, mërzia e burgut, vuajtjet e burgut, malli për vendlindjen e familjet etj. ja se si Bajrush Xhemajli e shtron marrëdhënien burg-karakter i njeriut:

“Mënyra e vuajtjes së dënimit, në kontekst me rrethanat dhe kushtet e burgut është një ndër faktorët që përcakton karakterin e të burgosurit. Duke u bazuar në këtë kriter themelor ne vlerësojmë se si i ka hije dhe si mund të dalë dikush nga një vend: kokëllartë apo me sy përdhe. Të tillët lënë gjurmë, prandaj kujtohen me respekt. Në gëzohemi që Lila u takoi këtyre të parëve. Më ka lënë mbresë një dialog i tij me Nazën. Ku ky i thotë se “një pjesë e imja po mbetet këtu, bashkë me ju”, Naza ia kthen: “edhe një pjesë e qenies sonë po vie bashkë me ty”, çka vërtetë është ashtu.”¹⁸

Dashuria. Dashuria në letrat nga burgu shfaqet në shumë përmasa: dashuri ndaj lirisë, ndaj atdheut, ndaj vendlindjes, ndaj familjes, ndaj jetës e shumë e shumë përmasa të tjera. Më e papritur është dashuria ndaj femrës (grua apo e dashur), por pikërisht kjo përmasë e dashurisë është e shfaqur jashtëzakonisht shumë. Musli Kosumi ia ka shkruar 200 letra,

¹⁶ Letra nga burgu/libër i censuruar, 2004, f. 122-123.

¹⁷ Letra nga burgu/libër i censuruar, 2004, f. 292

¹⁸ Për ta qartësuar kuptimin e tekstit: dialogu bëhet midis dy të burgosurve politikë (Lili dhe Naza, fjala është për Halil Selimin dhe Nazmi Hoxha), në prani edhe të burgosurve të tjerë (autori etj.), me rastin e lirit të njërit prej tyre, Lilit.

shumica me temë dashurie, gruas së tij, Dritës, dhe ai e mund jetën e burgut duke shkruar çdo javë ose çdo dhjetë ditë një letër për gruan e tij.

“Letra 24

29.06.1984

E dashura ime Dritë,

Është mbrëmje. Ora saktë 19. U ula të ta shkruaj këtë letër dhe kjo mbrëmje po më përkujton mbrëmjet e asaj vere kur ishim martuar, atëherë kur në atë qetësi të errësirës, pasi leja librin anash, merrja kitarën dhe ia thosha ndonjë kënge të lehtë. Oh sa do të doja që t’i kalojmë disa çaste të tilla tash! Sa e bukur është kitara! A do ta mësojmë Besartën tonë të dashur që në pleqërinë tonë të na i përkujtojë këto ditë me kitarë? Do ta mësoj t’i bie kitarës. Patjetër!

Imja Dritë, jam duke lexuar letrën tënde të 20 prillit dhe po analizoj. Kishe bërë një krahasim për të kaluarën time në burg dhe për të tashmen time. (...)”¹⁹

Letra 26

10.07.1984

Drita ime e dashur,

Sot pasi që u ktheva nga puna në orën 15, mi dhanë katër letra tua të shkruara më 20.05.84, 23.05.84, 27.05.84 dhe 02.06.84. Sot ishte ditë sportive (dhe ne memzi e presim këtë ditë) mirëpo aq shumë u gëzova për letra e ti lija ato e të luaj futboll? Kjo ishte e pamundur prandaj u ula në një skaj mbi bar dhe hapa letrën e parë. (...)”²⁰

Ideali dhe hedonizmi. Në këto letra rri e ringjallur tërë kohën ajo dilema e vjetër në mes të dashurisë për jetën e zakonshme dhe dashurisë për një jetë më të mirë e më të përsosur, e kjo e fundit gjithmonë paguhet shtrenjtë, dilema në mes të idealit e hedonizmit. Sherif Konjufca e thotë hapur:

“Vërtet pa ty Ymrane nuk kam mundur kurrë ta mendoj jetën megjithëqë edhe jam rebeluar ndonjëherë, por sot pa ty ndoshta do ta kisha më të lehtë burgun. Dashuria më e madhe t’u bëka barra më e rëndë në burg vërtet qenka vështirë të zgjedhësh në mes dashurisë dhe idealit. Njërin më duhet ta lë keq. Të dyja nuk mund t’i kënaq.”²¹

Musli Kosumi i thotë gruas se i dhimbset tepër që po heq të zitë e ullirit,

¹⁹ Musli Kosumi, Letra të pa publikuara. (arkiv personal).

²⁰ Musli Kosumi, Letra të pa publikuara. (arkiv personal).

²¹ *Letra nga burgu/libër i censuruar*, 2004, f. 469.

por që të kërkojë falje nga autoritetet shtetërore, mos e bëj o zot!

Ndarja dhe ndalimi. Pesha e ndarjes e të burgosurit është e madhe. Ndarja nga familja, nga e dashura, nga gruaja, fëmijët, prindërit; ndarja nga atdheu e njerëzit e tij; ndarja nga librat, nga indexi..., të gjitha këto janë motiv i përhershëm i këtyre letrave. Kjo ndarje nga njerëzit e nga natyra krijon nganjëherë situata shumë të efektshme. E ka stopuar burgu jetën e të burgosurve, apo jo? Është jeta e burgut jetë, vazhdim i jetës së zakonshme, apo aksident, apo edhe ndërprerje, vendnumërim i jetës, apo të gjitha nga pak? Gani Koci, edhe pse i ka mbushur 26 vjet, mendon se ende i ka 21 a 22, aq sa i ka pasur kur e kanë burgosur. Jeta e vërtetë aty i është ndalur, si një orë që s'është akorduar. Ndërsa Sherif Konjufca kur i numëron vjetët e dashurisë me gruan i futë në llogari edhe dy vjetët e burgut, por nuk është krejt i sigurt se a mund të quhen edhe ato vite të dashurisë?

Numërimi dhe kuptimi ndryshe i kohës. Në burg s'ka ditë, javë, muaj, stinë..., të gjitha këto përmbliken në dy kuptime: dita-nata. Madje, ndodhë që në vetmi të burgut edhe këto dy kuptime të mos dallohen mirë. Janë të dhembshme fjalitë: më dërguan te mjeku dhe pashë se kishte dalë pranvera! Ose, Myrvete Dreshaj i shkruan Bacit të vet *"njëmend kishte dalë pranvera..."*. Kjo pranverë është jo një, po dhjetë, dymbëdhjetë, pesëmbëdhjetë... pranvera të përvjedhura *"nëpër vrimat milimetërshe"* të furgonit të burgut, nëpër grila a në një rast të jashtëzakonshëm.

Prania e botës së jashtme në botën e burgut. Duke qenë të izoluar nga bota e jashtme, të burgosurit e kërkojnë atë në çdo mundësi dhe në çdo përmasë. Ky është një prej motiveve më të realizuara të letrave nga burgu. Kjo botë shfaqet në shumë përmasa:

*"Nganjëherë vijnë e na "vizitojnë" edhe në dritaren tonë, kumria gugatin ndonjëherë dhe shkojnë më tutje, ku sigurisht e ndjejnë veten më të sigurt. Këtu lehtë mund të dëgjohet zëri i tyre: gu-gu, ku-ku Isuf, ku-ku Isuf."*²²

Liria. Liria rri prapa çdo fjale të letrave nga burgu. Ajo është herë e hapur e herë alegorike. Ja si shkruan Ilmi Ramadani:

"Të dashur prindër,

(...)

²² *Letra nga burgu/libër i censuruar*, 2004, f. 97.

Ju jetën po e kaloni në terr të zi, pa pasur pranë vetes një fëmijë. Liria shtrenjtë po na kushton, por s'mund ta ndalë kurrfarë force. Edhe fëmijës në bark të nënës prej helmit po i ndryshojnë të rrahurat e zemrës. Pikërisht kjo na obligon që sa më parë ta fitojmë lirinë.

Me mall e plot respekt ju përqafojmë. ²³

Me të njëjtin ligjërim edhe Jakup Krasniqi i nxitë vëllezërit (popullin) për të vepruar për lirinë:

“Çdo popull që lufton për paqe, punë e liri, do të ketë edhe ardhmëri. Deri më tash ne na kanë shikuar si një objekt, që për të tjerët të flisnim e për të tjerët të duartrokisnim. Tani më s'është ashtu, se edhe ne jemi subjekt që dimë të mendojmë, dimë të flasim, dimë të punojmë, edhe për veten tonë. (...)

Vëllezër, në përgjithësi na ka rrëmbyer një entuziazëm i pa shoq. Është mirë që ka entuziazëm, por as nuk duhet të flemë mbi dafina. Mjaft kemi bërë, por ama na presin edhe shumë punë. ²⁴

4. Gjuha e errët, eliptike dhe alegorike. Tipa të alegorive

Të folurit alegorik është aq prezent në letrat nga burgu, sa që është tepër vështirë të dallohet nga të folurit e zakonshëm. Bile, kjo ka krijuar një si **tendencë letrare**, pra ligjërata synon të jetë gjithnjë alegorike, po edhe atëherë kur ka funksion referencial. Për shkak të censurës, në njërën dhe, për shkaqe letrare, në anën tjetër, alegoria përshton çdo fjali e kuptim. Nganjëherë alegoritë janë tejet të tejdukshme, të klishezizuara (psh. nevoja për rrezet e diellit gjithnjë ka kuptim alegorik), po nganjëherë janë tepër hermetike dhe krejt personale, e si të tilla fare të pa deshifruara për marrësin mesatar. Duke folur për bujqësinë, për mbjelljet etj. mund të ndodhë të dërgohet një porosi e caktuar politike. Nëse në një letër nëna i thotë Hydajet Hysenit se të rinjtë e fshatit ua kanë prashitë kollomoqin, kjo s'duhet kuptuar veç si një ndihmë konkrete në punë bujqësie, po si një njoftim se të rinjtë e fshatit po ndjekin rrugën politike të të burgosurve. Berat Luzha flet me nënën e vet, po asnjëherë nuk mund të kuptohet plotë-

²³ Letra nga burgu/libër i censuruar, 2004, f. 227.

²⁴ Letra nga burgu/libër i censuruar, 2004, f. 248.

sisht në është duke folur me nënën që e ka lindur apo me nënën Kosovë:

*“Pret, moj nënëloke, se mos njëri nga nipat a mbesat që të rrethojnë kur ti u tregon atyre përralla të vjetra plot, do të të lajmërojë...Dhe ti pret e pret lajmin e kthimit, atë lajmin e takimit, atë lajm që në ankth të mbet. E, në e arrifsha atë ditë, ke thënë, edhe vdekja mirë se vjen”.*²⁵

Këto fjali të bukura kujt i drejtohen në të vërtetë? Nënës, Lirisë, Nënës Kosovë, Nënës Shqipëri, apo të gjithave përnjëherë?

Në një ligjërim të tillë ku alegoria është aq e dendur sa që e mbizotëron tërë ligjërimin, pyetja që mund të shtrohet me të drejtë është nëse alegoria është figura dhe tipi i dëshiruar i ligjërimin, apo është figura dhe tipi i imponuar i ligjërimin? Alegoria është një figurë e dëshiruar e letërsisë moderne, e përveç kësaj, ajo ka një traditë shumë të fuqishme në letërsinë gojore shqipe, veçanërisht në stilin bisedor, me të cilin stil letrat nga burgu kanë një afërsi të madhe, në mos janë tërësisht brenda tij. Në anën tjetër, duke i shkruar në burg, e duke kaluar nëpër censurë të ashpër zyrtare, autorët e letrave nga burgu është dashur të fshehin e të kamuflonjë mendimet e vërteta, apo të kodojnë gjuhën në atë mënyrë që mund ta kuptojë marrësi, por jo edhe censori. Këtu ka ndihmuar edhe një fakt socio-linguistik: dhënësi e marrësi i kanë takuar të njëjtit areal kulturor, ndërsa censori, në të shumtën e rasteve ka qenë shqipfolës i një areali tjetër kulturor, i cili e ka mësuar shqipen si gjuhë të dytë. Kjo e ka lehtësuar komunikimin alegorik, sepse shumë frazeologji lehtë të kuptueshme për dhënësin e marrësin, nuk janë hetuar nga censori. Nëse thirrmi në formulën e komunikimit sipas modelit Klaudie Shannon dhe e pasuruar nga Warren Weaver (1947-49), atëherë censori luan dy role: njëri është roli i kanalit (ai mund të stopojë letrën, të mos e dërgojë te marrësi) dhe i dyti, ai është roli i zhurmuesit që synon të pengojë komunikimin midis dhënësit e marrësit.

Nga analiza e bërë në letrat nga burgu, më poshtë kemi përkufizuar dhe tipizuar disa nga tipat e ligjërimin alegorik, të cilat në disa raste mund të kuptohen edhe si strategji të komunikimit. Analiza e tipave të ligjërimin alegorik, pra analiza për të kuptuar se si, në ç’formë dhe në ç’farë konteksti është përdorë ligjërimi alegorik, do të ndihmojë në kuptimin e përgjegjës

²⁵ *Letra nga burgu/libër i censuruar*, 2004, f. 113.

nëse alegoria ka qenë figura e dëshiruar apo e imponuar e ligjërimit në letrat nga burgu.

Alegoria e funksionit fatik. Edhe pse në hyrje të letrave gjuha ka funksion fatik, dtht. shërben vetëm për të vënë fillin e bisedës, ajo shpesh merr edhe funksione alegorike. Kështu e fillon letrën Ahmet Qeriqi:

*“E mira e babit, po të shkruaj pa kurrëfarë shprese se do ta marrësh këtë letër, sepse si duket këtu nuk i lejojnë letrat e shkruara në gjuhën shqipe, edhe pse këtë nuk e thonë hapur.”*²⁶

Kjo fjali nuk është vetëm një përshëndetje, por një goditje në politikë kat kulturore dhe gjuhësore të Jugosllavisë ndaj shqiptarëve. Duke qenë në funksion fatik, kjo fjali nuk tingëllon shumë politike, edhe pse është e tillë, dhe është shkruar si alegori e lehtë për arsye të censurës.

Alegoria e intertekstualitetit. Në letrat nga burgu ka përplot intertekstualitet, në të gjitha format e tij të përkufizuar nga Zherar Zhenet, Julia Kristeva, Natalie Piegay-Gros etj.²⁷ Nga njëherë ky intertekstualitet është vështirë të dekodohet, e herë të tjera dekodohet lehtë, por semantikisht vështirë kuptohet. Ja një rast i tillë, kur Bajrush Xhemajli krijon një intertekstualitet të dukshëm, por me polisemi të theksuar:

*“Kur erdha këtu, në këtë dhomë, para katër muajsh, në ndarje me Balin e Shemin, deshën të ma jepnin njërin prej kalendarëve të vitit '89, por nuk e mora. Në vend të këtyre e kërkova kalendarin e “Kosovares” të vitit të kaluar, të cilin pata kërkuar që të mos e hiqnin fare nga muri, sepse më pëlqente shumë. Shokët ma dhanë me gjithë dëshirë. Nëse e ke parë, sigurisht të kujtohet: është një grua e re me fëmijën e saj në prehër. (...) Përfundi kësaj pikturë, aty ku janë shënuar muajt e kalendarit, i kam vendosur dy fotografi: njëra është ajo ku keni pozuar nëna, Naza e ti (“Nënë, motër e grua bashkë/Prisnin mbi minder me kashtë”), ndërsa tjetra është ajo ku keni pozuar ti e nëna. Nën ju është vendosur harta e botës, kështu që ju dukeni sikur keni hipur diku mbi botë, diku në lartësi të Olimp, për të më shikuar mua këtu.”*²⁸

Në këtë tekst intertekstualiteti është i shumfishtë:

- letra në raport me vargjet “Nënë, motër e grua bashkë/ Prisnin mbi minder me kashtë”

²⁶ Letra nga burgu/libër i censuruar, 2004, f. 52.

²⁷ Natalie Piegay-Gros, Poetika e intertekstualitetit, Parnas, 2011, f. 23 etj.

²⁸ Letra nga burgu/libër i censuruar, 2004, f. 96.

- letra në raport me kalendarin dhe me dy fotografitë
- dy fotografitë në raport me hartën e botës dhe me Olimpin.

Ndërsa alegoria është tërësisht personale dhe përmes saj autori e krijon një situatë epike: gruaja dhe nëna presin të kthehet ky nga burgu, ajo është e bukur dhe autori synon, dëshiron dhe kërkon nga ajo që të krijojnë një botë të tërë me fëmijë, kur të lirohet nga burgu. Si po shihet, alegoria këtu është mjaft komplekse, por jo për arsye politike apo censure.

Alegoria përmes humorit. Po thuajse në të gjitha letrat nga burgu shfaqet një ligjërim humoristik, vende vende. Gjithsesi, kjo kërkon një shpjegim jashtë letrar: si është e mundur që nga zgafellet e burgut, atje ku tortura dhe mundime të tjera fizike e psikike janë të përditshme, të vijnë letra me pjesë humori? Kjo s'ka se si të jetë ndryshe pos një alegori, në këtë rast jo për dhënësin (autor) por për marrësin. Marrësit janë gjithnjë njerëzit më të dashur të autorit, dhe ata do të duhej të mendonin pak a shumë në këtë mënyrë: deri sa ai bëka humor, s'mund të jetë edhe aq tmerrshëm.

Alegoria përmes natyrës animale. Në një letër nga burgu të Bajrush Xhemajlit shpendët janë personazhe që veprojnë dhe secili prej tyre ka një mesazh alegorik:

“Krrokatja kaq e madhe e korbave ma nxori gjumin shumë herët. Sot qenkam ngopur gjumë, andaj nuk paskam nevojë të fle më shumë. Këta çdo herë më zgjojnë herët, por zakonisht vazhdoj të flej deri sa të bie zilja. Në drunjtë e shumtë andej mureve të burgut qëndrojnë vazhdimisht shpend të ndryshëm. Sa mund të vërehet nga këtu, fjalën kryesore e kanë korbat. Këta dominojnë si për nga numri, ashtu edhe për nga zhurma. Ka aqë shumë, sa që formohet përshtypja se të gjithë korbat e Pozharevcit rrinë këtu. Ndoshta të kanë rënë në sy edhe ty kur ke ardhë në vizitë te unë. Ja, shihen nga këtu: me puplat e tyre pis të zeza, kur ngrihen trumba-trumba e nxiejnë qiellin, duke u sjellë e mbështjellë vazhdimisht dhe duke bërëtitur me krrokatjet e tyre të vrazhdëta. Kur i shoh kështu më shkojnë ndërmend lutjet e trimit vetullhollë, të rënë atje mes dy maleve me dëborë: “O ju korba që po nxini/ Sytë e zezë të zezë m'i lini/Të shoh nënë, motër, grua/Të shoh prapun mos m'u shua.

(...)

Edhe pse të shumtë, zëri i harabelave më pak arrin të depërtojë nëpërmjet 37000 vrimave të imta të dritares sonë (përafërsisht kaq vrima i ka rrjeta e metaltë). Zëri i tyre në këtë kor shpendësh s'arrin të artikullohet mirë në veshët tanë. Të mëdhenjtë e kanë fjalën këtu-korbat.

(...)

As mbreti i këngës, bilbili, nuk arrin që me zërin e tij të ëmbël t'ia ndërrojë rrjedhën melodisë së këtij kori të çakorduar. Para zërit të qjerrë të korbit, zëri i tij aq i adhuruar e melodik është i pafuqishëm.

Megjithatë, zëri i tij arrin deri këtu, së pakut atëherë kur gjatë ditës të tjerët lodhen në këtë "garë". Këto cicërima më nxisin edhe të recitoj: "O i vogli bilbil i ngratë/ti s'ke faj/s'di ti ç'ndodh kënde/shtatë shtete të egra na vunë bllokadë/si në eposet e mëdhenj..."²⁹

Alegoria në këtë tekst është tradicionale: burgu dhe grilat si vend ballafaqimi i korbave, harabelave e bilbilave, ku janë ndërfutur edhe intertekste, po ashtu alegorike.

Alegori pothuajse e zhveshur politike. Në kohën e vlimeve më të mëdha kulturore e politike antishqiptare në Serbi, kështu e përjeton dhe e artikulon Gani Koci këtë situatë:

"Nish, 20.9.1987

Të dashurit e mi,

(...)

Ne jemi duke jetuar dhe do të jetojmë për njëri tjetrin, e së bashku do të jetojmë për agimin e prituri-lirinë. Ne, gjithmonë, zemrat na rrahin në të njëjtin vend, për të njëjtën gjë. (...)

Kohë të vështira po vijnë. Prandaj, duhet t'i presim, t'i përballojmë ato ashtu siç duhet: të paepur e të fortë, si deri më tani. Duhet të dimë si t'i tejkalojmë ato. Asgjë nuk duhet të na thyejë e të na hutojë, as ne e as juve. Me besim dhe me mbështetje të plotë, ne në ju e ju në ne, të gjithave do t'u bëjmë ballë e do të dalim faqebardhë. Prandaj, keni besim e qëndroni të fortë e me dinjitet."³⁰

Ky tekst i Kocit është alegorik, sepse ai thërret për forcë e besim para furtunave që po rriteshin rreth Kosovës, por është aq e hapur sa mund të shënjohej si alegori e zhveshur.

Ligjërimi personal si alegori e ligjërimit publik. Janë të shpeshta ligjërimet publike të vendosura brenda letrave nga burgu, si tekste gjoja familjare e personale. Ja, psh. Jakup Krasniqi si e ndërton një tekst të tillë:

²⁹ Letra nga burgu/libër i censuruar, 2004, f. 97.

³⁰ Letra nga burgu/libër i censuruar, 2004, f. 160-161.

“Vëllezër, në përgjithësi na ka rrëmbyer një entuziazëm i pa shoq. Është mirë që ka entuziazëm, por as nuk duhet të flemë mbi dafina. Mjaft kemi bërë, por ama na presin edhe shumë punë.”³¹

Ligjërimi personal si alegori e ligjërimit filozofik. Januz Januzaj i shkruan letrat në një ligjërim filozofik. Fjalët e tij janë të thella, kanë kuptim të thellë, janë eliptike dhe të nderuara, në stilin niçean, si fjali të urta e proverba;

“Nënë, prej teje nuk pres letra. Ti i ke shkruar të gjitha, kaheër. I ke thënë të zezat e të bardhat: kush nuk i sheh, medet! Dejtë në duar, rrudhat në ballë, kërrusja, eshtrat që tregojnë me këmbëngulje jetën, nuk janë shenja të fundit, me to ke lindur.

Unë e ti nuk kemi çka t'i themi njëri-tjetrit. Kur flenë shpirti yt, flenë edhe shpirti im, kur ecën shpirti yt, ecën edhe shpirti im. Nëse ke vendosur “të shkosh” në atë dynja, shko! Ti je në mua. Vetëm do të më mbetesh borxh për një udhëtim në këmbë deri te dajallarët. Asgjë tjetër.

Të shtrëngon me duar dhe të përqafton, Januzi”³²

Alegoria nxitëse personale-publike. Merxhan Avdyli përdorë një alegori e cila krijon lidhjen midis personale dhe publike. Ai flet për personalen, por në fakt synon publikun:

“Pikërisht sot i kam mbushur 6 vjet e 4 muaj burg, edhe dy muaj kryhet gjysma e dënimit. Shendosh. Ditët po kalojnë edhe kështu, madje, më duket, për mua (e ndoshta edhe për shumë të tjerë), tash për tash është shumë mirë që jam në burg (për disa gjëra, kuptohet) sesa të isha jashtë, sepse sipas asaj që po lexoj në shtyp e po dëgjoj e shikoj në televizor, unë nuk do të kisha mund t'i mbyll sytë e veshët, e më në fund gojën. Kështu, megjithatë në burg është vendi më i përshtatshëm për të menduar atë që të fle në zemër sepse përtej burgut s'ka ku të shkojë. Pra, e vetmja liri që e kam në burg është liria e mendimit. Unë nuk e di se si janë punët jashtë, por sa po informohem nga shtypi e televizioni, vaj halli për ata që nuk mund të durojnë, por ja që koha sjell momente kur duhet të durohet saçi mbi kokë në pikë të vapës, apo koka në frigorifer, kur është acari më i madh.”³³

Sa i përket identifikimit politik në këtë tekst ai është i qartë dhe jo i fshehur. I fshehur dhe alegorik është këtu loja me burgun si vend për të menduar lirshëm. Pra, tërësisht alegori si stil i bukur i ligjërimit.

³¹ Letra nga burgu/libër i censuruar, 2004, f. 248.

³² Letra nga burgu/libër i censuruar, 2004, f. 263.

³³ Letra nga burgu/libër i censuruar, 2004, f. 309-310.

Alegoria si ironi. Për regjimin e egër në burgjet jugosllave, sidomos kundër të burgosurve politikë shqiptarë, flitet në të gjitha letrat, dhe kjo është një prej tematikave të shpeshta. Merxhan Avdyli ka ndërtuar një ligjërim të veçantë alegorik për këtë temë: ai shkruan alegori me anti-alegori. Apo: ai bëhet kishe po përdorë alegori, por në fakt e demaskon alegorinë e vet dhe me këtë krijon efekt të mirë ligjërimor:

“Pozharevc, më 8.11.1987, e diel

Tungjatjeta babëloku Nazmi!

Kësaj radhe po ju drejtohem Juve personalisht.

Në vizitën e fundit e morët vesh që isha në vetmi. Prej vetmisë kam dalë dje. Isha i dënuar 30 ditë. T’ju tregoj se përse isha në vetmi “nuk bën”, sepse nuk isha i dënuar vetëm unë dhe tash nëse ju tregoj mund të ndodhë që letra të futet në gërrshërë. Pra- pssst! Po e vras të vërtetën që të mbetet letra gjallë. Për vetminë mund t’ju them vetëm këtë: dhomat ku mbahet dënimi janë 2 metra e gjysmë nën dhe. Lampa elektrike tërë ditën rri ndezur, se për ndryshe mund të shihet vetëm sa për t’i futur gishtat në sy. Nuk ke të drejtë të lexosh, nuk ke të drejtë të shkruash as letra, madje. Mirëpo, edhe aty i ke disa të drejta, si për shembull: ke të drejtë, përveç ushqimit dhe fjetjes, edhe të marrësh frymë dhe të thithësh ajër, aq sa mund të përbirohet nëpër shoshë e sitë, pastaj edhe ke të drejtë të mendosh çka të duash (kuptohet, vetë më vete), në fund e ke edhe një të drejtë të madhe e të vlefshme që s’mund ta ndalojë askush, por para se ta përmend duhet të ju kërkoj falje në shprehje, pra nuk është e ndaluar të kryhet nevoja e vogël, e madje as e madhja!

Babëlok, ju e dini se një fjalë popullore thotë: “Qeni qenin nuk e ha”. Kurse unë po them se njeriu njeriun e ha edhe me tesha veshur, madje. Se kur do të bëhet njeriu njeri nuk dihet, por edhe një kohë të gjatë jo se jo. Që të mbetem i tëri nuk po e zgjas më tepër!”³⁴

Në këtë tekst dallohen qartë dy tipa ligjërimi: alegorik dhe ironik. Alegoria deshifrohet te mposhtja, injorimi, ironizomi etj. me egërsinë e burgut. Kot është dënuar Merxhani 30 ditë vetmi, ai del prej andej dhe ua përllaç atë regjim dhe atë civilizim. Ironia i vë kapak alegorisë: ata që bëjnë në atë dhunë, le më që nuk janë njerëz, por nuk dihet as se kur do të bëhen.

Ajo që neve na intereson në këtë analizë, alegoria është në funksion të shprehësisë sa më të bukur, pra është gjuhë e zgjedhur dhe jo e imponuar.

³⁴ *Letra nga burgu/libër i censuruar*, 2004, f. 310.

Alegoria si ëndërr. Shaban Shala ka zgjedhur ëndrrën për të bartur mesazhet e tija politike e personale. Ëndrra i shërben si një plaf i mjegullt, si një alegori, mbase për ta hutuar censorin (ky po folka për ëndrra! S'mund të jetë diçka e rrezikshme!) si dhe për të shprehur më bukur e më me efekt vizionin e tij. Ai i shkruan letër gruas së tij, ku i tregon ëndrrën që e ka parë, e në të cilën, në mënyrë shumë realiste e përshkruan veten, aktivitetin e tij, dashurinë ndaj gruas dhe fëmijës së tyre, përshkruan "*bishën e egër*" që shfaqet dhe e mbërthen Shabanin i cili mbrohej e luftonte duarthatë, gruaja qante dhe e kërcënonte bishën, por "*bisha e përjargur mua më shpinte drejt kafazeve të veta*". Nga lotët e vuajtjeve formohen tre lumenj të cilët bashkohen dhe formojnë një det: për bishën dhe këlyshët e saj deti ishte vdekja, sepse ato mbytën në atë det lotësh, por i njëjti, e mban në sipërfaqe Shabanin, deri sa avullohet dhe formon një ylber fitoreje.³⁵

Përfundimi që i jep Shaban Shala ëndrrës së tij është përrallor për nga arketipi, por një alegori lehtë e dekodueshme.

Alegoria si maskim. Shkrimi i poezive në formë të letrave nga burgu, ose më drejt maskimi i poezive, është një shfaqje e njohur në këto letra. Pjetër Arbnori kishte shkruar më larg me maskimin e letërsisë së vërtetë origjinale: ai e shkroi romanin *Brajtoni, një vetëtimë e largët* në Burgun e Burrelit më 1965, botuar në 2000, duke e shpërfytyruar tërësisht botën e romanit të tij: ngjarjen, personazhet dhe kohën e romanit i vendosi në Irlandë e në Angli, në vend të emrit të vet romanit i vuri emrin e një shkrimtari anglez, ndërsa gardianëve u thoshte se po përkthente një roman nga anglishtja në shqip. Jo vetëm me një, po me shumë vepra të tij kishte bërë kështu Arbnori.³⁶

Ngjashëm, shumë letra nga burgu nisin me paragrafin e parë të zakonshëm, përshëndetës, për të vazhduar pastaj me vargje poezie, por të shtruuara si proze (në dukje si letër nga burgu), apo duke vazhduar si ese, tregim ose një zhanër tjetër, por gjithnjë e maskuar si letër nga burgu.

³⁵ *Letra nga burgu/libër i censuruar*, 2004, f. 440-441.

³⁶ Anton Çefa, *Intervistë me shkrimtarin Pjetër Arbnori*,

http://albanovaonline.info/index2.php?option=com_content&do_pdf=1&id=238

5. Përfundime. Ligjërimi alegorik: art apo enigmë?

Më lartë e shtruar pyetjen nëse alegoria është figura dhe tipi i dëshiruar i ligjërimit, apo është figura dhe tipi i imponuar i ligjërimit? Në vazhdim mund ta shtrojmë pyetjen nëse ligjërimi alegorik, në të gjitha tipat e përkufizuar, ka shërbyer për të bartur një mesazh arti, ka shërbyer për efekte letrare, apo ka shërbyer për të fshehur e megjulluar, pra për të krijuar enigmën?

Kur Merxhan Avdyli e strukturon letrën e tij në atë mënyrë që duke mohuar pohon (psh.: unë nuk duhet ta them se kam qenë në vetmi...) dhe e ngre lart paradoksalitetin e këtij ligjërimit, sigurisht që shërbehet me alegorinë kryesisht për të krijuar shprehësi dhe efekte letrare. Por, kur Hydajet Hyseni i shkruan familjes që të thërrasin rininë e fshatit nëse duan ta ndihmojnë familjen ta prashitin misrin, sigurisht që kjo është një alegori e tipit enigmë. Nëse të rinjtë e fshatit do të vinin të organizuar të prashitnin arat e familjes së Hydajetit, mesazhi ishte se ata solidarizoheshin me ideologjinë dhe punën e tij, dhe e kundërta.

Ligjërimi alegorik në letrat nga burgu është një prej parimeve krijuese të këtyre teksteve. Ai është i thellë, i gjithanshëm, i ndërlikuar me tipa të tjerë të ligjërimit sa që shumë herë është vështirë të dallohet. Edhe lista e librave të lexuar, edhe lista e librave të kërkuar që t'u blihen, edhe përshkrimi më i thjeshtë i dhomës së burgut, ka efekte alegorike. Me këtë nuk duhet të kuptohet assesi se alegoria mbizotëron letrat nga burgu. Përkundrazi: shumë herë ligjërimi i letrave nga burgu është i hapur, referencial.

Nuk ka edhe një situatë tjetër kulturore, intelektuale e sociale në Kosovën e asaj kohe, as në hapësirat shqiptare të asaj kohe, nuk ka tekste të shkruara shqip në të cilat është folur aq hapur, aq me guxim (edhe me alegori) për zhvillimet e vërteta kulturore, politike, gjuhësore, sociale dhe etike, sidomos të shoqërisë shqiptare, por edhe më gjerë. Këto letra nga burgu janë përmendorja më e pastër e mendimit të guximshëm shqiptarë në dy dekadat e fundit diktatoriale të shekullit XX. Vetëm nga ky aspekt mund të kuptohet se sa të pa kënaqur kanë qenë të burgosurit politikë shqiptarë, autorë të letrave nga burgu dhe të një entiteti shumë më të gjerë

letrar, me gjithë atë që është shkruar në atë kohë në shqip, në media e pjesërisht edhe në letërsi. Vetëm duke pasur parasysh kuptimet, temat, alegoritë e deri te teksti referencial, pra i zhveshur e i hapur fare, i letrave nga burgu, të cilat kanë kaluar nëpër censurë zyrtare të shtetit jugosllav, mund të kuptohet dëshpërimi i Basri Musmuratit kur thotë:

“...kalemxhinjtë tanë, atje në Kosovë, i shkruan dhe po i shkruajnë himne gjithkujt, por jo edhe vetvetes. Më bëhet sikur kanë vdekur në këtë drejtim, po mos të lexoja ndonjë intervistë në gazeta të vetëm një akademiku tonë apo edhe të ndonjë gazetari.”³⁷

Pikërisht te ky fakt mund ta mbështesim pohimin tonë se krahas nevojës për fshehjen e mendimit për shkak të censurës, ligjërimi alegorik është përdorur, kryesisht për efekte letrare. Nëse në shumë pjesë të tekstit hasim paragrafë të tërë në të cilët shprehen hapur koncepte politike të dënueshme nga shteti, dhe të cilat censorët i kanë lexuar, pse atëherë në disa pjesë të tjera të tekstit mendimet shprehen me alegori? Përgjigjen duhet kërkuar te arti i këtyre letrave. Pra, nuk ka qenë qëllimi final i autorëve të letrave nga burgu fshehja a kamuflimi i mendimeve të tyre të vërteta, sepse ata jo vetëm për veten e tyre, por kërkojnë edhe më shumë, që edhe të tjerët t'i shfaqin më hapur mendimet e tyre. Pikërisht kur flasin për tema politike, e të cilat kanë qenë cak i fokusuar i censorëve, në letrat nga burgu flitet më hapur, ndërsa kur flasin për tema të tjera, shpesh herë personale, si dashuria, aty përdoret alegoria. Alegoria e imponuar është një formë e ekzistimit të këtyre teksteve, por në pjesën më të madhe alegoria është e dëshiruar nga autorët e tyre dhe këto tekste jetojnë si alegori letrare. Pothuajse të gjitha modelet e alegorisë në këto tekste, si alegoria e funksionit fatik, alegoria e intertekstualitetit, alegoria përmes humorit, alegoria përmes natyrës animale, alegori pothuajse e zhveshur politike, ligjërimi personal si alegori e ligjëritimit publik, ligjërimi personal si alegori e ligjëritimit filozofik, alegoria nxitëse personale-publike, alegoria si ironi dhe alegoria si ëndërr, ligjërimi alegorik përdoret si kusht letrar e estetik i gjuhës, e jo vetëm si kusht ekzistencial. Përfundimisht, ligjërimi alegorik në këto letra fermenton tekstin me funksionin estetik të gjuhës dhe duhet të trajtohet nga historianët e letërsisë.

³⁷ *Letra nga burgu/libër i censuruar*, 2004, f. 109.

Bibliografia e cituar:

- Çefa, Anton, *Intervistë me shkrimtarin Pjetër Arbnori*,
http://albanovaonline.info/index2.php?option=com_content&do_pdf=1&id=238
- Dreshaj-Baliu, Myrvete, “Vepra shkencore e Bajram Kosumit”, Kumtesë e mbajtur në
 aktivitetin e ARS Clubit “Vjeshta letrare e Gjilanit”.
<http://www.rajonipress.com/shfleto-artikujt.php?id=29958>
- Gjoka, Behar, “Letërsia nga burgu – gjurmimi i vlerave në këtë qark letrar”, <http://uni-gjilan.net/wp-content/uploads/2015/12/Behar-Gjoka.pdf>
- Hamm, SJ, Dennis, *Philippians, Colossians, Philemon*, Published by Baker Academic, 2013.
- Katnic-Bakarsic, Marina, *Stilistika*, Naucna i Univerzitetska Knjiga, Sarajevo, 2001.
- Kosumi, Bajram, “Ese për letërsinë epistolare nga burgu/libri i fitores mbi të keqen”,
 parathënie në librin *Letra nga burgu/libër i censuruar*, përgatitur për botim nga
 Merxhan Avdyli e Bajram Kosumi, Brezi '81, 2004.
- Kosumi, Bajram, “Letërsia nga burgu/çështje të identifikimit, të përkufizimit dhe të trajtimit
 të saj”, ligjëratë në Seminari i XXX Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe
 Kulturën Shqiptare, Prishtinë, më 15-27 Gusht 2011
- Kosumi, Bajram, *Letërsia nga burgu/kapitull më vete në letërsinë shqipe*, Botimet Toena,
 2006.
- Letra nga burgu/libër i censuruar*, përgatitur për botim nga Merxhan Avdyli e Bajram
 Kosumi, Brezi '81, 2004.
- Mercer Dictionary of the Bible*, by Watson E. Mills (Author, Editor), Edgar V. McKnight
 (Editor), Roger A. Bullard (Editor), Mercer University Press, 2001.
- Piegay-Gros, Natalie, *Poetika e intertekstualitetit*, Parnas, 2011.
- Taylor, Gene, *The Prison Epistles of the Apostle Paul/ Ephesians, Colossians, Philippians,
 Philemon*, <http://www.centervilleroad.com/>.
- Utlely, Bob, *Paul Bound, the Gospel Unbound: Letters from Prison (Colossians, Ephesians
 and Philemon, then later, Philippians)*, 1998. (përkthimi serbisht në:
www.Poslanice iz zatvora-Free BibleCommentary).

MATERIALE

Mehmet HALIMI, Prishtinë

KDU 811.18'282.3

VISARE LEKSIKORE NGA E FOLMJA E KARADAKUT

Studimi im monografik: “*E folmja e Karadakut*”, e botuar më 2008, është ndarë në dy pjesë: në *Fonetikë dhe në Morfologji*, në të cilën nuk është përfshirë leksiku i kësaj të folmeje. Mirëpo, kureshtja ime për të njohur më gjerësisht e më thellësisht këtë të folme shtrihet përtej studimeve të fenomeneve fonetike dhe trajtave morfologjike. Këtë herë interesin tim e kam pe kam përqendruar në njohjen, mbledhjen e sistemit të leksikut, llojet e fjalëformimit si dhe toponimet dhe tipat e formimit të tyre në të folmen e Karadakut.

Materiali që po paraqesim është shënuar gjatë ekspeditave individuale dhe ekipore në kuadër të kërkimeve dialektologjike e leksikologjike të organizuara nga Instituti Albanologjik i Prishtinës.

Meqenëse treva e Karadakut është kryesisht vis malor, ajo është e pasur me leksik nga sfera e blegtorisë, pylltarisë e pemëtarisë dhe zejeve të ndryshme popullore, që ushtrohen nga zejtarët e kësaj zone, si ato të përpunimit të drurit, përpunimit të leshit, të qumshtit, të pemëve dhe llojet e tyre të nduarnduarta.

Në leksikun e kësaj të folmeje ndeshim mjaft orientalizma (persizma, arabizma e turcizma) dhe sllavizma, kryesisht terminologji të administratës serbe, por sllavizma ndeshim edhe në bujqësi e në pasuri pronësore.

Ka shumë fjalë, që janë specifike vetëm për këtë të folme, që mungojnë në të folmet tjera, i mungojnë falorit të gjuhës shqipe.

Leksiku që kam vjelë vjen nga e folmja e Karadakut verilindor, që ngërthen mbi 40 (dyzet) fshatra të komunave: *Viti, Gjilan, Preshevë dhe Bujanoc*, e që dallon nga shqiptimi i së folmes së Karadakut

jugperëndimor, që ngërthen fshatrat e këtij areali që bëjnë pjesë në ko-

Agërshak-i, m.sh. -a, -at.:(Krd).	Copë e rrumbullakët, zakonishte prej argjili, që i vihet boshtit në fund kur gratë tjjerratore tjjerrin lesh.
Allgje:ah-a, f.sh. -a, -at.	Lopë e kuqe, dhi e kuqe.Përdoret edhe kalin Allxh-i, e kaun Allxhoj.
allta:an-a, f.sh. -a, -at.	Lopë e kuqe, lopë me lesh bojëgjake.
Amle psth. (St.P.),	mëshoj, bjeri: <i>arapi i tha djalit amle!</i> Arapi i tha djalit bjeri !
Arani:-a, f.sh. -a, -at (St.E.)	1.Shpellë, gropë e thellë; 2.Enë, kazan i vogël për ushqim.
Ashusoj fol. (St.E.)	Kur njeriu mundohet të shpreh një mendim me një fjalë të veçantë, por nuk e gjen dot, apo nuk i bie ndërmend thuhet: <i>po ashusoj</i> .
Avli:-a, f.sh. -a, -at (St.E.)	1. Avlli; gardh: <i>avli naper</i> , gardh që thuret me katër thupra; <i>Gardh bistek</i> ose <i>gardh kunur</i> , me povoja të trashë katër thuprash.

munat: *Kaçanik, Shkup e Kumanovë*.

A

B

baballak-i, m.	pronë e trashëguar nga bashkësia patriarkale: <i>ket pasuni e kam pi baballakit</i>
babaplak (St.P.)	bablok-i, gjysh-i, babgjysh-i.
baç-i, m.sh. -a, -at (St.E.)	1.Ushkur i brekëve, një lloj shiriti i leshtë ose i pampukët, që shërben si përforcim i brekëve për trupi; 2.Për të lidhur foshnjen për djepi, që i thonë edhe <i>l u l a k: thmi: i vogël lulak</i> .
baçi:c-a, f.sh.	-a, -at (Krd.), gruaja që merret me përpunimin e leshit e të bulmetit: kos, djath, gjizë e gjalp.
bajrak/e-ja f. (St.P)	dhi me brirë të gjatë, e cila u prinë dhive të tjera të tufës.
ballti:-a, f.	sëpatë e vogël e me bisht të shkurtër.
balo:sh/e-ja, f. (St.E.)	dhi me larë të bardhë në ballë.
bar dale tf. (St.P.) Bot.	Bimë barishtore shumëvjeçare. Rritet në ahishta. Përmban në vete saponinën helmuese, glukosidet pandinë, acid limonik e malik, pektin, etj. Në mjekësi përdoret e gjithë bima.

bar dejz tf. (St. P.) Bot.	Bar dejç, gjethe delli, dejz; lapa dielli.
bar i shtri:m tf. Bot.	Një lloj bari që rritet i shtrirë për tokë, bar gjanë, këputje, bar paresh (BM).
bar koçedashi tf. (St. P.) Bot.	Bar i familjes së orkidaceve në ngjyrë trëndafili; lule salepi (<i>archis</i>), <i>bar qyqe</i> .
bar lithi tf. (St.P.) Bot.	bimë barishtore me kërcell të lartë e të degëzuar, me lule jargovani në të kuq; kinë e fushës, bar ethesh, kantarion, kantalion, bimë mjekësore.
bar matergoni tf. (St. P.) Bot.	Bimë e familjeve të solanaceve, e cila rritet në vende të papunuara, në shkurre e gërmadha; bar i trashë. Në mjekësinë popullore përdoret si sedativ qetësues, antispazmatik, kundër astmës e kundër dhimbjeve të dhëmbëve.
bar sahati tf. (St. P.), Bot.	Bar i familjes së gjunjëzorëve, që rritet në ranishtat bregdetare. Në mjekësinë popullore përdoret në formë infuzioni kundër shumë sëmundjeve, sidomos kundër reumatizmit. Ndërsa i tharë pihet si duhan kundër astmës bronkiale. Bar dejz, bar dreri, gjunjëz, kripa, nënshtull qirith, kren lepuri, bar ngjitës (BM) (<i>Ephedra disi tachya</i>)
bar shite tf. (St.P.) Bot.	Bimë helmuese nga familja e liliaceve. Në mjekësi përdoret si rrudhës i lehtë. Tërheq bletët; poligonatë mjekësore (BE); bar shite (FB); rejçë e zogjve, bar thekmi, bar thekuri, bar pate, bar gjanë (BM) (<i>Poligonatum officinale</i>).
bar stenicash tf. (St. P.)	bimë njëvjeçare ; rritet në djerrina dhe në ara të mbjella. Në mjekësi përdoret kundër astmës, neuralgjisë, reumatizmit e shumë sëmundjeve të tjera.
bar tufak tf. (Dun.),	bot. Një lloj bari që është shumë i imët dhe tufa-tufa. Rritet nëpër livadhe. Kafshët nuk e hanë; bar ethesh, kinë fushe, kantarion (BM) (<i>Centarium umbellatum</i>).
bar turreci, tf. (St.P.)	Bot. Ka formë të bishtit të dhelpërës e me vija gishta-gishta; Rritet në livadhe e në tokë të freskëta, pungacë, pungaca e livadheve (BE) (<i>Alo pecurus pratensis</i>), por del edhe nëpër grunaja , e pëprzihet me grurë, ndaj buka del e zezë.
bar uji tf. (St.P.)	bimë barishtore njëvjeçare, rritet në vende me lagështi. Ka erë të rëndë e me gjethe të gjata . Në mjekësi farat e tij përdoren kundër të ftohurit, gurëve në veshka, kundër urinimit, diaresë, por edhe si ushqim për shpezët . Kokërrajë mjekësore, barujthi (BE); (<i>Lethos pumum</i>)

- officinale*); *ricin*, *bar ujthi*; *metik*, *rriqëm (FB) (Ricinus L.)*
bari thyem tf. (St.P.) bot. Bar tamli, lulequmshtore, qumshtore, lule gomari, lule dylli, rryell (FGJSH) (Euphorbia)
bashkru:shk-a, f.sh. -a, -at. Dele me kurriz të lakuar.
bele:shk-a, f.sh. -a, -at. Dele me kurriz të lakuar.
bërda:ank-a, f.sh. -a, -at. Lloj pushke e shkurtër.
besharet-i, m.sh. -a, -at (Krd). 1.Shpif, që vihet nëpër ara për t'i trembur shpendët për të mos bërë dëm në të mbjella. Njeri i shëmtuar nga pamja; 3.Artist popullor: *Ish ba besharet e lujke si arushë*, humorist.
bishtavel-i, m.sh. -a, -at, *njeri që i bëhet bisht dikuj* dhe i shkon prapa ose grua bishtavele. Khs. me *stërshel e stëshele*: M' u ka ba stërshel, M' u ka ba bifton. (Në Opojë *bithok*).
bishtga:t, mb. *dash bishtga:t*, dash me brirë të medhenj e me bisht të gjatë.
bishtkaçub, mb. (St.P.) *dash bishtkaçub*, dash i bardhë me bisht të gjatë, e në fund të bishtit ka një xhufkë në formë kaçube.
bokëz-a, f.sh. -a enë në të cilën mbahet kripa; boskë, kripës, kripsnik, kripanik.
bre:n-a f.sh. (St. E dhe St. P.) 1.**brenë, trinë, vllaçë**, 2.shkop i gjatë dhe i trashë. 3.ndëshkim, shuplakë e madhe (shih te Gazulli).
bre:shk-a, f. sh. -a, -at (St.E) gjedhi me fytyrë të bardhë: **mushtjerr e balme**
brigjanë mb. *dash brigjanë*, dash me brirë të gjerë
brihapët, mb. Dash ose dhi me shpinë e gjoks të gjerë dhe me brirë të hapët., *Dash brihapët (brinahapt)*
briholl, mb. *dash briholl*, me brirë të hollë.
brikulaç mb. (St.P.) dash që i ka brirët si rrotë të rumbullakët, e kemi ndeshur edhe *Dash kotllaz, me brirë të lakuar kolar*.
brus-i, m.sh. -a, -at (Krd.) 1.Grihë, rrasë, që shërben për të mprehur kosën. Fig. *Nuk shkon kosa pa rrasë, nuk pren pa e mprehur*, por edhe pa ngrënë mirë.Fjalë që ka dy kyptime homonimike.Një kosëtar paguhet sa dy korrëtar, *Ni kosaç ka vlerë sa dy korra:ç*.
buhaf (i, e) mb. Njeri, burrë a grua me shëndet jo të mirë, me fytyrë të fryrë e të zverdhur: *Ish buhav ftyres*, burrë i buhaf;grue e buhaf.

buhet (dbuhet) fol.	(Stç.) buhet (ndiqet) pela, bushtra, ulkoja, etj.
bunak-i, m.	sh. <i>buna:k</i> , (God.) drutë që kufizojnë vatrën, oxhakun e odave.
bungur-i, m. (St.P.)	ballgur, grurë i bluar trash.
buxhill-i, m.sh. – a, -at (Krd.)	1.Ujë i fjetur, ujë amull, i papastër, pus me ujë të ndotur. Përdoret në fj.urtë: <i>Lavdin n'qjiell, e vet n' buxhill.</i>

C

cabig-u, m.sh. – a, -at (Zheg.)	pjesa e drurit të prerë , që mbetet në tokë si <i>cumrak</i> .
cangël ndf.	Me ngritur diç pezull: <i>Maca i kish marrë thmit e vet cangël.</i>
ce:k-e, mb.	Tokë ceke, tokë e ligë, jopjellore. <i>Kjo toka jonë është ceke.</i>
cicel mb.	ushqim tepër i tharbët. Kos i tharbët <i>cicel</i> .
cirilong mb.	Gjellë e hollë e pa shije, njëfarë gjelle cirilong.
cumrak-i, m. sh. -a, -at,	pjesa e drurit të prerë e pa degë: <i>Ish metë cumrak pa teshë n'trup, mish n'helli.</i> I palëvizshëm.
curr-i mb.	Njeri me vesh të vegjël; <i>Çaj njeri i kish vesht curr; 2. Curr/e-ja, delja Curre; curran-i, dashi curran</i> , me vesh të vegjël
currik psth.	I thuhet kalit kur e ngjesim në qerre: <i>currik!</i> eja prapa; fig. Ndalu ose prapakthehu.!

Ç

çakrraisem fol. (St. E.)	mërzitem, nevrikosem: <i>Ish çakrrais e nuk dike as çka flet.</i>
çy:k-a, f.sh. -a, -at	çyka e sakicës ose e shatit, ana e kundërt e tehut; Përdoret edhe si mbiemër: Sakica koka ba çykë, e nuk po prejka hiç, është topitur (është t'humue në Tërrnoc). 2. E ka menen çykë; është kokëtrashë; është këmbëngulës e nuk lshon pë hiç.
çyrik-a, f.sh. -a, -at	me të meta fizike: <i>Ish njeri çyrik e kanë lshue pej ushtrie si njeri çyrik.</i>

D

ditue (me), fol.	Me kalue ditën, duke ndenjur: <i>Ktyniher çikat shkojshin te krojet me mushë ujë, e shpesh herë aty</i>
-------------------------	---

i zatetshin kaçakët tuj ditue.

dorëz-a, f.sh. -a, at.

1. dorëz gruri i korrur në arë: *dorëza-dorëza bahet duej*. Analog me: *fije-fije bari bahet mullari*, apo; *pika-pika bahet pusi*; 2. Dorëz, i thonë edhe dorëzës së parmendës, dorëzës së derës, por që ka përnduar në: *rezë-a (nga dorëzë=rézë)*

DH

dh-i, m.sh. -t. (St. E.)

1. dhëmbi i njeriut; 2. dhëmbi i shpatës së vekut, i bërë prej drurit të thanës, ku përshkohen (enden) fijet e tjerrit të pëlhurës. **Shënim:** *tre dham bajn nji t'thazhme, dhetë t'thazhme ni krye, ni shpatë e qilimave ka dhetë krena.*

F

firade mb.

I tregoi firade, hollësisht, saktësisht, fill e për për:
Kallxojke firade-firade krejt qysh â konë.

fushnjan-e, -ja, f.sh. -e, et;

fushare, grua e fushës (Shurdhan); rrafshalike (Gollaku).

fushnjan-i, m.sh. -ë, -ët;

banor i fushës; fushar, rrafshali (Gollaku); fusharak (FGJSH).

fshisatore-ja, f.sh. -e, -et. (Zheg.)

grua e cila fshinë e pastron shtëpinë, që e ka rendin e fshisë në një familje të madhe patriarkale. **Shënim:** *Në familjet e mëdha patriarkale gratë i ndanin punët: magjetore, fshisatore, nihmatore, rangatore, javatore, plehatore, ujatore, vekatore, enatore, etj.*

frigar, -e, mb. (St. E.),

frikacak-e, që ka frikë, tutës; tuc, tuce, ku *ts=c*, sikurse *tsh=ç*

flukem, fol.,

i vihëm dikujt pas, vrapoj, turrem: *flukju n'mujsh me nxanë!*

fluçk/ë-a f.

djath sapo i zënë, pa kripë, pshere.

fit-i, m.sh. -tme, -tmet;

fitme, grindje, përçarje, i ka hî fiti, u ka hi përçarja: *Me fitme e nerskamca nuk shkohet përpara; me fitme nuk mahet shpia.*

filzi-ezë, mb.

Shpirtkeq, shpirtkeqe; filzi, filzezë: *çfarë fili kemi - tepër mirë jemi.*

filkeq-i mb.	Njeri shpirtkeq, zemërlig, shpirtzi, që nuk ia do të mirën askujt.
fijon (po.) fol.	Po bie borë fije-fije: <i>Po fijon</i> kur bie bora me fërflazë.
fija:t (po.) fol.	<i>Po fija:t bora, po bje me meça:v</i> , me fërflazë, borë imë e me erë si miell.
gravani:c¹ -a, f.	kunj i bigës së qerres, ku vihet zgjedha (Zheg.), është një metatezë e fjalës gravanicë, që e ndeshim në të folmen e Moravës së Epërme. (Shurdhan), gëzhojë e vesë: <i>gozhitlat e voes, të arrës</i> .
gozhit/ël - a, f.sh. -la, -lat	
gërsha:n/-t, f.sh. -ë, -ët (St. E.)	Pjesët e drunjtat të qerres, që lidhen me bishtin; kërrabë, kraca (nga krahës-a = krahca = kraca), nersjetlla (M.E.), gërshanëz.
gozhdare ndf. (Zhegër)	<i>meta gozhdare (meta godare - Drenicë), mbeta pykë, pisk, mbeta ngusht</i> .
gardh lepurisht tf. (St. E.),	Gardh i arave ose i oborrit, por që thuret shumë thjesht, me nga dy thupra rendi (povoji), gardh i rrallë, e jo gardh bistek ose gardh kunur .
gllavi:n-a, f.sh. -a, -at (Krd.)	Pjesë e rrotës së qerrës së drunjt, ku vihet spicat, që lidhin gobelen me gllavinën (me bucelën).
gurgac mb.	gur gurgac, që duket sikur flakon. Përdoret për të ndezur eshkën me unuer, brincë, <i>gur brincak</i> (Krd.).
gajta:n-e, -ja f.	dhi e zezë, që e ka leshin vija-vija të zeza si fije gajtani. (St.P.).
gërre:ll-a, f.sh. -a, -at,	Vend me gropa të gërryera nga uji, gërrella të thata nëpër të cilat vështirë kalohet, ndaj kafshët shpesh i thyejnë këmbët.
gjerda:nk-a, f.sh. -a, -at,	dele e zezë me qafë të bardhë: <i>I thojmë gjerda:nk</i> (St. P.).

H

¹ Fjalën *gravanicë*, të cilën e ndeshim në fshatin Zhegër, nuk është tipike për krejt Karadakun, ajo është karakteristikë vetëm për Zhegërën, që është një metatezë e *gavranicë*.

Mbase nga fjala *gavër-gavra*, që i përket leksikut të pasivizuar, por duke marrë prapashitesën sllave - *nicë* u përfutua fjala *gavranicë-a*, që ka shtrirje në tërë Karadakun, në Moravën e Epërme dhe Moravën e Poshtme e më gjerë.

hatëll-hatlla, f.sh. -a, -at,

dru i gdhendur katërkëndësh, që vihet në mur për të përforcuar murin në mungesë të armaturës së hekurit.

hana e re tf.

Hana në të sosur, kur ajo paraqitet si hark, si pë. Kush e sheh i pari e përshëndet me këto fjalë: *Hana re, hana re/ ti si pë unë si drë/ ti hanatare, unë me pare/ ti hantore, unë punëtare!* (St. E.).

hjeksi-i, m.sh. -a, -at.

1. Vegël prej hekuri, që shërben për t'i gdhendur e lëmuar drunjt, zakonisht bishtat e sakicës, të shatit, të kazmës e të lopatës; 2. Kjo fjalë përdoret edhe me kuptim: *hjeksi e ka hjeksiue; kallauz, spiun*; 3. Në kompozitë merr tjetër kuptim: *udhëhjekës, udhëheqës, prijës, që udhëheq turmën, popullin.*

hudër e egër tf.

L.Bot. hutra, hudhër e egër (*Allium aleraceum*).

I

iftijaç mb.

Njeri iftijaç, diku edhe miftijaç, nevojar i madh, që ka nevojë për gjëra elementare; iftijaçli, skamnor, nevojar për çdo gjë: Puno, emos u ban sadaka iftijaç (miftijaç) i kurkujt!

iftire-ja, f. sh. -e, -et.

Shpifje. Kur të fajësojnë me gjëra të pabëra: *t'pabame e t'pakujtueme. S'ka sen ma i ranë se iftirja* (Krd.).

imshti-a, f.sh. -i, -it.

Fëmijë të vegjël, që kanë ende nevojë për kujdesin e prindëve: *I ka ni pllug thmi imshti, sun po ndel kurkun ner shoqe.*

imshta:j-a, f.sh. -a, -at.

Imshtë, mal i vogël, çufrajë, mal kaçubash: *Hala s'â rritë mali, hala âsht imshtajë.*

ilgji:n/a, f.sh. -a, -

Bot. Lloj bari, farat e të cilit përzihen me grurë (Zheg.). Elgjinë (M.E.).

J

janxhik-i, m.sh. -a, -at.

Torbë prej lëkure të regjur të edhit ose të qengjit, tarçuk, i cili u shërben barinjve ose udhëtarëve për të ruajtur dhe bartur ushqimin ditor.

japa:nxh-a, f.sh. -a, -at.

Lloj veshje si kaput, e bërë me lesh, e veshur me pëlhur dhe e therur si jargon, e gjatë deri nën gjunj: *Mali asht japanxha e fukarasë, do të thotë ai që nuk ka japanxhë të mbrohet nga era e ftohtë, mali është shtruhër dhe mburojë*

për të.

jezerçe mb.

Mollë jezerçe (St. E.), lloj molle e madhe, e rrumbullakët; e thartë dhe si e vrugët (zijoshe) e me shije majhoshe.

K

kast ndf.

Punë e bërë me qëllim, apostafat, kastile: *Ma bani me kast*, me qëllim; *Po punon me kast*, me tendencë: *Ka vnu kast me m'ngelë n'klasë*.

kotlla:jk -a, f.sh. -a, -at.

Enë prej dheu të botës (argjilit), e cila shërben për të bartur bylmet (kumsht, kos, dhallë e tamël) argatëve në fushë. Në Moravën e Epërme e ndeshim me trajtën: *katlanicë*, e nëse në të mbahet peshkëve, katran, i thonë edhe: *katranicë*.

kumsht-i m.

1. Hirrë, që pihet në vend të qumshtit, lëng djathi. Fj. urt.: *Kur t'shkon djathi, le t'shkon edhe hirra* 2. *I ka hi hirra; ka marrë hirrë*, ka zënë m'u prishë diç, 3. E ka kap sëmundja

krahnez-i, m.

Kanë vnu pemët ose drunjt krahnez, ndeshin edhe sinonimet: *shtrez, kaprroz*. *I kishin vnu musteqet krahnez, kaprroz* (Tanishec).

kata:n-a, f.

lopë e mirë, e madhe dhe hjeshme.

kamanoz/e-ja f.

dele me këmbë të gjata. Kamanoz i thonë edhe njeriut këmbëgjatë dhe që ecë shumë, njeri maraton.

kaçadre:nk-a, f.

dhi ose lopë që ka brirët të kthyer përpjetë si krroçe, *kaprrece*.

kërcëllon fol.

1. Me i kërcëllue dhëmbët, me gëlltitë diç me dhëmbë kërcërcë. Po kërcëllon buka, drithi është bluar pas cokatjes së gurit të mullirit, ndaj grimcat e gurit janë përzer me miell (Zheg.).

katub-i, m.sh. -a, -at (St. E.)

boçë e misrit pa kokrra, të cilat i përdorin për t'i djegur.

katrrithem fol.

Ngjitem përpjetë ndonjë druri a lisi, katrrizem. *Me u katrrith kodrës përpjetë*, por *katrrizem lisit*.

katrapit ndf.

1. Katrapihas, rrëmujë; bje katrapit-bie kryengulthi: *Kur t'vjen deka s'ka kvit-katrapit*, shpirtin ki me dorëzue. (Lug.)

katrani:c -a, f.sh. -a, -at,

enë ku ruhet katrani, në formë të katlanicës, por pa vegë e me grykë të ngushtë.

kastis (me.) fol.

1. Me ia ulë fitilin llampës së vajgurit që të mos bëjë dritë shumë dhe të mos harxhojë vajguri shumë: *Kastise llamën*

- mos t'harxhohet gaz shumë; 2. Kali kastis me kam; çukërmon. 3. Rueju se po kastis plumi! Kur shtie njeriu me revole apo me pushkë.*
- kasak-i, m.sh. -a, -at (Zheg.)**
kapuçaz ndf. (Dun.)
 1. Lloj loje. Loja kapuçaz, e cila luhet në fushë, kur i mshojnë plisit me këmbë.
- kaprroz-i, mb.**
 1. Burrë i fortë e i pashëm me mustaqe të mëdha e të dredhura për anash: *Idriz Seferi i kish musteqet kaprroz; 2. kaprroç (FGJSH); 3. Krahnez (M.E.);* borë e imët, akull i ngrirë në fije të holla.
- kopçë-a f.sh. -a, -at (Zheg.),**
kanarçe mb.
 monedhë turke, që përdorej për stolisje.
- kamanoze mb.**
 Dardhë kanarçe (St.E.), lloj dardhe e madhe dhe e gjatë si boça e kanarit.
- kalakryq ndf.**
Dele kamanoze, dele me këmbë të gjata, edhe dash kamanoz; kacagele (Opojë); Kumanece (Tanishec).
- kallamoçisht/ë -a f.sh. -a, -at.**
 1.1 *rashë Karadakit kalakryq, kryq e tërthuer; 2. sende të vëna pa rregull dosido, drutë qiten në vatër kalakryq.*
- kaçarremk/ë, -a, f.sh. -a, -at;**
 1. *Ara e mbjell me misër. 2. Tallishtë, hamulllore.*
- kosobáš-i, m.sh. -a, -at;**
 Shkop me krryl, kërrutë, krroçe, dëgjohej edhe me g: *gaxharremkë-a.*
- kosobáš-i, m.sh. -a, -at;**
 kosëtari që u prinë kosëtarëve të tjerë, sikurse renatari i prashtarëve. Në këtë trevë dëgjohej fjala kosaç - kosaçë: Ni kosaç ban sa dy korra:ç, do të thotë edhe punë bënë edhe vlen sa dy korretar.
- korraç-i, m.sh. -ë, -ët,**
kopërdhe:c (m'u) fol.
 korrës, korretarë.
- kopërc-e, mb.**
 Zgurdulloj sytë nga të ftohtit: *Jam kopërdhe:c, jam shtangur, jam ngrirë nga të ftohtit.*
- kokrrosh-e mb. Fig.**
 Fizikisht i fortë, thuhet për pleqtë: *Kopërça i plak nuk po i dorëzohet pleqnisë, por po qëndron i fortë.*
- kimon (po.), fol.**
 Djalë i shëndosh, *E kish ni djalë kokrrosh, të shëndosh si molla. Si ndajfolje: Ish veshë kokrrosh, ish veshë mirë e me shije, ishte zbukurua.*
- kërçel/e-ja f.sh. -e, et.**
 Po bie borë nga pak fije-fije: *Po kimon bora, po qëmton.*
- (Magjere-Karadak)** 'vllag, saj për të bartur dru. Përdoret edhe si mbiemër: *E kish ba kamën kërçeje, e ngrehke zhag*

- si kërçele*, e kishte thyer këmbën.
- kazdis (me) fol.** Çukërmon: *Kali kazdi:s me kamë t'para*; 2. *Me kazdis plumi*, m'u kthye prapa, mund të jetë tragjik.
- kuqevi:sht-a, f. (St. P.)** 1. Lloj qershie që piqet heret, nga më të parat, në gjysmën e parë të qershorit, janë të kuqe dhe të ëmbla, e shumë të shijshme.
- kurthuroj, fol.** 1. ngatërroj fillin e një pune: *M'i kurthuroj punët*. M'i ngatërroj punët.
- kullo:sh-a, f.sh. -a, f.sh. -a, -at** (St. E.). **Dhi** e kullme, që e ka leshin e bojëkaft.
- kulaçe mb. (St.P.)** 1. Lloj dardhe ose molle shpatuke në formë kulaçi: *mollë kulaçe*.
- kraho:sh/e f.sh. -e, -et (St.E.)** 1. Krahoshë - dhi e zezë e vija-vija.
- kubrrri:c-a, f.sh. -a, -at (St.E.)** 1. Lis zgor, ku lihej drithi e pasuli. Pra, lisi zgor i prerë, që shërbente në vent të tinarit apo fuçisë së drunjt.
- kallauz-i, m.sh. -a, -at.** 1. Njeri që i prinë dikuj; udhërrëfyes, spiun. Fj.urt. *Katuni qi doket kallauz nuk do*.
- kaprrec/e-ja, f.sh. -e, -et (St.E.)** 1. Dhi me brirë të gjatë e të drejtë thik përpjetë.
- krye-kreni, sh. -a, -at. (St.E.)** 1. Njësi e tjerit prej tridhetë fijeve, që bëjnë një krye, apo *dhetë t'thazhme nga tri fije përbëjnë një kren*. 2. Kren-ët, pleqnarë, pajtimtarë, që shumësin e bëjnë edhe: *krentarë*.
- kaptyll-i, m.sh. -a, -at (St.E.)** 1. Pjesa e lakuar në formë gjysmë rrethore, harkore, e djepit të drunjt të foshnjes: *Ahri pa vjeta e shpia pa djepa nuk shtohen*.
- kryeshneik mb.** 1. Njeri kryemadh: *E kish kryet e madh sa ni shneik*.

L

- lyfty:r-a, f.sh. -a, -at;** lidhëse e bërë me kashtë thekre, që shërben për të lidhur duajt (e grurit, të elbit, të tërshërës apo të misrit) të korrur me drapër, në disa treva të Kosovës (Llap) *liktyrë-a*, (nga *ligatura*), *lidhnje*, etj.
- lme:z-a, f.sh. -a, -at;** fshesë nga degë druri të shkozës ose dushkut; rrametë, që shërben për t'ia vënë mullarëve të sanës a të kashtës për të mos i shpërndarë era. Figurativisht: *Kësaj pune duhet me ia vnue lmeztë; m'i vënë maje, m'i gjetë zgjidhje*.

li:sk² -a, f.	i thonë deles tërësisht të bardhë, por që ka disa pika të kuqe fytyrës e këmbëve. Në Moravën e Epërme <i>Zhujkë-a</i> .
luleshpatëz³ -a, f.sh. -a, -at	(St.P.), lule e kuqe, shpatëz e kuqe.
lo:tk-a f.sh. -a, -at,	dele me pika të zeza rreth syve e që duket sikur i lotojnë sytë.
lenik-i, m.sh. -ë, -ët (Dun.)	1. Lisnik, mullar dushku; 2. vend i rrethuar me gardh, ku ruhet ushqimi i kafshëve shtëpiake, diku i vendosin edhe kosheret e bletëve.
lipisk-i, m.sh. -ë, -ët (Krd.),	njeri servil, dallkauk, lëvyrës e çanaklëpirës (lipi:sk-a, f.).
larç-i m. (St.E.)	<i>cjap i larm.</i>
lik-i, (3) m.sh. -liq, -liqt (St.E.)	<i>liki i vekit (sh. Liqt e vekit)</i> , ku kalojnë fjetet e tymnit, i cili nga shuli i mbramë lidhet me shulin e parë.
lito⁴ ndf. (St.E.)	pëlhurë e bërë me një palë liq, e hollë dhe e rrallë: <i>I ka punët lito</i> , i ka punët hollë, është takat-hollë ekonomikisht, nga lik=lito, kalimi i k=t, (Si krevet=krevet, kakurek=kakuret, çykë=çytë, zatek=zatetë, etj.)
larushkue (me), fol. (St.E.)	Me ba pëlhurë me lara: <i>E larushkon pëlhurën me lara</i> . Këtu, sh-ja është shtesë e emrit larë , larash, laryshi=larushkue, e nuk ka fare të bëjë me emrin e

² M.Halimi, Skicë e së folmes së fshatrave Mjak dhe Tanishec, në Kërkime dialektologjike, Prishtinë 1985, f.366. (Zgjerimi i fjalës *li-a* në sufiksin -sk dha li+sk=lisk. Krahajo me dash sysk, nga sy+sk=sysk ose delja sykë e syskë).

³ *Lulëshpatëz-a*, mbase sipas mendimit tim e heq zanafillën etimologjike nga deminutivi i emrit *shpatë-a*, dhe vërtetë gjethet e saj, janë të forta e të mprehta dhe kanë formën e shpatës, dhe po të mos jeshë i kujdesshëm mund të prejsh duart si me shpatë, në mënyrë të pahetueshme do të shohësh gjakun duke rrjedh nga dora jote.

⁴ Fjala *lito* vjen nga fjala *lik*, alternimin e k-së në t e ndeshim shpesh jo vetëm ndër të folme dialektore, por edhe në gjuhën e shkruar. Si për shembull; *krevet=krevet; kakurek=kakuret; zatek=zatetë, çykë=çytë, etj.*

Vlen të theksojmë se në këtë të folme nuk ekziston njëjësi i fjalës *lik-u siç e ndeshim në të folmen e Llapi dhe të Vushtrisë: I ka dalë ni dham nerlik*, e cila u zgjerua edhe në gjuhën e shkrimit, si: *ndërlik-ndërlikoj-ndërlikim*, i ndërlikur që sot ëshë bërë produktive.

	barit ngjitës larushk-u, që rri gjithnjë i gjelbër, i cili u ngjitet lisave (Shih.: <i>Si larushku-dushkut, si samari-mushkut</i>).
lu:rk-a, f.sh. -a, -at (St.E.)	Veshje e ngjashme xhurdinë, por më tepër e bardhë.
leqe-t, mb.	1. Dredhi, me punue me leqe, me punue me hile: <i>Mos ban leqe, burrin nuk punon me leqe</i> ; 2. Leqe, shenja, njolla në rroba.

LL

lloçkovi:n-a, ndf.	Rrugë me baltë, vend me lloç, lloçovinë , khs, me shiovinë, kushovinë, etj.
llokopenër/-ra, -at (Krd.)	gjepura, dokrra: <i>Mos kallxo përralla llokopenra! Mos fol gjepura!</i>

M

molla miske tf. (St.P.)	Bot. Molla me lëvore të hollë; janë të verdha e kanë erë miske; molla malazeze, gjataruqe (Gazulli).
molla të brijthta tf. (St.E.)	Bot. Molla të kuqe, të tharbëta e të forta (<i>Molus acerbo</i>).
milla:j nf.	Borë e imë si mielli: <i>Po bje borë millajë, borë e imë sikur kur e sitë miellin, çasaj bore na i thojmë millajë</i> , që bje me fërflazë e me erë dhe formon smeta(pengesa), <i>fryjë-a</i> (Veleshtë - Maqedoni)
mazo:jk-a, f.sh., -a, -at (God.)	mëze, mazujkë (Begracë)
malu:ng-a, f.sh. -a, -at (St.E.),	maj, tokmak për rrafshimin dhe rrahjen, rrastimin e dheut. Përbëhet prej një cungu të madh dhe shkopit.
maxha:ark-a, f. (St.P.),	Lopë e kuqe.
ma:c⁵-a f.sh. -a, -at	(Zheg.) Spagë opingash, nga mathcë-a=ma(th)ca=maca.

⁵ Për fjalën *spagë* opingash ndeshim fjalën *macë-a*, nga fjala *mathca*, ku th-ja për arsye lehtëshqiptimi e bukurzanimi ka rënë, si te fjala *bithsht = bisht*.

mengez⁶ -i m.

Koha kur bariu i bie bagëtitë (delet, dhitë ose lopët) në drekë për pushim, aty rreth orës dhjetë, në stinën e verës: *Çobani i pruni dhët n'mengez*. Fjalë që i përket leksikut të pasivizuar. Sepse kjo fjalë nuk përdoret në leksikun aktiv, por vetëm si fjalë e rrallë, e dedikuar vetëm për këtë rast. Madje, në këtë të folme edhe fjala *bari-u* nuk përdoret në leksikun aktiv, ajo është mbuluar me fjalën *çoban-i*.

N**nerzgojz/ë -a, f.sh. -a, -at;**

zinxhir apo litar, një lloj freri (pengojcë), që u vihet kuajve nën nofullën e poshtme, në mënyrë që kur tërhiqet freri kjo i shtrengon dhe i detyron të ndalen: *Nuk u nalke se i kish dalë nerzgojza*. Në Rugovë e ndeshim edhe me emrin *pengojcë-a*.

P**pera:jk-a, f.sh. -a, -at.**

Vegël druri për t'i larë rrobat në lumë ose në govatë; lasë, lajse, por edhe rrehc-i.

pir-i, m.

njohje me temel e një zejeje: *Ja di pirin zanatit t'vet*; ia di mananë punës, nejtës e sefasë.

pilçik-i, m.sh.

pilçikë-pilçikt (St.E.) përçik, masë, hapësira ndërmjet gishtit të madh dhe gishtit tregues.

progon-i, m.sh. -a, -at (Zheg.)

1. Ara e mbjellë me duhan, ndahet në parcela më të vogla me qëllim lehtësimi për punë, kurse në Cernicë i thonë: *maternik-i*.

pikthaç-i, m.sh. -a, -at (Dun.)

zool. Picrrak, picirang (*Salamandra maculalo*).

pe:t-a, f.sh. -a, -at (Stç.)

1. Përpeç pa vezë, pite me petë më të trasha se pitja e rëndomtë, e bërë vetëm me harç: djath e kos apo droçka e gjizë.

⁶ Fjala *mëngez-i*, i përket leksikut të pasivizuar. Kjo fjalë në të folmen e përditshme nuk përdoret fare. Ajo përdoret vetëm e shtanguar, që shënon periudhën kohore aty rreth orës dhjetë, kur barinjtë i bijnë dhentë ose dhitë për pushim në drekë: *çobani i pruni dhët, dhitë në mëngez*, e nuk përdoret gjetiu. Ndërsa fjala *mëngjes-i* e *mirëmëngjes*, në këtë të folme kanë hyrë vonë nëpërmjet gjuhës letrare e arsimit të fëmijëve tanë në shkolla. Edhe fjala *bari-u*, që është e gurrës shqipe, në këtë të folme është zëvendësuar me fjalën *çoban-i*.

povoj-i, m.sh. -a, -at
(Krd.)

1. Një rend thuprash kur vihet në *gardhin naper* ose *gardh kunur*. 2. Fig. *Niher duhet me qitë ni povoj tani me punue*, duhet ngrënë, pastaj duhet vazhduar puna.

Q

qyme-qyme ndf.

grupe-grupe, turma-turma: *Shkojshin gjinja qyme-qyme*. (Stubëll).

qafëz-a, f.sh., -a, -at
(Krd.)

1. Pjesë e zgjedhës, pjesa e gdhendur në formë harku për të mos ia vrarë qafën kaut. 2. Gryka e çarapës, 3. Qafë mali, me të cilën ka plot toponime gjithandej viseve shqiptare.

R

repaca:ajk-a, f.sh. -a, -at
(St.E.)

Dele që i ka rënë leshi shpinës, duke hyrë nëpër therra i ka mbetë leshi në to, ndaj delet repacajka kanë më së paku lesh. Kur qethen delet, qethtari ka pak punë në to.

rabush-i, m.sh., -a, -at
(St.E.)

1. Druri ose shkopi i dhëmbëzuar, me të cilin shënohen zhgunat kur dërgohen me u shkalë në shkalëtore (valavicë, vajavicë ose dërstilë).

RR

rreknye (m'u), fol,

1. M'u rreknye, me u rrokullis me vështirësi të madhe në një vend të thepisur; 2. M'u rreknye diqysh, me gjallnue me vështirësi, me skamje të madhe.

rreknim ndf.

1. Vend i thepisur; tatëpjetë e madhe, e theksuar; 2. Vend, ku mund të praptohen lehtë qerret e drunjtat ose sajat: *Ish ni vend rreknim*.

rroka:t (m'u) fol.

1. Njeri nevrik, që nevrikoset për çdo gjë; 2. Njeri që është matufosë, e ka kapë edhe skleroza: *Asht rrokatë, asht hallakatë*, është çmend e nuk di çka flet.

rra:h-a, f.

1. Shteg, këmbësore: *Ka ra borë e madhe, po udhtart e kanë çelë rrahen (rrehen - Gollak)*. 2. Rraha e kresë: *Me da rrahen e flokëve*, m'i da flokët përmes kokës: *rraha e flokëve (rreja e flokëve - Gollak)*.

rrusfaj ndf.

1. *E bani rrusfaj; I foli e bani hor*; e kritikoi ashpër, e qortoi, ia tha troç të gjitha të metat e të gjitha gabimet.

rrah ndf.

Kur ndonjë sëmundje epidemike përfshinë të gjithë anëtarët e familjes, thuhet: *jena krejt familja t'smutë rrah*.

rush e kumlla

shprehje frazeologjike; 1. Shpenzim i tepërt; *I bani paret*

- rezëm-rrezmi** *rrush e kumlla*; i harxhoi vend e pa vend: *E shiti pasuninë e babës dhe i harxhoi paret e i bani rrush e kumlla.*
1. Gjendje ekonomike, themel; *Filani e ka rrezmin e fortë*; është në gjendje të mirë ekonomike, ka themel të pasur ekonomik.
- rzak-i, m.sh.** **-rrzeq, - rrzeqtë (St.P.)** 1. Dem i tredhur, por jo mirë, gjysmë i tredhur; *errzak-errza:k* (M.E.); *letrak-letreq* (Rrafshi i Dukagjinit).
- ro:z-a, f. (St.P.)** 1. Bot. rrodhëz, rodhe; rrogza (M.E.), rrozga, me trajtë metatetike (M.P.)
- rebçe mb.** 1. Dardhë rrebçe (St.P.), dardhë kanarçe, piqet vonë në vjeshtë.
- rahavend-i, m.sh. -e, et (Dun.)** 1. Rrah, vend i çelur e i bërë livadh.
- rokollaç ndf.** 1. Në formë të mbështjellur rrethore (Zheg.). *E pashë ni gjarpën ish ba rrokollaç; Ish mledh qeni katullaç* (M.E.), por edhe *kotërllaçë*.
- rokç ndf.** **Bylyzyk, rrokç dore** (hallhalle, rrathë dore prej ari).

S

- emt ndf.** 1. *I erdh n'semt; I erdh n'kuti, i ra për shtati*; vend strategjik.
- prihell-i, mb.** 1. Njeri i hollë e i gjatë dhe me hund të mprehtë, hunspreht, sprihell, njeri *me hun sprihell*.
- ofrabez-i, m.sh. -a, -at** 1. Lloj çarshafi që shtrohet nën sofër për të mos lejuar të shpërndahen thërmiat e bukës: *Ni herë shtrohet sofrabezi, tani shtrohet sofrë e bukës mbi të*.
- ingjinçe, mb.** 1. *Dardhë singjinçe* (St.P.), *dardhë e verdhë*, e vogël si dardha të egra.
- ildis (m'u), fol. (St.E.)** 1. Shndritë, shkëlqen një metal nga të ngrënët; 2. Fig. sildisem, matufosem: *Ish sildisë krejt e s'po dike gjâ* - ishte matufosur e s'po dinte asgjë.
- truka-t, f.sh. -a, -at (St.E.)** 1. Pelena, shpërngenjsh fëmijësh në djep.
- kurfillanëz-a, f.sh. -a, -at (Stç.)** 1. **zoologji:** mullenj (*Turdus merula*), *skurfillanzë*.

SH

- shke:k-a, f.sh. -a, -at** 1. Xhepat e tirqve, që nuk kanë fund. Nuk mund të shtiesh në ta asjë pos duarve kur duam m'i ngoh nga të ftohtit; 2. *Shkeka e nganit t'dreçit*; thuhet për ndonjë grua a vajzë e

- përdaltë, e pamoralshme.
- shushlak-i, m.** 1. Mbeturinat që mbesin pas qërimit (zhvoshjes) të misrit nga tramaku i mbështjellë me luspa, fletëza; 2. Byk sharre.
- shneik-i, m.sh. (St.E.)** 1. Masë drithi, që zë drith sa një teneqe; 2. Masë e tokës: *Ni shneik dhetë ari tokë apo 100 metra katror. Kryeshneik*, njeri kryemadh.
- she:k-a, f.sh. -a, -at (St.E.)** 1. Enë e drunjt, diç më e madhe se vedra, masë drithi, e ngjashme me shinikun.
- shinër-shinra, f.sh. -a, -at (St.E.)** 1. Shinra e vedrës, dorëza, kuu kapet vedra; 2. Shinrat e tavanit; shikulla-shiklla (Rrafshi i Dukagjinit).
- shkemëz-a, f.sh. -a, -at (St.E.)** 1. Një lloj druri gëmushor, ngjyrë portokalli.
- shkreh (m'u) fol.** (Terziaj) 1. *M'u shkreh drutë - m'u* djegë drutë në vatër, në oxhak ose në koftorr: *Bani mukajet zjermit se u shkrehën drutë*: u dogjën deri në fund, u bënë hi, e nuk mbeti asgjë prej tyre.
- shyto:sh-a f. (St.P.)** dhi pa brirë.
- shterpu:lk-a, f.sh. -a, -at** (St.E.), 1. Delja që s'pjellë kurrë i thonë shterpulkë. Fig. thuhet edhe për gratë beronja.
- sha:rk-a, f. (Stç.)** 1. Dele e larme; 2. Mantel prej leshi të bardhë, gëzof, guxhuf, flokatë (FGJSH).
- shasharke mb. (St.P.)** 1. Dardhë shasharke, një lloj dardhe me ngjyrë të verdhë e pak si e gjatë, ka shije të thartë, piqet në shtator. Emrin e ka marrë nga fshati **Shashar (Sasare)** me origjinë sase, ku kanë jetuar në mesjetë sasët, një fis gjerman).
- shokëz-a, f.sh. -a, -at (Zheg.)** 1. Shiriti i thurur me kërrabza, që shërben për të lidhur djepin me gjithë foshnje, diku përdoret: **lulak**.

T

- tarapushk ndf.** 1. Një lloj loje me shkopinj; 2. *I shkojnë punët tarapushk*, rrokopujë, mbështjellim, në mënyrë kaotike.
- temerruc mb.** 1. Njeri koprrac, dorështrenguar; 2. Njeri heshtak, i tërhequr, që frikësohet të flasë para shokëve, njeri i mbyllur në vetvete e fjalëpak.
- trupoj fol.** 1. i ra trup një rruge, i ra drejtë: *Trupoj malit*, kaptoj malit, i ra rrugës së shkurtër e pa leqe.

rashka:t (me), fol.

1. me ngacmue dikë, me ngucë, me shqetësue; mos me lënë rehat, me aktualizua një punë: *Mos e tarashkat atë punë ma!*

V

vidim-i, m.sh. -a, -at.

1. Kungull misiri, kungull i bardhë, **hutin** (Cernicë), **qylah** (Pozheran).

vojshti:n-a, f.sh. -a, -at

1. Dyll i bletëve, hoje, fashuell, mjalt me hoje, me vojshtinë.

vervele-vervelja f.

1. Siklet, nervozë: *E ka kapë vervelja s'po mun me zanë vend.*

vang-i, m.sh. vangje, -et.

1. Vangu i opingës, si një lloj rrëfane; 2. Shkas, arsye, sebeb: *Me zanë vang, me ia gjetë vangin;* me gjetë shkas për grindje.

vedër-vedra, f.sh. -ra, -rat

(St.E.) 1. Enë prej druri, e cila shërben për të vënë qumshtin, kur i mjelim dhinë, delet apo lopën.

XH

xhurdi-a, f.sh. -a, -at (St. E.)

Veshje e lehtë prej zhguni, të cilën e bartin burrat: *Xhurdia ardheke deri n'shkeka*, kishte edhe ndodnjë fije gajtan e me krah të shkurtër deri në bërryla, me ngjyrë të zezë.

Y

ymërگا:t, mb.

1. Njeri që ka jetë të gjatë, jetëgjatë: *Ish konë ymërگا:t e pshtoj pi lufte.*

mërshkurt, mb.

1. Njeri jetëshkurtër.

ZH

zhyllan-i, m.sh. -a, -at.

1. Njeri i papastër ose me rroba të zhyllafta, të palara: *Ish konë ni thmi zhyllan me tesha t'zhyllafta*, me rroba të palara.

Përmbyllje

Ky fond leksikor dëshmon për pasurinë e madhe leksikore të së folmes së Karadakut. Këto njësi leksikore janë vetëm një ekstrakt nga fusha e gjerë dhe e pashterrëshme e gurrës leksikore të kësaj të folmeje. Ndaj e vlen që leksiku i kësaj së folmeje të eksplorohet e sistemohet dhe të studiohet nga shumë aspekte: 1. Tipat e fjalëformimit, 2. Toponimia e Karadakut dhe tipat e fjalëformimit të tyre; 3. Frazelgjizmat dhe shprehjet frazeologjike; 4. Fjalët e urta e deri te 5 . Leksiku i pasivizuar. Kur të shterohen dhe të studiohen të gjitha këto fusha, atëherë do të kemi një pasqyrë të plotë të studimeve të gjithanshme gjuhësore të kësaj të folmeje dialektore.

LETËR E GJERGJ PEKMEZIT PËR GJENDJEN NË SHQIPËRI PARA VITIT 1901

Në trashëgiminë që ka lënë konsulli austriak në qendrat shqiptare August Ritter von Kral në Arkivin e shtetit në Vjenë gjendet një raport i gjerë i Gjergj Pekmezit, “kandidat për filozofi”, që domethënë kandidat për doktor në filozofi në Universitetin e Vjenës, lidhur me rrethanat në Shqipëri. Raporti është shtypur me makinë, nuk ka datë dhe asnjë shënim tjetër. Thjesht është gjetur në dosjen **Nachlass August Kral I** të Arkivit.

August Ritter von Kral (1869-1953) kishte shërbyer në funksione të ndryshme diplomatike të Austro-Hungarisë, e më vonë të Austrisë në Perandorinë Osmane dhe në Persi. Ka qenë një nga më të rëndësishmit në diplomacinë austriake në hapësirat shqiptare, shumë aktiv sidomos në dy dekadat e para të shekullit XX. Veprimtaria e tij me botën shqiptare, raportimet dhe angazhimet në lidhjet me lëvizjet ndër shqiptarë, kanë të bëjnë në radhë të parë me qendrat ku Austro-Hungaria kishte shërbimet e saj diplomatike – Manastir, Selanik, Shkodër, Cetinje, Prizren, Elbasan, Durrës, etj. Kral kishte mësuar shqip dhe kishte krijuar lidhje të gjera dhe komunikime intensive me personalitete dhe figura të ndryshme dhe të shumta shqiptare të periudhës – pjesa e dytë e dekadës së fundit të sh. XIX dhe të dy dekadave të para të sh. XX, ndër të tjera me personalitete si Dervish Hima, Faik Konica, Ndre e Lazar Mjedia, Hasan Prishtina, Bajram Curri, Gjergj Pekmezi, Gjergj Fishta, e shumë të tjerë. Në dosjet e trashëgimisë së tij të njohura si “Nachlass August Kral” gjenden shumë korrëspонденca dhe materiale të tjera me vlerë për lëvizjet ndër shqiptarë dhe për lidhjet e personaliteteve të ndryshme shqiptare të kohës me diplomacinë austriake dhe për raportet e kësaj fuqie të kohës me lëvizjet dhe veprimtarinë kulturore e patriotike ndër shqiptarë, sidomos në periudhat me rëndësi si ajo e përpjekjeve për njësimin e alfabetit, të kryengritjeve, të lëvizjeve në Kosovë në periudhën menjëherë pas shpalljes së Pavarësisë së

Shqipnisë, në kohën e Komisisë letrare të Shkodrës, në veprimtarinë për hapjen e shkollave shqipe gjithandej, etj.

Shënimet e tjera në letër na ndihmojnë ta vendosim përafërsisht në Kohë: letra i drejtohet Shefit të Seksionit në Ministrinë e Jashtme, ndërsa mbrenda flet edhe për Konsullin Kral në Manastir. Sipas shënimeve dihet që Kral ishte me shërbim në Mansatir si DA Konsulat nga 1897 deri më 1901, ndërsa si Leiter më 1904 deri në nëntor.

Dr. Gjergj Pekmezi njihet si një nga figurat e rëndësishme kulturore e shkencore shqiptare të pjesës së parë të shekullit XX, si gjuhëtar dhe studiues, si mësimdhënës i gjuhës shqipe, si atdhetar me veprimtari të shumta në fushën e kulturës – në lidhje me alfabetin e shqipes, me shkollat dhe sidomos me Komisinë Letrare të Shkodrës të viteve 1916-1918, si Kryetar i saj. Ka lindur në Tushemisht të Pogradecit më 1872, vdiq në Vjenë më 1938, ka mësuar në shkollat greke në Ohër e Manastir, studime të larta në teologji ka bërë në Beograd (1890-1894), ndërsa stuidmet për filozofi e filologji i ka mbaruar në Vjenë më 1901. Nga 1903 ka vepruar si lektor i shqipes në Vjenë, ndërsa më 1904 bashkë me Hilë Mosin e Kolë Rrotën themeloi shoqërinë atdhetare *Dija*. Më 1913 ishte i angazhuar në punë me komisionin për caktimin e kufirit në jug të Shqipërisë, ndërsa më 1914 dragoman i Austro-Hungarisë në Durrës. Më 1916 u caktua Kryetar i Komisisë letrare të Shkodrës, ndërsa më 1917 ndihmoi dhe shoqëroi delegacionin e prijësve shqiptarë në vizitën në Vjenë për takime me autoritetet imperiale. Nga 1920 deri më 1924 dhe nga 1926 deri më 1928 shërbeu si konsull shqiptar në Austri.

Në punën shkencore e kulturore njihet për punën e tij si mësimdhënës i shqipes në Vjenë, si studiues i gjuhës, si botues. Bashkëpunoi me autoritete të kohës si Rajko Nahtigal, Maximillian Lambertz, Norbert Jokl, etj. Njihet për Gramatikën e rëndësishme të shqipes gjermanisht të vitit 1908 (Grammatik der albanesischen Sprache), për raportin mbi studimin e dialektit të Elbasanit, Vjenë 1901, për Bibliografinë shqype të hartuar bashkë me Manek, 1909, për tekstin e mësimi të shqipes (Sprach fuchrer zur schnellen Erlernung der albanesiuscchen Sprache, Vjenë 1913, për Lehr und Lesebuch des Albanischen bashkë me M. Lambertz, Vjenë 1913, për botimin Bleta shqypëtare e Thimi Mitkos, Vjenë 1924, etj.

Raporti që po botojmë u gjet nga anëtari i Akademisë Austriake të Shkencave prof. dr. Oliver Schmitt dhe na u dergua i skanuar, për çka i shprehim falënderimin tonë të përzemërt. Vetë e pamë dhe morëm edhe një herë në Arkivin e Shtetit në Vjenë në maj 2017. Këtu e sjellim të plotë në origjinalin gjermanisht të fotokopjuar dhe në përkthimin shqip të profesor dr. Teuta Abrashit.

Fjala është për një raport që Gjergj Pekmezi i dërgonte shefit të Seksionit në Ministrinë e Jashtme në Vjenë. Është nënshkruar me shtesën **cand. phil.**, që domethënë kandidat i filozofisë, pra kandidat për t'u doktoruar në filozofi (ku përfshihej filologjia). Brenda përmendet dhe takimi me August Kral, konsull austrohungarez në Manastir, detyrë në të cilën ai ishte në periudhat 1897-1901, ndërsa si Leiter më 1904. Nga dokumentet që gjenden në arkivin e Universitetit të Vjenës shihet se Gjergj Pekmezović kishte bërë kërkesën për provimin **Rigorosum** më 1901, ku ishin hartuar edhe vlerësimet për punën e tij nga Paul Kretschmer dhe Vatroslav Jagić. Kjo do të thotë se raporti do të jetë hartuar para kësaj date. Është gjithsesi shumë i hershëm. Duket se do të jetë i vitit 1900 apo 1899, kur Pekmezi përgatiste raportin dialektor.

Numrat në kllapa të thyera shënojnë numrat e faqeve të origjinalit, gjithsejtë 52.

Hochwolgeborener Herr Sections-Chef

mein innigst verehrter Vortäter !

Vor etwa vier Monaten unternahm ich eine Reise in meine Heimat Albanien. Es geschah dies zum Zwecke des philologischen Studiums einiger albanesischer Dialecte und lag mir schon damit ich von dieser Hauptaufgabe meiner Reise nicht abgezogen werde - die Absicht ganz ferne, auch die sonstigen Verhältnisse, insbesondere die *c u l t u r e l l e n* und *p o l i t i s c h e n* Zustände meines Heimatlandes, in den Kreis meiner Studien und Beobachtungen einzubeziehen.

Einleitung.

Trotzdem war es für mich als Einheimischen, der von seiner Heimat lange abwesend war, unvermeidlich, dass ich mich auch auf dem culturellen und politischen Gebiete erklärlicher Weise bald für dieses bald für jenes interessirte, da sich mir ja die bezüglichen Beobachtungen ganz von selbst aufdrängten. Die hierbei gewonnenen verschiedenen Eindrücke möchte ich nun, Ihrer freundlichen Aufforderung folgend, hier in Kürze zusammenfassen. Ich tue dies umso lieber, als ich hiedurch vielleicht ein Zweifaches erreichen

./.

2.

könnte : den Zustand Albanien's in ein besseres Licht stellen und der albanesischen Sache dienen.

Was das erstere, ein besseres Licht über Albanien zu entwerfen, betrifft, dürfte das wol kein zu Kühnes und Überflüssiges Unterfangen sein, wenn man bedenkt, wie ja dieses europäische Land in jeder Hinsicht in puncto fast völliger Unbekanntheit und Dunkelheit sozusagen mit den entlegensten Gegenden Afrika's rivalisiren könnte. Man würde wahrlich den europäischen Forschern, Ethnographen, Archäologen und vielleicht auch den Politikern zurufen mögen : Warum denn in die Ferne schweifen, das Gute liegt ja doch so nah ! Seit den Zeiten eines Hahn ist es trotz mehrfacher Bestrebungen und Opfer bis jetzt wol noch Niemandem gelungen, Hahn's schöne Leistungen in gleicher Weise fortzusetzen. Soll man sich das etwa so erklären, dass sich bis jetzt nur zu schwache Kräfte an die Arbeit gewagt haben, und dass es auch diesen an der unumgänglich notwendigen, kräftigen Stütze eines mächtigeren Culturkörpers, eines Culturstaates, gefehlt hat ? Und an wen anderen könnte man in der letzteren Beziehung denken, als an das benachbarte Oesterreich-Ungarn, welches durch seinen Einmarsch in Bosnien und Hercegovina de facto der einzige mögliche, naturgemässe Culturträger für die ganze Balkanhalbinsel geworden ist ?

Für Oesterreich aber bietet Albanien nicht nur ein Object wissenschaftlichen

3.

Studiums, welches seine Gelehrten zu betreiben berufen sind. Es gibt da für Oesterreich - ich kann mich dieser Ueberzeugung nicht entschlagen - noch viel wichtigere, überaus vitale, unumstößliche, politische, mercantile und andere Interessen, die unabweislich Oesterreich-Ungarn's regate Aufmerksamkeit auf das genannte Land und dessen Bewohner geradezu herausfordern. In Albanien sind die verschiedenen, das Volk demoralisirenden Propaganden kleiner und wol auch kleinlicher, schwächlicher Staaten noch nicht so weit gediehen wie z.B. in Macedonien; doch fängt es auch dort bereits an zu gähren. Soll da nicht die zuversichtliche Erwartung berechtigt sein, Oesterreich werde seine mächtige Hand dazwischen legen und den in der Türkei ohnehin ganz allein verbreiteten und offen zu Tage tretenden Wünschen und Sympathien, welche das verlassene albanesische Volk für Oesterreich-Ungarn hegt, entgegenkommen, indem es vermöge seiner ersten Grösse, nicht in einer Degeneration, in einer Entnationalisirung des dortigen Volksstammes /:wie andere kleine Völklein, welche sich derart um ein Paar Millionen vermehren müchten :/, sondern vielmehr in der idealen Aufgabe, der Hort der Civilisation und der Träger der Cultur zu sein, seinen Ruf und seine Kräftigung erblickt. Die Albanesen sind die Nachbarn der Oesterr.-ungar. Monarchie. Es muss also früher oder später infolge natürlicher Notwendigkeit zu einer Ausgleichung kommen, so dass aus dem vollen Born der Cultur, welchen Oesterreich-Ungarn birgt, in das von

4.

von der Cultur so völlig bare, an Naturschätzen und mannigfaltigen Eigentümlichkeiten jedoch so reiche albanesische Land, das dem Letzteren Fehlende überfließt. Es geschieht schon jetzt vielleicht "so Manches" doch kann ich versichern, dass es nicht genügt, um zu irgend welchen Resultaten innerhalb Albaniens selbst zu führen. Man sieht kaum Spuren davon, das etwas getan wird; denn nicht in Brüssel, Bukarest, Sofia, Athen, Unteritalien oder sonst irgendwo kann der normale Herd für die Herstellung gesunder, geistiger Nahrung, für das nach Büchern, Schulen, Bildung, Cultur und Befreiung dürstende albanesische Volk sein: er kann, er muss nur in Wien bestehen.

Man täuscht sich auch gewaltig, wenn man sich unter einem Albanesen a priori bloss einen nach Raub und Todtschlag lechzenden Wildling vorstellt, der im Vergleiche zu einem aussereuropäischen Wilden nur umso gefährlicher und antipathischer ist, als er mit guten Feuerwaffen gut umgeht und mehr Mut besitzt. Ich glaube es dürfte meine nachfolgende Schilderung zeigen, wie tief bei den Albanesen die Wurzeln eigener Selbsterkenntnis und eines echten und verständigen Patriotismus schon eingedrungen sind - eines Patriotismus, der auf die Ausbildung einer nationalen Individualität, dieser von selbst sich heranbildenden Frucht freier Aneignung der Cultur hinausläuft. Wie viel Schönes und Edles könnte da gezeitigt werden, wenn eine helfende Macht

./.

5.

beispringen würde. Ueberall, wo ich gewesen, trug man mir ja in erster Linie, von Seite der Führenden im Volke, mit dem grössten Enthusiasmus vor, was alles die Liebe zum eigenen Volke leisten würde, wenn sie es vermöchte. Nicht confessionelle Fragen stehen im Vordergrund des Interesses der albanesischen Patrioten /: und als solche bekommen sich fast ausschliesslich alle nach den dortigen Begriffen der Intelligenz angehörenden Leute :/, sondern die Sorge für das nationale Wol, die sich umso schmerzlicher gestaltet, weil sich die Leute ihrer Ohnmacht, besonders des Fehlens aller notwendigen materiellen Mittel bewusst sind. Mit naiver Offenherzigkeit - und zwar vornehmlich weil ich aus Oesterreich kam und dort sogar studire - entdeckte man sich mir überall, wie man mit fester Zuversicht von Oesterreich die notwendige Hilfe erwartet. Und ist diese Hilfe ratsam, so ist sie auch leicht und ausführbar. Ohne mich in politische Theorien einzulassen, glaube ich, tut es zunächst not, die culturellen Bestrebungen der Albanesen zu unterstützen, also vor allem für die Beschaffung der nötigen Bücher und für den Aufbau eines heimischen Schulwesens auf Grundlage der nationalen Sprache Sorge zu tragen.

Es dürften wol mit dem Angeführten

./.

6.

auch die Referate des Österr.-ungar. Consuls in Bitolj, Herrn Král, welchen ich wiederholt zu besuchen die Ehre hatte und bei welchem ich mir hiebei die Schul- und Schulbücherfrage zur Sprache zu bringen erlaubte, übereinstimmen. Ich möchte es - jedoch mit der ausdrücklichen Bitte, dass dies nicht als ein unbescheidenes, anmassendes Urteil aufgefasst werde - als eine erfreuliche Tatsache bezeichnen, dass in Herrn Král ein so tüchtiger, energischer und einsichtsvoller Vertreter der Österreichischen Interessen auf der Balkanhalbinsel gefunden worden ist, der diesen so geschickt auch die rein albanesischen Interessen einzufügen und beide mit einander zu verbinden verstanden hat.

Schliesslich erlaube ich mir in dieser Einleitung zu bitten, an meine nachfolgende Schilderung nicht mit Anforderungen der Systematik und Vollständigkeit heranzutreten. Mein Reisezweck war ja - wie gesagt - ein ganz anderer, als der Gegenstand dieser Zeilen. Auch bin ich mir in politicis meiner Schwäche bewusst. Ich möchte nur den Wunsch Euer Hochwohlgeboren erfüllen, die Eindrücke, welche ich auf meiner Reise - abgesehen von dem eigentlichen Zwecke der letzteren - empfangen habe, festzulegen. Um hiebei möglichst genau und objectiv vorzugehen, will ich mich chronologisch an den Gang meiner Reise halten und, denselben folgend, die gemachten Beobachtungen und Erfahrungen nie-

./.

7.

derzuschreiben.

Meinen Weg nahm ich über Serbien. Schon hier /: bei Niš :/ hatte ich Gelegenheit, auf der Fahrt mit mehreren, und zwar intelligenteren Albanesen zusammenzutreffen, welche aus Bulgarien und Rumänien heimkehrten. Die aus B u l g a r i e n kamen, kannten sehr gut die Leistungen des albanesischen Vereines " D e s i r e " in Sofia; sie wussten aber auch von der Tätigkeit der Albanesen in Bukarest und waren von grossem patriotischem Selbstbewusstsein erfüllt. Doch überflügeln diese in Allen jene, die aus R u m ä n i e n kamen, welche vieles aus der in verflochtenen Jahre in Bukarest herausgegebenen Geschichte Skenderbogs und den dort erscheinenden albanesischen Journalen u.s.w. zu erzählen wussten. Auch rühmten sie sich, wie sie jetzt albanesisch schreiben und lesen können. Schliesslich rief mich, man könnte sagen, der Intelligenteste von ihnen bei Seite und zeigte mir, wo er mehrere albanesische Bücher, die er als Geschenke in seine Heimat mitbringen wollte, versteckt hatte, obwohl er die Gefahr gut kannte, die ihn deshalb bevorstehen könnte. Auf meine Frage, wo er die Bücher gekauft habe, und wie teuer sie waren, antwortete er, man bekomme sie unsonst von den Landsleuten in Bukarest, die sich schon viele Jahre bemühen, uns mit albanesischen Büchern zu bereichern. Da ich mich interessierte, wie sich die rumä-

Die Albanesen in Sofia und namentlich in Bukarest.

./.

8.

nische Regierung zum Tun und Lassen der dortigen Albanesen verhalte, erklärte er mir, dass in Bukarest für das patriotische Wirken derselben der günstigste Boden sei, indem ihnen von der Regierung gar kein Hindernis in den Weg gelegt werde, sie fänden vielmehr bei ihr Unterstützung. "Die Vlachen /:Rumänen:/ sind eben" - sagte er in naiver Weise - "unsere Bundesgenossen."

Rauf-Bej in Leskovik, dann der Dichter Petrasri und die albanesischen Studenten in Constantinopel.

In Salonichi kam ich dann durch einen glücklichen Zufall mit Rauf-Bej und seinem Vater Aslan-Bej aus Leskovik in Albanien zusammen. Rauf-Bej hatte vor 2 Jahren in Constantinopel eine höhere türk. Schule absolviert und sollte, wenn er nicht durch sein auffallendes patriotisches Auftreten das Misstrauen der türk. Regierung hervorgerufen hätte, zum Kajmakam in einer grösseren Stadt ernannt werden. Rauf-Bej wusste mir zu erzählen, wie die erwähnte Schule sehr stark von albanesischen Jünglingen besucht sei und wie diese Jünglinge überaus patriotisch gesinnt und für die albanesische Sache begeistert seien. Das soll nach seinem Dafürhalten auf die öftere Zusammenkunft derselben mit den besten und einzigen heutigen albanesischen Dichter und grossen Patrioten Najm-Bej, der sich in einer mir unbekannten Stellung in Constantinopel befindet, zurückzuführen sein. Rauf-Bej will mit allen seinen gewesenen Kollegen in Correspondenz stehen. Dieselben melden ihm fortwährend

./.

9.

von den Erfolgen, welche sie in ihrer Tätigkeit für die Verbreitung des albanesischen Patriotismus erzielen. Rauf - Bej wusste auch von den Albanesen, die in Monastir in den grossen Mektep erzogen werden, so Manches und constatirte, dass auch dort unter der Jugend derselbe Geist herrsche. Zuletzt sprach Rauf-Bej auch von seiner Tätigkeit. Er selbst hat mehrere Gedichte in albanesischer Sprache verfasst und soll eine Geographie aus dem Türkischen in's Albanesische übersetzt haben. Er hätte in der gleichen Richtung noch mehr geschaffen & würde es mit vermehrten Kräften fortsetzen, wenn seine Produkte irgendwo erscheinen könnten. Es schien mir, als ob er erwartete, dass ich ihm sagen werde : Gib mir die Handschriften, denn ich werde sehr leicht in Wien den Druck solcher für uns unentbehrlicher Sachen besorgen können. Ich fand hier zum erstenmal den Gedanken, den ich dann allgemein in Albanien antraf, dass man aus Wien Hilfe ersenne und erhoffe.

Rauf-Bej's Ansicht ist : Die Albanesen könnten ganz selbständig, bloss auf sich selbst angewiesen, nicht existiren und müssten daher von einer fremden Macht annektirt werden. Könnte das nun ein Balkanstaat, vielleicht Montenegro, Griechenland, Serbien oder Bulgarien sein, fragte er lachend. Was bleibt nun also ? Uns von Italien

./.

10.

italienisieren zu lassen und dann mit den italienischen Brüdern an Tuche der Armut zu nagen und die Reihe der anarchistischen Mörder zu vermehren? Staunen muss man aber, sagte Rauf - Bej, über den gewaltigen Fortschritt, der in Bosnien und der Herzegovina seit der Occupation durch Oesterreich sichtbar ist, der uns überall in Albanien sehr gut bekannt ist und den wir endlich auch in Albanien erleben möchten. Ohne jeglichen Zweifel ist gewiss nur Oesterreich im Stande, aus uns etwas ordentliches zu machen, und deshalb genießt es auch bei uns grosse Sympathien und den besten Ruf.

Die bulgarische Propaganda, der Bischof und die S. Clemens-Bibliothek in Ochrid.

Aus Salonichi begab ich mich über Bitolj
/: Monastir :/ nach Ochrid, wo ich in Folge privater Gründe einen längeren Aufenthalt zu nehmen gezwungen war. Da ich in dieser Gegend, wo ich viele Freunde und Bekannte habe, 10 Jahre nicht war, so erregte meine Ankunft einiges Aufsehen und ich wurde, ohne mich im mindesten zu bemühen, in kurzer Zeit in alle dortigen Verhältnisse, so z.B. was die verschiedenen Propaganden betrifft, eingeweiht. So unterhielt ich mich darüber mit dem bulgarischen Bischof Methodius aus Ochrid. Nach seiner Ansicht hätte in der Ochrider Paza die bulgarische Propaganda am meisten Aussicht auf Erfolg. Er ist überzeugt, dass die Serben nie den Bulgaren gleich kommen können. Er wisse auch sehr genau, dass die türkische Regierung den Bulgaren nur deswegen, weil sie die stärkste Macht entwickeln, Hinder-
./.

11.

nisse in den Weg legt, während sie die Serben und die übrigen Propaganden unterstützt. In weiteren Verlaufe des Gespräches meinte der Bischof, dass nur die allgemein bekannte und sich immer mehr Bahn brechende albanesische Idee eine Gefahr zu Ungunsten der Bulgaren in sich bergen könnte. Natürlich müssten die Bulgaren, so wie so mit den Albanesen eine Allianz eingehen. Nur hätte der Bischof die Erfahrung gemacht, dass die Albanesen mit diesen Gedanken nicht sympathisieren. Er selbst hätte ja von vielen Albanesen sehr oft gehört, dass sie nur eine Occupation à la Bosnien und Herzegovina durch Oesterreich-Ungarn herbeisehnen. Aus dem Munde des Bischofs habe ich auch zum ersten Male von einer lokalen albanesischen Bewegung in Ochrid gehört. Dem Bischofe muss überhaupt, wie ich sah, seitens der bulgarischen Regierung die Aufgabe zugewiesen sein, sich um alle dortigen Zustände selbst unwichtigere, genau zu interessieren. Als ich nach ein Paar Tagen dem Bischofe den Gegenbesuch abstattete, zeigte er mir mehrere slavische Pergament-Bücher, die ich flüchtig durchsah, ihm erklärte und in Kürze beschrieb. Deshalb bat er mich, ich möge mir noch die sehr reiche S. Clemens-Bibliothek etwas ansehen, wo etliche Bücher wären, die er nicht zu würdigen im Stande sei. Die erwähnte Bibliothek barg einst einen sehr reichen Schatz von wichtigen Büchern und archäologischen Denkwürdigkeiten. Heute

./.

12.

ist dieser schon um vieles ärmer geworden, da sich Freunde der Wissenschaft gefunden haben, die der letzteren durch Stehlen zu Hilfe kommen wollten.

Leider konnte ich nur eine Woche dazu verwenden, um die circa 200 Nummern zählende Collection von Büchern in flüchtiger Weise durchzugehen. Von den slavischen Handschriften, deren einige für die alte Literatur-Geschichte grosses Interesse haben, habe ich mir einige nähere Notizen gemacht. Auch habe ich von der ganzen Bibliothek ein Inventarverzeichnis mitgebracht.

Serbische Propaganda.

Was die serbische Propaganda angeht, sprach ich mit dem Lehrer der serbischen Schule in Ochrid, Georg Tasić, mit dem ich bereits vor mehreren Jahren in Belgrad bekannt geworden war. Freudigen Antlitzes äusserte er sich über die schnellen Fortschritte der serbischen Propaganda in Ochrid, die besonders in den letzten Jahren einen grossen Aufschwung erfahren habe. Auch werde es nur noch ein Jahr dauern, dass für Macedonien eine serbische Hierarchie errichtet wird. Und so hoffe ich, sagte er, dass es dann nicht mehr lange Jahre dauern wird, dass sich ganz Macedonien zu Serbien bekennen werde.

/: Bis jetzt gelang es in Ochrid nur 10 Häusern zu bestechen und für sich zu gewinnen.:/

Griechische Propaganda.

Betreffs der griechischen Propaganda sprach ich mit dem griechischen Bischof selbst. Obwol auch er sich über das Gedei-

./.

2

13.

hen derselben ziemlich zufrieden ausdrückte, sah ich doch gleich, dass in seinem Tone keine solche Zuversicht herrschte, wie sie z.B. der bulgarische Bischof an den Tag legte. In Ochrid ist kein einziger Grieche ansässig und die 12 graecophilen Häuser halten sich nur, da ihnen das grosse Vermögen des S. Naum-Klosters in der Nähe von Ochrid zur Verfügung steht. Zwischen den Serbo- und Graecophilen bestehen in Ochrid noch freundschaftliche Beziehungen, während solche in Salonichi bereits aufgehört haben.

Mehrere griechische Priester kamen zu mir und fragten mich, ob es möglich wäre den katholischen Ritus beizutreten, und was für ein Bene damit verbunden wäre. Sie hätten gehört, dass katholische Priester vom Papste sehr gut bezahlt werden und daher nichts vom Volke brauchen, was besonders für unser armes Volk sehr willkommen wäre. Dieselben Fragen stellten an mich 2 griechische Priester auch in Pogradec. Doch interessirte sie nicht nur für die Bezahlung der katholischen Priester, sondern mehr noch dafür, wie es mit dem Katholicismus verbunden wäre, dass für Schulen und die Aufklärung des Volkes in der richtigen Weise gesorgt werde. Der eine, Pap Constantin, charakterisirte die jetzigen wenigen griechischen Schulen in Südalbanien sehr gut, indem er constatirte, wie ganz unpaedagogisch dieselben sind. Man lasse die Kinder 13 Jahre lernen und

Clerus und
Schulen.

./.

14.

zum Schlusse erziele man das Resultat, dass sie einen einfachen Brief in neugriechischer Sprache nicht schreiben oder ein neugriechisches Buch nur schlecht verstehen könnten. Und so geschehe es, dass man sich für die alltäglichen Bedürfnisse schriftlich gar keiner Sprache bedienen könne. Dazu komme die völlige Unkenntnis in jenen unentbehrlichen Gegenständen, die überall die Grundlagen der Cultur ausmachen, von denen man aber bei Kindern, die die erwähnten Schulen absolviert haben, fast gar keine Ahnung finden kann, z.B. von den Anfangsgründen der Arithmetik oder Physik etc.

Albanesische Verhältnisse.

Auch die Ochrider albanesischen Verhältnisse lernte ich zunächst aus dem Munde der der griechischen Propaganda angehörigen Leute, vor allen durch manche meiner einstigen Schulcollegen vom Ochrider *Ελληνοκόρ θεογέτορ* /:erkklärlicher Weise lauter Grascophilen:/ und dem dortigen griechischen Bischofe kennen.

Handi-Bej in Ochrid.

Besonders viel wussten sie mir von dem sehr aufgeklärten und grossen albanesischen Patrioten und einflussreichsten Beg in Ochrid, Handi-Bej, zu erzählen, welcher infolge seiner feurigen und hervorragenden Anteilnahme an der albanesischen Sache sogar mehrere Jahre eingekerkert war. Er gründete in Ochrid eine geheime albanesische Schule und lässt sich sehr die Verbreitung albanesischer Bücher angelegen sein. Im Vereine mit einem

./.

15.

Freunde, der sich jetzt in Periferi befindet, hat er sogar /:er erwähnte mir das später selbst:/ albanesische Erzählungen, Gedichte und Wörter aus den verschiedensten Dialecten gesammelt, und würde diese Sammlungen herausgeben, wenn er es könnte. * Er ist wirklich in der ganzen Gegend um Ochrid, Bitolj, Dibr, Elbasan, Pogradec, Korça als ein begeisterter albanesischer Patriot bekannt und wird seitens der Regierung streng überwacht; doch ist er, wie ich mich später überzeugt habe, trotz alle dem überall in der genannten Gegend fast ein allmächtiger Herr.

Mit Ungeduld musste ich wünschen, diesen interessanten und für mich so wichtigen Mann kennen zu lernen, und machte ihm deshalb meinen Besuch. Sobald er von mir hörte, dass ich hauptsächlich zum Zwecke eines Studiums der albanesischen Sprache an Ort und Stelle gekommen sei, sowie, dass ich seine albanesisch-patriotische Gesinnung und aufopfernde Tätigkeit kenne und preise, fing er an mir mit dem grössten Enthusiasmus zu erzählen, wie gern er bereit wäre, für sein, von allem Notwendigen entblösstes, in cultureller Beziehung so notleidendes albanesisches Vaterland die grössten Opfer zu bringen und Tag und Nacht mit der grössten Energie zur Rettung und Hebung desselben zu wirken.

Anmerkung. Vielleicht gelingt es mir diese Sammlungen zu erwerben.

./.

16.

Er war, wie er mir erzählte, ein volles Jahr in Serbien /:Belgrad:/, woher es auch kommt, dass er gewisse freundschaftliche Beziehungen zu Leuten der serbischen Propaganda pflegt; einmal begegnete ich ihm z.B. sogar in der serbischen Schule.

21
Seine albanesische Aufklärung, seine nationalen Anschauungen und seine Begeisterung für die Sache seines Heimatlandes schöpfte er jedoch in Bukarest, wo er ziemlich lange gelebt hatte. Das anerkennt er dankbar selbst. Mit dem Österreichischen Consul in Bitolj /:Monastir:/ ist er durch die engsten Bande der Freundschaft verbunden. Er ist nach albanesischer Sitte sein Wahlbruder. Ja er verlangte von mir anfangs irgend ein Zeichen von Herrn Král, um sich mit mir ganz frei in ein Gespräch über derartige Dinge einlassen zu können. Ich sah überhaupt, dass Hamdi-Bej/:gewiss infolge der über ihn verhängten Gefängnisstrafe :/ viel vorsichtiger und diplomatischer geworden sein müsse, als ich ihn mir anfangs auf Grund der Erzählungen über ihn vorgestellt hatte. Er selbst sprach darüber, wie er schon viel matter wäre, als er seinerzeit war. Am meisten drückte ihn das Bewusstsein, wie ihm so manches hätte gelingen können, wenn ihm nur die nötigen Mittel immer zu Gebote gestanden wären. Tagtäglich kämen Leute zu ihm und verlangten Bücher von ihm. Er selbst möchte alles lesen, was albanesisch erscheint, " doch, sagte er, es verbietet uns ja dieser unser Hund in Constan-

./.

tinopel *) alles und erlaubt uns nicht einmal das zu sein, was wir in Wirklichkeit sind. Wir kennen ja sehr gut die aus Constantinopel ausgehenden Bestrebungen, die darauf hinauslaufen, uns zu turcisieren. Das glaube nicht ich allein, ganz Albanien hat davon Kenntnis. Wir werden aber den elenden Hund schon belehren, dass wir Albanesen sind und keine Tataren. Wir haben uns entschlossen, entweder Kinder Skenderbeg's zu bleiben, oder lieber nicht zu existieren!

Noch mehr aber als die Missgunst in Constantinopel, lähmt uns unsere Armut, der Mangel an Geld, welcher es uns unmöglich macht, albanesische Schulen zu gründen und die notwendigen Bücher für dieselben zu beschaffen.

Nur eine einzige Volksschule haben wir in Korça und auch diese wird nur mit den ungeheuersten Schwierigkeiten und Anstrengungen am Leben erhalten. Es ist wahr, dass man in Bukarest sehr viel bereits getan hat, doch so viel, als hier not tut, kann ein Verein allein selbstverständlich nie leisten. Das zu verlangen oder zu hoffen, wäre arger Irrtum. Aufrichtig gesagt, fügte Hamdi-Bej bei, ich kann es wirklich nicht begreifen, wie Oesterreich, der einzige uns am nächsten stehende grosse Culturstaat nicht das geringste Interesse, obzwar dies zu seinem eigenen Nutzen wäre, für uns an den Tag legt.

./.

*)

Anmerkung.

Ich glaube, diesen gewiss höchst unpassenden und ganz unziemlichen Ausdruck, weil er für die wilde Empörung eines mohamedanischen Bej's bezeichnend ist, unverändert wiedergeben zu sollen.

18.

Man muss sich wundern, dass wir noch nicht unsere Sympathien für Oesterreich-Ungarn verloren haben. Es ist dies vielleicht für uns sogar schädlich, denn warten können wir nicht länger. Es ist höchste Zeit, dass wir uns aufraffen. Vielleicht könnte eine andere Macht, wenn Oesterreich es nicht will, uns, der wildesten, ärmsten und verlassensten Nation in ganz Europa, schliesslich doch hilfreich die Hand darbieten. Man könnte irgend ein Memorandum an die Gebildeten Europa's senden, in dem wir unseren argen, beklagenswerten Zustand darlegen. Nur würde uns so etwas wahrscheinlich nicht viel frommen. Wir würden gewiss die Sympathien und das Mitlied edel denkender Leute erwecken; eine wirkliche, ausgiebige Hilfe kann aber wol nur ein benachbarter grosser Culturstaat bieten. Es scheint mir überhaupt, dass Europa unsere Verhältnisse nicht nur nicht kennt, sondern sich um dieselben gar nicht kümmern will; denn wie könnte es sonst als Hort der Civilisation schweigen und untätig bleiben."

Es sind dies Aeusserungen einer nahen wilden Verzweiflung, die ich möglichst w e r t l i c h wiederzugeben bestrebt war.

Verhältnisse in
Pogradec.

Von Ochrid wandte ich mich nach Pogradec. Dort, sowie überhaupt im ganzen Gebiete von Mokra und Korča, fand ich die nationale albanesische Idee allgemein verbreitet. Die einzigen in Pogradec

./.

19.

die daran nicht teilgenommen, waren der dortige Priester Pap Kostas und sein Sohn, der jetzige griechische Lehrer in dem genannten Orte, welche von der griechischen Regierung bezahlt werden und sich keines besonderen Ansehens erfreuen. Mir gegenüber benahmen sich beide in zweideutiger Weise. Sie spielten die Rolle von Spionen. So geschah es einmal, dass auf ihre Veranlassung das Haus meines Bruders, in dem ich wohnte, und das meines Schwagers bei Nacht von einer Menge von Gendarmen umringt und bewacht wurden.

Dass der albanesische patriotische Sinn im Gebiete von Starova, Mokra und Korca besonders feste Wurzeln auch in den tieferen Schichten der Bevölkerung gefasst hat, ist darauf zurückzuführen, dass die meisten in die Fremde und zwar nach Rumänien ziehen, wo sie am leichtesten /: hauptsächlich als Maurer :/ Arbeit bekommen, und wo auf dieselben seitens der Auswanderer-Colonie in Bukarest eine solche Aufklärungstätigkeit geübt wird, dass diese einfachen Leute, späterhin nach Albanien zurückkehrend, daselbst auch ihrerseits die in ihnen erweckten patriotischen Gefühle weiter verpflanzen. Man sieht da, auf wie einfache Weise ganz nennenswerte Erfolge erzielt werden können.

Bei den Patrioten in Pogradec fand ich auch ein noch grösseres Entgegenkommen als bei jenen in Ochrid. In Ochrid kennen nämlich die Albanesen in den dortigen Ge-

20.

misch von Bulgaren, Türken, Zinzaren, Zingunern etc. nicht so selbstbewusst auftreten, wie dort, wo sie in Massen wohnen. Die Ochrider Albanesen sind überdies fast lauter Mohamedaner und wohnen als solche üblicher Weise zusammen mit den Türken und sonstigen Mohamedanern in dem türkischen Stadtteile /:Mala:/ . Man kann daher auch sehr schwer irgend welche verlässlicheren Daten über ihre Anzahl feststellen.

In der Starover Kaza wohnen dagegen lauter Albanesen, deren eine Hälfte orthodox, die andere mohamedanisch ist.

In Pogradec, sowie in den übrigen Gegenden dieses Landteiles, die ich besucht habe, gelang es mir schon während meines so kurzen Aufenthaltes, besonders viele und zwar hervorragendere Leute für mein - auf Grund des Lateinischen - hergestelltes und im XXI. Bande des Archiv's für slavische Philologie S. 214 ff. begründetes albanesisches Alphabet zu gewinnen und ihnen dasselbe derart zu eigen zu machen, dass die seit meiner Rückkehr nach Wien aus jenen Gegenden an mich einlangenden Briefe nach meinen genannten Alphabete in tadelloser Orthographie geschrieben sind und dass mich die Schreiber dieser Briefe, von denen die meisten schon früher irgend ein Alphabet /:so einige die türkische Schrift, andere die griechische, viele aber auch die in Mittelalbanien übliche Orthographie der in Bukarest herausgegebenen albanesischen literarischen Erzeugnisse :/ kannten, als ihren "goisti-
./.

21.

gen Vater " begrüßen, welches überschwengliche Vertrauen mir in diesem Falle im Interesse der Sache nicht unerwünscht ist.

Hätte ich den Leuten nur noch Bücher geben können, nach welchen sie sich so sehnen, dann wäre sofort der allererste Schritt zur geistigen Selbständigkeit der dortigen Albanesen, der sich dann schon weiter verbreiten würde, getan und es wäre allen Graueisierungsbestrebungen der hier einzig tätigen griechischen Propaganda für immer der Boden entzogen.

Der einflussreichste, eigentlich allmächtige Herr in Pogradec ist Istref-Bej, der einen einzigen erwachsenen Sohn, Hajdar-Bej, hat. Es gereichte mir zur grossen Freude, dass sich die Gerüchte, die ich über sie hörte, ganz und gar nicht bewahrheitet haben. Sie wurden mir als fanatische Türken geschildert. Wol beobachtet der alte Istref - Bej die grösstmögliche Vorsicht, da er bereits mehrere Male von der Regierung verfolgt worden ist, und wahrscheinlich hat ihn eben dies bei den Leuten in den gedachten Ruf gebracht. Nach meinen falschen Voraussetzungen hatte ich die Absicht in meiner Unterregung wenigstens mit dem jungen Hajdar-Bej den Versuch zu machen, ihn zu überzeugen, dass er kein Türke, sondern vielmehr ein vornehmer Albanese ist. Man stelle sich nun mein Erstaunen vor, als er mich eigentlich gar nicht auf die Sache selbst kommen liess, sondern sofort etliche patriotische albane-

Hajdar-Bej in
Pogradec.

./.

22.

sische Bücher und in erster Linie einen ganz vor kurzem in Bukarest erschienenen und an den Sultan gerichteten Appell des jetzt in Italien befindlichen Mehmed Bej Frasëri zeigte, in welchem Appell das Tun und Lassen der türkischen Beamten, von den höchsten angefangen, einer überaus scharfen Kritik unterworfen wird. Dabei fügte Hajdar-Bej hinzu, dass er der sklavischste Verehrer des Verfassers dieses Appells, des grossen Patrioten Mehmed Bej Frasëri, sei und ihm in jeder Hinsicht zustimme. Als ich hierauf die Verdienste der Mohamedaner für die albanesische Sache rühmend hervorhob, sprang Hajdar-Bej auf, umarmte und küsste mich, reichte mir die Hand und sprach :

" Von nun an sind wir zwei Brüder. Sie als der Ältere und besser unterrichtete, mögen befehlen und ich werde zum Nutzen unserer albanesischen Sache Alles, was in meinen Kräften steht, tun. "

Hajdar-Bej war auch einer von jenen, die mein Alphabet erlernten. Vor kurzem bekam ich einen Brief von ihm, in welchem sich der Charakter der türkischen Schrift in den Zügen der nach meiner Theorie regelrecht angewandten lateinischen Buchstaben abspiegelt. Hajdar-Bej konnte nämlich früher nur türkisch schreiben, und es kostete ihm grosse Mühe, sich den Gebrauch der lateinischen Zeichen anzueignen, was er aber für einen jeden Albanesen für notwendig erachtete.

In die Zeit meines Aufenthaltes in Pogradec fiel auch ein freudiges Ereignis

23.

im Hause Istref-Bej's, welches für meine Zwecke von grossen Nutzen war; es heiratete nämlich sein eben erwähnter einziger Sohn Hajdar-Bej die Tochter des berühmten Alo-Bej aus Korča. Bei der Hochzeit wurde ich durch die hervorragende Vianrolle ausgezeichnet. Die Hochzeit bot mir auch Gelegenheit, das grosse Ansehen, ja die Allmacht Istref-Bej's in seinem Gebiete und den grossen Einfluss desselben auch über die Grenzen dieses Gebietes hinaus zu beobachten.

Ich traf bei der Hochzeit die vornehmsten Leute aus Korča, Gora, Mokra, Berzešta, Korča, Dibar und Ochrid an. Ich verpasste diese günstige Gelegenheit nicht, eine nähere Bekanntschaft mit den auf eine so glückliche Weise versammelten Führern des albanesischen Volkes anzustreben. Am dritten Tage der Feier, die 14 Tage gedauert hat, nahm ich mit dem Bräutigam am Nachtmahl in dem für die anwesenden Bej's bestimmten Konak teil. Meine Erscheinung /: ich kam in europäischer Salonkleidung :/ rief unter den Bej's einiges Aufsehen hervor. Sie interessierten sich, wer ich wäre. Ich stellte mich ihnen in vollkommen landesüblicher Weise vor und erzählte ihnen in einer, ihrer Auffassung entsprechenden Art vom Zwecke meiner Reise und der Aufgabe meines Lebens, was sie sich in der Weise zurechtlegten und begriffen, mein Bemühen gehe dahin, den Albanesen Bücher zu schaffen

Die bei Hajdar-Bej's Hochzeit versammelten Notabeln einer weiten Umgebung.

./.

24.

und die albanesische Sprache in der ganzen Welt bekannt zu machen. Man wunderte sich und einigen kam das ganze etwas unwahrscheinlich vor. Der greise, hochangesehene Limblošmi-Aga aus Berzešta glaubte, ich wäre aus Rumänien gekommen. Als ich ihn darüber aufklärte, dass ich in Wien studiere und bald wieder dahin zurückzukehren beabsichtige, begann er Oesterreich-Ungarn zu loben, indem er hinzufügte, wie ihm sein Sohn, der ein höherer Beamte in Constantinopel ist, von den "Nemcen" /: so nennen die Albanesen die Oesterreicher, während sie die Deutschen aus dem deutschen Reich Prussen heissen :/ und von ihren "Marifeten" /:Tausendkünsten:/ erzählt hatte. Auch von mir verlangten sie über die mannigfaltigsten Dinge Auskunft, wobei sie mit dem grössten Interesse zuhörten, als das Gespräch auf die grossartigen Entdeckungen des culturellen Nordwestens /: z.B. die verschiedenartige Verwendung der Electricität, etc., :/ , sowie überhaupt auf dessen Cultur, Civilisation und Humanität geführt hat. Ich sah aber, dass meine Zuhörer nicht nur keine Ahnung von den ihnen zum Besten gegebenen Dingen hatten, sondern sogar den Schein einiger Ungläubigkeit zur Schau trugen.

Zwischen Hajdar-Bej, Ademaga /: Herr von Mokra :/, Limblošmi und Pašo-Bej entwickelte sich ein interessantes Gespräch über den oben erwähnten Appell Mehmed-Bej-

./.

25.

Fraseri's, indem Hajdar-Bej die Genannten befragte, ob sie denselben bereits aus Korça, woher man solche Dinge, Schriften, Bücher etc. bezieht, erhalten haben, was diese bejahten. Man drückte sich allgemein in überaus lobender Weise über den Inhalt des Appells und seinen Verfasser aus. Paso-Bej citierte eine Stelle aus demselben, wo über die "faulen" Paschas gesprochen wird, was ein lang andauerndes Lachen verursachte. Höchst sympathisch wurde schliesslich meine Beschreibung der erhabenen Person Seiner Majestät, des österreichischen Kaisers, seiner allgemein rühmlich bekannten Herzensgüte, Ritterlichkeit, Regentenweisheit und musterhaften Lebensweise u.s.w. aufgenommen.

Am nächstenfolgenden Tage kam ich wieder mit den meisten jener Bej's, die ich an gedachten Abende kennen gelernt hatte, zusammen, so mit dem Bruder Alo-Bej's, mit dem alten Krek und seinem Bruder Kapër, mit Limblošni, Jusuf-Baba, einem angesehenen Bej aus Gora, u.s.f. Was ich von ihnen erfahren habe, wäre kurz ungefähr folgendes :

Die meisten von ihnen kennen nach Fraseri's das ist der von Bukarest aus verbreiteten Orthographie albanesisch lesen und schreiben. Von mir lernten sie nun die meinige. In gewissen Fällen ist die Kenntnis der albanesischen Schrift & sogar der Impuls dazu von den Söhnen derselben ausgegangen, was nicht so unerklärlich ist. Der Sohn Limblošni's z.B. soll in Constantinopel in freundschaftlichen Beziehungen zu dem be-

26.

kannten und schon oben erwähnten albanesischen Dichter Main-Bej Frastri stehen.

Sehr stolz sind sie darauf, dass das meiste, was bis heute für die albanesische Idee geschehen, den Mohamedanern zu verdanken ist. Man wies dabei auf die Frastrioten hin.

Von mir haben sie erwartet, dass ich viele albanesische Bücher mitgebracht habe, um sie in Albanien zu verteilen. Als ich das verneinte, meinte einer, ich hätte wenigstens die versificirte Geschichte Skenderbeg's bringen sollen, da man davon in Oesterreich so viel bekommen könne, als man wolle. Von Oesterreich sprach man unter diesen Bej's mit grosser Sympathie und verwies auf die Tätigkeit desselben in Bosnien und Hercegovina, während man über den Sultan und seine Regierung fürchterlich schimpfte.

Die albanesischen Zeitungen, woher sie auch immer stammen, gefallen ihnen sehr. Nur Adem-Aga aus Mokra drückte seine Antipathie gegen die in Italien erscheinenden Zeitschriften aus, was er auf Grund der in Brüssel erscheinenden "Albanie" tat. Er meinte, dass die italienischen Albanesen leider nicht mehr recht albanesisch denken können. So wäre er vor kurzer Zeit in Durrës/Durazzo/ mit einem durch und durch italienischen Albanesen zusammengekommen, der ihm mit Enthusiasmus eine in Italien erscheinende albanesische Zeitung gezeigt und daraus vorgelesen hätte, wovon er jedoch gar kein einziges Wort verstehen konnte, da die Sprache der Zeitschrift die italienische ist, was Adem-

./.

27.

aga bedauert und überhaupt nicht begreifen kann. So wäre er auch durch denselben Mann in eine albanesische Gesellschaft dortselbst gekommen, in welcher meistens italienisch gesprochen wurde, was ihm durchaus nicht gefiel. Schliesslich habe er von einer sehr verlässlichen Seite erfahren, dass nicht nur die Zeitungen der italienischen Albanesen vollkommen italienisch gesinnt sind und nichts Nützliches für die Albanesen in sich enthalten, sondern, dass die Herausgeber selbst nicht einmal albanesisch sprechen können.

Leider konnte ich mit der genannten Person nicht so lange Zeit verkehren, als es für mich vielleicht wünschenswert gewesen wäre. Bei ihrer Abreise richteten die Meisten an mich die Bitte, ihnen albanesische Bücher zu senden.

Nach der Hochzeit fuhr ich mit den Einwohnern von Pogradec auf den Kirchtag zum Kloster Kalista, welches 6 Stunden weit von Pogradec am Ufer des Ochrider Sees liegt. Der Zweck des Zuges war, um dort auch den neuerwählten Bischof von Durs, Gora, Mokra und Spathia zum ersten Mal zu empfangen. Unterwegs und in Kalista traf ich mehrere archäologisch interessante Gegenstände.

In Kalista angelangt statteten wir dem Bischof einen Besuch ab. Der Bischof ist bloss des Griechischen und Türkischen mächtig. Vom Albanesischen hat er keine Ahnung. Einen komischen Eindruck machte

Kloster Kalista
und der neue
griechische Bi-
schof von Duraz-
zo.

./.

28.

es auf mich, als der Pogradecer Priester Pap Kosman, der bei unserer Bewirtung durch den Bischof neben demselben zu sitzen kam, /: ich sass wieder neben Pap Kosman :/, auf alle an ihn, den Graecomanen, gerichteten griechischen Fragen des Bischofs über kirchliche und sonstige Angelegenheiten bloss mit tiefem Stillschweigen antwortete. Ich war genötigt mich in's Mittel zu legen und den Bischof aufzuklären, wie wenig das Griechische in diesen Gegenden verbreitet wäre, indem, selbst abgesehen von dem gewöhnlichen Volke, nicht einmal die Priester und die meisten Lehrer der sogenannten griechischen Schulen keine eigentliche Kenntnis der griechischen Sprache haben. Mit wenig Erfolg verliere man viele Jahre, um diese hier nicht einheimische Sprache den Leuten einzudrillen, obwohl man zu diesem Zwecke alles andere im Unterrichte hintansetzt und vernachlässigt. Erregt äusserte sich der Bischof, dass er sich nicht genug wundern könne, wie man bis heute einen so elenden Zustand dulden konnte. Hiebei entschlüpfte seinem Munde sehr abfällige Worte über seinen Vorgänger, während er zugleich des Weiteren entwickelte, wie er ganz anders vorgehen wollte. Auf meine Bemerkung über den schlechten Zustand der Schulen, und dass zu einer Besserung derselben die erste pädagogische Forderung wäre, die Landessprache als Unterrichtssprache einzuführen, wobei man hauptsächlich auf die Verbreitung wirklicher Bildung Ge-

./.

20.

wicht legen und dann auch das Griechische als Unterrichtsgegenstand belassen sollte und im letzteren einen wirklichen Erfolg erreichen könnte, ging der Bischof nicht vollends ein. Er möchte die Knabenschulen ganz abschaffen und nur die Mädchenschulen gut reorganisiren, so dass schliesslich eine jede absolvirte Schülerin perfect griechisch sprechen könnte. Wenn nun die Mutter zu Hause griechisch spräche, würden es auch die Kinder erlernen.

Ich wagte den Einwurf, dass dieser Plan denn doch nicht so leicht ausführbar wäre. Die Mehrzahl der Bevölkerung sei mohamedanisch und der Bischof wisse wol, dass mohamedanische Mädchen nie Schulen, die von ihm abhängen würden, besuchen können. Aber auch bezüglich der mit der mohamedanischen Majorität völlig gemischt lebenden christlichen Minorität würde ich zweifeln, dass ein Mädchen nach den Paar Jahren, in welchen sie die Schule besucht, die griechische Sprache so beherrschen und ganz in sich aufnehmen könnte, dass sie sogar ihre in einem etwas ferneren Schoosse der Zukunft liegende Familie graecisiren könnte. Wie schwer man überhaupt in unseren Schulen die griechische Sprache bis zur Redegewandtheit erlernt, hätte ich an mir selbst erprobt. Diese wirklich "göttliche" Sprache ergab sich mir vollständig erst, nachdem ich das ganze griechische Gynnasium in Monastir absolvirt hatte, obwol man an dem letzteren das Hauptgewicht auf ihre Erler-

./.

30.

nung gelegt hatte. Dasselbe könne ich von meinen Collegen sagen; ja die letzteren hätten nichts mehr als eine nicht gar zu tiefe Kenntnis des Griechischen über das Gymnasium hinaus gerettet. Ich knüpfte hieran - obzwar ich sofort einen richtigen Maastab für den hochwürdigen Bischof gewonnen hatte und die Nutzlosigkeit jeder weiteren Discussion ersah - eine kurze Mitteilung über meine der albanesischen Sprache gewidmeten Studien und versuchte ihm in einer seiner Auffassung und Graecisirungstendenz Rechnung tragenden Weise die Möglichkeit, auf Grund eines albanesischen Elementarunterrichtes auch eine bessere Kenntnis des Griechischen zu erreichen, gegenüber der Zweifelhaftigkeit eines Erfolges nach der von ihm geplanten Methode darzulegen. Ich tat das nicht, um ihn zu ärgern, vielmehr um ihn einer weiteren Ueberlegung der Sache und besseren Einsicht wenigstens in einigen Punkten zuzuführen. Der Erfolg war, dass er sich eingeschüchtert stellte und sogleich die Art und Weise seiner Sprache änderte. Er erzählte mir die abgedroschene, von Griechen und Graecophilen immer und immer vordeclamirte Fabel des gleichen Ursprunges der Albanesen und Griechen aus den alten Pelasgenvolke. So schieden wir. Als bald aber zeigten sich die Früchte dieser Unterredung. Meine Nichte, die bereits 2 Jahre zur vollsten Zufriedenheit eine Lehrerin in Pogradec bekleidet hatte, wurde entlassen. Ich erwiederte diesen

./.

31.

Coup damit, dass ich dieselbe alsbald sehr gut verheiratete. Hierauf wurde mein Cousin, der ebenfalls schon 3 Jahre in Pogradec Lehrer war, nach Elbasan geschickt, wohin er sich stante pede, im Laufe von 3 Tagen, begeben musste. Dies konnte hingenommen werden und Ärgeres geschah gottlob nicht. Mir gegenüber trug aber der Bischof in listiger Weise auch weiter grosse Freundlichkeit zur Schau.

Durch meinen Cousin, der wie gesagt, nach Elbasan geschickt worden war, erfuhr der dortige Archimandrit Germanos /: Germanos:/, der Nefte des vor 2 Jahren verstorbenen Bischofs von Durs, Gora, Mokra und Spathias von mir und - schnell entschlossen - erschien dieser würdige Mann eines schönen Tages bei mir in Pogradec. Man kann sich meine Freude vorstellen, als mir so, abgesehen von allen Anderen, schon in Ansehung meiner philologischen Studien die ersuchte Gelegenheit zu Teil wurde, während eines Gespräches von circa 8 Stunden, das schönste Elbasaner-Albanesisch hören zu können. Doch auch vieles andere Interessante erfuhr ich vom Archimandriten Germanos, da er ein sehr gebildeter, intelligenter Mann ist. Die theologische Hochschule absolvierte er in Athen. Albanien kennt er ganz, da er dasselbe mit seinem Onkel kreuz und quer bereist hat. Auch sonst ist er ziemlich in der Welt herumgekommen.

Archimandrit Germanos aus Elbasan.

Er erfreut sich unter dem Volke gros-

./.

31.

Coup damit, dass ich dieselbe alsbald sehr gut verheiratete. Hierauf wurde mein Cousin, der ebenfalls schon 3 Jahre in Pogradec Lehrer war, nach Elbasan geschickt, wohin er sich stante pede, im Laufe von 3 Tagen, begeben musste. Dies konnte hingenommen werden und Ergeres geschah gottlob nicht. Mir gegenüber trug aber der Bischof in listiger Weise auch weiter grosse Freundlichkeit zur Schau.

Durch meinen Cousin, der wie gesagt, nach Elbasan geschickt worden war, erfuhr der dortige Archimandrit Germanos /:Germanos:/, der Nefte des vor 2 Jahren verstorbenen Bischofs von Durs, Gora, Mokra und Spathias von mir und - schnell entschlossen - erschien dieser würdige Mann eines schönen Tages bei mir in Pogradec. Man kann sich meine Freude vorstellen, als mir so, abgesehen von allen Anderen, schon in Ansehung meiner philologischen Studien die ersuchte Gelegenheit zu Teil wurde, während eines Gespräches von circa 8 Stunden, das schönste Elbasaner-Albanesisch hören zu können. Doch auch vieles andere Interessante erfuhr ich vom Archimandriten Germanos, da er ein sehr gebildeter, intelligenter Mann ist. Die theologische Hochschule absolvierte er in Athen. Albanien kennt er ganz, da er dasselbe mit seinem Onkel kreuz und quer bereist hat. Auch sonst ist er ziemlich in der Welt herumgekommen.

Archimandrit Germanos aus Elbasan.

Er erfreut sich unter dem Volke gros-

./.

ziren," als es sich um Spata handelte. Ich stehe in engen Beziehungen zu den Spatarionten, so dass man für alles, was da geschah, mir die Schuld zuschrieb, und ich muss aufrichtig gestehen, dass ich wirklich der Urheber der ganzen Sache war. Wollen Sie jedoch wissen, was ich eigentlich aus den Spatarionten machen wollte? Bei Gott nicht Orthodoxe, was ja für mich das natürlichere wäre, sondern, - wundern Sie sich nicht - Katholiken, aber nur solche Katholiken, die nicht der italienischen Propaganda angehören sollten, sondern einem gerechten, die Volksindividualität schützenden und fördernden Oesterreich. Und mein Wunsch ging nicht nur darauf aus, bloss Spata, sondern ganz Mittelalbanien durch das Mittel des Katholicismus Oesterreich zuzuführen. Unerklärlicher Weise versagte mir der österreichische Consul in Bitolj jedwede Hilfe. Ich fragte ihn nach dem Grunde und erhielt - keine Antwort! Damals wollte ich mich, wie gesagt, nach Wien begeben und dort aus dem Munde des Herrn selbst und nicht seines untergeordneten Beamten die Ursachen erfahren, aus welchen uns die ersuchte Hilfe versagt worden ist. Der russische Consul aus Bitolj hingegen kam öfter nach Elbasan und bemühte sich sehr, mich für sich zu gewinnen. Es war dies vergeblich, denn längst schon beherrscht mich ganz nur der eine feste Entschluss, entweder meinem Volke zu nützen - deshalb sehe Sie bei mir auch diese schwarze Priestermitze - oder lieber gar nicht zu leben. In diesem Ent-

34.

schlusse, die Rettung unseres Volkes über Alles zu stellen, ist es mir persönlich ganz egal geworden, ob ich ein Orthodoxer oder ein Katholik bin, da ich überzeugt bin, auch als Katholik ein sehr gottgefälliger Christ bleiben zu können, und jetzt glaube ich, ist die Zeit gekommen, wo wir, durch ein kleines Opfer vieles erlangen können. Wenn nun Oesterreich verlangt, dass wir Katholiken werden, damit es berechtigt sei, uns zu helfen, so bin ich ohne Zurückhaltung gerne bereit, das Gesagte zu tun, und auch dazu meine geistlichen Brüder zu überreden, nur um uns zu retten. Den Anfang, die erste Grundlage für unsere Rettung erblicke ich aber in der Errichtung albanesischer Volksschulen. Als ich nun den russischen Consul die Frage hinsichtlich der nationalen Schulen stellte, sprach er sich entschieden dagegen aus und fing in überschwänglichen Worten die Wichtigkeit der griechischen Sprache für die Albanesen zu preisen an: Grund genug, dass wir von da an nie mehr ein Wort mit einander gewechselt haben. Ja, der geehrte Consul trägt sich sogar mit dem Gedanken herum und unterstützt die Tendenz, uns zu graecisiren oder vielleicht gar zu slavisiren, indem in Spata griechische Schulen eröffnet worden sind, in welchen auch russisch, albanesisch aber nicht vorgetragen wird. Doch trotz des russischen Geldes und russischen Bemühens bin ich überzeugt, dass ich in einer sehr kurzen Zeit Spata und die übrigen Gegenden Mittelalbanien's katholi-

./.

siren könnte, wenn ich nur auf die Hilfe des Österreichischen Consuls zu bauen vermöchte. Deswegen möchte ich noch heute nach Wien fahren und nicht nach Rom, wie mir gelegentlich Don Karolini /:?:/, der Secretär des katholischen Bischofs von Dura^{*)}, und auch letzterer selbst rieten. Als ich dem Don Karolini einwarf, ich möchte in keiner Weise selbst noch zur Italienisirung der Albanesen beitragen, fing er an, mir über die päpstlichen Anschauungen zu erzählen, und bemerkte, dass eine solche Reise gar nichts mit der italienischen Regierung zu tun hätte. Ich wendete ihm ein, er vergesse auf die Tatsache, dass alle katholischen Schulen in Nordalbanien ohne Unterschied, ob sie von Oesterreich oder Italien subventionirt werden, zur Unterrichtssprache das Italienische benützen und überhaupt ein völlig italienisches Gepräge haben; diese Tatsache allein beweise zur Genüge einen übertriebenen, schädlichen italienischen Einfluss. Würde ich oder ein anderer in Wien darüber vorstellig werden und die Dinge im richtigen Lichte beleuchten, so könnte nur von dort das, was zur Abhilfe notwendig ist, geschehen, während ich aus Italien, sei es von der Regierung oder von Sr. Heiligkeit dem Papste, gerade in dieser für uns vitalen Richtung naturgemäss absolut keine Abhilfe erhoffen können.

Don Karolini bemühte sich hierauf in ganz nervöser Weise die Berechtigung der ita-

*)

Anmerkung.

Bermanos erinnerte sich nicht genau an den Namen desselben.

./.

36.

lienischen Sprache als Unterrichtssprache zu beweisen, indem er sich darauf berief, es wäre dies etwas traditionelles; unsere Geistlichkeit hätte anfangs nur aus Italienern bestanden, wie noch heute sehr viele Italiener bei uns anzutreffen seien. Wir müssten daher dem Italienischen ein gewisses historisches Recht einräumen. Also, weil ein Uebelstand, rief ich, bei euch in Nordalbanien historisch geworden, sollen auch wir in Mittel- und Süd-Albanien denselben übernehmen ? ! Nachdem wir seit Menschengedenken gegen den Graecismus kämpfen, sollen wir katholisch werden, um uns dem Italianismus anheimzugeben ! Das geschieht nicht; denn wir verlangen und haben auch ein natürliches Anrecht auf ein selbständiges nationales Leben auf dem Boden der allgemeinen menschlichen Cultur und dieses selbständige nationale Leben können wir nur mit Hilfe Oesterreich's erhoffen, von Italien und durch einen italienischen Unterricht in unseren Volksschulen aber niemals erlangen. "

Archimandrit Germanos geriet bei dieser Erzählung in die feurigste Aufregung und wiederholte dann auch mir gegenüber immer und immer wieder seine Sehnsucht, wirklich ehestens nach Wien zu kommen, um sich hier an kompetenter Stelle Belehrung zu holen, in welcher Masse und in welcher Weise seine Wünsche hinsichtlich der Einwirkung Oesterreich-Ungarn's auf Albanien berechtigt sind, und um vielleicht auch selbst einiges zur wolwollenden Beurteilung dieser Wünsche beizutragen. Uebrigens fragte er mich um Rat, was am besten zu tun wäre. Ich legte

./.

ihm dar, wie ich weder im Stande, noch berufen sei, ihm diesfalls einen Rat zu geben, und dass er die Antwort nur von Wien bekommen könne.

Im weiteren Verlaufe unseres Gespräches erzählte mir Archimandrit Germanos von seinen sehr guten Beziehungen zu Dervis-Bej in Elbasan, dem weit und breit bekannten albanesischen Patrioten, und fügte bei, dass mich nicht nur dieser, sondern noch viele andere Albanesen in Elbasan mit grosser Freude erwarten. Interessant waren seine Auseinandersetzungen betreffs der Griechen und ihrer Propaganden auf dem Balkan. Da er 4 Jahre in Athen gelebt hatte, kennt er die griech. Tendenzen sehr genau. Er sagte, er befürchte von den griech. Bestrebungen gar nichts für Albanien; das lehrten die Resultate, die diese in den übrigen Balkanstaaten zur Folge gehabt haben, das ist: ein schliessliches Piasco.

Am folgenden Tage musste der Archimandrit wieder nach Elbasan zurückkehren, denn er fürchtete, dass sein Bischof, der an demselben Tage in Pogradec ankommen sollte, von seiner Anwesenheit erfahre. Er verlangte jedoch, dass ich mit ihm gehe. Nachdem ich vorher gehört hatte, dass Dervis-Bej von Elbasan abwesend sei, entschloss ich mich erst nach längerer Ueberlegung, von Germanos' Aufforderung Gebrauch zu machen. Ich tat dies, weil Elbasan für meine philologischen Studien sozusagen der wichtigste Ort Albanien's ist.

Sogleich am ersten Abend, nachdem wir in Elbasan angelangt waren, gab Archimandrit

In Elbasan.

38.

drit Gernanos anlässlich meines Besuches ein Mahl, zu dem er seine besten Freunde einlud. Unser Gespräch drehte sich anfangs um Dervis-Bej. Man bestätigte mir, dass Dervis-Bej ein sehr energischer und einsichtsvoller albanesischer Patriot sei, aber auf Schritt und Tritt bewacht werde, worüber er sehr gut instruiert ist. Man behauptete auch, dass er sehr gerne zur katholischen Religion übertreten würde, wenn nicht sein Leben dabei im Spiele wäre.

Abermals der Bischofen von Durazzo.

Darauf fragte ich nach dem neuen orthodoxen Bischof, und welchen Eindruck er bei seiner vor kurzem stattgefundenen Durchreise in Elbasan zurückgelassen hatte. Man erzählte mir hierauf manche Episoden aus der Zeit dieser Durchreise, so z.B. dass er in Elbasan mit Gendarmen seine Gebühren selbst einsammelte und bei denjenigen, welche durch dieses Vorgehen brüskiert, diese Gebühren nicht entrichten wollten, oder wegen Armut nicht entrichten konnten, die Gendarmen abscheuliche Barbareien und Gewalttaten verüben liess. Mit Gewalt habe man da Nahrungsvorräte und Einrichtungsstücke weggenommen und sofort verkauft, die Leute geprügelt u.s.w.

Daher wollte auch niemand am ersten Sonntage, als der Bischof die Messe lesen sollte, in die Kirche gehen. Die Unzufriedenheit gegen den Bischof sei umso grösser, als die Elbasaner gewünscht und erwartet hatten, es werde Gernanos als der natürliche Nachfolger seines Onkels Bischof werden. Wenn es nur gehen wird, sagten diese Elbasaner, werden wir diesen mislike-

./.

bigen Bischof davenjagen.

Lange sprach ich auch da mit meinen Cousin und dem zweiten Lehrer dortselbst. Beide versicherten mich, dass sie den Voratz haben, die Kinder nur in ihrer albanesischen Muttersprache schreiben und lesen lernen zu wollen. Beide kannten schon meine Orthographie. Der zweite Lehrer meinte, dass es in Elbasan mit geringen Hilfsmitteln sehr leicht wäre, die bestehende griechische Schule in eine albanesische umzuwandeln. Es existire ja in Elbasan gar kein Mensch, der griechisch gesinnt wäre, und es will der zweite d.h. der ältere Lehrer schon früher viele Mohamedaner und Christen albanesisch schreiben und lesen gelehrt haben.

Albanesische Orthographie.

Man sprach in Elbasan über den öfteren Besuch des österreichischen Herrn Consuls von Bitolj /:Monastir:/ und man glaubte, dass sich dadurch auch die Verhältnisse im Lande verbessern würden. Einige der angeseheneren Leute wussten auch zu erzählen, dass Dervis-Bej in einer näheren Beziehung zu dem erwähnten Consul stehe, und erhofften sich auch aus dieser Verbindung sehr viel Gutes.

In Elbasan arbeitet jetzt sehr fleissig eine vor kurzem eingeführte rumänische Propaganda. Sie errichtete dortselbst eine Schule. Schwer wollte ich anfänglich begreifen, dass sogar die Söhne des bekannten albanesischen Sprachforschers, Uebersetzers etc. Christoferidis rumänisirt und der ältere rumänischer Lehrer, der jüngere rumänischer Stipendist in Bukarest sein

Rumänische Propaganda.

40.

sollen. Man klärte mich aber dahin auf, dass die Gemahlin Christoforidis' eine Cinzero-Valachin sei und nach dem Tode ihres Mannes ihre Kinder bloss im rumänischen Sinne aufgezogen habe.

Christoforidis'
WB-terbuch.

Bekanntlich hat Christoforidis unter anderem auch ein albanesisches Lexicon verfasst. Dasselbe ist leider nur erst im Manuscript vorhanden und befindet sich jetzt im Besitze der drei Töchter Christoforidis'. Es hat für dieselben den Wert einer Mitgift.

Dervis-Bej.

Nach 3 Tagen verliess ich Elbasan, und wurde bis Cuks vom Archimandriten Germanos begleitet. Dort begegneten wir durch einen günstigen Zufall Dervis-Bej. der gerade heimkehrte. Dervis-Bej entsprach ganz der Schilderung, die ich über ihn in Elbasan erhalten hatte. Er ist wirklich ein sehr energischer, noch junger Mann und macht den Eindruck grosser Intelligenz. Leider konnten wir wegen der Anwesenheit seiner Begleitung, unter welchen sich Beamte, Gendarmen und andere befanden, nicht lange zusammen sein. Dervis-Bej versprach mir versuchen zu wollen, mir das Lexikon von Christoforidis zu verschaffen. Dies dürfte jedoch schwer gehen. Ich könnte mich nämlich mit einer Verletzung des Rechtes der dormaligen Besitzerinnen desselben nicht einverstanden erklären, der rechtliche Erwerb um den Anschaffungspreis von etwa 400 türkischen Lira würde aber auch einem Dervis-Bej, dessen Reichtum denn doch hauptsächlich in Grund

./.

41.

und Boden besteht, kaum entsprechen. Sehr sympathisch sprach Dervis-Bej von Herrn Österr.-ungar. Consul in Bitolj. Dieser soll sein bester Freund sein. Von mir wünschte er, dass ich noch ein Mal nach Elbasan käme, er möchte mit mir länger sprechen. Ich vermochte ihm nichts bestimmtes zu versprechen. Mit dem beiderseitigen Wunsche, uns möglichst bald wieder zu sehen, schieden wir in der freundschaftlichsten Weise von einander.

Von Cuk weiter, reiste ich durch Berzeſta und die ganze Mokra und kam erst in 2 Wochen nach Pogradec zurück, von wo aus ich dann wieder neue Ausflüge unternahm.

Mit meinem Schwager und dem ersten Secretär /: Baſcatib /: des Kajmakans von Pogradec, einem aus Flovdiv gebürtigen mohamedanisch-bulgarischen Auswanderer /: Mohadzir /: fuhren wir per Wagen zunächst nach Korca auf einer der miserabelsten Strassen der Welt.

In Zvezda, wohin wir nach 4 Stunden kamen und wo wir Rast hielten, sahen wir den Kapetan Kajo mit 5 Begleitern. Ich erwähne desselben, weil er sich 30 Jahre hindurch als Oberhaupt von Hajduken in Mittelalbanien wie ein unumschränkter Herrscher geberdete, im vorigen Jahre aber mit der Regierung Frieden geschlossen hat.

Kapetan Kajo
in Zvezda.

Abends waren wir in Korca. Wir stiegen bei einem meiner Verwandten ab. Am nächsten Tag besuchte ich den dort im Rufe eines grossen Patrioten stehenden und auch sonst sehr angesehenen Thimo Marko.

Korca.


Thimo Marko.

42.

welcher für die albanesische Schule in Korca grosse Opfer gebracht hat. Korca ist nämlich der einzige Ort in ganz Albanien, der wirklich eine albanesische Schule besitzt. Die Albanesen in Korca haben aus diesen Orten ein patriotisches Nest im besten Sinne des Wortes gebildet und sich auch zu dem Zwecke zusammengetan, um mit Hilfe der albanesischen Colonie in Rumänien eine Volksschule zu errichten, die der albanesischen Gemeinde in Korca untersteht und das Albanesische zur Unterrichtssprache hat.

Wegen dieser lebhaften albanesischen Bewegung hatten die Korcaner Albanesen viele Unannehmlichkeiten zu erdulden. Der griechische Bischof untersagte seinen Priestern, den Albanesen die religiösen Tröstungen zu gewähren; er selbst verfluchte sie öffentlich in der Kirche. Noch härter waren die Schläge, die man von der Regierung zu leiden hatte. Mit dem erwähnten Thimo Marko, bei dem ich über alles dies Näheres erfahren hatte, ging ich dann zu Oroman-Bej.

Oroman-Bej.



Oroman-Bej ist ein sehr gebildeter Mann, des Türkischen, Neugriechischen, Altgriechischen & Französischen mächtig. Er liesserte seine Freunde mich kennen zu lernen, da er von mir und dem Zwecke meiner Reise bereits von Istref-Bej aus Pogradec gehört hatte. Er meinte, dass zu den jetzigen Zeiten die Albanesen hauptsächlich noch von auswärts für die albanesische Idee und Sprache wirken müssen und dass wir viele solche, die dies tun, haben sollten, um etwas zu erreichen, da man

./.

ja von denjenigen, die im Lande selbst weilen, nicht viel erwarten könne; den letzteren hätte die ottomanische Regierung so fest die Hände gebunden, dass sie nur im geheimen mithelfen können.

Alle drei gingen wir schliesslich vorerst in die albanesische Knabenschule, wo durch einen Diener /:Sejmën:/ Croman-Bej's unsere Ankunft schon angemeldet worden war. Wir wurden sehr feierlich empfangen. Man sang uns albanesische Lieder vor. Der Oberlehrer prüfte dann zur Probe die oberste Classe durch, um uns die Fortschritte der Kinder zu zeigen. Der Lehrer sowie die Schüler hatten keine gedruckten Bücher, sondern nur Manuscripte. Die beiden angestellten Lehrer kennen ausser dem Albanesischen nur noch das Griechische. Daher sind die von denselben im Manuscripte verfassten und in der Schule verwendeten Lehrmittel nach griechischen Mustern zusammengestellt. Ich bat um eines dieser Manuscripte und konnte mich alsbald überzeugen, dass die als Muster gebrauchten ganz veralteten griechischen Originale keineswegs dem heutigen pädagogischen Standpunkte entsprechen. Ich versuchte den Lehrern in dieser Beziehung gesprächsweise Eignes zu erklären, und meinte, man möge doch wenigstens die neuesten griechischen Ausgaben übersetzen. Allein der Oberlehrer erklärte, dass es ganz unmöglich sei, solche in der Türkei zu erhalten; sie aus Athen zu bestellen, sei aber gleichfalls

Die orthodoxe albanesische Knabenschule.

44.

unausführbar, weil die türkische Regierung die Sendung vernichten würde. Mit Freude erzählte mir der Oberlehrer, wie sehr die albanesische Schule im Ansehen gestiegen sei und wie viel hiedurch auch die ganze albanesische Sache gewonnen habe, seit die Schule im vorigen Jahre durch den Besuch des österreichischen Consuls in Bitolj ausgezeichnet worden ist. Dieser Besuch habe besondere Wirkung und eine erhöhte Stimmung hervorgebracht, weil er gerade auf den Tag der Examina fiel. Ich bat den Lehrer schliesslich, den Schülern der obersten Classe aufzugeben, es möge ein jeder zu Hause irgend ein Märchen oder dergleichen aufschreiben. Ich wollte sehen, wie sich ein albanesischer Aufsatz von dieser Altersstufe :um das 15. Jahr :/ ausnehme.

Es geschah dies und ich sah später diese Aufsätze ein. Auf Grund dessen kann ich es als feststehend constatiren, dass zwischen den griechischen Schulen in Albanien, deren Erfolge ich sehr gut kenne, und diesen albanesischen bei gleicher Altersstufe gar kein Vergleich angestellt werden kann, so sehr übertreffen die in ihrer albanesischen Muttersprache unterrichteten Kinder ihre bedauernswerten Schulkollegen, die allen Lehrstoff durch das ihnen völlig fremde griechische Medium aufnehmen sollen. Wenn sich die albanesische Schule in Korca nur erhält und man dann mit der Zeit noch eine höhere, den Bedürfnissen entsprechende Schule dazu errichten würde, so wäre von einer griechischen Propaganda in Korca/: es existirt daselbst sogar ein ganzes griechisches Gymna-

./.

45.

sium :/ in Bëldo keine Rede mehr.

Abends gab Groman Bej ein Gastmahl, ^{Abendunterhaltung bei Groman-Bej.} an welchem die hervorragendsten Albanesen von Korca teilnahmen. Darunter befanden sich auch zwei Mohamedaner, die, wie man mir erzählte, gute albanesische Dichter sein sollen. Ich bemerkte auch wirklich, dass die beiden vortrefflich albanesisch sprechen. Der eine von ihnen, ein Hodza /: mohamedanischer Priester und Lehrer :/ hatte die Gewohnheit den Sprechenden ununterbrochen zu corrigiren, indem er für die gebrauchten türkischen Fremdwörter echte albanesische nannte.

Das Gespräch drehte sich um die Schulen, um den Bischof u.s.w. Furchtbar verriess man die griechischen Schulen. Ebenso kritisierte man das Gebahren des Bischofs sehr scharf. Man klagte darüber, dass viele sehr reiche Albanesen leider sogar Führer der griechischen Propaganda sind, und verdammte die Verblendung jener in der Fremde reich gewordenen und verstorbenen Landsleute, die ihr Vermögen der griechischen Propaganda in ihrer Heimat vermachten und der letzteren so das kräftigste Mittel in die Hand gaben, ihre Brüder zu entnationalisiren. Solche Fälle sollen sehr zahlreich sein. Groman-Bej bedauerte es, dass gerade von den reichen Albanesen, deren es ohnedies nicht viele gebe, nur die wenigsten patriotisch gesinnt sind, weshalb sich auch der beklagenswerte Zustand in Sachen, wo Geld vonnöten wäre, begreifen lässt. Thimo Marko ./.

46.

lobte es dagegen, dass es wenigstens in Bukarest manche hervorragende reiche albanesische Familien gebe, welche bisher schon viele materielle Opfer gebracht haben und welchen es hauptsächlich zu verdanken sei, dass man in Korca ein albanesisches Leben halbwegs blühen sehe.

Der Oberlehrer hinwiderum interessierte sich sehr für meine Orthographie, und ich benützte diese Gelegenheit, um dieselbe auf Grund der den Korčanern geläufigen Frastrischen Orthographie auseinanderzusetzen. Man lobte es, dass meine auf der Aussprache beruhende Orthographie viel einfacher sei; nur meinten die Leute, dass sich in ihrer Gegend die Orthographie nach Frastri bereits ziemlich eingebürgert habe. Sie entschieden sich deshalb dafür, meine Orthographie stufenweise einzuführen, was durch die Schule am ehesten durchführbar wäre, wenn man nur eine Quelle hätte, welche Bücher mit meiner Orthographie liefern würde.

Evangelische Mädchenschule in Korca.

Am folgenden Tage besuchte ich die evangelische Mädchenschule. Auch dort wurden wir mit Freude empfangen. Durch Zufall kam mir daselbst ein Manuscript in die Hände, welches die Geschichte der Entstehung und der Entwicklung dieser Schule enthält und von dem jetzt schon verstorbenen evangelischen Albanesen Gerasimos herrührt. Ich kam später auch in den Besitz eines zweiten Manuscriptes von demselben Verfasser. Letzteres enthält die Geschichte seiner Gefangenschaft. Ich hoffe diese Manuscripte, ins-

./.

47.

besondere aber das erstere bald irgendwo herauszugeben. Die genannte Mädchenschule überflügelt die oben früher erwähnte Knabenschule. Ich bekam auch hier gleiche Arbeiten der Schülerinnen in die Hand, wie von den Knaben, und ein Vergleich beider fällt zu Ungunsten der letzteren aus.

Aus Korca machte ich einen Abstecher nach Bobosnica und dann noch weiter etliche 6 Stunden südlich von Korca. Ausser sprachlichem Material brachte mir jedoch dieser Ausflug nichts Nennenswerthes.

Zurückgekehrt, reiste ich sogleich nach Bitolj. Unterwegs constatirte ich, dass die ganze Kaza von Prespa und Resna von Albanesen überflutet sind.

In Bitolj stellte ich mich sofort Herrn Král, dem Österr.-ungar. Consul daselbst vor. War ja doch mein Interesse für diesen Herrn schon durch jene Schilderungen geweckt worden, welche ich an den verschiedensten Orten der von mir bereisten Gegenden über ihn erhalten und im Vorstehenden kurz skizzirt habe. Ich erfuhr von ihm, dass er durch Euer Hochwohlgebornen über mich bereits benachrichtigt sei, und wurde sehr sympathisch und äusserst gastfreundlich aufgenommen. Den Gegenstand unseres Gesprüches bildeten hauptsächlich die albanesischen Verhältnisse. Es entpuppte sich mir in ihm ein grosser Freund der Albanesen, der dabei auch mit einer staunenswerten Kenntnis ihres Landes, Charakters, ihrer Bedürfnisse u.s.w.

Bitolj/: Monastir/: Der Öst.-ungar. Consul Herr Král.

./.

48.

ausgestattet ist. Er ist ganz erfüllt von der Gewichtigkeit seines Vertrauenspostens, und er, in dem der echteste Österreichische Patriotismus, der gewissenhafteste Amtseifer eines Österr.-ungar. Vertreters mir in so real erfasster Verbindung mit hingebungsvoller Freundschaft für Albanien wie verkörpert vor die Augen trat, erfüllte wieder mich, der ich albanesischen Patriotismus mit der aufrichtigsten Dankbarkeit und Anhänglichkeit an die Öster.- ungar. Monarchie in mir vereinige, mit dem glücklichen Gefühle einer wahren Ideen- und Interessenharmonie !

Ich möchte sagen, Herrn Král versteht es, wie keiner, aus Albanesen auch gute Österreicher zu machen.

Ich hatte schon eingangs mir erlaubt, meine volle Bewunderung für diesen so tüchtigen Vertreter Österr. Interessen auszusprechen, und kann ihnen, hochgeehrter Herr Sections-Chef, nicht verhehlen, dass ich als ein an Oesterreich mit allen Hoffnungen für seine Nation sich aus Ueberzeugung anklammern-der Albanese nur den Wunsch haben kann, es mögen Herrn Král's Anschauungen an hoher Stelle in Wien vollen Wiederhall finden. Dann werden wir - und hiezu ist jetzt der günstigste Zeitpunkt - nacheinander alsbald in der ganzen Bitoljer, Ochrider, Dibraner, Korcaner und Elbasaner Kaza, also in Horzen von Albanien Schulen eröffnen, in Wien einen albanesischen Bücherverschleiss, einen albanesischen literarischen Verein, vor welchen der in Bukarest von der Bildfläche

./.

48.

verschwinden muss, entstehen sehen und das Centrum, von welchem alles nationale Leben und Streben in Albanien Nahrung und Richtung bekommt, in Wien besitzen.

Es ist dies die einzige Abschweifung, die ich für meine eigenen Gedanken mir in diesem Reiseberichte bisher erlaubt habe.

Ich kehre nach Bitolj zurück. Herr Consul Král lernt eifrig auch selbst albanesisch. Unterrichtet wird er von einem sehr tüchtigen Sprachmeister. Es ist dies Georg Kyrias, der das Depôt der englischen Bibelübersetzung in Monastir inne hat. Ich lernte auch diesen kennen. Er, eigentlich aber sein verstorbener Bruder Gerasimos, haben sich grosse Verdienste erworben, indem sie trotz aller Schwierigkeiten unermüdlich für die Verbreitung der albanesischen Bibelübersetzung sorgten, wodurch sie ungemein viel zur Kräftigung der albanesischen Idee beitrugen.

Georg und Gerasimos Kyrias

Durch Vermittlung des Georg Kyrias wurde ich mit mehreren patriotisch gesinnten Albanesen Bitolj's bekannt. Ausserdem stattete ich aber auch dem serbischen Consul Michael Ristić, da er einstens in Belgrad mein Freund war und ich von ihm möglicher Weise einige interessante Expectationen zu erfahren hoffte, einen Besuch ab. Wir sprachen ebenfalls über albanesische Dinge. Ristić erzählte, dass auch die Serben jetzt anfangen, ein Interesse für die Albanesen an den Tag zu legen und für dieselben womöglich etwas zu tun. Man habe

Der serbische Consul Ristić.

./.

50.

jetzt in Belgrad an der Hochschule einen Albanesen, aus dem man einen tüchtigen Albanologen auszubilden gedenke. Er stünde mit Simic dem serbischen Consul in Altserbien, in Correspondenz. Beide kümmern sich vorzüglich um albanesische Sachen. Er lud auch mich ein, in serbische Dienste zu treten. Man würde mir gewiss ohne weiteres ein ordentliches Stipendium geben, mit dem ich ohne Sorgen beliebig irgendwo im Auslande meine Studien noch weiter vervollständigen könnte. Eine spätere Anstellung als Albanologe wäre mir in Belgrad in sicherer Aussicht.

Spione des russischen Consuls.

Als ich ein zweites Mal beim Österr.-ung. Consul war, machte mich dieser in reservirter Weise darauf aufmerksam, dass man in Bitolj unter den Consula sehr viel über mich spreche, und dass insbesondere der russische Consul mich durch Spione sehr strenge beobachten lasse. Ich habe auch einmal mit einem dieser Spione, Namens Vasiljev, zusammen genachtmahlt. Es war dies beim Dr. Anastas Hristidis, meinem einstigen Schulcollegen, bei dem er plötzlich ganz ungerufen erschien. Wir sprachen aber bloss von den slavischen und griechischen Angelegenheiten in Macedonien. Vasiljev lud mich ein, ihn in seiner Wohnung zu besuchen. Er hätte es daselbst gewiss versucht, mich etwas auszuforschen. "Leider" musste ich, durch die Umstände gezwungen, wieder den Reigestab in die Hand nehmen und weiter ziehen.

Schlusswort.

Ich muss Ihnen, mein innigst verehrter Weltäter, bestens danken, wenn Sie die gros-

./.

51.

se Geduld hatten, den ganzen vorausgeschickten Reisebericht durchzunehmen.

In der Einleitung habe ich mir die Bemerkung erlaubt, dass nach meinem unmassgeblichen Dafürhalten Oesterreich durch tausendfache Gründe geradezu gezwungen sei, auch die albanesische Frage in die Hand zu nehmen. Woraus ich diese Bemerkung herleitete, hat sich - glaube ich - im Laufe meiner obigen Reiseerzählung von selbst ergeben. Man sieht genau, wo Not und die dringendsten culturellen Bedürfnisse das albanesische Volk bedrücken. Man hört, wie laut und allgemein die im Volke tief eingewurzelte Hochachtung und das Vertrauen auf Oesterreich zum Ausdrucke kommen. Man überzeugt sich, dass es nicht etwa nur meine Stimme, sondern Volkestimme ist, die da ruft: Bücher und Schulen, überhaupt Förderung der geistigen und culturellen Auferstehung der Albanesen; Ausbildung talentirter Jünglinge; Hilfe und Schutz bei Gründung eines albanesischen geistigen Centrums in Wien! Wahrlich finden Sie hierin nicht eine schöne Aufgabe für einen grossen Culturstaat, wie Oesterreich-Ungarn, bei dem es ein geschichtlicher charakteristischer Zug geworden ist, überall und immer für die Wahrung und Verbreitung der Humanität und Civilisation einzutreten! Möge man doch die Sympathien, die Oesterreich-Ungarn unter den Albanesen geniesst, nähren und nicht verloren gehen lassen! Ich könnte an letzteres nicht denken, aber ich er-

./.

52.

wähne es, weil andere auf der Lauer sind und mir die Zeit schon sehr vangerückt, die Sache vielleicht schon in dem höchsten Stadium der Reife zu sein scheint.

Mit dem nochmaligen Ausdrucke meines innigsten Dankes an meinen grossen Vortäter, ohne den ich meine Heimat nicht so bald und auf eine solche, besonders in meinem speciellen Fachstudium von so viel Erfolg begleitete Art gesehen hätte, zeichne ich mich Euer Hochwollgeboren

ergebenster und dankbarster

Đorđ Pekmezi

cand.phil.

Antiquarisch
Scherer'sche Antiquarische
Bibliothek

[1]

Shkëlqesia juaj zotëri Shef i Seksionit

Bamirësi im më i dashur!

Hyrje

Rreth dy muaj më parë ndërmora një udhëtim në atdheun tim, në Shqipëri. Kjo u bë me qëllim të studimeve filologjike të disa dialekteve shqiptare me ç'rast synoja - pa u shpërqendruar nga detyra ime kryesore - që në studimet e mia të përfshij edhe vrojtimit e rrethanave të tjera, e sidomos gjendjen kulturore dhe politike të atdheut tim.

Por për mua si një vendës, që nuk isha një kohë të gjatë në atdheun tim, ishte e pashmangshme që të interesohesha qoftë për këtë qoftë për atë çështje në fushën e kulturës dhe të politikës, ngase vrojtimit përkatëse të tyre imponoheshin vetvetiu. Duke marr parasysh kërkesën tuaj miqësore, dëshiroj këtu t'i përmbledh shkurtimisht përshtypjet e ndryshme të fituara në këtë mënyrë. Këtë e bëj edhe më me qejf sikur eventualisht do të

[2]

arrij dy gjëra: të paraqes gjendjen në Shqipëri në një dritë më të mirë dhe t'i shërbej kauzës Shqiptare.

Sa i përket të parës, për t'i hedhur Shqipërisë një dritë më të mirë, nuk duhej të ishte një përpjekje aq e guximshme dhe e tepruar, nëse kihet parasysh se ky vend evropian gati tërësisht i panjohur dhe në një errësirë të plotë mundet në çdo pikëpamje të rivalizojë me zonat më të largëta të Afrikës. Në të vërtetë, hulumtuesve evropianë, etnografëve, arkeologëve e madje edhe politikanëve mund tu thuhet: përse bridhni në largësi, e mira është aq afër! Që nga kohët e Hahn-it, pavarësisht nga përpjekjet dhe sakrificat, deri më tani askujt nuk i shkoi përdore ti vazhdonte arritjet e bukura të Hahn-it në mënyrë të njëjtë. A mund të shpjegohet kjo gjoja se deri më tani vetëm forcat e dobëta morën guximin të punojnë diçka, por edhe këtyre u ka munguar mbështetja esenciale dhe e domosdoshme e një trupi më të fortë kulturor, e një shteti kulturor? Dhe për kë mund t'i shkojë mendja dikujt se kush mund të jetë ky i fundit, përveç se Austro-Hungaria

fqinje, e cila me pushtimin e Bonjë e Hercegovinës u bë *de facto* bartësja e vetme natyrore e kulturës për tërë gadishullin e Ballkanit.

Por për Austrinë Shqipëria nuk është vetëm një objekt i studimit shkencor,

[3]

të cilin dijetarët e saj janë të thirrur ta bëjnë. Për Austrinë - këtë bindje nuk mund ta heq - ka edhe shumë më shumë interesa të rëndësishëm, jashtëzakonisht vitalë dhe të pakundërshtueshëm, politikë, tregtarë dhe interesa të tjerë që pashmangshëm sfidojnë pikërisht vëmendjen e Austro-Hungarisë për vendin në fjalë dhe banorët e tij. Në Shqipëri, propagandat e ndryshme, të cilat janë duke demoralizuar popullin, ende nuk janë aq të avancuara si p. sh. në Maqedoni; megjithatë edhe aty ato kanë filluar të fermentohen. A nuk do të duhej të ketë ndonjë shpresë bindëse se Austria do të jetë në gjendje për të vënë dorën e saj të fuqishme, dhe t'u datë përballë dëshirave dhe simpatie, tashmë të përhapura dhe të bëra publike në Turqi, që populli i braktisur shqiptar i ka për Austro-Hungarinë, mirëpo pesha e madhështisë së saj mos të shpie në një degjenerim, në një shkombëtarizim të fisit vendës /: sikurse kombet e tjera të vogla të cilat si të tilla synojnë të shumohen për disa milionë /:, por më tepër të jetë një detyrë ideale, si bastion i qytetërimit dhe bartës i kulturës të shohë reputacionin dhe forcimin e saj. Shqiptarët janë fqinjët e monarkisë austro-hungareze, prandaj për shkak të një nevojë natyrore, herët a vonë, do të ndodhë një balancim ndërmjet vendlindjes së kulturës që konsiderohet Austro-Hungaria dhe një vendi

[4]

të zhveshur tërësisht nga kultura, por të pasur me tipare aq të shumëllojta si shteti shqiptar. Mbase qysh tani "disa gjëra" janë duke ndodhur, por mund t'ju siguroj se kjo nuk mjafton për të arritur çfarëdo rezultatesh brenda Shqipërisë. Vështirë shihen gjurmët se do të bëhet diçka; ngase në Bruksel, Bukuresht, Sofje, Athinë, Itali e Jugut ose në ndonjë vend tjetër nuk mund të gjendet ndonjë furnelë për të përgatitur ndonjë ushqim të shëndetshëm dhe shpirtëror për popullin shqiptar aq të etur për libra, shkolla, arsimim, kulturë dhe çlirim: ai mundet, ai duhet të jetë vetëm në Vjenë.

Bëhet gabim i pamasë nëse një shqiptar apriori paramendohet si një i egër i uritur thjesht për grabitje dhe vrasje, që, në krahasim me një të egër joeuropian është më i rrezikshëm dhe më antipatik, ngase ai është më i zoti me armë zjarri dhe ka më shumë kurajo. Besoj që përshkrimet e mia në vijim tregojnë sa thellë janë të ngulitura te shqiptarët rrënjët e vetnjohjes dhe të një patriotizmi të mirëfilltë dhe të vetëkuptueshëm - një patriotizmi që shpie në formimin e një individualiteti kombëtar, që rrjedh vetvetiu si fryt vetarsimues nga përvetësimi i lirshëm i kulturës. Sa gjëra të bukura dhe fisnike do të mund të tregoheshin sikur të ndërhynte një forcë ndihmëse.

[5]

Kudo ku kam qenë, prijësit e popullit, para së gjithash, me një entuziazëm të theksuar, më tregonin se ç'gjëra mund të bënte dashuria ndaj popullit të vet, sikur ajo të kthehej në realitet.

Çështjet fetare nuk janë në qendër të interesave të patriotëve shqiptarë /:si të tillë pretendojnë pothuaj të gjithë njerëzit, që, sipas koncepteve të atjeshme, i përkasin inteligjencës/ por kujdesi për mirëqenien kombëtare, e cila rezulton edhe më e dhimbshme, për shkak se njerëzit janë të vetëdijshëm, veçanërisht në mungesë të mjeteve të nevojshme materiale, për pa-fuqinë e tyre. Me një sinjeritet naiv - kryesisht për shkak se unë vija nga Austria dhe madje studioja atje - më rrëfenin gjithandej, se si me një bindje të fortë presin ndihmën e domosdoshme nga Austria. Dhe në qoftë se kjo ndihmë është e këshillueshme, atëherë është edhe lehtë e realizueshme. Pa hyrë në teoritë politike, besoj se është e nevojshme të mbështeten aspiratat kulturore të shqiptarëve, para së gjithash *për të siguruar librat e nevojshëm dhe për të ndërtuar një sistem shkollor vendor të bazuar në gjuhën kombëtare*. Çështjet e përmendura deri më tani

[6]

përputhen edhe me prezantimet e konsullit në Manastir, z. Kral, të cilin pata nderin ta vizitoja herë pas here, me ç'rast i jepja vetit liri të ngrija edhe çështjen e arsimit dhe të librave shkollorë. Do të kisha dashur të përmend një fakt, natyrisht me një lutje të theksuar që ky të mos kuptohet si një gjykim i pacipë, se z. Kral është një mbrojtës shumë i vyeshëm, energjik

dhe me pikëpamje të thella të interesave austriake në gadishullin Ballkanik, i cili ka arritur t'i përfshijë në mënyrë të zgjuar edhe interesat shqiptarë dhe t'i kombinojë ndër vete.

Në fund të kësaj hyrjeje i jap të drejtë vetes të bëj një lutje, që në përshkrimet e mia në vijim mos të kërkohet një sistematikë dhe kompletim i fiksuar. Qëllimi i udhëtimit tim - siç e thashë edhe më herët - ishte i ndryshëm nga subjekti i këtyre rreshtave. Unë jam po ashtu i vetëdijshëm për dobësitë e mia në politikë. Dua vetëm të përmbush dëshirën e Shkëlqesisë Suaj për të parashtruar përshtypjet e mia të udhëtimit - pavarësisht nga qëllimi i tij i fundit. Në mënyrë që të jem mundësisht sa më i saktë dhe objektiv, do t'i përmbahem rrjedhës kronologjike të udhëtimit dhe, duke ndjekur atë, do t'i shkruaj vëzhgimet dhe përvojat që kam pasur.

[7]

Shqiptarët në Sofje dhe veçanërisht në Bukuresht

Rrugëtimin e mora nëpër Serbi. Qysh këtu /: te Nishi/ gjatë udhëtimit pata madje mundësi të takohesha me shumë shqiptarë intelektualë, të cilët ktheheshin nga Bullgaria dhe Rumania. Ata që vinin nga *Bullgaria* dinin fort mirë për aktivitetet e shoqatës "Dëshira" në Sofje; por të gjithë dinin edhe për veprimtarinë e shqiptarëve në Bukuresht dhe ishin të mbushur përplot me vetëdije patriotike. Në mesin e tyre dalloheshin sidomos ata që vinin nga *Rumania*, të cilët, përveç të tjerave, tregonin për botimin e Historisë së Skënderbeut në vitet e kaluara nëpër revistat shqiptare. Ata gjithashtu mburreshin se si tashmë dinin të shkruanin dhe lexonin shqip. Në fund më thirri mënjane, mund të themi, më intelektual në mesin e tyre dhe më tregoi një mori librash shqiptare, të cilat ai donte t'i sillte në vendlindje të fshehura si dhurata, ani pse e dinte mjaft mirë rrezikun që i kano-sej për këtë. Në pyetjen time, ku i ka blerë librat dhe sa ka paguar për to, ai u përgjigj se ato merreshin pa pagesë nga bashkëvendësit në Bukuresht, të cilët me vite të tëra bëjnë përpjekje për të na pasuruar me libra shqip. Meqë unë isha i interesuar për mënyrën se si sillej qeveria rumune

[8]

me shqiptarët atje, ai më tha se Bukureshti është një vend i favorshëm për

punë patriotike, duke mos pasur asnjë pengesë nga ana e qeverisë, ata madje gjetën mbështetje tek ajo. Vllehtë janë thjeshtë, tha ai me naivitet, aleatët tanë.

Rauf-Bej në Leskovik, pastaj poeti Fërasri [Frashëri] dhe studentët shqiptarë në Konstantinopojë

Në Selanik me një rastësi fatlume u takova me Rauf beun dhe babain e tij Asllan beun nga Leskoviku në Shqipëri. Para dy viteve, Rauf beu u diplomua në Konstantinopojë në një shkollë të lartë turke dhe do të duhej, po qese nuk do të shfaqet ndonjë mosbesim te qeveria turke për shkak të paraqitjes së tij dukshëm patriotike, të emërohej prefekt në njërin nga qytetet e mëdha. Rauf beu më tregonte se si shkolla e cekur vijohej nga shqiptarë të rinj dhe se si këta të rinj kanë një bindje jashtëzakonisht patriotike dhe janë shumë të entuziazmuar për çështjen shqiptare. Kjo, sipas mendimit të tij, është rrjedhojë e takimit të shpeshtë të tyre me poetin më të mirë të sotëm shqiptar dhe patriotin e madh Naim beun, i cili është i vendosur në një vend për mua të panjohur në Konstantinopojë. Rauf beu dëshiron të jetë në korrespondencë (kontakt) me të gjithë kolegët e tij. Po të njëjtit vazhdimisht i raportojnë

[9]

për sukseset që ata i arrinin në përhapjen e patriotizmit shqiptar. Rauf beu dinte edhe për shqiptarët e shkolluar në Mejtepin e Madh të Manastirit, shumë gjëra dhe konstatoi se edhe atje mbizotëronte një frymë e njëjtë. Në fund Rauf beu foli edhe për veprimtarinë e tij. Ai vetë ka shkruar disa poezi në gjuhën shqipe dhe ka përkthyer nga turqishtja në gjuhën shqipe një gjeografi. Ai do të kishte bërë në këtë drejtim madje me forca të shumëfishuara edhe më shumë, nëse puna e tij do të ishte botuar diku. Më dukej sikur ai priste t'i thosha: m'i jep dorëshkrimet, ngase unë në Vjenë do të siguroja shumë lehtë shtypjen e këtyre gjërave aq të nevojshme për ne. Unë vërejta këtu **për herë të parë mendimet, të cilat i hasa në përgjithësi në Shqipëri, sa kërkohej dhe shpresohej ndihma nga Vjena.**

Pikëpamja e Rauf beut është: shqiptarët nuk do të mund të ekzistojnin tërësisht të pavarur, duke u mbështetur vetëm në vetveten, prandaj

duhet t'i bashkohen një fuqie të huaj. A do të mund të ishte kjo një shtet ballkanik, si Mali i Zi, Greqia, Serbia apo Bullgaria, pyeste ai duke u qeshur. Çfarë na mbetet, pra?

[10]

Të italianizohemi nga Italia e pastaj të lindim në lecka të varfërisë së bashku me vëllezërit italianë dhe të shumëzohet kështu vrasësit anarkistë? Por është për t'u habitur, tha Rauf beu, me përparimin e hovshëm, i cili që nga okupimi i Bosnje e Hercegovinës nga Austria, është i aq dukshëm, sa që është i njohur kudo te ne në Shqipëri dhe të cilin fundja edhe ne në Shqipëri duam ta përjetojmë. Pa asnjë dyshim, vetëm Austria është në gjendje të bëjë diçka të duhur nga ne, prandaj ajo edhe gëzon simpati të madhe dhe reputacion aq të mirë.

Propaganda bullgare, peshkopi dhe biblioteka e Shën Klimentit në Ohër

Nga Selaniku nëpër Manastir shkova në Ohër, ku për shkaqe private isha i detyruar të bëja një qëndrim më të gjatë. Meqë në këtë zonë, ku kam shumë miq dhe të njohur, nuk kam qenë tash 10 vite, vizita ime nxiti goxha vëmendje dhe, pa bërë ndonjë mund, në një kohë të shkurtë u inaugurua në të gjitha rrethanat e atjeshme, siç janë p. sh. propagandat e ndryshme. Për këtë bisedova me peshkopin bullgar Metodie nga Ohri. Sipas pikëpamjes së tij në rrethinën e Ohrit propaganda bullgare ka më së shumti gjasa për sukses. Ai është i bindur se Serbët kurrë nuk mund t'u afrohen bullgarëve. Ai gjithashtu e di tamam se qeveria turke u vë pengesa bullgarëve mu për arsye se ata paraqesin fuqinë më të madhe,

[11]

ndërkaq propagandën serbe dhe të tjerat i mbështet. Në bisedë e sipër peshkopi pandehte se ideja tashmë e njohur dhe tejet e përparuar shqiptare mund të ngërthejë një rrezik në dëm të bullgarëve. Natyrisht, bullgarët duhet të lidhin edhe ashtu një aleancë me shqiptarët. Por, sipas përvojës së tij, shqiptarët nuk kanë fort simpati për një ide të tillë. Ai vetë ka dëgjuar shpesh nga shqiptarët se mezi e presin një okupim të Austro-Hungarisë si

në Bosnje e Hercegovinë. Nga vetë goja e peshkopit për herë të parë dëgjova për ekzistimin e një lëvizjeje shqiptare në Ohër. Siç e vërejta, peshkopëve në përgjithësi u janë dhënë detyra nga ana e qeverisë bullgare të përcjellin nga afër të gjitha çështjet madje edhe ato më pak të rëndësishme. Kur pas disa ditëve peshkopit ia ktheva vizitën, ai më tregoi, sqaroi dhe shkurtazi i përshkroi disa libra-pergameni sllave, të cilat i shikova përciptazi. Prandaj ai më ofroi nëse kisha dëshirë të shihja bibliotekën shumë të pasur të Shën Klimentit, ku kishte disa libra të cilat ishte në gjendje t'i vlerësonte. Biblioteka e përmendur dikur përmbante një thesar shumë të çmuar të librave të rëndësishëm dhe monumente arkeologjike. Sot,

[12]

kjo është tashmë shumë më e varfër, ngase miqtë e shkencës kanë zbuluar se këtë të fundit duan ta ndihmojnë duke e vjedhur.

Mjerisht pata kohë vetëm një javë për të shfletuar përciptazi koleksionin e afro 200 librave. Për disa dorëshkrime sllave, disa prej të cilave kanë interes të madh për historinë e letërsisë së vjetër, mora shënime më të përafërta. Gjithashtu me veti solla edhe një tabelë inventari për tërë bibliotekën.

Propaganda serbe

Për sa i përket propagandës serbe, bisedova me mësuesin e shkollës serbe në Ohër, Georg Tasić, me të cilin u pata njoftuar para shumë viteve në Beograd. Me paraqitje miqësore, ai u shpreh për përparimin shumë të shpejtë të propagandës serbe në Ohër, posaçërisht për ngritjen e madhe që kishte përjetuar viteve të fundit. Gjithashtu, do të zgjatë edhe vetëm një vit, përderisa të formohet një hierarki serbe për Maqedoninë. Dhe kështu shpresoj, tha ai, se nuk do të zgjatë më me vite, që e gjithë Maqedonia do të pranojë të jetë Serbi./: deri më tani u arrit që në Ohër vetëm 10 shtëpive t'u jepet ryshfet dhe të bëhen për vete./

Propaganda greke

Për propagandën greke bisedova me vetë peshkopin. Ani pse

[13]

ai ishte bukur i kënaqur me përparimin, e vërejta menjëherë, se në zërin e tij nuk mbizotëronte një bindje e atillë siç e pat p. sh. peshkopi bullgar. Asnjë grek nuk zuri vend në Ohër, të 12 shtëpitë grekofile ishin aty vetëm se kishin në dispozicion pasurinë e manastirit të Shën Naumit në afërsi të Ohrit. Ndërmjet serbofilëve dhe grekofilëve ende zotërojnë marrëdhënie miqësore, por të tillat tani më kanë pushuar në Selanik.

Kleriku dhe shkolla

Shumë priftërinj grekë erdhën tek unë dhe më pyetën se a do të ishte i mundshëm bashkimi me ritin katolik dhe çfarë e mire do të lidhej me këtë. Ata kishin dëgjuar se priftërinjtë katolikë paguheshin shumë mirë nga Papa dhe prandaj nuk kishin nevojë të merrnin nga populli, çfarë do të ishte veçanërisht e mirëseardhur për popullin tonë të varfër. Të njëjtën pyetje ma bënë 2 priftërinj grekë edhe në Pogradec. Mirëpo, ata nuk u interesuan vetëm për pagesën e priftërinjve katolikë, por më shumë se si do të ishte lidhur në mënyrë të duhur katolicizmi me shkollën dhe ndriçimin e mendjes së njerëzve. Njëri, at Konstatini, i karakterizoi shkollat e pakta greke sot në Shqipërinë e jugut shumë mirë, me ç'rast ai konstatoi se sa jopedagogjike janë ato. Fëmijët dërgohen 13 vjet për të mësuar

[14]

e në fund arrijnë një rezultat me të cilin nuk janë në gjendje as një letër të zakonshme ta shkruajnë në greqishten e re apo një libër grek, vetëm keq mund ta kuptojnë. Dhe kështu ndodh që për nevoja të përditshme të të shkruarit asnjë gjuhë të mos hyjë në përdorim. Mbi këtë vjen edhe padituria e plotë rreth gjërave të domosdoshme, që kudo e krijojnë themelin e kulturës, por për të cilat fëmijët, që kanë përfunduar shkollat e cekura, pothuajse gati fare nuk ia kanë idenë p. sh. për bazat e aritmetikës apo të fizikës, etj.

Marrëdhëniet shqiptare

Edhe për marrëdhëniet shqiptare në Ohër mësova fillimisht nga goja e njerëzve që i përkasin propagandës greke, para së gjithash nga disa ish

kolegë të shkollës nga *Ελληνικόν σχολεῖον* (shkolla helenike T. A.) e Ohrit /:e shpjegueshme sipas grekofilëve/ dhe nga peshkopët e atyshëm grekë.

Hamdi beu në Ohër

Veçanërisht shumë dinin të më tregonin për patriotin e madh dhe shumë të ndritur shqiptar, Hamdi beun, i cili, për shkak të pjesëmarrjes së zjarhtë dhe të mrekullueshme në kauzën shqiptare, ka qenë i mbajtur në burg madje disa vite. Ai në Ohër themeloi një shkollë të fshehur shqiptare dhe bënte shumë për shpërndarjen e librave shqip. I shoqëruar nga një mik,

[15]

i cili tani është në periferi, ai madje /: ai më vonë ma përmendi këtë vetë/ kishte mbledhur tregime shqiptare, poezi dhe fjalë në dialekte të ndryshme dhe sikur të kishte mundësi, këto përmbledhje do t'i botonte¹. Ai vërtet në tërë rrethinën Ohrit, Manastirit, Dibrës, Elbasanit, Pogradecit, Korçës është i njohur si një patriot entuziast dhe është i vëzhguar nga ana e qeverisë; por pavarësisht të gjithave ai është, siç u binda më vonë edhe vetë, pothuajse një zotërues i plotfuqishëm kudo në rajon.

Me padurim dëshiroja ta njoftoja këtë njeri interesant dhe për mua aq të rëndësishëm, prandaj mu për këtë i bëra vizitë. Sapo dëgjoi për mua, se kisha ardhur kryesisht me qëllim të një studimi të gjuhës shqipe në terren, si dhe që unë e njihja dhe e çmoja qëndrimin e tij patriotik-shqiptar dhe veprimin e tij vetëflijues, ai filloi të rrëfente me entuziazmin më të madh se si me kënaqësinë më të madhe do të ishte i gatshëm për atdheun e tij, të zhveshur nga gjithçka dhe në pikëpamje kulturore aq të varfër, shqiptar të bënte sakrificat më të mëdha dhe me energjinë më të madhe të ndikonte ditë e natë në shpëtimin dhe ngritjen e tij.

[16]

Ai, siç më tha, kishte qenë një vit të plotë në Serbi /:Belgrad/, për këtë arsye ai edhe kultivon njëfarë marrëdhënieje miqësore me njerëzit e propagandës serbe; një herë p. sh. e takova madje në shkollën serbe.

¹ Vërejtje. Ndoshta do t'ia dal ti siguroj këto përmbledhje.

Iluminizmin e tij shqiptar, pikëpamjet nacionale dhe entuziazmin për kauzën e atdheut të tij, ai megjithatë i krijoi në Bukuresht, ku jetoi bukur gjatë. Ai këtë e pranon edhe vetë në mënyrë shumë mirënjohëse. Me konsullin austriak në Manastir është i lidhur me lidhjet më të afërta të miqësisë. Sipas dokeve shqiptare ai ishte vëllam i tij. Kështu në fillim ai kërkonte nga unë një çfarëdo shenje të zotit Kral, që të mund të hynte tërësisht lirshëm në bisedë për gjëra të tilla. Në përgjithësi vërejtja se Hamdi beu /: sigurisht për shkak të dënimit me burg/ ishte bërë shumë më i kujdesshëm dhe diplomatik se sa fillimisht, në bazë të rrëfimeve për të, e kisha pararenduar. Ai vetë fliste se si ai tashmë ishte më i avashtë se ç'kishte qenë dikur. Më së shumti e brente ndërgjegjja se si shumë gjëra do t'i shkonin përdore, sikur të kishte në dispozicion fonde të nevojshme. Çdo ditë vinin njerëzit tek ai dhe kërkonin libra prej tij. Ai vetë donte t'i lexonte të gjitha ato që botoheshin në shqipe, "por ky qen i Stambollit, thoshte ai,

[17]

na ndalon të gjithat dhe madje nuk na lë për të qenë ashtu siç jemi në realitet². Ne i njohim mjaft mirë aspiratat e Stambollit, të cilat shpjen drejt turqizimit tonë. Këtë nuk e pandeh vetëm unë, tërë Shqipëria e di këtë. Por, ne do t'i tregojmë këtij qeni të mjerë se ne jemi shqiptarë e jo tatarë. Ne kemi vendosur, ose të mbetemi bij të Skënderbeut ose më mirë mos të jemi fare!

Më shumë se rrethanat e pavolitshme në Stamboll, po na paralizojnë varfëria jonë, mungesa e të hollave, e cila po na e pamundëson hapjen e shkollave shqipe dhe sigurimin e librave të domosdoshëm për to.

Kemi një shkollë të vetme në Korçë, madje edhe ajo po mbahet në jetë me vështirësi dhe përpjekje të papara. Është e vërtetë se tashmë shumë është bërë në Bukuresht, por, skamjen që sundon këtu vetëkuptohet se asnjë shoqatë nuk mund ta përballojë. Të kërkosh apo shpresosh një gjë të tillë do të ishte një gabim i bezdisshëm. Të them sinjerisht, shtoi më tutje Hamdi beu, unë vërtet nuk e kuptoj se si Austria, fuqia e vetme e madhe kulturore pranë nesh, nuk e shfaq as interesin më të vogël, ani pse kjo do të ishte në dobi të saj.

² Vërejtje: Besoj se këtë shprehje aspak të pavend dhe mjaft të pahijshme, që është tregues i revoltës së egër të Beut mysliman, është riprodhuar pa ndonjë ndryshim.

[18]

Është për tu habitur se si ne ende s'e kemi humbur simpatinë për Austro-Hungarinë. Ndoshta kjo është madje e dëmshme për ne, sepse ne nuk mund të presim më gjatë. Është koha e fundit që ne të zgjohemi. Ndoshta një fuqi tjetër do të kishte mundësi, nëse Austria nuk do, që neve, kombit më të egër, më të varfër dhe më të harruar në Evropë, më në fund të na ofrojë megjithatë dorën e ndihmës. Do të kishte gjithashtu mundësi t'i dërgojmë një memorandum Evropës së arsimuar, në të cilin do të paraqitnim gjendjen tonë të bezdisshme e të mjerueshme. Por, diçka e tillë me shumë të ngjarë nuk do të na bënte shumë të devotshëm. Me siguri do të kishim zgjuar simpatinë e njerëzve me mendje fisnike; por një ndihmë të vërtetë dhe të gjerë mund ta ofrojë padyshim vetëm një shtet fqinj me kulturë të madhe. Në përgjithësi më duket se Evropa rrethanat tona jo vetëm që nuk i di, por për to as që do të brengoset; përndryshe si ka mundësi që si bastion i civilizimit të heshtë dhe të mbetet jovepruese".

Këto ishin shprehjet e një dëshpërimi tejet të egër, të cilat bëra përpjekje t'i riprodhoja mundësisht *fjalë për fjalë*.

Rrethanat në Pogradec

Nga Ohri lëvizta në Pogradec. Atje, si dhe në tërë zonën e Mokrës dhe Korçës, ideja kombëtare shqiptare ishte gjithandej e përhapur. Të vetmit në Pogradec,

[19]

që nuk bënë pjesë në këtë, ishin prifti i atjeshëm at Kosmai dhe i biri i tij, mësuesi i tanishëm në këtë vend, të cilët paguheshin nga qeveria greke dhe nuk gëzonin ndonjë reputacion të veçantë. Me mua që të dy këta u sollën në mënyrë dykuptimëshe. Ata e luanin rolin e spiunëve. Kështu një herë ndodhi që me nxitjen e tyre shtëpia e vëllait dhe e dhëndrit tim, në të cilën banoja, një natë u rrethua dhe u vëzhgua nga një grup xhandarësh.

Se ndjenja patriotike shqiptare në zonat e Starovës, Mokrës dhe Korçës kishte kapur rrënjë të qëndrueshme veçanërisht edhe në shtresat e thella të popullatës, duhet t'i atribuohet shkuarjes së shumicës në Rumani,

ku ata gjenin punë lehtë /: kryesisht si ndërtimtarë/ dhe ku e njëjta koloni e mërgatës në Bukuresht praktikonte një veprimtari të tillë iluministe, ashtu që këta njerëz të thjeshtë, më vonë të kthyer në Shqipëri, edhe vetë i mbillnin më tutje ndjenjat e zgjuara patriotike. Me këtë shihet se si në mënyrë të thjeshtë mund të arrihen rezultate mjaft të vlefshme.

Te patriotët e Pogradecit gjeta një reflektim akoma edhe më të madh se sa tek ata të Ohrit. Në Ohër shqiptarët e dinë

[20]

se në përzierjen e atjeshme me bullgarët, turqit, cincarët, ciganët etj. ata nuk paraqiten me aq vetëbesim si aty ku jetojnë në shumicë. Për më tepër shqiptarët e Ohrit janë pothuajse myslimanë të pastër dhe si të tillë ata jetojnë në lagjen turke /:Maala/. Mu për këtë është shumë vështirë të nxirren të dhëna të besueshme për të përcaktuar numrin e tyre.

Në anën tjetër, sipas shqiptarëve, në lagjen e Starovës banojnë gjysma ortodoksë dhe gjysma myslimanë.

Në Pogradec, si dhe në pjesën tjetër të kësaj pjese të vendit, të cilën e vizitova, arrita gjatë qëndrimit tim madje aq të shkurtë, të përfitoj - për shkak të latinishtes - veçanërisht shumë njerëz të shquar për alfabetin tim të hartuar dhe justifikuar në vëllimin XXI të arkivit për filologji sllave, f. 214 dhe të njëjtin ta përvetësojnë si të tyrin, ashtu që qysh prej kthimit tim në Vjenë letrat e arritura nga kjo zonë tek unë janë të shkruara me një ortografi të përkryer të alfabetit tim të cekur dhe që shkruesit e këtyre letrave, nga të cilët shumica qysh më parë e njihnin një alfabet si "babanë e tyre shpirtëror" /: disa prej tyre alfabetin turk, të tjerët grek, por shumica gjithashtu edhe ortografinë të bërë zakon në Shqipërinë e mesme të botimeve letrare shqiptare të Bukureshtit/ e përshëndetën,

[21]

e në këtë rast ky besim i papërmbajtur, për hir të çështjes, nuk është i padëshirueshëm.

Sikur vetëm të kisha pasur mundësi që njerëzve t'u jepja edhe librat, për të cilët ata janë aq të etur, atëherë do të ishte bërë hapi i parë i pavarë-

sisë shpirtërore të shqiptarëve të atjeshëm, e cila do të ishte shtrirë edhe më gjerë dhe me këtë të gjitha aspiratave greqizuese të propagandës së vetme vepruese greke në këtë anë do t'i ishte hequr përgjithmonë dhe nën këmbë.

Hajdar beu në Pogradec

Zotëruesi më me ndikim dhe, në të vërtetë, i plotfuqishëm në Pogradec është Istref beu, i cili ka një të vetëm djalë të rritur, Hajdar beun. Ishte një kënaqësi e madhe për mua, që thashethemet që dëgjova për ata nuk dolën të vërteta. Ata m'u portretizuan si turq fanatikë. Beu i vjetër Istrefi shikon patjetër të jetë sa më i kujdesshëm që të jetë e mundshme, ngase ai disa herë ka qenë i përndjekur nga qeveria dhe me sa duket kjo bëri që ai të njerëzitet të ketë një reputacion imagjinar. Për shkak të supozimeve të mia false, me ngutësinë dhe pamaturinë time, kisha ndërmend të bëja një përpjekje që së paku beun e ri Hajdarin ta bindja se ai nuk është turk, por është një shqiptar i shquar. Tani paramendojeni habinë time, kur ai as që më la mundësi të nisja një përpjekje të tillë, por sakaq më tregoi një mori librash patriotikë shqip

[22]

dhe para së gjithash një apel, të shfaqur së voni në Bukuresht dhe të drejtuar Sulltanit, nga Mehmet Bej Frashëri që tani gjendet në Itali, në të cilin apel veprimet dhe mosveprimet e zyrtarëve turq, nisur nga rendi më i lartë i tyre, i nënshtrohen një kritike tejet të rreptë. Lidhur me këtë Hajdar beu shtoi se ai është admiruesi më skllav i mundshëm i hartuesit të këtij apeli, Mehmet bej Frashërit, me të cilin pajtohet në të gjitha pikëpamjet. Kur unë pastaj vura në dukje, me një lëvdatë të theksuar, meritat e myslimanëve për kauzën shqiptare, Hajdar beu kërcëu lart, më mbështolli me duar dhe më përqafoi, më dha dorën dhe më tha:

"Nga tani e tutje ne jemi dy vëllezër. Ju si më i vjetri dhe më i arsimuari, mund të urdhëroni dhe unë gjithçka ç'është e mundshme të bëhet me forcat e mia për kauzën tonë shqiptare, do ta bëj."

Hajdar beu ishte njëri prej atyre që nxuri alfabetin tim. Së voni mora një letër prej tij, në të cilën karakteri i shkrimit turk pasqyrohej në tiparet e

letrave latine, të cilat në teorinë time janë zbatuar në mënyrë korrekte. Më herët Hajdar beu mund të shkruante vetëm turqisht dhe atij iu desh të bënte përpjekje të mëdha për t'iu përshtatur përdorimit të germave latine, diçka që ai e konsideronte të domosdoshme për secilin shqiptar.

Në kohën e qëndrimit tim në Pogradec ndodhi edhe një ngjarje e lumtur

[23]

në shtëpinë e Istref beut, e cila për qëllimin tim ishte me një dobi të madhe; i biri i tij i vetëm Hajdar beu martoi vajzën e beut me nam Alo beut nga Korça. Gjatë dasmës u nderova me rolin e shkëlqyeshëm të vëllamit. Dasma më ofroi gjithashtu mundësinë të shihja reputacionin e madh, pra plot-fuqishmërinë e Istref beut në zonën e tij dhe ndikimin e madh të tij edhe përtej kufijve të kësaj zone.

Shënimet e mbledhura në dasmën e Hajdar beut në një rreth më të gjerë

Në dasmë takova njerëzit më të shquar të Korçës, Mokrës, Gorës, Bërzeshtes, Dibrës dhe Ohrit. Unë nuk e lëshova këtë rast të volitshëm për t'u njohur më përafër me prijësit e popullit shqiptar të mbledhur në këtë mënyrë aq fatlume. Në ditën e tretë të festimit, që zgjati 14 ditë, mora pjesë në darkë me dhëndrin në një konak të paraparë për bejlerët e pranishëm. Pamja ime /: unë erdha i veshur me roba sallonesh evropiane/ tërhoqi vëmendjen e bejlerëve. Ata u interesuan se kush isha unë. U prezantova tamam në mënyrën se si është e zakonshme në këtë anë dhe u tregova atyre, në përputhje me pikëpamjet e tyre, për qëllimin e udhëtimit tim si dhe misionin e jetës sime, diçka që ata e morën parasysh në mënyrë të drejtë dhe e kuptuan se përpjekjet e mia janë të krijoj libra shqip

[24]

dhe ta bëj gjuhën shqipe të njohur kudo në botë. Ata u çuditën dhe disave u dukej krejt kjo si zor e realizueshme. Më i moçmi, shumë i respektuari agë Limblloshmi nga Bërzeshta, kujtonte se unë kam ardhur nga Rumania. Kur

unë i shpjegova, se unë studioj në Vjenë dhe se e kam ndërmend pas pak të kthehem përsëri atje, ai filloi të lavdëronte Austrinë duke shtuar, se si i biri i tij, i cili është një zyrtar i lartë në Stamboll, i kishte treguar për "Nemcen" /: kështu i quanin shqiptarët austriakët, kurse gjermanët nga Reich-u Gjerman i quanin Prusianë/ dhe për "marifetet" / : njëmijë artet/ e tyre. Edhe nga unë kërkonin informacion për gjërat më të ndryshme, me ç'rast ata dëgjuan me interesin më të madh, kur biseda çoi te zbulimet e mëdha të Veriperëndimit të kulturuar /: si p. sh. përdorimi i shumëllojshëm i elektricitetit etj./ si dhe kulturës, civilizimit dhe humanitetit të tij në përgjithësi. Mirëpo, vëreja se bashkëbiseduesit e mi jo vetëm që nuk kishin fare haber për gjërat e thëna me qëllimin më të mirë, por ata kishin pamjen paksa të mosbesimit.

Ndërmjet Hajdar beut, Adem agës /: sunduesi i Mokrës/ Limblloshmit dhe Pasho beut u zhvillua një bisedë interesante rreth apelit të sipërpërmendur të Mehmet bej Frashërit,

[25]

me ç'rast Hajdar beu i pyeti të përmendurit nëse këta e kishin marr atë nga Korça, nga ku këso gjërash, si shkrime, libra etj. edhe merren, të cilën këta e pohuan. Lidhur me përmbajtjen e apelit dhe hartuesin e tij, ata shpreheshin në mënyrë shumë të gjallë. Pasho beu citoi një vend, ku flitej për pashët "dembela", çfarë shkaktoi një të qeshur të gjatë. Në fund, me dashamirësinë më të madhe u prit përshkrimi im i personalitetit të lartmadhërisë së tij, Kajzerit austriak, mirësinë e tij të lavdërueshme dhe gjithandej të njohur, kalorësinë, urtësinë e një regjenti dhe mënyrën shembullore të jetesës së tij.

Në ditët në vijim u takova përsëri me shumicën e bejlerëve, të cilët i njoftova në atë mbrëmje, si me vëllanë e Alo beut, me Krekun e vjetër dhe vëllanë e tij Kaper, me Limblloshmin, Jusuf babën, një bej i shquar nga Gora etj. Se çfarë mësova prej tyre, do të ishte shkurtimisht si vijon:

Shumica prej tyre dinë të shkruajnë dhe lexojnë një ortografi si e Frashërit, e cila është e përhapur nga Bukureshti. Nga unë e mësuam vetëm timen. Në raste të caktuara, njohja e shkrimit shqip buron madje nga shtyt-

ja e bijve të tyre, diçka që s'është edhe aq e pashpjegueshme. Kështu p. sh. djali i Limblloshmit është në Konstantinopojë në lidhje miqësore me

[26]

poetin e njohur dhe tashmë të lartpërmendur Naim bej Frashërin. Ata janë shumë krenarë, që për atë që ka ndodhur për kauzën shqiptare deri më sot duan falënderuar myslimanët. Me ç'rast ata u referohen Frashërve. Nga unë kanë pritur të kem sjellë shumë libra shqip për t'i shpërndarë në Shqipëri. Kur e mohova këtë, njëri më tha se do të duhej së paku të kisha sjellë Historinë e vargëzuar të Skënderbeut, ngase në Austri të tilla mund të merren aq sa ta do qejfi. Për Austrinë të këta bejlerë flitej me dashamirësi të madhe dhe i referoheshin veprimtarisë së saj në Bosnje dhe Hercegovinë, kurse sultanin dhe qeverinë e tij e shanin tmerrësisht.

Gazetat shqiptare, ngado që vinin, atyre u pëlqenin shumë. Vetëm Adem aga nga Mokra shprehu josimpatinë e tij për revistat e botuara në Itali, diçka që e bëri për shkak të "Albanie" të botuar në Bruksel. Ai mendonte se shqiptarët e Italisë, mjerisht, nuk janë në gjendje të mendojnë mirëfilli shqip. Kështu ai ishte takuar rishtazi me një shqiptar të Italisë në Durrës, i cili me entuziazëm i kishte treguar dhe lexuar një revistë shqiptare të botuar në Itali, nga e cila ai nuk e kuptoi as edhe një fjalë të vetme, sepse gjuha e revistës ishte italisht,

27

për çfarë Adem aga shpreh keqardhje dhe fare s'mund ta kuptojë. Ai gjithashtu, nëpërmjet po të njëjtit njeri, shkoi të një shoqatë shqiptare, tek e cila flitej kryesisht italisht, çfarë atij nuk i pëlqeu aspak. Fundja, ai mësoi nga një palë e besueshme, se gazetat e shqiptarëve të Italisë jo vetëm që janë tërësisht me mendje italiane dhe asgjë nuk përbëjnë të përdorshme për shqiptarët, por vetë botuesit e tyre nuk janë në gjendje të flasin shqip.

Mjerisht nuk kisha mundësi të isha aq gjatë sa do të duhej me personin e përmendur. Para largimit shumica prej tyre m'u drejtuan me lutjen për t'u dërguar atyre libra shqip.

Manastiri i Kalishtës dhe peshkopi i ri grek në Durrës

Pas dasmës, së bashku me banorët e Pogradecit shkova në Ditën e Kishës në manastirin e Kalishtës, i cili është 6 orë larg nga Pogradeci, në breg të liqenit të Ohrit. Qëllimi i shkuarjes ishte për të pritur për herë të parë peshkopin e ri të Durrësit, Gorës, Mokrës dhe Shpatit. Rugës për në Kalishtë pashë shumë objekte interesante arkeologjike. Kur arritëm në Kalishtë, i bëmë një vizitë peshkopit. Peshkopi ishte zotërues i greqishtes dhe turqishtes. Shqip s'dinte fare. Mua më la një përshtypje të çuditshme,

[28]

kur prifti nga Pogradeci, at Kosmai, i cili gjatë pranimit tonë nga peshkopi u ul pranë tij /: unë përsëri u ula për krahu at Kosmanit/, në të gjitha pyetjet e bëra greqisht nga Peshkopi për çështje kishtare dhe çështje të tjera, përgjigjej vetëm me një heshtje të thellë. U detyrova të reflektoj dhe t'ia qartësoj peshkopit sa pak e përhapur është greqishtja në këtë anë, ku lëre më njerëzit e thjeshtë, madje as priftërinjtë dhe shumica e mësuesve të të ashtuquajturës shkollë greke nuk kanë ndonjë njohuri të duhur të gjuhës greke. Për fare pak sukses, humbet me vite kohë, për t'i disiplinuar njerëzit me këtë gjuhë joamtare, ani pse për këtë qëllim çdo gjë tjetër lihet pas dore dhe neglizhohet. I shqetësuar u foli Peshkopi, se ai nuk mund të pushojë së habituri, se si deri më sot është duruar kjo gjendje e mjerë. Në lidhje me këtë, gojës së tij i shpëtuan shumë fjalë fyese për paraardhësin dhe në të njëjtën kohë shpaloj se si ai do të veprojë në mënyrë krejtësisht tjetër. Në vërejtjen time lidhur me gjendjen e keqe të shkollave dhe se për një përmirësim të tyre, masa e parë pedagogjike duhej të ishte futja e gjuhës vendore si gjuhë e shkollës, ku theksi vihet kryesisht në përhapjen e arsimimit të mirëfilltë

[29]

dhe vetëm më pastaj do të duhej të lejohej greqishtja si lëndë mësimore dhe ashtu që kjo e fundit të arrijë një sukses të vërtetë, peshkopi nuk u pajtua tërësisht. Ai dëshiron t'i mbyllë shkollat e djemve dhe vetëm t'i riorganizojë shkollat e vajzave, ashtu që secila nxënëse e diplomuar të flasë përkryer greqisht. Kur në shtëpi nëna e flet gjuhën greke, atëherë edhe fëmijët do ta mësojnë atë.

Mora guximin të bëj vërejtjen se ky plan nuk do të jetë i lehtë për t'u zbatuar. Shumica e popullatës është myslimane dhe peshkopi e di mirë se vajzat myslimane kurrë nuk do të mund të vijnë në shkollat, të cilat janë të varura nga ai. Por dyshoj gjithashtu se një vajzë e minoritetit të krishterë, i cili bashkëjeton me shumicën myslimane, pas disa viteve të vijimit të shkollës do ta zotërojë dhe nxërë gjuhën greke në atë masë, sa që në një të ardhme të largët të jetë në gjendje ta greqizojë familjen e saj. Se sa e vështirë është në përgjithësi të mësohet gjuha greke nëpër shkollat tona dhe të flitet me shkathhtësi, e kam provuar edhe vetë. Këtë gjuhë vërtet "hyjnore" e kam nxënë tërësisht vetëm pasi e kam përfunduar gjithë gjimnazin në Manastir, ani pse ky i fundit theksin kryesor e kishte vënë në mësimin e saj.

[30]

Njëloj kisha mundur të them edhe për kolegët e mi; në të vërtetë këta të fundit nga gjimnazi nuk kishin mundur të merrnin asgjë më shumë se sa një njohuri sipërfaqësore të greqishtes. Këtu ndërhyra - ani pse menjëherë vëreja orientimin e vërtetë të peshkopit të nderuar dhe kotësinë e çdo diskutimi të mëtejshëm - me një informatë të shkurtër rreth studimeve të mia kushtuar gjuhës shqipe dhe u përpoqa t'i deshmoja, në një mënyrë e cila është në përputhje me pikëpamjen dhe mënyrën e gjykimit të tij rreth synimit të greqizimit, për mundësinë që në bazë të një mësimi elementar të gjuhës shqipe të arrihet gjithashtu edhe një njohuri më e mirë e greqishtes, kundruall suksesit të dyshimtë të metodës së planifikuar të tij. Këtë s'e bëra për ta zemëruar atë, por më shumë t'i bëja një shqyrtim të mëtejshëm të çështjes dhe për të pasur, së paku në disa pika, një pasqyrë më të mirë. Rezultati ishte që ai u çekuilibrua dhe menjëherë e ndërroi mënyrën e bisedës. Ai më tregoi fabulën e fabrikuar dhe bajatë të grekëve dhe grekofilëve për prejardhjen e përbashkët të shqiptarëve dhe grekëve nga populli i lashtë pellazg. Kështu u ndamë. Por menjëherë u shfaqën frytet e kësaj bashkëbisede. Mbesa ime, e cila tashmë 2 vite me kënaqësinë më të madhe mbante një vend mësueseje në Pogradec, u shkarkua nga puna. Kësaj goditjeje të befasishme iu përgjigja

[31]

duke e martuar atë shumë mirë. Fill pas kësaj kushëriri im, i cili ishte gjithashtu tashmë 3 vjet mësues në Pogradec, u transferua në Elbasan, ku, brenda 3 ditëve, duhej menjëherë të paraqitej. Kjo ishte e pranueshme dhe, shqyrtuar zotit, nuk ndodhi diçka më keq. Por, peshkopi shtihej, në mënyrë dinake, se edhe më tutje kishte miqësi të madhe me mua.

Arkimandriti Germanos nga Elbasani

Nëpërmjet kushëririt tim, që, siç u tha, u dërgua në Elbasan, për mua mësoi Archimendrit Gjermani /:Germanos/ i atjeshëm, nipi i peshkopit të Durrësit, Gorës, Mokrës dhe Shpatit, të vdekur para 2 viteve, i cili duke vendosur shpejt, një ditë të bukur, ky njeri fisnik u shfaq tek unë në Pogradec. Ju mund të paramendoni gëzimin tim, kur kështu m'u dha mundësia, pa marrë parasysh të gjitha të tjerat, për afro 8 orë të kem mundësi të dëgjoj më të bukurën shqipe të Elbasanit, mundësi kjo e dëshiruar qysh gjatë studimeve të mia filologjike. Por nga Arkimandriti Gjermani mësova edhe shumë gjëra të tjera interesante, sepse ai është një njeri shumë i arsimuar dhe inteligjent. Shkollën teologjike ai e përfundoi në Athinë. Shqipërinë e njeh mjaft mirë, ngase me dajën e tij, e kaloi atë gjatë e gjerë. Përndryshe, ai ka udhëtuar goxha edhe nëpër botë.

Në popull ai gëzon

[32]

një simpati të madhe dhe do të kishte krijuar shumë, sikur t'i ishin lënë në dispozicion mjetet e nevojshme. Për këtë ai është i vetëdijshëm. Dëshirimi i tij synon, këtë ai e sheh si një postulat logjik, që Austria të bëjë kthesë. Ai tha se pse shkollat katolike nën protektoratin austriak në veri dhe pjesërisht në Shqipërinë e mesme kanë, e këtë thjesht s'mund ta kuptonte, një karakter italian e jo shqiptar dhe në këtë mënyrë ndikimi italian ishte rritur aq shumë sa që vetë priftërinjtë katolikë, vendorë dhe shqiptarë, pothuajse kanë harruar shqipen. Gjuha shqipe megjithatë është e pranishme në Shkollë, por vetëm si gjuhë e huaj. Në këtë mënyrë - tha Gjermani - në veri dhe Shqipëri të mesme kemi tani thjesht një propagandë italiane dhe asgjë tjetër, të financuar madje nga fondet austriake, por Austria nuk mund të dëshironte të na italianizojë; te ne këtë askush s'e beson. Megjithatë kjo de

facto ndodh, ose nëse këtë nuk duam ta quajmë një italianizim, atëherë në këtë mënyrë megjithatë i bëhet shtytje kauzës italiane. Për mua, metoda, të cilën e përdor ana austriake, nuk është e duhura. " Para 2 viteve desha të vij në Vjenë", tha ai, po e skicoj me vetë fjalët e Gjermanit rrjedhën e mëtejshme e bisedës sonë,

[33]

" kur ishte çështja e Shpatit. Unë jam në lidhje të ngushtë me shpatarët, prandaj për gjithçka çfarë ndodhi atje, mua m'u vesh faji, dhe sinqerisht më duhet ta pranoj se unë kam qenë iniciator i gjithë kësaj çështjeje. A doni ta dini se çfarë doja në të vërtetë të bëja me shpatarët? Jo ortodoksë para zotit, çfarë për mua do të ishte më e natyrshme, por - mos u habitni - katolikë, por aso katolikësh, të cilët nuk duhej t'i takonin propagandës italiane, por një Austrie të drejtë dhe mbrojtëse dhe mbështetëse të individualitetit të kombeve. Dhe dëshira ime ishte që jo vetëm Shpati, por e tërë Shqipëria e Mesme, të mbështetet me mjetet e katolicizmit të Austrisë. Në mënyrë të pashpjegueshme konsulli austriak në Manastir m'i ndali të gjitha ndihmat. E pyeta për arsyen dhe nuk mora ndonjë përgjigje! Për këtë dëshiroja, siç thashë, të shkoja në Vjenë dhe atje nga vetë goja e prijësit e jo të vartësit të tij të mësoja arsyen, se për çfarë na u ndalua ndihma aq e pritur. Në anën tjetër, konsulli rus në Manastir erdhi shpesh në Elbasan dhe u përpoq shumë të më bënte për vete. Kjo ishte e kotë, sepse qysh moti më zotëron tërësisht një vendim, ose t'i shërbej popullit tim - prandaj e shihni tek unë këtë kapelë të priftërinjve - ose më mirë fare të mos jetoj. Në këtë vendim,

[34]

për të shpëtuar mbi të gjitha popullin tonë, për mua personalisht nuk ka rëndësi nëse jam ortodoks ose katolik, ngase jam i bindur, se edhe si katolik para zotit do të mbetem një i krishterë i pëlqyer, dhe besoj që sot ka ardhur koha, ku ne me një sakrificë të vogël mund të arrijmë shumë. Nëse sot Austria do të kërkonte, që ne të bëhemi katolikë, për të justifikuar ndihmën që do të na e jepte, unë do të isha pa ndonjë shtrëngim i gatshëm për të bërë atë që u tha dhe për këtë t'i bindja edhe vëllezërit e mi shpirtërorë,

vetëm e vetëm për të na shpëtuar. Por fillimin, bazën e parë për shpëtimin tonë, e shoh në themelimin e shkollave kombëtare shqipe. Kur konsullit rus ia shtrova pyetjen rreth shkollës kombëtare, ai foli në mënyrë të vendosur kundër dhe filloi me fjalë të shfrenuara të lartësonte rëndësinë e shkollës greke për shqiptarët: një arsye kjo e mjaftueshme që ne qysh nga atëherë kurrë më se kemi shkëmbyer as edhe një fjalë me njëri tjetrin. Po, konsulli i nderuar e bart madje andej-këndej idenë dhe mbështet tendencën për të na greqizuar apo madje për të na sllavizuar, siç janë shkollat e hapura greke në Shpat, në të cilat mësohet edhe rusisht, por jo shqip. Por, pavarësisht të hollave dhe përpjekjeve ruse jam i bindur, se për një kohë shumë të shkurtër Shpati dhe pjesa tjetër e mbetur e Shqipërisë së Mesme do të katolicizohet

[35]

sikur vetëm të kisha mundësi për të marrë ndihmën nga konsullit austriak. Mu për këtë dua të udhëtoj qysh sot në Vjenë e jo në Romë siç më këshilloj herë pas here vetë Don Carolini /:?/, sekretar i Peshkopisë katolike së Durrësit³. Kur i ndërhyra Don Carolini-t, se në asnjë mënyrë nuk kisha dashur të kontribuoj në italianizmin e shqiptarëve, filloi të m'i tregonte pikëpamjet e Papës dhe theksoi se një udhëtim i tillë s'do të kishte asgjë të bënte me qeverinë italiane. Atij ia ktheva, se të gjitha shkollat katolike në Shqipërinë e veriut, pa dallim nëse janë të subvencionuara nga Austria apo Italia, si gjuhë mësimi e përdorin italishten dhe në përgjithësi kanë një frymë tërësisht italiane; vetëm ky fakt dëshmon mjaftueshëm për ndikimin e tepruar dhe të dëmshëm italian. Sikur unë apo dikush tjetër do t'i drejtohej Vjenës dhe t'i parashtronte gjërat në vijën e duhur, do të kishte mundësi që vetëm atje, ajo që është e domosdoshme për t'u korrigjuar do të ndodhte, kurse nga Italia, qoftë nga qeveria apo nga Shkëlqesia e Papës, pikërisht në këtë drejtim, aq vital për ne, natyrisht se s'mundet fare të prisnim ndonjë çare. Don Carolini pastaj u përpoq në mënyrë tejet nervoze të dëshmonte legjitimitetin e gjuhës italiane

³ Vërejtje: Gjermanit nuk i kujtohej tamam emri i të njëjtit.

[36]

si gjuhë mësimore, me ç'rast i referohej faktit, gjoja se kjo ishte diçka tradicionale; kleri ynë fillimisht përbëhej vetëm nga italianët, madje akoma edhe sot ndër ne mund të takohen shumë italianë. Prandaj ne duhet t'i japim italishtes një të drejtë të caktuar historike. Meqë, pra, thashë unë, është bërë një defekt te ju në Shqipërinë e Veriut, a duhet edhe ne në Shqipërinë e Mesme dhe Jugore ta përvetësojmë një të tillë?! Pasi që e luftojmë greqizimin qysh nga fillimi i mendimit njerëzor, tani duhet të bëhemi katolikë, për t'iu dorëzuar italizimit. Kjo nuk do të ndodhë; sepse ne kërkojmë dhe kemi një të drejtë natyrore për një jetë të pavarur kombëtare në tokën e kulturës së përgjithshme njerëzore dhe për këtë jetë të pavarur kombëtare mund ta shpresojmë vetëm nga Austria, mirëpo nga Italia dhe nëpërmjet mësimit të italishtes në shkollat tona kombëtare këtë s'mund ta arrijmë kurrë".

Gjatë këtij tregimi Arkimandrit Germanos ra në një eksitim të zjarhtë dhe ma përsëriste edhe më tutje dëshirën e tij të madhe, vërtet sa më shpejt të vinte në Vjenë dhe të merrte këshilla në një vend kompetent, se në ç'masë dhe në ç'mënyrë dëshirat e tij lidhur me ndikimin Austro-Hungarez për Shqipërinë janë të justifikueshme dhe mbase edhe për të kontribuar për një vlerësim dashamirës të këtyre dëshirave. Meqë ra fjala, ai më pyeti për këshillë, se çka do të ishte më së miri për të bërë.

[37]

I shpjegova atij se as që jam në gjendje dhe as që jam i thirrur t'i jap ndonjë këshillë në këtë rast dhe se përgjigjen mund ta merrte vetëm në Vjenë.

Në vazhdim të bisedës tonë Arkimandrit Germanos më tregoi për marrëdhëniet shumë të mira të tij me Dervish beun nga Elbasani, një patriot i njohur anë e përtej, dhe shtoi se jo vetëm ai, por edhe shumë shqiptarë të tjerë më prisnin në Elbasan me kënaqësi. Interesante ishin diskutimet e tij lidhur me grekët dhe propagandën e tyre në Ballkan. Meqë kishte jetuar 4 vite në Athinë, ai i dinte tamam tendencat e grekëve. Më tha se nuk u ka fare frikë aspiratave greke për Shqipërinë; këtë na tregojnë rezultatet, të cilat këta i kanë pasur në shtetet e tjera të Ballkanit, ato janë thjeshtë një fiasko.

Në ditët në vijim Arkimandriti u desh të kthehej përsëri në Elbasan, sepse kishte frikë se peshkopi i tij, kur do të vinte në të njëjtën ditë në Pogradec, do të mësonte për praninë e tij. Por ai kërkoi që unë të shkoja me atë. Pasi kisha dëgjuar që më parë se Dervish beu nga Elbasani mungonte, vetëm pas një peshimi të gjatë vendosa ta miratoja ftesën e Gjermenit. Këtë e bëra sepse Elbasani, ta themi kështu, për studimet e mia filologjike është vendi më i rëndësishëm në Shqipëri.

Në Elbasan

Që në natën e parë, pasi arritëm në Elbasan, Arkimandrit

[38]

Gjermani me rastin e vizitës sime shtroi një darkë, në të cilën ai ftoi miqtë e tij më të mirë. M'u konfirmua se Dervish beu është një patriot shumë energjik dhe i zgjuar, por që në çdo hap ishte i përcjellë, për çka ai ishte shumë i vetëdijshëm. Thuhej gjithashtu, se ai me dëshirë do të kalonte në fenë katolikë, sikur në atë rast të mos rrezikohej jeta e tij.

Edhe një herë peshkopi i Durrësit

Pastaj pyeta për peshkopin e ri ortodoks dhe çfarë përshtypjesh pat lënë ai gjatë vizitës së tij të bërë rishtazi në Elbasan. Më treguan disa episode nga koha e kësaj vizite, si p. sh. ai vetë, së bashku me xhandarët, i kishte mbledhur tarifat e veta dhe tek ata që nuk e përfillën, tek ata pra që nuk donin apo që s'mundnin t'i paguanin këto tarifa nga varfëria, ua lejoi xhandarëve të ushtrojnë barbarizma dhe dhunë të tmerrshme. Me dhunë ua morën rezervat ushqimore dhe pjesët e mobileve, të cilat u shitën menjëherë, njerëzit u rrahën, e gjëra të tjera.

Mu për këtë, në të dielat e para, askush nuk donte të shkonte në kishë kur peshkopi mbante meshën. Pakënaqësia ndaj peshkopit ishte edhe më e madhe, ngaqë elbasanasit kishin dëshiruar dhe pritur që Gjermani, si pasardhës i natyrshëm i xhaxhait të tij, të bëhej peshkop. Sikur vetëm të kishim mundësi, thoshin elbasanasit,

[39]

do ta kishim përzënë këtë peshkop.

Ortografia shqipe

Atje bisedova gjatë edhe me kushëririn tim dhe mësuesin e dytë. Të dy më siguruan se kanë për qëllim që fëmijët t'i mësojnë shkrim lexim vetëm në gjuhën e tyre amtare shqipe. Tani më të dy e njihnin ortografinë time. Mësuesi i dytë mendonte se në Elbasan vetëm me pak mjete ndihmëse do të ishte lehtë që shkollat ekzistuese greke të shndërroheshin në shkolla shqipe. Në të vërtetë në Elbasan nuk ekziston as edhe një njeri me mendje greke dhe mësuesi i dytë, më i vjetri, qysh më parë ka mësuar myslimanë dhe të krishterë shkrim-lexim shqip.

Në Elbasan flitej për vizitat e shpeshta të z. konsullit austriak në Manastir dhe për këtë pandehej se, nëpërmjet tyre, edhe rrethanat në vend do të përmirësoheshin. Disa nga njerëzit e shquar madje pohonin se Der-vish beu kishte relacion të ngushtë me konsullin e përmendur dhe shpresonin edhe nga kjo lidhje shumë të mira.

Propaganda rumune

Në Elbasan momentalisht vepron shumë zellshëm propaganda rumune e futur rishtas. Ajo aty ngriti edhe një shkollë. Fillimisht vështirë mund ta kuptoja, se madje edhe bijtë e gjuhëtarit, përkthyesit etj. të njohur shqiptar Kristoforidhi, janë rumanizuar dhe i madhi është mësues i rumanishtes, dhe i dyti është bursist në Bukuresht.

[40]

Por më vonë më treguan se gruaja e Kristoforidhit është një Cincar-Vllahe dhe pas vdekjes së burrit ajo thjesht i rriti fëmijët e saj në frymën rumune.

Fjalori i Kristoforidhit

Siç dihet, Kristoforidhi përveç tjerave, hartoi edhe një leksikon shqip. Mjerisht ai është vetëm në formë dorëshkrimi dhe gjendet në duar të tri vajzave të Kristoforidhit. Për to, ai ka vlerën e një prike.

Dervish beu

Pas 3 ditëve braktisa Elbasanin dhe u përcolla deri në Kukës nga Arkimandrit Gjermani. Atje me një rastësi fatlume takuam Dervish beun, i cili mu atëherë kthehej në shtëpi. Dervish beu përputhej tërësisht me përshkrimet, që i mësova për të në Elbasan. Ai vërtet është një djalë energjik, ende një burrë i ri dhe të lë përshtypjen e një inteligjence të lartë. Mjerisht, për shkak të përcjelljes së tij, në mesin e së cilës ishin zyrtarë, xhandarë e të tjerë, nuk mundëm të ishim së bashku gjatë. Dervish beu më premtoi se do të provonte të ma siguronte leksikonin e Kristoforithit. Por kjo do të ishte një punë e vështirë. Do të thotë se unë nuk pajtohesha për një shkelje të së drejtës së pronareve të atëhershjme, përvetësimi ligjor i të cilit, me një çmim prej 400 lirave turke, ishte madje edhe për Dervish beun,

[41]

pasuria e të cilit në patundshmëri dhe tokë ishte e pakapshme. Dervish beu foli me shumë simpati për konsullin austro-hungarez në Manastir. Ky duhej të ishte miku i tij më i mirë. Nga unë dëshironte që të shkoja edhe një herë në Elbasan, donte të fliste më gjatë me mua. Nuk desha t'i premtoja diçka. Me dëshira të ndërsjella, që mundësisht sa më shpejt të shiheshm përsëri, u ndamë në mënyrë miqësore nga njëri tjetri.

Nga Kukësi udhëtova nëpër Bërzishtë dhe tërë Mokrën dhe pas 2 jave u ktheva në Pogradec, nga ku përsëri ndërmora udhëtime të reja.

Me dhëndrin tim dhe sekretarin e parë /:Bashqatib/ të prefektit të Pogradecit, një emigrant i lindur bullgar-mysliman nga Plovdivi /: Muha-xhir/ udhëtuam me makinë së pari në Korçë nëpër rrugën më të mundimshme në botë.

Kapedan Kajon në Zvezdë

Në Zvezda, ku arritëm pas 4 orëve dhe bëmë një pushim, takuam kapedan Kajon me 5 përcjellës. Po e përmendi këtë ngase ai, si prijës i hajdutëve në Shqipërinë e Mesme, 30 vjet sillej si sundimtar absolut, por vitin e kaluar ai lidhi paqe me qeverinë.

Korça

Në mbrëmje ishim në Korçë. U ndalëm te një i afërt imi.

Thimi Marko

Të nesërmen vizitova atje një patriot në zë dhe shumë të shquar Thimi Marko,

[42]

i cili bëri sakrifica të mëdha për shkollën shqipe në Korçë. Mund të thuhet se Korça është i vetmi vend në tërë Shqipërinë, i cili vërtetë ka një shkollë shqipe. Shqiptarët në Korçë nga ky vend kanë ndërtuar një çerdhe patriotike në kuptimin më të mirë të fjalës dhe janë mbledhur së bashku me qëllim për të themeluar, me ndihmën e kolonisë shqiptare në Rumani, shkollën kombëtare, e cila kontrollohet nga komunitetit shqiptar në Korçë dhe e cila e ka shqipen si gjuhë mësimore.

Për shkak të kësaj lëvizjeje të zjarrtë shqiptare, shqiptarët nga Korça u deshën të durojnë bezdisje të shumta. Peshkopi grek ua ndaloi priftërinjve t'u jepnin shqiptarëve shërbesat fetare; ai vetë i mallkoi ata publikisht në kishë. Edhe më të forta ishin goditjet e pësura nga qeveria. Së bashku me Thimi Markon, nga i cili i mësova këto për së afërmi, shkova pastaj tek Oroman beu.

Oroman beu

Oroman beu është një njeri shumë i arsimuar, i cili zotëron turqishten, greqishten e re, greqishten e vjetër dhe frëngjishten. Ai shprehu kënaqësinë për të më njoftuar, ngase ai tashmë kishte dëgjuar për mua dhe për qëllimin e udhëtimit tim nga Istref beu i Pogradecit. Ai mendonte, se në këtë kohë shqiptarët duhet ende të punojnë jashtë vendit për kauzën shqiptare dhe për të arritur na nevojiten shumë të tillë që e bëjnë këtë, ngase

[43]

nga ata, të cilët rrojnë këtu në vend, nuk mund të pritet shumë; këtyre qeveria otomane ua ka lidhur aq fortë duart, saqë vetëm fshehurazi mund të ndihmojnë.

Shkolla ortodokse shqipe e djemve

Që të tre shkuam së pari në shkollën shqipe për djem, ku nëpërmjet një shërbyesi /:sejmen/ të Oroman beut, ardhja jonë ishte paralajmëruar. Ne u pranuan shumë solemnisht. Na kënduan këngë shqipe. Më pastaj kryemësuesi testoi klasën më të lartë për të na treguar përparimin e fëmijëve. Mësuesi dhe nxënësit nuk kishin libra të shtypur, por vetëm dorëshkrime. Të dy mësuesit e punësuar përveç shqipes dinin vetëm greqishten. Për këtë arsye mjetet mësimore të shkruara nga ata në formë dorëshkrimi ishin të hartuara sipas mostrave greke. Unë kërkoja njërin nga këto dorëshkrime dhe aty për aty u binda se mostrat e përdorura ishin origjinale shumë të vjetruara greke, të cilat assesi nuk përputheshin me pikëpamjet e sotme pedagogjike. Në lidhje me këtë, provova që mësuesve t'ua shpjegoja disa gjëra, dhe u thashë që bile së paku duhej të përktheheshin botimet më të reja greke. Por kryemësuesi na njoftoi se është e pamundshme që ato të sigurohen në Turqi, kurse të porositen në Athinë është e përealizueshme,

[44]

ngase qeveria Turke do t'i asgjësonte ato. Kryemësuesi më tha me kënaqësi se sa i është rritur reputacioni shkollës shqipe dhe se sa ka përfituar në këtë mënyrë e tërë kauza shqiptare, qëkur vitin e kaluar shkolla u dekorua nga konsulli austriak në Manastir. Kjo vizitë pati një ndikim të veçantë dhe solli një gjendje shpirtërore të ngritur, ngase qëlloi të jetë mu dita e provimit. Në fund i luta mësuesit t'ua jepnin për detyrë nxënësve të klasës më të lartë që secili të shkruante në shtëpi një përrallë apo diçka të ngjashme. Desha të dija se si duket një shkrim shqip, i hartuar nga kjo klasë /:rreth 15 vjeç/ e lartë.

Kështu edhe ndodhi dhe unë më vonë i pashë hartimet. Në bazë të tyre mund të konstatoj qartë, se shkollat greke në Shqipëri, rezultatet e të cilave i njoh shumë mirë, dhe shkollat shqipe për të njëjta grupmosha nuk mund të krahasohen fare, sepse fëmijët e shkolluar në gjuhën amtare i tej-

kalojnë mjerisht aq shumë kolegët e tyre shkollorë, të cilët të gjitha lëndët duhet t'i përvetësojnë nga një medium tërësisht i huaj grek. Sikur shkolla shqipe në Korçë të mbijetonte dhe më vonë të themelohej, në përputhje me nevojat, një shkollë më e lartë, atëherë shumë shpejt për propagandën greke në Korçë /: ekziston madje një gjimnaz i tërë grek/

[45]

as që do të bëhej fjalë.

Argëtimi në mbrëmje tek Oroman beu

Në mbrëmje, Oroman beu shtroi një darkë, në të cilën morën pjesë shqiptarët e shquar nga Korça. Ndër ta ishin edhe dy myslimanë, të cilët, siç më treguan, ishin poetë të mirë shqiptarë. Vërtet e vërejta se të dy flisnin shkëlqyeshëm shqip. Njëri nga ata, një hoxhë /: prift dhe mësues mysliman/ kishte zakon t'i korrigjonte pandërprerë folësit, me ç'rast ai për fjalët e huaja turke e thoshte fjalën përkatëse shqipe.

Biseda sillej rreth shkollave, peshkopit etj. Kritikoheshin jashtëzakonisht shkollat greke. Gjithashtu kritikohesh shumë rreptë sjellja e peshkopit. Ankoheshin se shumë shqiptarë të pasur mjerisht ishin prijës të propagandës greke dhe mallkohej verbërimi i atyre bashkëvendësve të pasuruar dhe të vdekur në vende të huaja, të cilët pasurinë e tyre ia linin trashëgim propagandës greke në atdheun e tyre, duke i dhënë kësaj të fundit mjetet më të fuqishme për të shkombëtarizuar vëllezërit e tyre. Raste të tilla dukej se kishte shumë. Oroman beu shprehte keqardhjen se pikërisht nga shqiptarët e pasur, nga të cilët nuk ka edhe aq shumë, vetëm disa prej tyre janë me frymë patriotike, prandaj është edhe e kuptueshme gjendja e mjerueshme të çështjet ku paraja ishte e nevojshme. Thimo Marko

[46]

përkundrazi vlerësonte se, së paku në Bukuresht, ka disa familje shqiptare të shquara dhe të pasura, të cilat deri më tani kanë bërë shumë sakrifica materiale, dhe kryesisht falë atyre në Korçë shohim një jetë shqiptare gjysmë të lulëzuar.

Kryemësuesi përsëri u interesua shumë për ortografinë time dhe unë përfitova nga ky rast për të ballafaquar po të njëjtën me ortografinë, tashmë të zakonshme për korçarët, të Frashërit. Ata vlerësonin se ortografia ime e bazuar në shqiptim është shumë më e thjeshtë; mirëpo njerëzit mendonin se në zonën e tyre ortografia e Frashërit tashmë ishte bukur e përvetësuar. Prandaj, mu për këtë, ata vendosën, që ortografinë time ta fusnin shkallë-shkallë, gjë që do të ishte më e përshtatshme të bëhej nëpërmjet shkollës, por sikur ta kishin pasur vetëm një burim, i cili do t'u dërgonte libra me ortografinë time.

Shkolla evangjeliste e vajzave në Korçë

Në ditët në vijim vizitova shkollën evangjeliste të vajzave. Edhe aty u pritëm solemnisht. Rastësisht më ra në dorë një dorëshkrim që përbënte historinë e themelimit dhe zhvillimit të kësaj shkolle dhe i cili rridhte nga tashmë i ndjeri evangjelisti shqiptar Gjermani. Më vonë mora në posedim edhe një dorëshkrim nga hartuesi i njëjtë. Ky i fundit bën fjalë për historinë e burgimit të tij. Shpresoj që këto dorëshkrime,

[47]

por posaçërisht të parin, pas pak diku t'i botoj. Shkolla e cekur e vajzave ia tejkalonte shkollës së sapopërmendur të djemve. Edhe këtu i mora punimet e njëjta të vajzave, sikur të djemve, por krahasimi i tyre flet në disfavor të këtyre të fundit.

Nga Korça bëra një rrugë të tërthortë deri në Boboshticë e pastaj edhe nja 6 orë në jug të Korçës. Përveç materialit gjuhësor, ky udhëtim nuk më solli diçka që është e vlefshme për të cekur.

Si u ktheva, udhëtova fill në Manastir. Gjatë rrugës, konstatova se e tërë ana nga Prespa dhe Resnja ishte e vërsuar nga shqiptarët.

Manastir: Konsulli austro-hungarez, z. Kral

Në Manastir iu paraqita menjëherë z. Kral, konsullit austro-hungarez. Interesimi im për këtë zotëri ishte zgjuar nga përshkrimet, që i kisha marrë në vende të ndryshme nëpër zonat ku kisha udhëtuar dhe për të cilat

kam bërë skica shkurtimisht në vijim. Nga ai mësova se ai tashmë ishte njoftuar nga Shkëlqesia Juaj për mua, dhe u pranova me shumë dashamirësi dhe me një mikpritje të jashtëzakonshme. Temat e bisedës sonë ishin kryesisht rrethanat shqiptare. Ai doli të ishte një mik shumë i madh i shqiptarëve, i pajisur me një njohuri mahnitëse për vendin, karakterin, nevojat etj. të tyre.

[48]

Ai është plotësisht i mbushur me peshën e postit të besuar të tij dhe ai, tek i cili patriotizmi më i mirëfilltë austriak, zelli më i ndërgjegjshëm i përfaqësuesit austro-hungarez, m'u shfaq, në lidhje aq reale me miqësinë e devotshme ndaj Shqipërisë, si e mishëruar para syve, më mbushi përsëri mua, i cili patriotizmin shqiptar e bashkon me mirënjohjen dhe besnikërinë më të sinqertë ndaj Monarkisë austro-hungareze, me ndjenjat fatlume të një harmonie të vërtetë të ideve dhe interesave.

Dua të them se z. Kral e kupton, si asnjë tjetër, se si nga shqiptarët të bëjë austriakë të mirë.

Që në fillim i lejova vetes, me admirimin tim të plotë për këtë përfaqësues të zellshëm të Austrisë, të shprehja interesat dhe nuk mundem, i nderuari z. shef i Seksionit, ta fsheh se unë si një shqiptar në Austri i përcaktuar me bindje për të gjitha shpresat për kombin tim, mund të kem vetëm dëshirën, që pikëpamjet e z. Kral të kenë jehonë në një instancë të lartë në Vjenë. Dhe ne - e tani është momenti i përshtatshëm - do t'i hapnim aty për aty, njërën pas tjetrës, shkollat në zonat e Manastirit, Ohrit, Dibrës, Korçës dhe Elbasanit, pra në zemrën e Shqipërisë, në Vjenë të krijohej një librari⁴, shoqata letrare shqipe, nga e cila ajo në Bukuresht do të zhdukej nga faqja e dheut

[49]

si dhe qendra, nga e cila jeta dhe aspirata kombëtare do të merrnin ushqim dhe kahe, të jetë në Vjenë.

⁴ Verschleiss: Verkauf im Kleinen (oesterreichische Amtssprache, cf. DUDEN)

Është ky digresioni i vetëm, që për mendimet e mia, e kam lejuar deri më tani në këtë raport udhëtimi.

Gjergj dhe Gjermen Kyrias (Qiriaz)

Kthehem në Manastir. Z. konsull Kral mëson zellshëm edhe vetë shqip. Ai merr mësim nga një zotërues shumë i zgjuar i gjuhës. Është ky Gjergj Qiriaz, i cili në Manastir e mban visarin e biblës së përkthyer në anglishte. Edhe atë e njoftova. Ai, si dhe vëllai i ndjerë i tij Gjermani, kanë merita të mëdha për kujdesin që, pa marrë parasysh të gjitha vështirësitë e mëdha, për shpërndarjen e përkthimit të biblës shqip, me ç'rast ata kontribuan jashtëzakonisht shumë për kauzën shqiptare.

Konsulli serb Ristić

Me ndërmjetësimin e Gjergj Qiriazit u njoftova me shumë shqiptarë me frymë patriotike. Përveç kësaj, i bëra vizitë edhe konsullit serb Michael Ristić, i cili ishte një miku im nga Beogradi dhe shpresoja se nga ai, mundësisht, do të mësoja disa nga pritjet. Ne biseduam gjithashtu për çështjet shqiptare. Ristić-i më tregoi se edhe serbët tani kanë filluar ta fusin në rend dite interesin për shqiptarët dhe mundësisht për të bërë diçka për ta.

[50]

Aktualisht në Beograd është një shqiptar në shkollën e lartë, për të cilin po mendohet për ta shkolluar në një albanolog të zellshëm. Ai është në korrespondencë me Simić-in, konsullin serb në Serbinë e Vjetër. Të dy kujdesen shkëlqyeshëm për çështjet shqiptare. Ai më ofroi edhe mua që të hyja në shërbimet serbe. Me siguri se do të më ndanin aty për aty një bursë të respektueshme, me të cilën do të kisha mundur t'i përfundoja studimet e mia pa brenga kudo në një vend të huaj. Më pastaj do ta kisha të sigurt një angazhim si albanolog në Beograd.

Spiunët e konsullit rus

Kur e vizitova për herë të dytë konsullin austro-hungarez, ai më bëri me dije në mënyrë të rezervuar se në Manastir në mesin e konsujve flitej

shumë për mua dhe se posaçërisht konsulli rus nëpërmjet spiunëve më vrojtonte me shumë saktësi. Një herë edhe unë vetë me një spiun, që quhej Vasiljev, kisha ngrënë darkë. Kjo ndodhi te dr. Anastas Kristidis, një koleg i dikurshëm imi, tek i cili ai u shfaq i paftuar. Por ne biseduam për çështjet sllave e greke në Maqedoni. Vasiljev-i më ftoi ta vizitoja në banesën e tij. Ai me siguri përpiqej të më hulumtonte sadopak. "Mjerisht", mua m'u desh përsëri të merrja shkopin e rrugës dhe të lëvizja më tutje.

Fjala mbyllëse

Juve, dhuruesit më të shtrenjtë timit të nderuar, ju jam shumë falënderues nëse do të kishit pasur durimin e madh ta shikonit paraprakisht të tërë raportin e udhëtimit të përmendur.

[51]

Në hyrje mora lirinë të bëja vërejtjen që, sipas opinionit tim të parëndësishëm, Austria, për mijëra arsye, është e shtyrë pikërisht ta marrë në dorë edhe kauzën shqiptare. Se nga e kam nxjerrë këtë vrojtim, besoj se kjo del vetvetiu nga rrjedha e raportit tim të mësipërm të udhëtimit. Aty shihet saktësisht se ku skamja dhe ku nevojat urgjente kulturore e shtypin popullin shqiptar. Zëshëm dhe kudo dëgjohet se si shprehet respekti dhe besimi i rrënjosur thellë në popull për Austrinë. Mund të bindeni se nuk është gjoja vetëm zëri im, por është zëri i popullit që thërret: libra dhe shkolla, promovim i përgjithshëm i ringjalljes shpirtërore të shqiptarëve; shkollim i rinjve të talentuar; ndihmë dhe mbrojtje për themelimin e një qendre shpirtërore shqiptare në Vjenë! Vërtet, këtu s'do të gjeni një detyrë të bukur për një shtet aq të madh kulturor, si Austro-Hungaria, për të cilin tashmë është bërë një zakon dhe karakteristikë historike që gjithnjë dhe kudo të ndërhyjë për garantimin dhe përhapjen e humanitetit dhe civilizimit! Në fund të fundit, simpatitë, të cilat i gëzon Austro-Hungaria në mesin e shqiptarëve, le të ushqehen dhe të mos humbasin. Këtë të fundit s' mund ta paramendoj, por e përmend, sepse të tjerët janë në pritje dhe mua po më ngushtohet koha, duket sikur çështja ka arritur shkallën më të lartë të pjekurisë.

Me shprehjen e sërishme të falënderimit më të thellë për bamirësin tim të madh, pa të cilin unë nuk do ta kisha parë aq shpejt vendlindjen time

dhe në një mënyrë të tillë shumë të suksesshme, posaçërisht në fushën time
të veçantë të studimit, Ju përshëndes Shkëlqesinë tuaj,
i përvuajturi dhe falënderuesi

Gjergj Pekmezi

Kand[idat] i fil[ozofisë]

KRITIKA, RECENSIONE

Remzi PËRNASKA: *Gjuhësi gjuhësore I*, Maluka, Tiranë, 2015, ff. 283;

Remzi PËRNASKA: *Gjuhësi gjuhësore II*, Maluka, Tiranë, 2015, ff. 473.

Studiuesi në zë, Remzi Përnaska, rivjen sërish para lexuesit, tashmë me veprën e tij të përzgjedhur e të përmbledhur “Gjuhësi gjuhësore”.

Përvoja e tij e gjatë në fushën e studimit dhe botimit, trajtimet e thelluara në shqyrtime, angazhimi njëherazi në probleme nga më të rëndësishmet dhe nga më të vështirat që parashtronte dhe parashtron ngutshëm zhvillimi i mendimit gjuhësor në etapa të caktuara e, për më tepër, angazhimi në studime e botime qysh në rini e deri në moshë të mbrame, kanë përvijuar natyrshëm vendin e merituar të kontributeve të tij në fusha të ndryshme të studimit të gjuhës shqipe e historisë së saj; e në këtë kontekst, vepra e tij e përzgjedhur dhe e përmbledhur është e mirëpritur. Por e nxit më tej nismën për botimin e përmbledhjeve të kësaj natyre edhe shpërhapja dhe botimi i shkrimeve në organe të ndryshme, ndikimi negativ i një morie vështirësish që përftoheshin natyrshëm prej distancës kohore të botimit, ose dhe ndikimi i pengesave që hasen praktikisht për t’i konsultuar studimet (tashmë të kërkuara në një gjeografi shumë më të zgjeruar, si brenda kufijve shtetërorë të Shqipërisë, por sidomos edhe përtej tyre).

Nga ana tjetër, botimi i disiplinuar kronologjikisht dhe i përzgjedhur mbi një kriter tematik t’j shkrimeve, studimeve a shënimeve, që për arsye të ndryshme nuk e kanë parë dritën e botimit, është edhe ndihmë e vlerësueshme që u jepet lexuesve të sotëm,

të cilët, në mënyrë sistemore e lehtësisht të konsultueshme, ballafaqohen, në këtë mënyrë, me kahje të caktuara dijeje dhe tregues të ecurisë së mendimit shkencor në fusha të caktuara të saj; dijet e përfutuara në studimet dhe botimet e R. Përnaskës e gëzojnë në vijimësi vlerën e referencës për studimet e sotme, ndaj mbeten të kërkuara dhe të konsultueshme nga specialistët, e po ashtu nga rishtarët në fushën e studimeve gjuhësore e albanistike, mësuesit e gjuhës shqipe dhe dashamirët e gjuhës.

Në mënyrë të veçantë, nevoja për përmbledhje të tilla ndihet tashmë sidomos në mjediset universitare. Kanë qenë edhe interesimi dhe kërkesa e përfutur në mjediset universitare në të cilat R. Përnaska vijon të jetë i angazhuar si ligjërues e studiues, që kanë nxitur nismën për botimin e veprës *Gjuhësi gjuhësore* (në gjashtë vëllime), dy botimet e para të së cilës janë botuar ndërkohë nga Shtëpia botuese *Maluka*, Tiranë, 2015; vëllimi i tretë do të botohet në pranverë të 2017-ës. Ai do të përmbajë shkrimet për sistemin foljor dhe emëror (E tashmja, Formalizimi i së pakryerës, Kundërvënja e kryer e thjeshtë/e kryer, Për normëzimin e dysorëve të habitores, A ka rasë gjinore gjuha shqipe, A është shumësi i emrave fjalë më vete).

Lënda e vëllimit të parë të veprës së përmbledhur, vëllim i titulluar *Këndvështrimet gjuhësore*, është përqendruar në informacione e trajtime të natyrës teorike e filo-

zofike që lidhen me gjuhën/ligjërimin; është përqendruar gjithashtu në parashtrime e informacione për “teoritë e të thënit” e veçanërisht për “teorinë e operacioneve thënësore”, në të dhëna e trajtesa për formalizimin, aparatën matematik ose teknikat informatike që përdoren në studimin e ligjëritimit njerëzor.

Lënda e këtij vëllimi është e strukturuar në dy pjesë. Pjesa I, me katër shkrime të botuara në vitet 1971-1972 në revistat *Arësimi popullor* dhe *Revista pedagogjike*: *Gjuha dhe mendimi – forma dhe përmbajtja*, *Gjykimi dhe fjalia*, *Disa probleme të studimit të fjalisë*, *Fjalia për nga aspekti statik dhe dinamik*; ndërsa në pjesën e dytë janë botuar për herë të parë shënimet që autori ka mbajtur në ligjëratat e Antuan Kyliolisë (Antoine Culioli), teoricienit të gjuhësisë ligjëritmore, semantike, sidomos të gjuhësisë së Operacioneve Thënësore (TOTh), si edhe ato të mbajtura në ligjëratat për matematizimin dhe formalizimin e dukurive gjuhësore të Zhan-Pjer Deklesë (Jean-Pierre Desclés) që autori i ka ndjekur në Universitetin e Parisit VII dhe në Ecole Normale Supérieure të Parisit nga viti 1974 deri në vitin 1982, dije të një gjuhësie, parimet e së cilës vetë autori është përpjekur t’i zbatojë në shumë prej studimeve të tij.

Shkrimet në këtë vëllim janë t] disa dhjetëvjeçarëve më parë, por paraqesin interes për lexuesin e sotëm, pasi në to gjenden përgjigje për probleme të natyrës teorike e filozofike që lidhen me gjuhën/ligjërimin, të cilat ende mund të mos i ketë të disiplinuar *sa* dhe *si* duhet në materialet që ka në përdorim, por që mbeten në qendër të interesimeve të tij edhe në periudhën e tanishme; për më tepër, lexuesi do të gjejë

në parashtrime sqarimin e shumë koncepteve me të cilat studiohen aktualisht shumë prej dukurive gjuhësore; gjen atje parashtrime dhe informacione për “teoritë e të thënit”, e veçanërisht për “teorinë e operacioneve thënësore”, që shënojnë ballafaqime ndër më të parat të lexuesit shqiptar me këto kahje dhe metodologji studimi; gjen të dhëna dhe trajtesa për formalizimin, aparatën matematik dhe teknikat informatike që përdoren në studimin e ligjëritimit njerëzor, që janë tashmë njohuri të domosdoshme themelore për t’u orientuar më mirë, më shpejt dhe në mënyrë më të efektshme në metodologjitë e sotme të shqyrtimit të dukurive gjuhësore që s’mënojnë të përdorin rëndom edhe këto mjete dhe teknika.

Sidomos në pjesën e dytë të vëllimit, autori përvijon edhe shumë prej treguesve qenësorë teorikë e metodologjikë që do të karakterizojnë këndvështrimet e tij në trajtimin e dukurive të ndryshme gjuhësore të shqipes, të cilat do të trajtohen në shkrimet e pranishme në vëllimet e tjera, për shembull, ato që kanë të bëjnë me *temporalitetin/kohësinë* në shqipe, *modalitetin* dhe veçantitë e albanizmave që bartin atë, *nën-sistemin e trajtave të shkurtra të përemrave vetorë në shqipe*, etj.; janë studime të bëra kryesisht gjatë periudhës që punonte pranë ekipit të A. Kyliolisë (të periudhës së Parisit, nëse do ta emërtonim të tillë këtë kohë të kërkimit të tij shkencor) a nën ndikimin e teorive të përpunuara pranë atij ekipi - është periudha kur në kahjet e shqyrtimit të albanizmave prej tij u përvijua këndvështrimi që synonte të qokëtonte dhe interpretonte të veçantat dhe jo universalet në gjuhë; ndaj albanizmat përbënin jo thjesht objekte kurreshtjeje, por objekte të mirëfillta shqyrtimi

dhe interpretimi që nxisnin më tej reflektime në tërë ekipin; ishte koha e pranimit dhe përqaftimit prej tij të motos së teorisë së të thënit: *jo të gjejë universale, por të qokëtojë invariantet në gjuhë*.

Lënda e vëllimit të dytë, të titulluar *Çështje të studimit të marrëdhënieve kundranore në gjuhën shqipe*, është përzgjedhje shkrimesh që përqendrohen përgjithësisht në të njëjtën temë studimi: *shprehjen e marrëdhënieve kundranore në gjuhën shqipe*.

Edhe vëllimi i dytë është strukturuar në dy pjesë: në pjesën e parë, në mënyrë kronologjike janë përmbledhur shkrime dhe studime të kryera qysh nga viti 1969 e deri në vitin 2012 për problematikën në fjalë; përzgjedhja e këtyre shkrimeve është bërë me kujdes për të mënjeluar sa më shumë të ishte e mundur përsëritjet, që në përzgjedhje të kësaj natyre, e për më tepër në botime që zënë hapësirë kohore kaq të gjerë, nuk është e lehtë të mënjanohej plotësisht. Ndaj autori ka lënë (jo pa një lloj brengje) jashtë kësaj përmbledhjeje dy shkrime të shkruara në frëngjisht dhe rusisht, njëri për bashkëpërshtatjen e “trajtave të shkurtra të përemrave vetorë” me kundranorin, i hartuar me bashkautor Zhan-Lui Dyshenë (Jean-Louis Duchet), botuar në frëngjisht në revistën *Faits de langues*, *Revue de linguistique*, 8, Paris, 1996, dhe tjetri në rusisht në *Studia linguistica et balcanica*, Saint Petersburg, 2001. Jashtë kanë mbetur edhe dy studime të tjera të autorit të cilat ka kohë që i mban në duar – por, siç thekson ai, ende nuk është i bindur se kanë marrë formën përfundimtare – njëri për nënsistemin e “trajtave të shkurtra të përemrave vetorë” dhe logjikën e Aristotelit dhe, tjetri, për nënsistemin e “trajtave të

shkurtra të përemrave vetorë” dhe problemin e “dy kokave” në vështrimin sintaksor të Lysjen Tenjerit (Lucien Tesnière).

Vënia në rend kronologjik e shkrimeve, e për më tepër, përzgjedhja e shkrimeve mbi kriterin tematik të njëjtë a të përafërt, i mundëson lexuesit të sotëm të ndjekë lehtësisht ecurinë e shtjellimit dhe argumentimit të çështjeve të tilla, si: *a janë përemra “trajtat e shkurtra të përemrave vetorë” në shqipen e sotme?; a e kanë humbur ato natyrën përemërore të tyre?; dhe në ç’shkallë humbjeje të kuptimit përemëror paraqiten ato sot?; a mund të thuhet prerë se prania a mosprania e trajtës së shkurtër të përemrit vetor shërben mirëfilli për shprehjen e gjymtyrëzimit aktual të thënies në gjuhën shqipe?; a mund të vihet kriteri sintaksor në bazë të përkufizimit logjik-gramatikor për kundranorin?; a mund të quhet kundranori gjymtyrë e dytë, ashtu si konceptohet sot gjymtyrja e dytë?; a ndjek bashkëpërshtatja kundranor–kallëzues po ato rregullsi që ndjek bashkëpërshtatja nënanor/ kryefjalë–kallëzues?; a kanë kundranori dhe nënanori/ kryefjala përmbytje afërsisht të njëjtë edhe në nivelet më të larta, në ato të predikatimit?; dhe, në këto kushte, a duhet rievështuar statusi sintaksor i kundranorit dhe a duhet ta shtrijmë zgjidhjen për këtë problem edhe në hapësirat e filozofisë, logjikës, psikologjisë, sidomos asajognitive, teorisë së komunikimit, informatikës?; a përbën rendi i gjymtyrëve në gjuhën shqipe funksionin themelor që ka të bëjë me gjymtyrëzimin aktual të thënies?; në ç’mënyrë dhe nga ç’pikëvështrime duhet bërë dallimi thënie-fjalë?; a janë fjalia dhe thënia e njëjta njësi kumtuese?, etj. Përgjigja për çështjet e ngritura vjen pas para-*

shtrimesh e analizazh të hollësishme, në një studim të vetëm ose në mënyrë vijuese në disa studime, ku tezat rimerren e analizohen duke u mbështetur në teori bashkëkohore e të përshtatshme edhe për shqipen, për të arritur në përfundime të argumentuara; për më tepër, me gjuhë të qartë e parashtrime të kthjellëta, përmes vështrimit sa më të gjerë të dukurisë, përgjithësisht në plan sinkronik, por hera-herës edhe diakronik. Kjo mënyrë vështrimi, analize e argumentimi u ka dhënë dijeve të përfuara në këto shkrime statusin e dijes së referencës.

Në pjesën e dytë risillet në botim studimi për kundranorin me parafjalë *Kundranori me parafjalë në gjuhën e sotme shqipe*, Dukagjini, Pejë, 1996, botim në të cilin autori pati sjellë trajtime të thelluara për njërën prej gjymtyrëve më të rëndësishme të fjalisë, kundranorit me parafjalë, në një kontekst shqyrtime në të cilin ende nuk kishte studime të plota për gjymtyrët e fjalisë, e në veçanti për kundranorin; botim në të cilin autorit i është dashur të plotësojë edhe një lloj zbrazëtie të pranishme në shqyrtimin e kësaj gjymtyre në aspektin e parashtrimeve teorike në kontekstin e studimeve gjuhësore për shqipen, dhe të orientojë po ashtu në kontekstin e teorive të pranishme në letërsinë shkencore të gjuhëve më të studiuara ku, gjithashtu, siç ai vetë thekson, “nuk gjeti qartësinë dhe rreptësinë shkencore që priste”, por që gjithsesi “më shumë se zgjidhje, ai gjeti ide dhe mendime nxitëse që jepnin mundësi dhe hapnin rrugë për hulumtime të imta me forcë përgjithësuese, me kusht që ato të mos zbatoheshin verbatazi”; një punim që synoi përcaktimin më të mirë të kufijve të vetë kundranorit me parafjalë dhe sidomos

të kufijve midis gjymtyrëve të dyta dhe kundranorëve me parafjalë; botim në të cilin ishin të pranishme shqyrtime dhe parashtrime që u mbështetën në një material të vjelë tejet të gjerë, sidomos nga vepra letrare dhe shkrime të botuara në gazetat në gjuhën shqipe në Shqipëri, Kosovë e më gjerë, shpeshherë vjelje shteruese, duke krijuar një skedar me disa dhjetëra mijëra skeda, shqyrtimi i të cilave parakuptonte analiza nivelesh të ndryshme e teknikash po ashtu të efektshme, si ato të përndarjes, ndërkëmbimit, etj.; botim në të cilin autori prirej të interpretonte veçantitë e shfaqjes e përdorimit të kësaj gjymtyre në shqipe, përmes analizave strukturore-semantike, duke mbajtur parasysh dhe duke u ndihmuar edhe nga analiza e togfjalëshit; e po ashtu, një botim i vlerësueshëm jo vetëm për analizat dhe zgjidhjet e dhëna, por edhe për problemet e ngritura dhe që presin në vijimësi zgjidhje, si ai që ka të bëjë me “reksionin e parafjalëve prej foljeve” ose problemi i “semantikës së foljeve në ndërtimet konkrete me parafjalë”, zgjidhje që, sipas autorit, do të jenë të dobishme jo vetëm për gramatikën, por edhe për leksikologjinë, në mënyrë të veçantë për praktikën leksikografike.

Tregues i një pune të kujdesshme, të gjatë e të tejmenuar, e cila spikat dukshëm në dijen e pranishme e në shqyrtime e këtyre botimeve është edhe përpjekja për të përshtatur një terminologji sa më të efektshme, që të nxjerrë në pah konceptet dhe veçantitë e shfaqjes së dukurive dhe interpretimin metagjuhësor të tyre. Përnaska është treguar i vëmendshëm dhe u ka mundësuar vlerë përdorimi gjetjeve që janë përvijuar nga përvoja e kolegëve të tij në fu-

shën e gjuhësisë, krahas shumë shqipëri-meve të bëra nga ai vetë, të cilat, edhe kur nuk marrin statusin e skajeve gjuhësore, i japin qartësi të dukshme ligjërimit dhe e bëjnë të komunikueshëm mesazhin.

Përgjatë parashtrimit dhe interpretimit të koncepteve të ndryshme gjuhësore, përzgjedhjes dhe përshtatjes së një terminologjie funksionale, del në pah edhe një veçanti e stilit të autorit: spikatin në vijimësi pohime për probleme të rëndësishme konceptuale të gjuhësisë, përqokje të veçantive të albanizmave dhe dukurive nëpërmjet të cilave shqipja mund të nxisë shqyrtime interesante në kontekstin e gjuhësisë teorike, e më tej ngjizen e shprehen ato në formën e sentencave, përkufizimeve, përcaktimeve shkencore logjike e të argumentuara, që e joshin lexuesin si brendi dhe paraqitje, e bëjnë atë më të vëmendshëm e reflektiv dhe i japin atij siguri në përvetësim të njohurive.

Lënda në dy vëllimet e para të veprës së përmbledhur të Përnaskës shfaq një natyrë të dyfishtë: një pjesë e shkrimeve (sidomos ato të vëllimit të parë) është përfutur me natyrën e një dijeje të *transpozuar* për mësuesit, si një mënyrë e ndërmjetme për t'u shndërruar në dije për t'u dhënë mësim; pjesa tjetër (sidomos shkrimet për studimin e marrëdhënieve kundranore në gjuhën shqipe, së bashku me studimin për kundranorin me parafjalë në shqipe) është përfutur si dije e mirëfilltë shkencore/dije reference; në këtë mënyrë, botimi i dy vëllimeve të para parakupton një lexues shumë më të gjerë sesa thjesht lexuesin e specializuar në fushën e gjuhësisë.

Një veçanti tjetër e dijes së përfutur në disa prej shkrimeve në dy vëllimet e para është ndërdisiplinariteti si kahje shqyrtimi, që shfaqet si domosdoshmëri në studimin e dukurive gjuhësore dhe ligjërimore.

Edhe pse mëton të qëndrojë në hapësirat e *gjuhësisë gjuhësore*, Përnaska ndjehet komod ndërsa endet në hapësirat e ndërdisiplinaritetit; ai është i ndërgjegjshëm (madje e synon me ngulm këtë kahje shqyrtimi në disa prej shkrimeve të tij) se ndërdisiplinariteti duhet të përfshijë jo vetëm njohuritë e përfshira në hapësirën e shkencave të ligjërimit, por edhe ato hapësira shkencore ku shtrihen *logjika* matematike dhe e synueshme, *algjebra*, *topologjia*, etj.

Në disa prej shkrimeve të pranishme edhe në këto dy vëllime të para, Përnaska ka përshkruar mënyrat dhe dobittë e përdorimit të aparatit matematik dhe metodat e formalizimit në shqyrtimin e dukurive gjuhësore, duke i zbatuar ato metodologji në çështje konkrete (le të kujtojmë, për shembull, sythet për *Formalizimin*, *Sistemin*, *Matematizimin*, në vëllimin I, ose *Çështje të kundranorit në gjuhën shqipe*, *Sprovë për formalizimin e dukurisë "së përsëritjes" së kundranorit të drejtë në vetën e tretë*", etj. në vëllimin II).

Ai shkel i sigurt në hapësirat jo shumë të njohura në mendimin tonë gjuhësor që lidhen me formalizimin, me aparatit matematik ose teknikat informatike në studimin e ligjërimit njerëzor. Tregues i sigurisë është jo vetëm informacioni i qartë dhe i ngjeshur që jepet, por edhe një sistem i tërë konceptesh dhe skajesh gjuhësore të sjella në shqip në mënyrë po ashtu të qartë e domethënëse. Kjo mënyrë parashtrimi do të

lehtësojë së tepërmi leximin e materialit të pranishëm (por edhe atë në vëllimet e tjera, në të cilat këto procedura zbatohen në shqyrtimin e drejtpërdrejtë të dukurive të ndryshme gjuhësore të shqipes dhe në gjetjen e invarianteve ligjërimore që janë të qokëtueshme nga gjurmët e tyre gjuhësore në shqipe).

Në etapën e tanishme të zhvillimeve të vrullshme të gjuhësisë informatike dhe shfrytëzimit të sistemeve të formalizuara për një mori aspektesh/problemesh që zgjidhen përmes inxhinierisë gjuhësore, parashtrimet e kësaj natyre nuk duhen konsideruar si rrugë elitare në shqyrtim; por në statusin e sotëm të asaj fushe dihej, ato janë njohuri të domosdoshme.

Duke shqyrtuar lëndën e pranishme në këto dy vëllime të botuara, dhe duke patur parasysh edhe atë që do të përbëjë vëllimet e tjera, titulli *Gjuhësi gjuhësore*, si titull i përbashkët për të gjitha vëllimet, si “mbititull”, bëhet gjithnjë e më i motivueshëm, duke mos u kuptuar thjesht si një përzgjedhje stilistikisht ndikuese nga ana e autorit. Edhe përmes titullit lexuesi ka hapësirë të gjerë të ndërtojë domethënie dhe të bëjë interpretime. R. Përnaska ka provuar ta shprehë, pra, qysh në emërtimin përbashkues të përmbledhjes së veprave kahjen e tij të shqyrtimeve përmes një rikonceptimi që i ka bërë, me gjasë, një pohimi të Lui Hjelmslev-it në lidhje me ekzistencën e gjuhësisë si *gjuhësi gjuhësore a imanente* dhe mëdyshjes që bartet gjithnjë në përcaktimet tejet përgjithësuese në lidhje me të, me kundërvënien/ përqasjen mes “gjuhësisë biologjike, psikologjike, fiziologjike, sociologjike” nga njëra anë, dhe nga

ana tjetër “gjuhësisë gjuhësore a gjuhësisë imanente”.

Përnaska e shfaq si sfidë teorike pikërisht këtë mëdyshje që përshkoi në pothuajse një gjysmë shekulli mendimin gjuhësor; ai pasqyron koncepte, ide, opinione, teza dhe hipoteza që lidhen me njësitë e gjuhës, me vlerat e përfutura në kod brenda sistemit; gjejmë në atë brendësi gjithsesi edhe hapësira që mundësojnë të shohësh edhe përtej, dukuri që përftohen përgjatë përdorimit të gjuhës e procesit të të thënit, madje edhe pikëvështrime që të mundësojnë të shohësh së jashtmi studimin e ligjërrimit; reticenca në titull parakupton një hapësirë gati 50-vjeçare shqyrtimesh të *gjuhësisë imanente*, por gjithsesi ... *jo gjithnjë imanente*.

Analiza më për nga afër e përvojave dhe prurjeve të gjuhësisë imanente, si strukturalizmi, distribucionalizmi dhe gramatika gjenerative na mundëson të vërejmë që shqyrtimet dhe interpretimet e tyre nuk arrijnë ta përkapin diskursin/përftesën ligjërimore, duke i lënë hapësira shqyrtimi një tjetër gjuhësie, *gjuhësisë së të thënit*, gjithashtu të pranishme dhe të efekshtme; prania e reticencës në emërtim bart, pra, domethënie e kësaj zone tjetër në shqyrtim.

Përballë një vepre të shkruar dhe, më së shumti, të botuar në Shqipërinë e para nëntëdhjetës, lexuesit të sotëm mund t'i lindë natyrshëm pyetja: a mundej studiuesi t'i shmangej diktatit ideologjik dhe t'i falej thjesht autoritetit shkencor (për më tepër, kur trajtonte tema të tilla që kanë të bëjnë me filozofinë e gjuës/ligjërrimit dhe sillte vështrime bashkëkohore të gjuhësisë europiane)?

Në fakt, komunikimi shkencor është një dukuri e ndërlikuar, në të cilën studiuesi, si mbrojtës ndaj kushtëzimeve, kufizimeve dhe shtrëngimeve të kohës ka një instancë të tretë që shfaqet në formën ideale të një kërkesë jo thjesht superiore, por më tepër ekzistenciale – është instanca së cilës studiuesi i falet për të qenë pjesë e komunitetit të kërkuesve, që s’ka të bëjë me ideologjinë, me pushtetin, politikën a mjedisin social në një kohë të caktuar. Është ajo instancë e tretë që ai i drejtohet në bashkëbisedimin real, të cilin M. Bakhtini (Mikhail Bakhtine) e quan *përtejbashkëfolësi* a *thëniemarrësi* i *përtejme/ surdestinaitare*; një i tretë që sipas Sofi Muaranit (Sophie Moirand) është “i sajuar/kuptuar si një paraqitës ideal i disiplinës, përkrahës i së cilës është autori ose përkrahës i së cilës ai mëton të jetë”.

Ishte e pranishme edhe kjo instancë e tretë në bashkëbisedimin me lexuesit që ka mundësuar ngjizjen e mesazheve në lëndën e shkrimeve të këtyre dy vëllimeve (dhe në përgjithësi të veprës së Përnaskës) edhe përtej mesazhmarrësve të kohës apo atyre të afërt me atë kohë; është kjo instancë e tretë, përfaqësuese e denjë e shkollave dhe e teorive përkatëse, që i ka mundësuar atij të dialogojë me lexues edhe përtej kohës së përfuturit të mesazheve, megjithë kontekstin kushtëzues dhe kufizues të kohës së përfuturit të tyre, t’u kundërqëndrojë heshturazi kufizimeve, duke u drejtuar për nga tezat shkencore dhe jo ideologjemat.

Përmbledhjet e kësaj natyre përkrijnë me një situatë leximore pothuaj të ndryshme nga ajo e kohës së shkrimit dhe botimit të shumicës së shkrimeve, jo vetëm si pasojë e dijes në zgjerim dhe thellim në atë

fushë, por edhe të lexuesit, i cili i qaset veprës tashmë me një tjetër kompetencë leximore, për të përthithur e ndërtuar prej saj domethënien në një kontekst të ri dijeje.

Sprova mbetet e suksesshme kur mesazhet në vepër, analizat, shqyrtimet, interpretimet, njohuritë dhe në tërësi problematika e trajtuar mbeten aktuale e të dobishme, dijet mbeten funksionale dhe nxitje për kërkime të mëtejshme. Studiuesi ndërmerr një sfidë, së cilës lexuesi i jep kuptim.

Interesi i gjerë dhe vlerësimet e bëra pas shqyrtimesh të kujdesshme dhe të shumanshme nga ana e studiuesve në konferencën shkencore të organizuar nga UE “A. Xhuvani”, më 24 prill 2015, me rastin e 80-vjetorit të lindjes së Përnaskës (kumtimet dhe diskutimet janë botuar në përmbledhjen e akteve të konferencës “Remzi Përnaska – personalitet i gjuhësisë shqiptare”, Shtypshkronja ILAR, Elbasan, 2015), janë tregues paraprakë se përmbledhja e veprave të tij *Gjuhësi gjuhësore* do të jetë e mirëpritur dhe kontribuese edhe për mendimin tonë gjuhësor të tanishëm.

Tomorr PLANGARICA

Rrahman PAÇARIZI. **Konversioni në gjuhën shqipe**. Parnas, Prishtinë 2015, ff.

Tradita gramatologjike e leksikore në gjuhën shqipe në zhvillimin e saj historik vazhdon të jetë tradicionale dhe me pak përpjekje që çështjet morfologjike dhe ato sintaksore të shihen nën prizmin e drejtimeve linguistike të shkollave të ndryshme moderne të zhvilluara tashmë në botë. Ç'është e vërteta përpjekjet individuale të autorëve shqiptarë dhe të huaj, sidomos kohëve të fundit, për t'iu qasur problemeve morfologjike e sintaksore të shqipes nga këndvështrimet strukturaliste, funksionaliste e gjenerativiste nuk kanë munguar, por të arriturat e këtyre studimeve nuk janë sintetizuar dhe nuk janë reflektuar pastaj në gramatikat shkencore e normative të shqipes. Në kuadër të këtyre studimeve edhe çështja e fjalëformimit në shqipe, ndonëse në të kaluarën është trajtuar nga autorë të ndryshëm, ende mbetet një fushë ku mund të bëhen studime të mëtejme dhe ku mund të zbatohen qasje të tjera teorike e metodologjike, të cilat tashmë i gjejmë të zbatuara në studimet e gjuhëve të tjera, sidomos në studimet për anglishten.

Në këto rrethana që u përmendën sipër, vjen tani studimi i Rrahman Paçarizit për konversionin si mënyrë e fjalëformimit në gjuhën shqipe, studim ky që sjell një qasje krejtësisht ndryshe nga ajo që është reflektuar në gramatikat e shqipes, më konkretisht në Gramatikën e Gjuhës Shqipe të Akademisë së Shkencave, duke e parë problemin jo vetëm si problem leksiko-gramatikor, por deri në një masë edhe si problem psikolinguistik. Në këtë studim të tij "Konversioni në gjuhën shqipe", Paçarizi del deri diku nga fusha e tij e preferuar që është psikolinguistika dhe futet në

problemet e sistemit dhe të strukturës së shqipes, për ta trajtuar një mënyrë të veçantë të fjalëformimit, siç është konversioni. Në 312 faqet e këtij libri, i ndarë në kapituj përkatës tematikë, autori ka shtjelluar në mënyrë të detajuar teorike dukurinë e konversionit në shqipe dhe mënyrat e tij prodhuese. Në fund, Paçarizi ka bërë edhe një klasifikim të fjalëve nga Fjalori i Gjuhës Shqipe sipas llojeve të formimit me konversion.

Në Gramatikën e gjuhës shqipe 1 (Morfologjia) të ASHSH-së konversionin e gjejmë të shpjeguar si mënyrë e formimit të një fjale të re, nëpërmjet procesit të kalimit të një njësie në pjesë tjetër të ligjëratës për shkak të kushteve sintaksore të përdorimit të saj. Duke kaluar në një pjesë tjetër të ligjëratës, fjala e formuar me këtë mënyrë ndërron edhe paradigmen e saj dhe fiton një paradigmë të re, ose e humbet atë krejtësisht, kur një pjesë e ndryshueshme e ligjëratës kalon në një pjesë të pandryshueshme. Për këtë arsye konversioni është quajtur mënyrë morfosintaksore. Si formant fjalëformues në konversion shërben paradigma që fiton fjala e re e motivuar, ose humbja e paradigmes së vjetër dhe lidhjet e reja sintaksore të fjalës, kur kalohet nga një pjesë e ndryshueshme e ligjëratës në pjesë të pandryshueshme.

Pikërisht ky përkufizim i dukurisë së konversionit, Paçarizit i është dukur i pamjaftueshëm për ta shpjeguar këtë dukuri të formimit të fjalëve. Prandaj, ai i është rrekur punës që, duke parë trajtimin e kësaj dukurie në gjuhët e tjera, sidomos në anglishte, nga autorë të huaj, që nga Sweet e

deri tek Marchand, Hudlestone, Pullum e Plag, t'i hyjë studimit të kësaj dukurie edhe në gjuhën shqipe.

Në fillim të librit, autori ka paraqitur mënyrat e përkufizimit teorik të dukurisë së konversionit, të cilat i gjejmë në studimet e ndryshme linguistike. Qysh në fillim, Paçarizi i ikën përkufizimit të dhënë në Gramatikën e Gjuhës Shqipe 1 të ASHSH-së dhe konversionin e përshkruan si një proces leksikor të formimit të fjalëve me ç'rast mbi bazën e një fjale ndërtohet një kuptim i ri, pa përfshirjen e ndajshesave apo formanteve të tjera fjalëformuese. Përshkrimi i dukurisë së konversionit në këtë mënyrë është më neutral dhe shkon në drejtim të kundërt me përshkrimet që jepen në gramatikat e ndryshme, sipas të cilave konversioni nënkupton procesin e formimit të një fjalë të re duke ia ndërruar kategorinë gramatikore një fjale të caktuar. Me fjalë të tjera, përkufizimi që jep autori del më i zgjeruar dhe përfshin edhe formimet me konversion brenda fjalëve të së njëjtës kategori gramatikore. Në të vërtetë, ndërrimin e klasës gramatikore ai e sheh si pasoje e jo si shkak, pasi shkak është formimi i fjalës se re, që mund të rezultojë ose jo me ndërrim të klasës gramatikore. Kjo, sipas tij, në fjalëformimin me konversion nuk është me rëndësi, se e rëndësishme është njësia e re semantike që mbulon një koncept të ri tashmë, sidomos në rastet kur kemi konversion brenda të njëjtës klasë. Pra, ai konversionin, më shumë se si ndërrim klase, e sheh si zhvillim koncepti, të

cilin e shënon e njëjta strukturë.

Më tej, për ta përimtuar këtë mënyrë të fjalëformimit në shqipe, për të cilën autori thotë se është prodhimtare, ai ka paraqitur trajtimin e dukurisë së konversionit në gramatikat e shqipes. Ai vëren me të drejtë se mënyra e formimit të fjalëve me konversion në studimet gramatikore të shqipes paraqitet në mënyrë jo të konsoliduar dhe me mospajtime lidhur me atë se çka mund të quhet konversion. Paçarizi vëren me të drejtë problemin e trajtimit të formimit të atyre fjalëve që nuk e ndërrojnë kategorinë gramatikore. Pastaj, ai shtjellon këtë dukuri duke promovuar një qasje shumëdimensionale. Pikërisht në këtë pikë Paçarizi konsideron me të drejtë se trajtimi i dukurisë së konversionit vetëm si dukuri morfologjike, ndonjëherë si dukuri morfosintaksore, është i pamjaftueshëm. Aq më tepër, ai thekson se me rastin e trajtimit të këtij procesi fjalëformues, duhet pasur një qasje jo vetëm morfologjike e sintaksore, por edhe leksikosemantike, madje edhe psikolinguistike e sociolinguistike. Angazhimi i Paçarizit që dukuria e konversionit të trajtohet në mënyrë shumëdimensionale, duke i kundruar rastet e ndryshme veç e veç dhe duke parë se cilat kritere gjuhësore kanë çuar në formimin e fjalës së re nëpërmjet procesit të konversionit, paraqet një risi në studimet linguistike jo vetëm shqiptare. Qasja shumëdimensionale studimore e formimeve të fjalëve me konversion, nëpërmjet trajtimit të rasteve veç e veç, na ndihmon t'i shohim të gjitha ato raste ku dukuria është shfaqur si rezultat i veprimit të faktorëve gramatikorë, më konkretisht i zhvillimeve morfologjike e sintaksore, si dhe rastet e tjera ku kanë vepruar faktorët semantikë, nëpërmjet

dukurisë së polisemisë.

Më tej, Paçarizi ka trajtuar llojet e konversionit në gjuhën shqipe, duke ndërtuar një tipologji të veçantë që nuk është hasur më parë në studimet linguistike shqiptare. Po ashtu, ai ka përshkruar edhe fazat e konversionit si proces, duke i parë ato si zhvillime semantike të fjalëve që hyjnë në proces të derivimit të njësisë të reja, të cilat mund të quhen si formime me konversion. Në fund të librit, duke bërë një dallim të konversionit me ndryshim pjese të ligjëratës dhe të konversionit pa ndryshim pjese të ligjëratës, autori sjell shembujt e vjelë nga Fjalori i Gjuhës Shqipe, duke i klasifikuar ata sipas kategorizimit që u përmend. Shembujt e vjelë nga Fjalori dëshmojnë qartë se dukuria e formimit me konversion në shqipe është mjaft prodhimtare.

Studimi i Paçarizit hap shtigje të reja, për ta trajtuar dukurinë e konversionit në shqipe. Qasja gjithëpërfshirëse e trajtimit të dukurisë së kësaj mënyre të fjalëformimit që sjell Paçarizi, imponohet si qasje shkencore e argumentuar dhe empirike. Ç'është e vërteta, Paçarizi nuk u vë pikë çështjeve, por i lë të hapura dhe fton për diskutim të mëtejshëm, ashtu siç duhet të jetë në studimet e mirëfillta shkencore. Me librin e tij ai ka nxitur gjuhëtarët që merren me trajtimin e dukurisë së fjalëformimit në gjuhën shqipe që kësaj dukurie t'i qasen në mënyrë shumë më të përimtuar dhe më të thellë, jo aq thjesht dhe sipërfaqësisht, siç është vështuar deri tash. Aq më tepër, hulumtimi i tij i mbështetur në studime të shumta teorike, është një udhërrëfim që edhe studimet e tjera të kësaj natyre do të duhej të bazoheshin në krahasime teorike e praktike me studimet e kryera në gjuhët e tjera, në mënyrë që

dukuritë e tilla të paraqiten dhe të elaborohen me një sfond sa më të pasur teorik.

Konsideroj se midis vlerave të shumta që sjell studimi i Paçarizit, është edhe fakti se autori ka marrë një problem në dukje krejt të vogël, siç është dukuria e formimit të fjalëve nëpërmjet konversionit, dhe i ka bërë trajtim të gjerë, duke nxjerrë një studim të plotë shkencor.

Shkumbin MUNISHI

INDEKSI I EMRAVE

- Abrashi, 205
Adem aga, 272, 273
Agani, 41
Agolli, 62, 66, 67, 87, 88
ALEKSIĆ-PEJKOVIĆ, 133
Aliçkaj, 58, 66
Aliu, 7, 53, 66
Andrić, 52
Antić, 56
Antoni, 41
Appian, 147, 148, 155
Arhimedrit Germanos, 278
Arsovski, 55
Ataturk, 56
Avdyli, 161, 162, 166, 176, 177, 179, 181
Babiniotis, 138, 141
Bakhtine, 298
BALA, 133
BALIU, 133, 181
Barbarich, 143
Basha, 7, 89
Belić, 152
Beqiri, 89
Berati, 149
BIHIKU, 66
Bob Utley, 163, 166
Boçari, 112
BOGA, 65, 133
Bogdan, 146
Bokshi, 52, 81, 89
Brâncuş, 52
Brooks, 54, 66
Bullard, 163, 181
Camaj, 80, 87, 88, 89
Cezarit, 90
Chiarini, 63
Corazzini, 62
COUROCLI, 133
Crnjanski, 56
Cronia, 54, 66
ĆUBILOVIĆ, 133
ĆUKIĆ, 133
Culioli, 293
CURTO, 134
Curri, 203
CVJIĆ, 133, 144
Çefa, 178, 181
Çiraku, 7, 80, 79
DAVUTOĞLU, 133
De Radës, 56
Dedja, 89
Deklesë, 293
DEMIRAJ, 133
DÉRENS, 133
Dervish beu, 279, 281, 282
Dervishi, 87, 88
Desclès, 293
DETSIKAS, 133
Dërvishit, 89
Dioskorides, 150, 154
DOKLE, 133
Don Carolini, 278
DRACE-FRANCIS, 134
Dreshaj, 170, 181
Duchet, 294
Eberts, 143
Erdeljanović, 144, 147
ERDOGAN, 133
EVANS, 133
FETIU, 66
Fishman, 101, 108
Fishta, 54, 62, 64, 67, 87, 122, 203
Forbiger, 149
Frashëri, 41
Frashërve, 272
Frashëri, Mehmet Bej 270, 271
Gajtani, 89
Gall, 94, 108
Gashi, 143
Gerullis, 152
GORI, 109, 123, 132, 133
Grajçevci, 7, 52, 54, 66, 79
Gunga, 52, 81, 89
Gjermani, 275, 276, 278, 279, 280, 281, 286, 287
Gjerqeku, 41, 52, 89
Gjoka, 181
GJORGIEV, 133
Hahn, 143, 144, 257
Hajdar beun, 269, 270, 271

- HALIMI, 5, 89, 183
 Hamdi beu, 265, 266, 267
 Hamiti, 5, 7, 9, 89
 Hamm, 163, 181
 Haxhiademi, 87
 Hekataios, 153
 Heroni, 151
 Hima, 203
 Hirt, 150, 157
 Hjelmlevit, 297
 Hoops, 153
 Hoxha, 31, 53, 66, 168
 HUSEIN, 133
 Hyseni, 161, 179, 171
 Idrizi, 56, 66, 133
 Isaku, 89
 Ismajli, 94, 108, 133, 141
 Istref beu, 270
 IVANOVA, 134
 Jagić, 205
 Jakobson, 164
 Janura, 56, 63, 66
 Januzaj, 176
 Jesenini, 70
 Jireček, 110, 135, 143, 144, 147, 157
 Jokl, 5, 144, 146, 147, 149, 151, 153, 156, 157, 159, 204
 Jorgo, 7, 66
 Joseph, 5, 137, 141
 Jusuf baba, 272
 Kadare, 26, 27, 28, 29, 52, 87, 88
 Kadić, 56
 Kaper, 272
 KAPITANOVA, 134
Kastrioti, 111
 Katnic-Bakarsic, 165, 181
 Kërveshi, 81
 Kiepert, 144, 157
 Klimenti, 262, 263
 Koci, 51, 170, 175
 Kodra, 52
 Koliqi, 62, 63, 66, 67, 80, 81, 82, 83, 87, 111
 Konica, 15, 49, 75, 78, 82, 203
 KONIORDOS, 134
 KONSTANTINOVIĆ, 66
 Konjufca, 167, 169, 170
 Koreshi, 87, 88
 Kosmai, 273, 268
 Kosovel, 54, 55, 56, 57, 58, 60, 61, 62, 63, 66, 67
 Kosumi, 5, 161, 162, 168, 169, 181
 Kovačevski, 56
 Kraja, 7, 5, 15
 Kral, 203, 204, 205, 259, 266, 286, 287
 Krasniqi, 5, 7, 41, 69, 78, 81, 171, 175
 Krekun, 272
 Kretschmer, 151, 205
 Kristeva, 173
 Kristidis, 288
 Kristoforidhi, 281
 Krishti, 144
 Krleža, 52, 56
 Kryeziu, 51, 134
 Kuçuku, 7, 5, 21
 Kylioli, 293
Kyrias, 287
 Lambertz, 144, 204
 Lavrov, 112, 134
 Limblloshmi, 271, 272
 Livius, 145, 153
 Lorka, 51, 64, 65, 70
 LUTOVAC, 134
 Lykophron, 151
 LLOSHI, 134
 Mackey, 94, 108
 Majakovski, 70
 Manek, 204
Manojlović, 55
 Marchand, 300
 Marko, 112, 135, 282, 283, 285
 MARKOVIĆ, 67
 Mažuranić, 147
 McKnight, 163, 181
 Mehmeti, 81, 89
 Mekuli, 5, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 15, 17, 18, 19, 21, 27, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36, 37, 38, 41, 42, 44, 51, 52, 53, 54, 56, 57, 58, 59, 61, 62, 63, 64, 65, 66, 67, 69, 70, 71, 72, 73, 74, 75, 76, 78, 79, 80, 81, 82, 85, 85, 86, 88, 89, 90
 Meyer, 137, 139, 141, 146, 150, 152, 156, 157, 158
 Micić, 61, 67
 Migjeni, 5, 13, 51, 52, 53, 54, 55, 56, 57, 58, 59, 60, 61, 62, 63, 64, 65, 66, 67, 70, 85, 87, 88, 166

- MILANI, 134
MIRDITA, 134
MIŠINA, 56, 67
Mitko, 204
Mjedia, 203
Mladenov, 147
Moirand, 298
MOLHO, 134
Morava, 161
Much, 153
Munishi, 5, 6, 93, 94, 95, 108, 301
Musliu, 79, 87, 88, 89
Musmurati, 180
Nahtigal, 204
Frashëri, Naim bej 272
Naza, 168, 173
Nazor, 41
Njegoš, 52
Nokshiqi, 31, 41
Noli, 87
Nopcsa, 158
Norcia, 53, 67
Novak, 60, 67
Nušić, 52
Oberhummer, 159
Oroman beu, 283, 284, 285
Oštir, 147, 159
Paçarizi, 6, 299, 300, 301
Pali, 163, 166
Papanastasi, 56
Pârvan, 144
Pasho beut, 271
Paudler, 159
Pavlič, 60, 67
Pedersen, 145, 152
PEKMEZI, 134, 203, 204, 205, 289
Pekmezović, shih Pekmezi 205
Përnaska, 6, 292, 296, 298
Philippsohn, 144
Piegay-Gros, 173, 181
Pipa, 53, 56, 63, 67
Plag, 300
Plangarica, 6, 298
Platoni, 78
Plinius, 147, 150, 153
Podrimja, 28, 52, 57, 65, 67, 87, 88, 89
Popovski, 56
Poradeci, 85, 87, 88
Pott, 150
Pribac, 54, 66
Prishtina, 141, 143, 203
Prokop, 147, 151, 158
PULAHA, 134
Pullum, 300
Pușcariu, 145
Qeriqi, 166, 173
Qiriazi, 287, 288
Qosja, 52, 54, 55, 58, 67, 79, 87, 88
Ramadani, 89, 170, 89
Rauf-Bej, 261, 262 261
Rexha, 41, 70, 112, 134
Rilke, 56
Ristić, 288
Rossi, 137, 141
Rufus, 154
Rugova, 94, 108, 141
Rrahmani, 88
Samoilov, 51, 64, 65
Sathas, 113, 134
Sax, 144
SCHMIDINGE, 134
Schmitt, 205
Schulze, 148, 149, 157, 158
Schwartz, 54, 64, 67
SEDAJ, 134
SEJDIU, 134
Selimin, 168
Selimović, 52
Simić, 288
Sinani, 5, 7, 51, 62, 67, 109, 123, 131, 133, 134
SIRDANI, 134
Skënderbeu, 55, 260, 266, 272
Skok, 152
Sopaj, 5, 7, 85
Spahiu, 87, 88
SPASSE, 128, 135
Spiridonović-Savić, 56
Spitzer, 145
Stanković, 56
Stefanović, 56
Stier, 148
Stojadinović, 56
Strabo, 146, 148, 155
Streitberg, 144
Stulpāns, 52
Šufflay, 110, 144, 151, 159
Sulejmani, 17, 73, 81, 118

- Suta, 67
Sweet, 299
Syla, 161
Shala, 5, 7, 31, 178
Shannon, 172
Shehret, 113
Shkreli, 52, 81, 89
SHPUZA, 135
Taçi, 51
Tasić, 263
Taylor, 163, 181
Tepelena, 113
Tesnière, 294
Tomaschek, 146, 148, 150, 152, 157
Triandafilidi, 138, 141
Trotsky, 57
Thaçi, 51
Thalöczy, 110, 135, 157
Theophrast, 150
Thumb, 151
Ujkani, 89
Ungaretti, 54
Utley, 181
Vasiljev, 288
Vasmer, 150
Velimirović, 56
Verković, 112
Vrečko, 60, 67
Vukasović, 56
Wackernagel, 153
Watson, 163, 181
Weaver, 172
Weigand, 144
Xenophon, 150
Xoxa, 87, 88
Xhaferi, 61, 67
Xhemajli, 167, 168, 173
XHUFİ, 135
ZEMON, 135
Zeqo, 88
ZIAGKOS, 135
Županić, 159
Zvicer, 51
Zhenet, 173
Zhiti, 161
Zhitia, 165
Zhupançiq, 41, 41
Кемал, 111
Троцкий, 57, 68

STUDIME

23

2016

Botues:

AKADEMIA E SHKENCAVE DHE E ARTEVE E KOSOVËS

Redaktor teknik:

ASHAK

Realizimi kompjuterik:

ASHAK

Madhësia:

19.44 tabakë shtypi

Tirazhi:

200 copë

Formati:

16x24 cm

U shtyp në shtypshkronjën:

Focus Print

Shkup